

POLIS

NR 7/2008

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE

Bordi Editorial

Prof. As. DR. ROMEO GURAKUQI, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

Dr. ERMAL HASIMJA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

Dr. LEA YPI, *Universiteti i Oksfordit, Britani e Madhe*

ENIS SULSTAROVA, *Universiteti i Durrësit*

Prof. Dr. FATOS TARIFA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

Dr. SHANNON WOODCOCK, *La Trobe University, Melburn, Australi*

Kryeredaktor

BLENDI KAJSIU

Universiteti European i Tiranës (UET)

Redaktor

HENRI CILI

Universiteti European i Tiranës (UET)

ELDA PAPA

Universiteti European i Tiranës (UET)

Assitent-Redaktor

BLERIANA BINO

Universiteti European i Tiranës (UET)

Arti grafik

KLEIDA MALUKA

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË

Bulevardi "Gjergj Fishta" / www.uet.edu.al / info@uet.edu.al



përmbajtja

<i>Fundi i iluzioneve mbi “fundin” e hegjemonisë Amerikane</i> PROF. DR. FATOS TARIFA	3
<i>Kufizimet e demokratizimit të imponuar: Qeverisja demokratike, Shteti dhe OJF – të në Rumani</i> ANTOINE HEEMERYCK	28
<i>Në shërbim të imperializmit informal: Instrumente të politikës Austro-Hungareze ndaj Shqipërisë</i> DR. KURT GOSTENTSCHNIGG	40
<i>Vartësia paradoksale e globalizmit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut</i> AURORA GUXOLLI	63
<i>Marrëdhëniet Shqiptaro – Gjermane 1987 - 2007</i> PROF. DR. PASKAL MILO	80
<i>Ballkani përëndimor dhe shkaqet historike të destabilizimit të tij</i> KLODJANA BESHIKU	93
<i>Politika e jashtme e Rusisë: Në kërkim të identitetit</i> ENRI HIDE	109
<i>Strategjia e re e Bashkimit Evropian për zgjerimin</i> ASS. PROF. DONATOS PAPAGIANI	121
<i>Shfaqja e antropologjisë heroike në historinë e ideve</i> PROF. ALBERT DOJA	131
<i>RECENCA</i>	
<i>Fatos Tarifa: Kërkimi i legjitimitetit dhe venitja e utopisë</i> BLENDI KAJSIU	149

Fundi i iluzioneve mbi “fundin” e hegjemonisë Amerikane

Prof. Dr. Fatos Tarifa

ABSTRAKT. Në dritën e zhvillimeve ndërkombëtare të viteve të fundit, të cilat kanë precipituar me ngjarjet tragjike të 11 shtatorit 2001 dhe fillimin luftës në Irak në pranverë të vitit 2003, është me interes të analizojmë strukturën e sistemit të sotëm të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe rolin e fuqive të mëdha në këtë sistem. Duke u fokusuar në strukturën e sistemit global të sotëm dhe duke e kontekstualizuar trajtimin e çështjes historikisht dhe gjeopolitikisht, analiza e mëposhtme synon të ndihmojë për të kuptuar më mirë dinamikën e marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare dhe natyrën e sistemit global që do të karakterizojë shekullin e 21-të.

“Polariteti” si koncept

Është veçse e natyrshme që kjo trajtesë të nisë me një analizë të shkurtër të koncepteve “pol” dhe “polaritet”, të cilët përdoren gjerësisht në analizat e sistemeve të marrëdhënieve ndërkombëtare. Këta koncepte nënkuptojnë se brenda një sistemi të caktuar marrëdhëniesh, një apo disa aktorë janë kaq të rëndësishëm sa ata përbëjnë një “pol”, apo “pole”, ndaj të cilit (apo ndaj të cilëve) aktorë të tjerë reagojnë apo kundërveprojnë ose duke u bashkuar në koalicion me to, ose duke qëndruar më vete, ose duke u bashkuar me njëri-tjetrin për të kundërbalancuar peshën e “aktorit polar”.

Aktorët që dominojnë një sistem marrëdhëniesh ndërkombëtare mund të jenë shtete të veçantë ose edhe një bllok apo koalicion shtetesh. Në një sistem historikisht të përcaktuar marrëdhëniesh ndërkombëtare konsiderohet “aktor polar” ai shtet apo koalicion shtetesh, i cili është kaq i rëndësishëm sa *largimi* apo *hyrja* e tij në sistem do të ndryshonte strukturën arkitekturale të vetë sistemit ndërkombëtar. Në të kaluarën, hyrja apo largimi i vendeve të veçantë me statusin e një fuqie polare në sistemin ndërkombëtar ka ndodhur kryesisht si pasojë e luftërave—luftërat napoleonike, Lufta

^{<2>} Fatos Tarifa, sociolog, studiues i shkencës politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, filozof dhe diplomat, pedagog në Universitetin Europian të Tiranës.

e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore apo Lufta e Ftohtë. Statusi i një fuqie polare, apo i çdo vendi të veçantë, në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare përcaktohet nga katër komponentë esenciale: (1) fuqia *politike*, (2) fuqia *ekonomike*, (3) fuqia *ushtarake* dhe (4) fuqia *teknologjike*. Nisur nga ky përcaktim, historia botërore njih tri tipe sistemesh të marrëdhënieve ndërkombëtare: sistemin *shumëpolar (multipolarity)*, sistemin *dypolar (bipolarity)* dhe sistemin *njëpolar (unipolarity)*.

Sistemi shumëpolar përfaqëson tipin e një strukture sistemi marrëdhëniesh ndërkombëtare, në të cilin predominojnë të paktën tri “pole”, apo tri “aktorë polarë”. Një sistem shumëpolar tipik ka qenë ai që ka mbizotëruar në Europë gjatë shekullit të 19-të dhe në gjysmën e parë të shekullit të 20-të. Sistemi dypolar zakonisht nënkupton sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare të periudhës së Luftës së Ftohtë, gjatë së cilës struktura e sistemit politik ndërkombëtar u konturua rreth dy “poleve”: Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Ky sistem ishte strukturuar dhe funksiononte si dypolar nga pikëpamja e *potencialit ushtarak*, e *tipit të regjimit politik*, e *formës së sistemit ekonomik* dhe e *ideologjisë sunduese*. Ai identifikohet me dy blloqe të mëdha politiko-ushtarakë—NATO dhe Traktati i Varshavës—çdonjëri prej të cilëve dominohej nga interesat, ideologjia dhe perceptimet e secilës superfuqi. Sistemi njëpolar përfaqëson një tip të tillë strukture marrëdhëniesh ndërkombëtare, në të cilin vetëm një “pol”, apo një “aktor polar”, është dhe pranohet si mbizotërues. Historikisht, sisteme njëpolarë kanë qenë ata, në të cilët rolin dominues në arkitekturën e marrëdhënieve ndërkombëtare e kanë luajtur perandoritë shumëkombëshe.

Përpara se të vazhdoj me analizën e këtij problemi dëshiroj të sqaroj një keqkuptim, të cilin e ndeshim jo rrallë në radhët e funksionarëve të lartë europianë në analizat që ata u bëjnë marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare. Shpesh dëgjon apo lexon prej tyre thirrje për një “multilaterizëm efektiv”, apo për krijimin e një “rendi botëror multipolar, të orientuar nga partneritetet”, apo për “forcimin e strukturave multipolare”, duke i përdorur termat “multipolar” dhe “multilateral” (*shumëpolar* dhe *shumëpalësh*) sikur të ishin identikë. Në fakt, termat “multipolar” dhe “multilateral” shprehin kategori të ndryshme ashtu sikurse përdorimi i tyre bëhet në nivele të ndryshme analizash. *Polariteti* është një koncept që përdoret në analiza në nivel *sistemi* dhe ka të bëjë, siç vumë në dukje më sipër, me shpërndarjen e pushtetit apo të fuqisë (siç ekziston dhe perceptohet ajo) në sistemin global të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në dallim nga ai, *unilaterizmi* apo *multilaterizmi* janë *qëndrime* që zgjedhin dhe mbajnë shtete të caktuar në politikën e tyre të jashtme në kuadër të një sistemi të dhënë marrëdhëniesh ndërkombëtare. Në parim, nuk ka asnjë arsye pse superfuqia e vetme, apo aktori i vetëm polar, në një sistem global njëpolar të mos ndjekë një politikë të jashtme multilaterale, ashtu sikurse mund të ndodhë që një fuqi e madhe në një sistem shumëpolar të ndjekë një politikë të jashtme unilaterale (Oudenaren 2004: 64).

Ekspertë dhe analistë të marrëdhënieve ndërkombëtare kanë formuluar konceptin “stabilitet hegjemonik” për të treguar pikërisht se, shumë herë, përkrahësit më të mëdhenj të një politike multilaterale janë vetë shtetet hegjemonë—Britania e shekullit të 19-të (flota e së cilës kontrollonte dhe sundonte oqeanet e botës dhe territoret e perandorisë

së saj në çdo anë të globit, në të cilat, siç thuhej atëherë, “dielli kurrë nuk perëndon”) dhe SHBA në fund të shekullit të 20-të—pasi multilaterizmi u ka shërbyer dhe u shërben si interesave të tyre kombëtare ashtu edhe stabilitetit të rendit global si një e mirë publike për të gjithë. Në të kundërt, Franca, e cila nuk ka qenë kurrë një fuqi hegjemone, ka ndjekur shumë herë, pas Luftës së Dytë Botërore, një politikë unilaterale duke kundërshtuar bashkëpunimin me fuqitë e tjera të mëdha si, për shembull, refuzimi prej saj më 1963 për të nënshkruar Traktatin mbi Ndalimin e Provave Bërthamore, kriza e “karrikes bosh” në Komunitetin Europian më 1965, refuzimi dy herë nga Franca—më 1963 dhe 1967—për të lejuar anëtarësimin e Anglisë në Komunitetin Europian,¹ largimi i Francës nga Komanda e Bashkuar e NATO-s më 1966, refuzimi prej saj për të nënshkruar Traktatin e Mospërhapjes së Armëve Bërthamore (krahas me Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Sovjetik dhe Britaninë e Madhe) më 1969, apo për t’u anëtarësuar në Agjensinë Ndërkombëtare të Energjisë me krijimin e saj në periudhën e krizës energjitike të viteve 1973-1974. Dhe ç’pamë të ndodhë në prag të luftës në Irak? Franca, e cila pothuajse gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të ka qenë një fuqi e dobët por, megjithatë, ka ndjekur thuajse vazhdimisht një politikë të jashtme unilaterale, u bë papritur vendi që filloi të moralizojë më shumë se kushdo tjetër mbi multilaterizmin kur kuptoi se Amerika, tashmë një “hyperpower”, apo një “hyperpuissance”, po të përdorim shprehjen e ish-ministrit të jashtëm francez Hubert Védrine, mund të angazhohej ushtarakisht në çdo pikë të globit pa marrë pëlqimin e Francës dhe të fuqive të tjera.

Të vesh shenjën e barazimit midis multipolaritetit dhe multilaterizmit (apo unipolaritetit dhe unilaterizmit) do të thotë të injorosh kompleksitetin e debatit mbi politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara duke e reduktuar atë në një konflikt njëdimensional midis unilateristëve dhe multilateristëve. Përderisa polariteti dhe unilaterizmi janë kategori të ndryshme analitike, vizionet mbi politikën e jashtme duhet të analizohen duke marrë në konsideratë, nga njëra anë, perceptimet e ndryshme mbi shpërndarjen e fuqisë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe, nga ana tjetër, preferencat e njëjës apo tjetër fuqi të madhe për politika unilaterale apo multilaterale (Oudenaren 2004: 64). *Përvoja historike nuk e mbështet argumentin se unilaterizmi amerikan është rezultat i sistemit të sotëm global njëpolar dhe se multilaterizmi është një kusht i domosdoshëm apo i njaftueshëm për krijimin e një sistemi të ri shumëpolar.*

Fundi i Luftës së Ftohtë, iluzionet mbi rendin e ri botëror dhe realiteti i marrëdhënieve ndërkombëtare

Shembja e sistemit komunist në Bashkimin Sovjetik, dizintegrimi i këtij shteti të fuqishëm imperial dhe i aleancës politiko-ushtarake (Traktati i Varshavës) të dominuar prej tij e prishën arkitekturën e sistemit global të krijuar pas Luftës

1 Nën drejtimin e Presidentit Charles de Gaulle, Franca vuri veton për të mos lejuar fqinjën e saj përtej Lamanshit t’i bashkohej klubit kontinental të vendeve të Europës Perëndimore. Anglia u bë anëtare e Komunitetit Europian (KE)—sot Bashkimi Europian—më 1973, pas vdekjes së Presidentit De Gaulle.

së Dytë Botërore. Të shumtë ishin ata teoricienë, ekspertë dhe analistë të marrëdhënieve ndërkombëtare në Perëndim, të cilët menduan se pas kësaj ngjarjeje epokale, e cila provoi se kapitalizmi demokratik është modeli më i suksesshëm për zhvillimin e çdo shoqërie, çdo vend do të zgjidhte eventualisht këtë model. Nga që u duk se liberalizmi kishte triumfuar përfundimisht në betejën e ideve, Francis Fukuyama formuloi tezën e famshme (tashmë të provuar si e pavërtetë), se “me mbarimin e historisë nuk kanë mbetur më konkurrentë ideologjikë seriozë ndaj demokracisë liberale” (Fukuyama 1992: 211).

Duke qenë se pas Luftës së Ftohtë e tërë bota u duk se do të konvergohte rreth parimeve të liberalizmit iluminist, shumë besuan se kjo do të bënte të mundur krijimin e një sistemi ndërkombëtar më të përsosur, të mbështetur mbi ligje dhe institucione, duke përmbushur kështu profecinë e Iluminizimit europian të formuluar qysh në shekujt e 17-të dhe 18-të. Një botë e përbërë nga vende demokratikë dhe qeveri liberale, siç e kishte përfytyruar Kanti në kohën e tij, do të ishte një botë pa luftra. Përplasja midis interesave nacionale që tradicionalisht kishin karakterizuar marrëdhëniet midis fuqive të mëdha do të ishte tashmë një gjë e së kaluarës. Një botë që e kish lënë pas Luftën e Ftohtë dhe që po globalizohej gjithnjë e më shumë do të karakterizohej këtej e tutje nga shkëmbimi i lirë i mallrave, njerëzve dhe ideve duke shënuar kështu fillimin e një epoke të re në historinë e njerëzimit, në të cilën s’do të kishte më shkaqe dhe vend për konflikt dhe luftë. Ideja e shprehur nga Montesquieu gati tre shekuj më parë se “pasojë e natyrëshme e tregtisë është se ajo çon drejt paqes” (cituar në Pangle & Ahrensdoorf 1999: 159) duket se u bë bindje e shumë analistëve liberalë. Ata besuan sinqerisht se kjo ëndërr e Iluminizimit ishte bërë tashmë e mundur dhe se me triumfin e liberalizmit në shkallë ndërkombëtare do të konvergonin edhe interesat gjeopolitike dhe strategjike të fuqive të mëdha. Martin Walker shpalli, madje, se “epoka e gjeopolitikës” kishte marrë fund duke ia lënë vendin “gjeoekonomisë”, simbolet e së cilës janë “eksportet, produktiviteti dhe ritmet e rritjes, ndërsa rolin e aktorëve të mëdhenj ndërkombëtarë e luajnë paktet tregtarë dhe superfuqitë ekonomike” (Walker 1996). Studiuesi liberal i marrëdhënieve ndërkombëtare G. John Ikenberry, e përshkruan botën e pas Luftës së Ftohtë si një realitet, në të cilin “demokracia dhe tregjet lulëzojnë anë e mbanë globit, globalizimi vazhdon si një forcë historike progresiste dhe ideologjia, nacionalizmi dhe lufta janë në tërheqje” (Ikenberry 2006).

Në fillim të viteve 1990-të dhe më pas dukej se Europa e bashkuar ofronte një “model për mënyrën se si do të organizohej bota në shekullin e 21-të” (Mandelbaum 2002: 374). Sipas studiuesit dhe diplomatit Robert Cooper, Europa po e udhëhiqte botën në një “epokë postmoderne”, në të cilën interesat kombëtare të shteteve dhe politika e fuqisë do ua linin vendin të drejtës ndërkombëtare, institucioneve supranacionale dhe “sovrانيتetit në ortakësi” (*pooled sovereignty*). Ndarjet kulturore, etnike dhe nacionale të së kaluarës do ua linin vendin vlerave dhe interesave ekonomike të përbashkëta. Ky autor, madje, e sheh zgjerimin e Bashkimit Europian si një proces që çon në krijimin vullnetarisht të një perandorie, e cila, ndryshe nga perandoritë e së kaluarës që impononin ligjet dhe sistemet e tyre qeverisëse, “nuk detyron asgjë” nga që kombet e dëshirojnë vetë bashkimin e tyre në këtë “perandori kooperuese [të Bashkimit Europian]... të dedikuar lirisë dhe demokracisë” (Cooper 2002).

Në dallim nga liberalët, teoricienë dhe ekspertë realistë të marrëdhënieve ndërkombëtare, në përgjithësi, nuk ushqyen iluzione dhe shpresa mbi ndonjë ndryshim rrënjësor në natyrën e marrëdhënieve ndërmjet fuqive të mëdha. Henry Kissinger, më i shquari ndër realistët e gjeopolitikës, ashtu si Hans Morgenthau pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore,¹ tërhiqte vëmendjen se rrethanat e krijuara pas mbarimit të Luftës së Ftohtë nuk do të zgjasnin për shumë kohë dhe se konkurenca dhe gara midis fuqive të mëdha, si pjesë e natyrës njerëzore, do të riktheheshin. Robert Kagan e formulon këtë ide duke u shprehur se dy dekadat e fundit kanë dëshmuar “jo një transformim” të marrëdhënieve ndërmjet fuqive të mëdha, por “thjesht një pauzë në konkurrencën e përhershme midis kombeve dhe popujve” (Kagan 2008: 11).

Shumë ekspertë dhe analistë besuan që nga fillimi—dhe vazhdojnë të besojnë—se “vakumin” që krijoi rënia e Bashkimit Sovjetik si superfuqi do ta zinin aktorë të tjerë polarë, si Gjermania (tashmë e bashkuar) apo Bashkimi Europian, Japonia, Kina, India dhe Rusia—të gjitha si fuqi të barabarta—duke krijuar kështu një sistem global shumëpolar, apo një “koncert” të ri të fuqive të mëdha, pak a shumë si ai që kishte ekzistuar para Luftës së Parë Botërore. Sidoqoftë, rolet e “aktorëve” në skenën e politikës globale nuk përcaktohen dhe nuk ndahen sipas dëshirës, orekseve apo perceptimeve të tyre. Ata janë rezultat i ndryshimeve objektive që ndodhin në strukturën e sistemit global të marrëdhënieve ndërkombëtare, ndryshime këto, të cilat përcaktohen nga zhvendosja e “pllakave tektonike” të planetit, apo nga rishpërndarja dhe ripërqëndrimi i potencialeve politikë, ushtarakë, ekonomikë dhe teknologjikë në plan rajonal dhe, sidomos, në plan global.

Duke analizuar situatën e re që po kristalizohej menjëherë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, Charles Krauthammer formuloi për të herë të parë pikëpamjen se sistemi i ri global do të ishte *njëpolar* dhe se Shtetet e Bashkuara do të ishin në atë *fin de siècle* dhe do të mbeteshin për një kohë të gjatë në shekullin e 21-të superfuqia e vetme (*the sole superpower*). E shprehur për herë të parë më 18 shtator 1990, në një leksion të mbajtur në Uashington, D.C., teza mbi sistemin global njëpolar u shtjellua më tej prej tij në një artikull të titulluar “Momenti njëpolar” (*The Unipolar Moment*), i cili, i botuar në dhjetor të atij viti në revistën *Foreign Affairs*, vazhdon të jetë edhe sot një ndër artikujt më të cituar në literaturën mbi marrëdhëniet ndërkombëtare. Krauthammer shkruante:

Është supozuar se bota e vjetër dypolare do t’ia lërë vendin një bote shumëpolare, në të cilën fuqia do të shpërndahet në qendra të reja si Japonia, Gjermania (dhe/ose “Europa”), Kina dhe një Bashkim Sovjetik i reduktuar/Rusia....[Ky supozim është] i gabuar. Bota e krijuar pas Luftës së Ftohtë nuk është shumëpolare. Ajo është njëpolare. Qendra e fuqisë botërore është superfuqia e pasfiduar, Shtetet e Bashkuara, e shoqëruar nga aleatët e saj perëndimorë (Krauthammer 1990/91: 23).

¹ Pas fitores mbi Nazizmin në Luftën e Dytë Botërore, një tjetër moment në histori kur shpresat për një lloj të ri rendi ndërkombëtar ishin të mëdha, Hans Morgenthau paralajmëronte që të bëhej kujdes nga iluzionet se pas ca kohe “perdja do të ullej për t’i dhënë fund një herë e përgjithmonë lojës së politikës së fuqive” (Morgenthau 1948: 20).

Pavarësisht iluzioneve të shumë ekspertëve dhe analistëve liberalë apo realistë të marrëdhënieve ndërkombëtare që shoqëruan mbarimin e Luftës së Ftohtë, fundi i saj provoi se Amerika nuk kishte atëherë—dhe nuk do kishte për një kohë relativisht të gjatë—asnjë rival që ta konkuronte atë në asnjë nga komponentët që përcaktojnë statusin e një fuqie polare. Disa analistë, madje, kanë vlerësuar se pas mbarimit të Luftës së Ftohtë Amerika u gjend në një pozitë të tillë të fuqishme, e cila nuk ka pasur precedent që nga koha e Perandorisë Romake (Walt 2002: 9).¹ Sidoqoftë, që nga mbarimi i Luftës së Ftohtë, ekspertë të politikës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare ka kohë që shtrojnë pyetje; A karakterizohet bota e sotme njëpolare nga mungesa e politikës së stilit të vjetër të balancës së pushteteve? A është sistemi i sotëm njëpolar më i stabilizuar dhe më pak konfliktual se sistemi dy-polar apo ai shumë-polar? A mundet Amerika të vazhdojë të ruajnë statusin e saj si superfuqi e vetme për një kohë të gjatë? A është sistemi i sotëm njëpolar një “iluzion”, një “moment” që nuk do të zgjasë për shumë kohë, apo që gradualisht po transformohet, apo do të transformohet, në një sistem dy- apo shumë-polar? Apo, mos vallë sistemi i sotëm ndërkombëtar është shndërruar tashmë, siç thotë Samuel Huntington (1999), në një sistem “një-shumë-polar” (*uni-multipolar*), i cili mund të kuptohet si një periudhë e shkurtër tranzicioni drejt krijimit të një sistemi të mirëfilltë shumë-polar? Analiza që vijon është një përpjekje për t’u dhënë përgjigje pikërisht këtyre pyetjeve

Përse nuk dëgjohet “muzika” e “koncertit të fuqive të mëdha” apo e “koncertit të demokracive”?

Pikëpamja mbi strukturën njëpolare të sistemit të sotëm global ka pasur dhe vazhdon të ketë përkrahës por edhe kundërshtarë të shumtë. Ndër përkrahësit më entuziastë të saj janë autorë të tillë të njohur si Charles Krauthammer, William Wohlforth, Robert Kagan, Walter Laqueur, Stephen Brooks, Stephen Walt e të tjerë. Kundërshtarë të saj kanë qenë dhe mbeten Samuel Huntington, Kenneth Waltz, Pierre Hassner, Charles Kupchan, Martin Walker, David Hendrickson etj. Në një artikull shumë të diskutuar me titull “Superfuqia e vetmuar” (*The Lonely Superpower*), botuar në revistën *Foreign Affairs* më 1999, Huntington e përkufizon sistemin njëpolar si një konstelacion të tillë të marrëdhënieve ndërkombëtare në të cilin ka “një superfuqi, asnjë fuqi të madhe të rëndësishme dhe shumë fuqi të vogla”. Në një sistem të tillë, sipas tij, superfuqia e vetme do të ishte në gjendje të “zgjidhte problemet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe asnjë kombinim shtetesh të tjerë nuk do ishte në gjendje që ta detyronte atë të mos vepronte”. Meqënëse, sipas tij, Amerika nuk është në gjendje të zgjidhë e vetme problemet e mëdha ndërkombëtare të kohës sonë, kjo do të thotë, arsyeton Huntington, se ajo nuk mund të konsiderohet e vetmja superfuqi dhe se sistemi i sotëm global nuk është një sistem njëpolar, por mund të quhet një sistem “një-shumë-polar” (*uni-multipolar*).

¹ Mbi pozitën dominuese të Shteteve të Bashkuara pas mbarimit të Luftës së Ftohtë shih gjithashtu Wohlforth (1999) dhe Nye (1990).

Pikëpamjen e tij e kanë kritikuar shumë analistë të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilët venë në dukje se ndërsa Amerika nuk është një fuqi omnipotente, e gjithëfuqishme, e cila mund të zgjidhë e vetme të gjitha problemet e botës, ajo është, sidoqoftë, *e vetmja fuqi e madhe pa të cilën nuk mund të zgjidhet asnjë problem i rëndësishëm në kohën tonë*. Stephen Brooks dhe William Wohlforth me të drejtë vërejnë se “në qoftë se supremacia e sotme amerikane nuk e bën sistemin [e marrëdhënieve ndërkombëtare] njëpolar, atëherë asgjë tjetër nuk mund ta bëjë atë “njëpolar” (Brooks & Wohlforth 2002: 21).

Pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme që ekzistojnë mbi natyrën e sistemit të sotëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, vështirë se mund të mohohet se Amerika mbetet superfuqia e vetme në kohën tonë. Sidoqoftë, edhe pse ajo është në gjendje të ushtrojë një influencë të jashtëzakonshme mbi zhvillimet e sotme në mbarë globin, fuqia e saj nuk është absolute. *Amerika vërtet nuk ka nevojë t’u marrë leje për të vepruar as Europës as fuqive të tjera, por që të ketë sukses ajo ka nevojë për mbështetjen e tyre*.

Nuk ka dyshim se shtete të tjerë janë gjithashtu mjaft të fuqishëm sa të ushtrojnë influencën e tyre në zhvillimet politike në rajone të caktuara apo në shkallë globale, edhe pse në krahasim me Amerikën ata mbeten fuqi të rangut të dytë. Japonia dhe Gjermania, për shembull, janë fuqi të mëdha ekonomike (e dyta dhe e treta fuqi ekonomike në botë, respektivisht, pas Amerikës). Anglia dhe Franca mund të projektojnë influencë diplomatike në rajone të veçanta të globit dhe, në një farë mase, edhe fuqinë e tyre politike dhe ushtarake. Rusia ka ruajtur disa elementë si fuqi e madhe ushtarake dhe gjatë viteve të fundit duket se është në gjendje të projektojë një influencë të madhe ekonomike, politike dhe diplomatike. Kina dhe India po shndërrohen me ritme të shpejta në fuqi të mëdha ekonomike dhe janë bërë, në mënyrë të paevitueshme, rivalë për përparësi gjeopolitike në Azi. Sidoqoftë, përveç ndikimit të tyre (veçanërisht të Kinës) në ekonominë, sistemin financiar dhe tregun botëror, as njëra as tjetra nuk janë në gjendje akoma të projektojnë ndonjë influencë politike dhe diplomatike të konsiderueshme përtej rajonit të Azisë dhe të Pacifikut.

Ndër fuqitë e mëdha të kohës sonë vetëm Amerika ka dhe vazhdon të ruajë të gjitha tiparet e një shteti hegjemon, i cili është në gjendje të projektojë fuqinë e vet ekonomike, ushtarake, politike, diplomatike dhe teknologjike në të katër anët e globit. Siç ka venë në dukje Francis Fukuyama në një artikull të botuar dy vjet më parë në revistën *The American Interest*,

Pesha *de facto* e Shteteve të Bashkuara në skenën globale ka krijuar një mungesë balance inherente. Shtetet e Bashkuara mund të ushtrojnë ndikimin e tyre në shumë vende të botës, ndërkohë që asnjë prej tyre nuk është në gjendje të influencojë në të njëjtën masë mbi Shtetet e Bashkuara. Kjo është absolutisht e qartë në fushën ushtarake, në të cilën Shtetet e Bashkuara mund të ndryshojnë relativisht lehtë regjime [në vende që janë] 8000 milje larg (Fukuyama 2006: 7).

Ekspertë të marrëdhënieve ndërkombëtare ndahen kur vjen fjala për të vlerësuar qendrueshmërinë e sistemit të sotëm njëpolar. Disa prej tyre, të cilët i përmbahen pikëpamjes

realiste se politika ndërkombëtare është një luftë Hobbesiane për pushtet, mendojnë se me daljen në skenë të fuqive të reja dhe me “mbylljen pak nga pak të ombrellës amerikane”, “njëpolariteti” po ia lë—ose shpejt do t’ia lërë—vendin një sistemi tjetër, në të cilin “pushteti dhe influenca do të jenë të shpërndarë në mënyrë më të barabartë” (Kupchan 1999). Sipas tyre, sistemi aktual njëpolar mund të sfidohet dhe të zëvendësohet nga një sistem shumëpolar, apo nga një “koncert” i fuqive të mëdha, nëse Europa dhe Azia Lindore i shkëputen varësisë së theksuar nga Amerika dhe krijojnë kundërpesha ndaj këtij shteti të vetëm hegjemon. Askush nuk e ka artikuluar më qartë një pikëpamje të tillë se Josef Joffe, edhe pse vetë ky autor, kohët e fundit duket se nuk i përmbahet më asaj. Sipas tij,

Librat e historisë tregojnë se Mr. Big gjithnjë inkurajon fundin e tij. Numrat 2, 3 dhe 4 do të bashkohen kundër tij, do të formojnë aleanca kundërvepruese dhe do të komplotojnë shkatërrimin e tij. Kjo ndodhi me Napoleonin, siç ndodhi edhe me Luigjin e 14-të dhe me perandorinë e madhe të Hapsburgëve, me Hitlerin dhe me Stalinin. Fuqia shkakton kundërfuqi më të madhe; ky është rregulli më i vjetër i politikës botërore” (cituar në Brooks & Wohlforth 2002: 24).

Dekada e fundit e shekullit të 20-të, sidoqoftë, nuk prodhoi asnjë ngjarje që t’u shërbente si evidencë mbrojtëse të kësaj pikëpamjeje. Gjatë asaj dekade distanca që ndan Amerikën nga të gjitha fuqitë e tjera të mëdha u rrit edhe më shumë, duke i bërë më të spikatura tiparet e sistemit njëpolar (Krauthammer 2002/03: 6). Ekspertë dhe analistë kinezë të politikës ndërkombëtare e karakterizonin sistemin global në vitet e fundit të administratës së Presidentit Bill Clinton jo si një botë shumëpolare, siç kishin shpresuar se do të bëhej ajo pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, por si një botë në të cilën “superfuqia [e vetme] është më super dhe fuqitë e shumta të mëdha janë më pak të mëdha” (Chen 2003: 287).

Lufta në Irak dhe rënia, gjatë viteve të fundit, e popullaritetit të Amerikës thuhet se në çdo rajon të botës, përfshirë edhe vendet aleate të saj në Europë, duket se e ka përtërirë zellin me të cilin shumë autorë përpiqen të argumentojnë se bota e sotme po bëhet shumëpolare. Kështu, për shembull, Peter Peterson, në një artikull të botuar pak kohë më parë në revistën *The National Interest*, shtronte pyetjen: “A do t’i zëvendësojnë vende të tjerë Shtetet e Bashkuara në rolin e liderit botëror?”. Vetë ky autor i përgjigjet pyetjes së mësipërme në këtë mënyrë:

Ne po shkojmë gjithnjë e më shumë drejt një bote shumëpolare, në të cilën roli i Shteteve të Bashkuara do të bjerë, në terma relativë, përballë fuqive tradicionale (kryesisht Europa) dhe veçanërisht fuqive të reja që po ngrihen (kryesisht Kina) (Peterson 2007: 21).

Një tjetër autor i njohur, Pierre Hassner, i Fondacionit Nacional për Shkencën Politike në Paris, në një artikull botuar jo shumë kohë më parë në revistën: *The American Interest*, shtron pyetjen: “A është vendosur se cili do të jetë fati i këtij shekulli?”. “Po”, përgjigjet ai, “nëse me këtë ne kuptojmë se nuk do të ketë më kthim mbrapa në

një sistem njëpolar të hegjemonisë amerikane dhe, për rrjedhojë, [të hegjemonisë] perëndimore” (Hassner 2007: 37).

Një “koncert” i fuqive të mëdha në kohën tonë, sipas shumicës së autorëve realistë, do të përfshinte fuqitë e mëdha të konsoliduara të globit si edhe fuqitë e reja që po ngrihen—me fjalë të tjera, Shtetet e Bashkuara, Europën, Rusinë, Kinën, Indinë dhe Japoninë (Haass 2005; Lind 2006; Lieven & Hulsman 2006). Autorë të tjerë sugjerojnë se vende të tillë si Kina, India, Russia dhe Brazili—të njohura në zhargonin politik vitet e fundit si një grup vendesh me akronimin BRIK (Brazil, Rusi, Indi dhe Kinë)¹—janë në prag të arritjes së statusit të fuqive të mëdha dhe se shumë shpejt ata do të sfidojnë liderшипin ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara. Sipas tyre, këto fuqi të reja po krijojnë një “sistem alternativ” në politikën globale, apo një “arkitekturë institucionale alternative”, e cila as nuk do të konfrontohet me Perëndimin, as do të asimilohet prej tij. Ky “rend” i ri botëror, të cilin e quajnë “një botë pa Perëndimin” (*a world without the West*), synon, sipas tyre, ta shndërrojë Perëndimin, veçanërisht Amerikën, në një faktor gjithnjë e më pak të rëndësishëm në politikën globale, duke e zhvendosur qendrën e gravitetit nga Perëndimi në vendet kryesisht aziatike që po mëkëmben (Barma *et al.* 2007: 23).

Një pikëpamje e tillë, natyrisht, ekzagjeron mundësitë që kanë vendet BRIK për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Së pari, me përjashtim të Rusisë, tre vendet e tjerë nuk kanë as resurset e domosdoshme natyrore që do të mundësonin diversifikimin e ekonomive të tyre nacionale. Së dyti, autorët që mbrojnë një pikëpamje të tillë “harrojnë” se suksesi ekonomik i Brazilit, Indisë dhe Kinës varen, në një masë të madhe, nga zgjerimi i marrëdhënieve të tyre tregtare me shtete më të zhvilluar, sidomos me Shtetet e Bashkuara, Japoninë dhe vendet e Bashkimit Europian. Së treti, ekonomitë në rritje të vendeve BRIK përfitojnë nga stabiliteti i ekonomisë në shkallë botërore dhe nga institucionet ndërkombëtare ekonomike dhe financiare ekzistuese dhe, për këtë arsye, ata nuk janë të interesuar t’u kundërvihen atyre për të krijuar një “arkitekturë institucionale alternative”. Për më tepër, lëkundjet në stabilitetin ekonomik dhe krizat apo gjysëmkrizat që mund të pësojë ekonomia e Shteteve të Bashkuara apo ekonomia europiane nuk mundet veçse të kenë efekte tronditëse për ekonominë në shkallë globale, pra edhe për ekonomitë e vendeve BRIK.

Ideja mbi krijimin e një “koncerti” të ri në kohën tonë, në të cilin Amerika, Europa, Kina, Rusia dhe fuqi të tjera të mëdha do të krijonin një farë kondominiumi ndërkombëtar, nuk ka gjasa të materializohet. Robert Kagan me të drejtë vë në dukje dallimet që ekzistojnë në fillim të shekullit të 21-të nga periudha të mëparshme historike. Ai shkruan:

“Koncerti Europian i fillimit të shekullit të 19-të veçoi nën ombrellën e një moraliteti të përbashkët dhe të parimeve të njëjta të qeverisjes. Ai synonte jo vetëm të ruante paqen në Europë por edhe, madje më shumë akoma, të mbronte rendin monarkik dhe aristokratik

1 Termi “BRIC” u përdor për herë të parë nga një grup ekonomistësh të bankës amerikane të investimeve dhe sigurimeve globale Goldman Sachs, në një raport të publikuar prej tyre në tetor 2003.

kundër ndryshimeve liberale dhe radikale që kishin paralajmëruar revolucionin francez dhe ai amerikan si edhe jehona e tyre në Gjermani, Itali dhe Poloni...Sot ekziston fare pak sens i një moraliteti dhe vlerash të përbashkëta midis fuqive të mëdha. Në vend të tij ekzistojnë dyshimi, një armiqësi në rritje dhe pikëpamja jo e pabazuar në radhët e vendeve autokratike se demokracitë, pavarësisht nga sa thonë, do ta dëshironin përmbysjen e tyre. Çdo koncert me pjesëmarrjen e këtyre shteteve do të krijohet mbi një bazë të lëkundshme, e cila do të shembet që me provën e parë serioze” (Kagan 2008: 77-78).

Një pikëpamje gjerësisht e përhapur në ditët tona është ajo, sipas së cilës, për shkak të dobësisht relativ të influencës së Shteteve të Bashkuara në arenën globale dhe mungesës së institucioneve ndërkombëtare efektive (përfshirë këtu, në radhë të parë, Organizatën e Kombeve të Bashkuara), ka ardhur koha të krijohen struktura të reja multilaterale, të cilat do të kishin autoritetin dhe legjitimitetin e nevojshëm të autorizonin ndërhyrjen kolektive në ata rajone dhe në ato situata që do të gjykoreshin të domosdoshme për të ruajtur (apo rivendosur) paqen dhe sigurinë. Një strukturë e tillë mendohet se mund të jetë një “aleancë e shteteve demokratike” (Fukuyama 2006; Daadler & Lindsay 2007; Kagan 2008), e konceptuar si *Liga e Kombeve* për të cilën fliste Immanuel Kant më shumë se 200 vjet më parë,¹ apo një “Koncert i Demokracive”, synonte të bashkonte në “një institucion të vetëm” demokracitë e konsoliduara të botës (nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja tek India dhe Japonia, nga Brazili dhe Argjentina te Botswana dhe Afrika e Jugut, nga Finlanda dhe Spanja tek Australia dhe Zelanda e Re), si shtetet më të aftë nga pikëpamja e potencialit ushtarak, e kapacitetit ekonomik dhe e peshës politike për të vepruar së bashku në të mirë të paqes dhe të sigurisë kolektive (Daadler & Lindsay 2007: 6, 9).

Edhe pse ideja për të organizuar demokracitë liberale të botës (rreth 60 të tilla në kohën tonë) në një “Koncert të Demokracive” duket një zgjidhje gati ideale për t’iu përgjigjur realiteteve të reja dhe sfidave të shekullit të 21-të, një pikëpamje e tillë mund të duket utopike, veç të tjerash edhe sepse ajo nënvlerëson influencën dhe rolin që luajnë në skenën e politikës globale shtetet jodemokratike apo regjimet autoritariste, si Kina, Arabia Saudite, Pakistani, Irani (po Rusia?) etj., të cilët, të marrë së bashku, kanë më shumë se gjysmën e popullsisë së planetit. Përveç kësaj, historia ka treguar se pavarësisht vlerave të përbashkëta që kanë, demokracitë jo gjithmonë bashkëpunojnë me njëra-tjetrën. Kjo është e vërtetë veçanërisht sot, kur, siç shkruan Kagan (2008: 4), “mungesa e unitetit i ka dobësuar dhe de-

¹ Në esenë e tij të famshme *Paqja e përherëshme (Perpetual Peace)* (1790 [1795]), Kanti bënte fjalë për krijimin e një “lige të një lloji të veçantë, e cila mund të quhet një ligë e paqes (*foedus pacificum*) dhe që do të dallohej nga një traktat paqeje (*pactum pacis*)” për shkak se ndërsa një traktat paqeje i jep fund një lufte të caktuar, një ligë e paqes (e formuar me pjesëmarrjen e “republikave kushtetuese”) do të mund “t’u jepte fund përgjithmonë të gjitha luftrave” dhe të ruante “sigurinë dhe lirinë” e të gjithë shteteve anëtarë të saj. Kanti besonte se ndërsa autoritarizmi është burim luftrash, demokracia mundëson vendosjen dhe ruajtjen e paqes. Ky ide kantiane u bë dhe vazhdon të jetë baza e teorisë liberale të “paqes demokratike”, e formuluar midis viteve 1970-të dhe 1990-të (Doyle 1982; 1995; Russett 1993). Ideja qendrore e kësaj teorie është se demokracitë liberale nuk luftojnë me njëra-tjetrën dhe, prandaj, mënyra më e sigurt për të krijuar një botë paqësore është krijimi dhe konsolidimi i sa më shumë shteteve demokratikë.

moralizuar demokracitë”. Me strukturën që ka sistemi i sotëm global, “muzika” që mund të prodhonte një “Koncert i Demokracive”, po të perifrazojmë një shprehje nga Mark Twain mbi muzikën e Vagnerit, do të ishte “jo aq e mirë sa tingëllon”.

Sa i qëndrueshëm, paqësor dhe i dëshirueshëm është sistemi i sotëm njëpolar?

Nëse i lëmë mënjanë retorikën dhe arsyetimet hipotetike dhe u referohemi fakteve, mund të themi se sistemi i sotëm njëpolar, i mishëruar në hegjemoninë amerikane, është i qëndrueshëm dhe do të vazhdojë të ruhet për një kohë të gjatë. Amerika ka sot një superioritet më të madh ndaj shtetit më të fuqishëm që vjen pas saj, apo ndaj të gjitha fuqive të mëdha të kohës të marra së bashku, se ç’ka pasur ndonjëherë ndonjë fuqi e madhe e vetme ndaj fuqive të tjera të mëdha gjatë tre shekujve të fundit (Wohlforth 1999: 7; Brooks & Wohlforth 2002: 21-23). Paul Kennedy, i cili në librin e tij shumë të cituar *Ngritja dhe rënia e fuqive të mëdha* (*The Rise and Fall of the Great Powers*), botuar më 1987, predikonte rënien e fuqisë amerikane, 15 vjet më vonë, më 2002, detyrohej të pranonte se:

Asgjë e ngjashme me këtë akumulim disproporcional të fuqisë amerikane nuk ka ekzistuar deri më sot. Perandoria Charlemagne u shtri vetëm në pjesën perëndimore të Europës. Perandoria Romake pati një shtrirje territoriale shumë më të gjerë, por në të njëjtën kohë me të ekzistonte edhe një perandori tjetër e madhe, ajo e Persisë, dhe një tjetër perandori më e madhe akoma në Kinë. Për këtë arsye asnjë krahasim nuk mund të bëhet (Kennedy 2002).

Shpenzimet ushtarake të Amerikës janë sot më të mëdha se ato të njëzet shteteve që vijnë pas saj të marrë së bashku. Forcat ushtarake detare, ajrore dhe kapacitetet për kontrollin e hapësirës që posedon SHBA-ja nuk rivalizohen nga asnjë shtet i veçantë apo grup shtetesh. Me fjalë të tjera, Amerika ka një supremaci të padiskutueshme në tokë, në ajër dhe në dete. Teknologjia amerikane gjithashtu është, sot për sot, e paarritshme. Asnjë fuqi tjetër në kohën tonë nuk mund të krahasohet me Shtetet e Bashkuara në aplikimin e teknologjive më të avancuara të informacionit dhe të komunikimit për nevoja ushtarake, çka ka bërë që Amerika të mos ketë asnjë rival përsa i përket aftësisë për të koordinuar dhe përpunuar informacionin mbi fushën e betejës dhe për të shkatërruar objektiva nga një distancë e largët dhe me një precizion të jashtëzakonshëm. Amerika po e bën gjithnjë e më të vështirë për fuqitë e tjera që të konkurojnë me të në këtë aspekt për shkak se shpenzimet e saj për studim dhe zhvillim (*research and development—R&D*) në fushën ushtarake janë tre herë më të mëdha se ato të gjashtë fuqive të tjera të mëdha që vijnë pas saj të marra së bashku. Asnjë shtet në historinë moderne të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk ka dominuar në këtë mënyrë mbi shtetet e tjerë si Amerika. Dhe pavarësisht problemeve dhe shpenzimeve të jashtëzakonshme ushtarake në Irak dhe në

Afganistan, barra e shpenzimeve ushtarake amerikane është veçse pak më e madhe se 4 përqind GDP-së së Shteteve të Bashkuara (Schmitt 2007). Siç shkruan Paul Kennedy (2002), “Të jesh Numri Një me një kosto të lartë është një gjë; por të jesh superfuqia e vetme e botës me një kosto të ulët është e habitshme”.

Ka autorë, të cilët mendojnë se edhe pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, nga e cila ajo doli e humbur, “Rusia nuk ka marrë fund si një fuqi e madhe” dhe se ajo disponon si *vullnetin*, ashtu edhe *mundësitë* për t’u rikthyer në skenën globale me statusin e një superfuqie (Dibb 2006: 78). Gjatë tre vjetëve të fundit Rusia e ka rritur buxhetin e saj të mbrojtjes mbi 20 përqind, duke shpenzuar për këtë sektor më shumë se çdo shtet tjetër në botë përveç Amerikës dhe Kinës (Kagan 2008: 15). Sipas burimeve zyrtare ruse, aktualisht Rusia shpenzon 4 përqind të GDP-së së saj për mbrojtje. Kjo përqindje është shumë me e lartë se ajo e çdo vendi të industrializuar dhe e barabartë me përqindjen e buxhetit të mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara në raport me GDP-në e këtij vendi.¹ Por, nëse përqindja për të dy vendet është afërsisht e njëjtë, ajo çfarë përfaqëson kjo përqindje në shifra absolute është shumë e ndryshme po të krahasojmë GDP-në e Shteteve të Bashkuara (13.21 triliard në vitin 2006) me atë të Rusisë (733.6 miliard po në të njëjtin vit).² Me një GDP 18 herë më të vogël se ajo e Shteteve të Bashkuara (më të vogël se gjysma e GDP-së së Kalifornisë, apo të barabartë me GDP-në e shtetit të Nju Jorkut), Rusia ka, pra, një buxhet mbrojtjeje 18 herë më të vogël se ai i Shteteve të Bashkuara.

Pavarësisht pikëpamjes gjerësisht të përhapur në radhët e realistëve amerikanë apo të neogolistëve francezë se bota e sotme po bëhet shumëpolare dhe se skena botërore shumë shpejt mund t’i ngjajë asaj të një “koncerti” të fuqive të mëdha, si në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, realiteti i sotëm nuk e konfirmon këtë. Edhe nëse struktura e sotme njëpolare e globit tonë do të zëvendësohet nga një “koncert” i ri i fuqive të mëdha, ajo nuk mund t’u ngjajë “koncerteve” historikisht të njohur deri më sot në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në “koncertet” e mëparshëm, fuqitë e mëdha kanë qenë aktorë thuajse të barabartë me njëri-tjetrin, ndërsa statusi i sotëm i Shteteve të Bashkuara ndryshon shumë nga ai i një fuqie të madhe “të barabartë” me fuqitë e tjera. Amerika nuk mund të konsiderohet një *primus inter pares*, sepse ajo qëndron nga çdo pikëpamje mbi të gjitha fuqitë e tjera të mëdha, pra është e *pabarabartë* me to. Edhe po të supozojmë, fjala vjen, se Bashkimi Europian do të mund të bëhet në të ardhmen një aktor polar, ai, siç shprehet John Van Oudenaren (2004), do të jetë një “pol” i dobët, një farë Austro-Hungarie në një sistem global të balancës së pushteteve, privilegjet e të cilit do të jenë të lidhura me Shtetet e Bashkuara. Sa për shtete të tjerë të fuqishëm, si Rusia, Kina apo India, ata mund të luajnë në të ardhmen një rol të rëndësishëm në sferat e tyre rajonale të influencës duke u bërë, si të thuash, “hegjemone rajonale”. Sidoqoftë, Amerika do të vazhdojë të mbetet i vetmi vend hegjemon në shkallë globale, apo, siç shprehet James Kurth, “hegjemoni global i të gjithë hegjemonëve të tjerë” rajonalë (Kurth 2007: 63).

1 “Our Small Defense Budget”, *The Wall Street Journal*, October 20, 2006.

2 CIA Fact Book. (<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/us.html>).

Një trajtim interesant të këtij subjekti e gjejmë në librin *Perandoria amerikane: Një debat* (*American Empire: A Debate*), botuar më 2007 nga dy ekspertë amerikanë të studimeve strategjike, Christopher Layne dhe Bradley Thayer. Divergjencat që shprehin këta autorë kundër (Layne) dhe pro (Thayer) status quo-së mbi vendin dhe rolin e Shteteve të Bashkuara në sistemin e sotëm të marrëdhënieve ndërkombëtare janë simptomatike përse i përket debatit që zhvillohet në shkallë ndërkombëtare mbi këtë temë. Në faqet e para të librit, Thayer shprehet në mbrojtje të rolit hegjemon të Shteteve të Bashkuara. Sipas tij, Amerika është sot një perandori, ndonëse jo një perandori në kuptimin tradicional të fjalës. Ky autor argumenton se influenca e Shteteve të Bashkuara në botë është e lidhur kryesisht me sigurinë që ofron fuqia e saj ushtarake, ekonomia e saj muskuloze dhe dinamike si edhe “pushteti i butë” (*soft power*) i saj, i cili ka të bëjë me idetë e saj politike dhe praninë e saj kulturore dominuese në të katër anët e globit.

Edhe pse Layne dhe Thayer pranojnë se Shtetet e Bashkuara nuk janë në fakt një perandori në kuptimin tradicional të fjalës, këta autorë ndahen në pikëpamjet e tyre kur vjen fjala për të argumentuar nëse Amerika do të vazhdojë të mbetet një shtet hegjemon apo ajo do të sfidohet nga fuqi të tjera të mëdha. Christopher Layne sugjeron se është në interesin e Shteteve të Bashkuara që ky vend, me gjeografinë e tij dhe i rrethur nga fqinjë të dobët, të adoptojë një strategji të re “gjoja izolacioniste”, duke pasur një ushtri të vogël, një flotë të madhe dhe vullnetin për t’u lidhur shpejt me aleatë të rinj dhe për t’i lënë aleatët e saj të vjetër nëse kjo është e domosdoshme. Një politikë e tillë, sipas tij, nuk do të stimulonte rivalitetin e fuqive të tjera të mëdha, do të eliminonte pasojat negative të tejshtirjes “imperiale” ushtarake të Amerikës dhe do të evitonte nevojën e kufizimit të kulturës civile dhe lirive të qytetarëve për hir të interesave të sigurisë kombëtare (Layne & Thayer 2007).

Shumë autorë argumentojnë se është në interesin e Amerikës që ajo të vazhdojë të ruajë rolin e saj hegjemon sot dhe në të ardhmen, pasi kjo është “esenciale për mirëqënien dhe sigurinë e vetë Amerikës dhe të ardhmen e lirisë” në botë. Roli hegjemon i Amerikës, siç argumenton Stephen M. Walt, “rrit sigurinë e kombit [amerikan], inkurajon një botë më të stabilizuar dhe zhvillimin e saj dhe u jep Shteteve të Bashkuara një influencë më të madhe mbi zhvillimet globale se ajo e çdo shteti tjetër” (Walt 2002: 10). Edhe pse një rol i tillë mund të bëjë që Amerika të mos shihet me admirim nga shumë njerëz dhe në shumë vende të botës, ai ofron, sidoqoftë, garancinë më të mirë për ruajtjen e sigurisë dhe të stabilitetit në shkallë globale. Kjo është arsyeja që edhe pse shumë vende në Europë dhe në Azi nuk e pëlqejnë dhe s’duan të jenë nën dominimin amerikan, apo të vazhdojnë të kenë forca ushtarake amerikane në territoret e tyre, ata nuk dëshirojnë që “Uncle Sam” të largohet, për shkak se kjo do të rrezikonte paqen, sigurinë dhe stabilitetin e tyre (Joffe 1984; 1995: 94; Bertram 1995; Walt 2002: 11).¹ Siç shkruan Kagan, “hegjemonia

¹ Ky rol i Shteteve të Bashkuara si mbrojtës i lirisë dhe sigurisë së popujve të tjerë, në imagjinatën popullore, madje edhe në atë të elitave të huaja politike, krahasohet me rolin e një “Sherifi hezitant” (po të huazojmë fjalët që Richard Haass ka zgjedhur për titullin e njërit prej librave të tij), një sherif me çizmet ngritur mbi tavolinë, i cili sheh punën e tij derisa një bandë tjetër kriminelësh trazon qytetin (Haass 1998).

amerikane nuk ka të ngjarë të marrë fund edhe për një kohë të gjatë, në një masë të konsiderueshme edhe për shkak se një pjesë e madhe e botës në të vërtetë nuk e dëshiron këtë” (Kagan 2008:86).

Pavarësisht sondazheve të opinionit publik dhe pavarësisht luftës në Irak, marrëdhëniet e Amerikës me aleatët e saj të vjetër dhe të rinj janë forcuar gjatë viteve të fundit. Kjo ka ndodhur, pa dyshim, në marrëdhëniet e Uashingtonit me Japoninë dhe Indinë. Në Europë shohim gjithashtu një tendencë të qartë drejt marrëdhënieve dhe bashkëpunimit më të ngushtë strategjik me Shtetet e Bashkuara. Ndërsa vetëm pak vjet më parë Franca dhe Gjermania flirtuan me Rusinë dhe u afruan me të për t’iu kundërvënë fuqisë amerikane, sot këta dy shtete (dhe thuajse çdo vend tjetër i Europës) po i zgjerojnë dhe forcojnë marrëdhëniet e tyre me Shtetet e Bashkuara. “Politikat më pro-amerikane të presidentit francez Nicolas Sarkozy dhe kancelares gjermane Angela Merkel shpjegohen jo vetëm me personalitetet e tyre të veçantë por edhe reflektojnë një rivlerësim të interesave franceze, gjermane dhe europiane” (Kagan 2008: 88). Për të ilustruar këtë dallim esencial në qëndrimet e Francës ndaj Amerikës, mjafton të krahasojmë këto fjalë cinike të ish-presidentit të fundit francez Jacques Chirac: “Përsa i përket politikës së jashtme unë kam një parim; unë shoh se ç’bëjnë amerikanët dhe bëj të kundërtën” (cituar në Giesbert 2006: 329), me fjalët e presidentit aktual të Francës, Nicolas Sarkozy, i cili, në një intervistë dhënë Radios “Europe-1” në maj të vitit të kaluar, shprehej: “Nëse do më pyesnit se me cilin vend do të mbajë Franca lidhje më të ngushta—Shtetet e Bashkuara apo Rusinë—përgjigja ime do të ishte Shtetet e Bashkuara...Miqësia midis Europës dhe Shteteve të Bashkuara është guri themeltar i stabilitetit në botë. Pikë”.¹

Këto fjalë të Presidentit Sarkozy më sjellin ndërmend liderin e madh evropian, Winston Churchill, i cili, më 1955, në mbledhjen e fundit si Kryeministër i Anglisë, u tha anëtarëve të Kabinetit të tij këto fjalë, të cilat i kanë respektuar pothuajse të gjithë kryeministrit britanikë pas tij: “*Never be separated from the Americans*”—“Kurrë mos u ndani nga amerikanët” (cituar në Hayward 2006). Në një esë botuar nga unë një vit më parë me titull “E ardhmja e Europës, zgjedhja e Europës” (*Europe’s Destiny, Europe’s Choice*), kam mbrojtur argumentin se Europa mund të jetë në prag të humbjes së të ardhmes së saj dhe, prandaj, ajo nuk mund të përballojë dot humbjen e miqësisë me Amerikën. Në këtë udhëkryq të historisë, evropianëve do u duhet të vendosin nëse duan të mbeten aleatë të Amerikës, apo jo (Tarifa 2007: 68). Dhe përderisa të mos jesh një aleat i demokracisë më të madhe dhe vendit më të fuqishëm në botë nuk është një zgjedhje e mençur, evropianëve do u duhet të ndjekin këshillën e Kryeministrit Churchill, pra të jenë aleatë të mirë.²

Që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore forca ushtarake amerikane ka bërë që bota të jetë më e sigurt dhe paqësore se ç’mund të kishte qenë ajo në mungesë të saj, apo nëse Amerika do të kishte qenë një fuqi më e dobët. Siç theksonte Harry Truman gati 60 vjet më

1 Cituar në *RIA Novosti*, Moscow, 7 May; Intervista është botuar gjithashtu në revistën amerikane *The National Interest* më 1 korrik 2007.

2 Ky argument është parashtruar me qartësi edhe nga Christoph Bertram (2003) në një artikull me titull “Interesi më i mirë për Europën: të qëndrojnë pranë Numrit 1”, botur në revistën *Internationale Politik und Gesellschaft*.

parë, “Paqja duhet të ndërtohet me anë të forcës si edhe përmes vullnetit të mirë dhe bëmave të mira” (cituar në Leffler 1992: 16). Siç vumë në dukje më sipër, sistemi i sotëm njëpolar mbështetet në një përqëndrim të fuqisë politike, ekonomike, ushtarake dhe teknologjike në një shtet të vetëm, siç është Amerika, një situatë kjo pa precedent në historinë e njerëzimit. Deri më sot, ky fakt duket se i ka mënjanuar nga politika botërore rivalitetet për hegjemoni nga ana e fuqive të tjera të mëdha, rivalitete të cilat kanë qenë burim i të gjitha konflikteve të armatosura midis tyre në të kaluarën. Në këtë vështrim, sistemi i sotëm njëpolar duket se inkurajon një strukturë paqësore (Wohlforth 1999: 7) dhe vetë Amerika, pavarësisht kritikave që i bëhen politikës së saj të jashtme në Moskë, në Pekin apo në Bruksel, mbetet, siç vë në dukje Robert Kaplan (2005), “garantuesi kryesor i sigurisë globale”.

Në një botë, e cila do të kishte prirjen të zhvillohej drejt një rendi gjithnjë e më të përsosur liberal, ekzistenca e një superfuqie që i njeh vetes një mision global të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në botë ndoshta do të dukej anakronike dhe pengesë për progres të mëtejshëm në këtë fillim shekulli. Por, në një botë të mbushur me armiqësi, konflikte dhe rreziqe a nuk është e rëndësishme, madje e domosdoshme ekzistenca e një superfuqie demokratike dhe roli i saj në plan global? Në qoftë se ekzistenca e një superfuqie të tillë nuk është e domosdoshme dhe as një gjë e mirë, atëherë, cila do të ishte alternativa? Cilës fuqi të madhe, apo cilave fuqi të mëdha do të duhej t’u liheshin në dorë fatet e globit? Kinës, Rusisë, Iranit apo Pakistanit? Robert Kagan argumenton se:

Në shumicën e rajoneve më të rëndësishëm të botës, në Azinë Lindore, në Europë dhe në Lindjen e Mesme, Shtetet e Bashkuara janë akoma guri themeltar i harkut. Hiqe këtë gur dhe harku do të shëmbet....Kjo është gjithashtu e vërtetë në një kuptim më të gjerë. Gjatë gjashtë dekadave të fundit, fuqia amerikane ka bërë të mundur një sërë të mirash publike ndërkombëtare—shërbime nga të cilat përfitojnë jo vetëm Shtetet e Bashkuara por edhe shumë kombe të tjerë. Po të marrim një shembull, flota amerikane garanton sigurinë dhe lirinë e rrugëve detare ndërkombëtare për të gjithë kombet dhe këtë e bën madje edhe kur vetë Shtetet e Bashkuara janë në luftë. Kjo mund edhe të mos ndodhte kështu. Gjatë pjesës më të madhe të historisë, kontrolli mbi rrugët detare dhe tregtare ka qenë kontestuar vazhdimisht nga fuqitë e mëdha. Kur ato zhvillonin luftë me njera-tjetrën, kjo ndikonte mbi tërë sistemin tregtar ndërkombëtar dhe kombet neutralë vuanin të njëjtat pasoja si edhe kombet ndërluftues. Po të lejoheshin të vepronin në këtë mënyrë, Kina dhe India do të kërkonin të kontrollonin Oqeanin Indian, Japonia dhe Kina mund të kontestonin kontrollin e ujrave midis tyre dhe, në rast lufte, rrugët kryesore tregtare do të mbylleshin jo vetëm për këta shtete por për të gjithë kombet e botës. Në mungesë të supremacisë detare të Amerikës, konfliktet rajonale në Lindjen e Mesme dhe në Gjirin Persik mund të çonin në mbylljen e kanalit të Hormuzit dhe atij të Suezit. Nëse kjo s’ka ndodhur në dekadat e fundit, kjo nuk do të thotë se popujt e botës kanë nxjerrë mësim, kanë ndryshuar dhe kanë adoptuar normat e sjelljes ndërkombëtare. Kjo ka ndodhur sepse flota amerikane dominon oqeanet (Kagan 2008: 95-96).

Nuk ka dyshim se hegjemonia amerikane i ka evituar deri më sot luftërat midis fuqive të mëdha dhe e ka bërë thuajse të paimagjinueshme një luftë midis demokracive

liberale të Perëndimit. Askush s'mund të përfytyrojë dot sot një konflikt të armatosur midis Francës dhe Gjermanisë, apo një luftë midis Anglisë dhe Francës, apo midis Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, Spanjës dhe Hollandës, etj. Po kështu, në një kuptim real të fjalës mund të themi se është për shkak të rolit të Amerikës dhe fuqisë së saj ushtarake e politike që një luftë midis Kinës dhe Japonisë (armiq tradicionalë), apo midis Kinës dhe Tajvanit, nuk ka ndodhur në këta 60 vjetë të fundit, ashtu sikurse nuk është përsëritur më një konflikt i armatosur midis Kinës dhe Indisë.

Po kështu, pavarësisht rezistencës së fuqive të tjera ndaj pranisë ushtarake amerikane në të katër anët e globit, bazat ushtarake amerikane, të krijuara pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore për të mbrojtur interesat kombëtare të Shteteve të Bashkuara i kanë shërbyer gjithashtu forcimit të sigurisë në rajone dhe vende të tjerë të botës. Mendoni për një çast rolin mbrojtës që ka luajtur “ombrella amerikane”—me bazat e saj ushtarake në Gjermani, Islandë, Itali, Spanjë, Turqi dhe në vende të tjerë të Europës—dhe NATO, si aleancë e përbashkët e demokracive perëndimore, për sigurinë e kontinentit evropian gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Përpiquni të përfytyroni për një çast situatën e sigurisë në Azinë Lindore dhe në rajonin e Pacifikut pa bazat ushtarake amerikane në Japoni dhe në Korenë e Jugut dhe pa prezencën e vazhdueshme të Flotës së Shtatë amerikane në Pacifikun perëndimor dhe në Oqeanin Indian. Konsideroni gjithashtu ç'ndryshim esencial ka pësuar situata e sigurisë në Ballkanin perëndimor gjatë dekadës së fundit me vendosjen e bazave amerikane në Bosnje-Hercegonivë dhe në Kosovë si edhe me instalimin e bazave të reja në Poloni, Hungari, Bullgari, Rumani dhe Gjeorgji.

Nuk ka dyshim se duke u shërbyer interesave strategjike amerikane, prania ushtarake e Shteteve të Bashkuara në rajone të ndryshëm të botës krijon një siguri dhe stabilitet të tillë, të cilin asnjë shtet tjetër apo koalicion shtetesh nuk do të ishin në gjëndje ta krijojnë as dje, as sot, as në një të ardhme të afërt. Amerika është, sot për sot, i vetmi shtet, i cili prodhon *të mira publike* (siguri dhe stabilitet), të cilat mund t'u shërbejnë të gjithë vendeve të globit pa qënë të detyruar që këta vende të paguajnë për to. Në një libër provokativ dhe ndër më të komentuarit, titulluar *Rasti i Goliathit: Si vepron Amerika si qeveria e botës në shekullin e 21-të* (*The Case for Goliath: How America Acts as the World's Government in the 21st Century*), Michael Mandelbaum (2006) argumenton idenë se Amerika e përdor fuqinë e saj në dobi të interesave të saj kombëtare, por kjo nuk do të thotë domosdo se interesat e saj janë të kundërta me ato të shteteve të tjerë. Në mënyrë figurative ai shprehet se Amerika nuk është “luani” i sistemit ndërkombëtar që terrorizon dhe vret kafshë më të vogla dhe më të dobëta për të mbijetuar vetë; përkundrazi, Amerika është “elefanti”, i cili ndihmon shumë krijesa të tjera—gjitarë të vegjël, zogj dhe insekte—duke prodhuar ushqim për to ndërkohë që ushqen edhe veten e tij.

Sistemi aktual njëpolar ka, natyrisht, difektet e tij, madje jo të vogla. Por, ashtu si Robert Kagan, shtrojmë pyetjen: “Cila është një alternativë tjetër realiste”?

Njerëzit do të donin krijimin e një bote më harmonike të mbështetur në një koncert të ri të kombeve, por gara e fuqive të mëdha dhe përplasja e interesave dhe e ambicjeve të tyre në rajonin e Euroazisë e bëjnë të pamundur një evolucion të tillë. Madje edhe nën

ombrellën e supremacisë amerikane mund të shpërthejnë konflikte rajonale, në të cilat angazhohen fuqitë e mëdha. Çështja është nëse një Amerikë dominuese do i bënte konflikte të tillë më pak apo më shumë të mundur. Shtetet e Bashkuara mund dhe në të vërtetë veprojnë ndonjëherë nisur nga interesat e tyre, duke trazuar ose edhe duke dëmtuar interesat e kombeve të tjerë. Por nuk është e qartë nëse në një botë shumëpolare, Rusia, Kina, India, Japonia apo edhe Europa do të tregoheshin më të zgjuara apo më të moralshme në ushtrimin e pushtetit të tyre. Një aspekt i ri i një bote të tillë shumëpolare do të ishte se shumica e këtyre fuqive do të zotëronin armë atomike. Kjo do t'i bënte luftrat midis tyre më pak të mundshme, por [nëse ato ndodhnin], më katastrofike (Kagan 2008: 93-94).

A është i mundur krijimi i një fuqie polare në Azi?

Sistemi i sotëm global njëpolar karakterizohet nga—dhe mbështetet në—dy faktorë kryesorë: *gjerësia* dhe *thellësia e hendekut* që ndan Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga të gjitha fuqitë e tjera të mëdha të kohës dhe *faktori gjeopolitik*. Me logjikën dhe ritmet e sotme të zhvillimit do të duhen disa dekada që ndonjë fuqi tjetër e madhe të mund të arrijë Shtetet e Bashkuara në ndonjërin prej komponentëve që përcaktojnë statusin e saj si fuqia e vetme hegjemone e botës. Përveç kësaj, që të shkaktojë ndryshime strukturore në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, çdo zhvillim që mund të vihet re në njërin apo në të gjithë elementët e fuqisë duhet të jetë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm.

Përsa i përket pozitës gjeografike të Shteteve të Bashkuara, ajo ka qenë, është dhe do të mbetet një avantazh shumë i madh për të sepse, e ndarë nga Europa dhe Azia me dy oqeanë, ajo nuk ka fqinj asnjë prej fuqive të mëdha. Të gjithë shtetet e tjerë që potencialisht mund të sfidojnë hegjemoninë amerikane (Kina, Rusia, Japonia apo Bashkimi Europian) nuk e kanë këtë avantazh dhe, siç venë në dukje me të drejtë Stephen Brooks dhe William Wohlforth, asnjëri prej tyre “nuk mund t’i rrisë kapacitetet e veta ushtarake për të balancuar Shtetet e Bashkuara pa u bërë njëkohësisht një rrezik imediat për fqinjët e tij.” Autorët e mësipërm sugjerojnë se,

Politika, madje edhe politika ndërkombëtare, është [para së gjithash politikë] lokale. Edhe pse fuqia amerikane tërheq vëmendjen e kujtdo në botë, shtetet janë zakonisht më të preokupuar me fqinjët e tyre se sa me ekuilibrin në shkallë globale. Nëse ndonjë fuqi potencialisht sfidonjëse do të bënte ndonjë përpjekje serioze për t’u matur me Shtetet e Bashkuara, përpjekjet balancuese rajonale [të fuqive të tjera] pothuajse me siguri do ta pengonin atë, siç do të bënin edhe vetë Shtetet e Bashkuara duke mobilizuar fuqinë e tyre masive latente për të parandaluar çdo rrezik që mund t’u vijë (Brooks & Wohlforth 2002: 24).

Edhe pse asnjë shtet—përfshirë këtu edhe Rusinë dhe Kinën—nuk dëshiron të deklarohet hapur si kundërshtar i Shteteve të Bashkuara, synimi dhe axhenda e tyre mbeten të dobësojnë vullnetin politik të Uashingtonit dhe influencën amerikane në

rajonet e tyre dhe në zgjidhjen e çështjeve të mëdha të globit duke marrë vetë një rol gjithnjë e më të madh. Është e vërtetë se Rusia dhe Kina nuk kanë sot kapacitetet ekonomike, politike, ushtarake, teknologjike dhe kulturore për të krijuar “pole” alternative ndaj superfuqisë amerikane, por si anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së këta shtete janë përpjekur të veprojnë për t’i komplikuar apo bllokuar shumë nga iniciativat politike dhe diplomatike të Uashingtonit, madje edhe duke vepruar në kundërshtim të hapur me interesat dhe politikën e Shteteve të Bashkuara.

Në sociologji dhe në shkencën politike pushteti konsiderohet si aftësia për t’i bërë të tjerët të veprojnë siç do ti vetë dhe për t’i penguar ata të veprojnë në atë mënyrë që ti nuk e dëshiron. Kuptuar në këtë mënyrë, mund të themi se me resurset e saj të shumta natyrore dhe të drejtën e vetos si anëtare e përhërëshme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Rusia—dhe bashkë me të Kina, si një tjetër anëtare e përhërëshme e Këshillit të Sigurimit dhe vendi më i populluar dhe me ekonominë më dinamike në botë—janë sot fuqi të mëdha dhe aktorë shumë të rëndësishëm në politikën globale, duke luajtur “role gjithnjë e më komplekse si arbitra” në shumë çështje të rëndësishme. Edhe pse Amerika mund të bëjë edhe pa Kinën dhe Rusinë, këto dy fuqi nuk mund të nënvleftësohen. Ato përpiqen ta sfidojnë influencën dhe hegjemoninë amerikane, siç tregon më së miri edhe rasti i Uzbekistanit. Kur në vitin 2005 Uashingtoni adresoi kritika të ashpra ndaj diktatorit të Uzbekistanit lidhur me shtypjen e dhunëshme të një mitingu të opozitës në atë vend, reagimi i tij ishte afrimi me Moskën dhe Pekinin dhe anëtarësimi në Organizatën e Kooperimit të Shanghait, ku bëjnë pjesë edhe shtete të tjerë autokratë si Kazakistani, Taxhikistani dhe Irani.

Pierre Hassner ka shkruar kohët e fundit se “kriza e influencës” së Shteteve të Bashkuara në arenën ndërkombëtare manifestohet aktualisht në një dinamikë të re, e cila evidenton rënien e fuqisë amerikane dhe erozionin e autoritetit të Washingtonit (Hassner 2007: 38). Sipas këtij autori, “momenti njëpolar”, për të cilin fliste Charles Krauthammers në fillim të viteve 1990-të, ka kaluar, madje edhe vetë teza e një bote njëpolare ka qenë edhe atëherë e ekzagjeruar. Hassner pohon se:

Shtetet e Bashkuara janë akoma fuqia më e pasur dhe me resurset më të shumta—e vetmja fuqi që mund të ndërhyjë kudo në botë dhe, ndoshta, gjithashtu, e vetmja fuqi e madhe veprimet e së cilës nisen nga synimet më të sinqerta për të ndihmuar botën, madje edhe kur në mënyrë të paqëllimshme ato e bëjnë atë më të rrezikshme. Por, iluzionet e Amerikës mbi fuqinë e jashtëzakonshme dhe virtytet e saj—të cilat, bashkë me ndjenjën e vulnerabilitetit të saj u dhanë shkas reagimeve të saj pas 11 shtatorit—janë lëkundur thellë. Amerika sot përballet me një botë nga e cila ajo nuk mund të tërhiqet, por të cilën ajo as mund ta kontrollojë—dhe të cilën, me sa duket, ajo në të vërtetë nuk e kupton (Hassner 2007: 40).

Unë mendoj, sidoqoftë, se Amerika do të vazhdojë t’i ruajë avantazhet e saj si superfuqia e vetme e botës për një periudhë relativisht të gjatë, pa rrezikuar të kundërbalancohet, apo të rivalizohet, nga fuqi të tjera, edhe pse përpjekjet për të

balancuar fuqinë amerikane nuk kanë munguar dhe nuk do të mungojnë as në të ardhmen. Këtë të fundit e dëshmojnë, veç të tjerash, krijimi në qershor të vitit 2001 i organizatës “Shanghai 6” (*Shanghai Cooperation Organization*), së cilës rusët i referohen si një aleancë “anti-NATO”, apo si një “Traktat i Varshavës 2” (shih Blomfield 2007); nënshkrimi në korrik të po atij viti i “Traktatit të Miqësisë Kino-Ruse” (*Treaty for Good Neighborliness, Friendship and Cooperation between the People’s Republic of China and the Russian Federation*), të cilin një komentator rus e ka cilësuar si “një akt i miqësisë kundër Amerikës”¹ si edhe, ndër të tjera, partneriteti që krijuan Franca (nën Presidentin Jacques Chirac), Gjermania (nën Kancelarin Gerhard Schröder) dhe Rusia (nën Presidentin Vladimir Putin) për të penguar ndërhyrjen ushtarake amerikane në Irak, qëndrimi i Rosisë ndaj pavarësisë së Kosovës, etj.

Coral Bell, në librin e saj *Të jetosh me gjigandët (Living with the Giants)*, pohon se nëse Rusia dhe Kina do të krijojnë një partneritet strategjik në mes tyre, kjo, “pak a shumë, do të krijojte një balancë bipolare brenda natës” (Bell 2005: 36). Por sa realiste është ideja se këto dy fuqi të mëdha mund të kooperojnë për të krijuar një “pol” të dytë si kundërpeshë ndaj Shteteve të Bashkuara?

Pavarësisht afrimit dhe marrëdhënieve shumë të mira kohët e fundit midis Rosisë dhe Kinës, këto marrëdhënie nuk ka të ngjarë të shndërrohen në një aleancë politiko-ushtarake të qëndrueshme, si një “Traktat i Varshavës 2”. Lordi Palmerston thoshte dikur se kombet nuk kanë miq të përhershëm, ata kanë vetëm interesa të përhershme. Dhe përderisa perceptimet që ka çdo komb për interesat e veta nuk janë të dhëna një herë e përgjithmonë, ato ndryshojnë bashkë me ndryshimin e perceptimeve mbi fuqinë e tij, duke ua lënë vendin ose ambicieve të reja ose duke u kthyer në ambicjet e vjetra. Nisur nga një konceptim i tillë dialektik i marrëdhënieve midis fuqive të mëdha, është tërësisht e justifikuar të pohojmë se marrëdhëniet midis Kinës dhe Rosisë në mënyrë të pashmangshme do të rikalibrohen me ngritjen e Kinës si një fuqi e madhe dhe rritjen e shqetësimeve të Moskës për sigurinë e provincave të largëta të Siberisë, në të cilat banojnë vetëm 7 milion njerëz. Siç argumenton Robert Kagan në librin e tij të fundit *Kthimi i historisë dhe fundi i ëndrrave (The Return of History and the End of Dreams)*:

Kina dhe Rusia kanë bashkëpunuar me njëra-tjetrën për t’iu kundërvënë Shteteve të Bashkuara. Por për krijimin e një aleance strategjike afatgjatë midis këtyre dy fuqive ka pengesa. Ato kanë nisur një aleancë armatimesh, në se jo edhe një aleancë formale strategjike, në të cilën Rusia i shet Kinës miliarda dollarë teknologji të avancuar ushtarake dhe armatime për t’i përdorur kundër Shteteve të Bashkuara nëse do të krijohet ndonjë konflikt midis tyre.... Sidoqoftë, ato vazhdojnë të jenë rivalë tradicionalë. Rusët vazhdojnë t’i trëmben faktit që popullsia masive dhe në rritje e Kinës një ditë do vërshojë në Siberi dhe në territoret thuajse të papopulluara të lindjes së largme të Rosisë. Ndërkohë, ekonomia kineze është më e varur nga tregu amerikan se ç’është Rusia si eksportuese e naftës. Udhëheqësit rusë ndonjëherë tremben se Kina më shumë do tregun amerikan se sa urren hegjemoninë amerikane (Kagan 2008: 86-87).

1 *The New York Times*, 17 July 2001, p. A1.

Një tjetër faktor i rëndësishëm që s'mund të lihet jashtë konsiderate është Japonia. Moska dhe Pekini janë dhe do vazhdojnë të jetë skeptikë dhe të shqetësuar për ngritjen e Japonisë si një fuqi ushtarake, sidomos për partneritetin e ngushtë midis Tokios dhe Uashingtonit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. *Rusia nuk dëshiron një Kinë të fortë dhe një Japoni të fortë në kufinjtë lindorë të hapësirës gjeografike të saj. As Kina nuk dëshiron një Rusi të fortë dhe një Japoni të fortë në hapësirën gjeopolitike të saj. Moska dhe Pekini, Moska dhe Tokio, Pekini dhe Tokio patjetër do të ndeshen një ditë për supremaci në Azinë Verilindore.*

Në një kohë kur thuajse të gjithë analistët dhe vëzhguesit e marrëdhënieve ndërkombëtare janë të fokusuar tek Kina dhe Rusia si fuqi të mëdha, është e lehtë të harrohet se Japonia është gjithashtu një fuqi e madhe. Ajo është shteti i dytë ekonomikisht më i fuqishëm në botë pas Amerikës, fakt ky, i cili po të mbajmë parasysh popullsinë dhe territorin relativisht të vogël të saj si edhe mungesën e resurseve natyrore, është shumë domethënëse. Ndërkohë, edhe pse buxheti i Japonisë për shpenzime ushtarake nuk e kalon 1 përqind të GDP-së së këtij vendi, ai është 40 miliardë dollarë në vit, një ndër tre apo katër buxhetet më të mëdha në botë për qëllime mbrojtjeje, ndërsa vetë forcat e armatosura të Japonisë janë nga më modernet. Po kështu, edhe pse Japonia nuk është një fuqi bërthamore dhe nuk dëshiron të bëhet e tillë, ajo është në gjendje që në një situatë krize të krijojë një arsenal bërthamor të fuqishëm brenda një kohe shumë të shkurtër (shih Kagan 2008: 37).

Japonia jo vetëm është një fuqi e madhe, por ajo edhe shpreh gjithnjë e më shumë ambiciet e saj si një fuqi e tillë. Rivaliteti midis Japonisë dhe Kinës ka qenë, është dhe do të mbetet një tipar qendror dhe i vazhdueshëm jo vetëm i gjeopolitikës së Azisë Lindore dhe rajonit të Pacifikut por edhe në skenën globale. Konfliktet dhe rivaliteti ndërmjet tyre si edhe rivaliteti për hegjemoni rajonale i çdo njëres nga këto fuqi të mëdha me Rusinë i shërbejnë ruajtjes dhe forcimit të hegjemonisë amerikane në këtë rajon dhe më gjerë në krejt Pacifikun.

Konkluzion

Të gjithë shtetet që aktualisht aspirojnë të bëhen superfuqi (Kina, Bashkimi European, Rusia, Japonia dhe India) nuk e kanë avantazhin gjeopolitik që ka Amerika. Për këtë arsye, përpjekjet e tyre për t'u fuqizuar apo për të lidhur aleanca me shtete të tjera, të cilët gjithashtu janë të pakënaqur me statusin aktual, ka shumë të ngjarë të shkaktojnë kundërpesha lokale dhe prishje të balancave ekzistuese *më parë* se ato të mund të krijojnë një kundërpeshë globale ndaj epërsisë së Shteteve të Bashkuara. Duhet mbajtur parasysh, siç vë në dukje me të drejtë Wohlforth (1999), se të gjithë "polet" potencialë, apo shtetet që aspirojnë të fitojnë statusin e një superfuqie, ndodhen në ose përreth Euro-Azisë, ndërsa Amerika është larg tyre.

Për shkak të faktorëve të mësipërm (hendekut të madh që ndan Shtetet e Bashkuara si fuqi politike, ekonomike, ushtarake dhe teknologjike nga të gjitha fuqitë e mëdha

të kohës, si edhe të pozitës së saj gjeostrategjike shumë të favorshme), duket se krijimi i një kundërpeshe ndaj Shteteve të Bashkuara prej një fuqie të vetme, apo prej një grupimi vendesh të fuqishëm, nuk do të bëhet i mundur për një kohë relativisht të gjatë. Rrjedhimisht, sistemi aktual i marrëdhënieve ndërkombëtare duket i qëndrueshëm dhe do të vazhdojë të mbetet njëpolar. Ai do pushojë së qëni i tillë kur një apo disa fuqi të mëdha të marra së bashku do të mund të krijojnë një pol të ri.

Sidoqoftë, për sa kohë që sistemi i marrëdhënieve ndërkombëtare mbetet njëpolar, pasiguria në zgjedhjen e partnerëve dhe të aleancave është më e vogël, siç është më i thjeshtë edhe kalkulimi i avantazheve apo i rreziqeve potencialë në politikën e jashtme të çdo vendi. Graham Fuller vë në dukje se asnjë vend serioz në skenën botërore nuk do të pajtohet me një sistem njëpolar, pasi çdo shtet i fuqishëm ka aspiratat e tij dhe do të donte të provonte opsionet që ofron realiteti global. Sidoqoftë, thekson ky autor,

Nëse puna do të vinte që vetëm ekzistenca e një superfuqie është e mundur, shumica [e fuqive të tjera] mund të preferonin që kjo superfuqi të jenë Shtetet e Bashkuara.... Sidoqoftë, ajo që ka rëndësi është se pak prej tyre e pranojnë këtë status quo. Ekziston një preokupim serioz kudo në botë për fuqinë e jashtëzakonshme amerikane, kundër së cilës, shumë e kuptojnë se çdo rezistencë serioze është e kotë (Fuller 2006: 39).

Në një konstelacion të tillë marrëdhëniesh ndërkombëtare, fuqitë e mëdha, apo shtetet e rangut të dytë, duket se kanë *vetëm* dy opsione të arsyeshme: e para, të bashkohen në aleancë me superfuqinë e vetme—Amerikën; e dyta, të mos ndërmarrin veprime të cilat provokojnë antagonizmin e saj. Për sa kohë që politikën e tyre të sigurisë janë të orientuara nga kapacitetet dhe preferencat e së vetmes superfuqi, ka pak të ngjarë që fuqi të tjera, apo shtete të rangut të dytë, të angazhohen në rivalitete që çojnë në konflikte të hapura dhe në politika që çënojnë arkitekturën ekzistuese të sigurisë apo prestigjin e tyre. Pavarësisht retorikës së Moskës, Brukselit apo Pekinit, që nga mbarimi i Luftës së Ftohtë deri më sot nuk kemi parë ndonjë opozitë serioze të fuqive të tjera të mëdha ndaj Shteteve të Bashkuara, të ngjashme me përpjekjet klasike të fuqive të mëdha në të kaluarën për të balancuar fuqinë e kundërshtarëve të tyre. Josef Joffe me të drejtë vë në dukje se:

Është e pamundur që Shtetet e Bashkuara të balancohen me mënyrat tradicionale duke formuar aleanca anti-amerikane, apo duke i shpallur luftë Amerikës....Nuk mund të imagjinohet dot që ndonjë aleancë në botë të mund të thyjë Shtetet e Bashkuara përveç se përmes një lufte bërthamore, e cila do të ishte një vetëvrasje bërthamore... (Joffe 2006b).

Kjo status quo, në të cilën asnjë fuqi e madhe nuk i kërcënon seriozisht sigurinë dhe interesat jetike të Shteteve të Bashkuara, siç kemi theksuar në këtë analizë, mund të ndryshohet vetëm në rast se hendeku midis superfuqisë së vetme dhe një shteti, apo një grupi shtetesh që e sfidojnë atë, ngushtohet dhe bëhet shumë i vogël në të gjithë

komponentët e domosdoshëm që karakterizojnë një superfuqi, ose nëse vendi apo vendet që aspirojnë të bëhen superfuqi e lenë pas superfuqinë ekzistuese në një apo më shumë nga këta komponentë. Kjo, sidoqoftë, nuk është një alternativë e mundshme të paktën edhe për disa dhjetëvjeçarë, pasi asnjë nga fuqitë e mëdha, mesa duket, nuk do të jetë në gjëndje të rivalizojë me Shtetet e Bashkuara në mënyrë të fokusuar dhe të qëndrueshme (Brooks & Wohlforth 2002: 21; Wohlforth 2007). Përveç kësaj, edhe kur ndryshimi i balancës së fuqisë në shkallë globale bëhet i mundur, ky proces, në mungesë të një disfate totale në luftë (si ajo e Gjermanisë dhe e Japonisë në Luftën e Dytë Botërore, apo e Bashkimit Sovjetik në Luftën e Ftohtë), nuk ndodh menjëherë por kërkon një kohë relativisht të gjatë. Sepse *transformimi i strukturës së sistemit ndërkombëtar është një ndryshim i tillë cilësor, i cili kërkon ndryshime të mjaftueshme sasiore në të gjithë elementët që përbëjnë pushtetin: material (ekonomik), fizik (ushtarak), kulturor dhe teknologjik*. Faktet tregojnë, sidoqoftë, se që nga fillimi i luftës në Irak, ngjarje kjo e cila identifikohet rëndom me fillimin e rënies së supremacisë amerikane, asnjë ndryshim esencial nuk ka ndodhur në këta faktorë “objektivë” që të justifikojë “teorinë” e kthimit në sistemin shumëpolar.

Në librin e tij *Überpower*, Josef Joffe (2006a) përfytyron si skenarin më të padëshiruar atë, në të cilin, ndërsa bota ka nevojë për lidërshpinin e Shteteve të Bashkuara, fuqi të mëdha përpiqen ta sabotojnë atë. Sidoqoftë, ky skenar ka fare pak mundësi të materializohet. Çdo renditje e fuqive të mëdha në dekadat e ardhëshme do t’i vendoste Kinën, Indinë, Bashkimin Europian, Japoninë apo Rusinë në vendin e dytë, të tretë, të katërt apo të pestë, edhe pse ndoshta jo në këtë renditje. Një konflikt i hapur, aq më tepër i armatosur, midis Shteteve të Bashkuara dhe çdo kombinimi midis këtyre fuqive duket, sot dhe në një të ardhme të parashikueshme, shumë i pamundur.

Dalja në skenën botërore e Kinës dhe e Indisë si fuqi të mëdha, “normalizimi” dhe fuqizimi ekonomik dhe ushtarak i Japonisë, zgjerimi dhe integrimi i mëtejshëm i Bashkimit Europian dhe ngritja ekonomike e Rusisë e kanë bërë jo vetëm *më të vështirë*, por edhe *më pak atraktive* perspektivën e çdonjërit prej këtyre vendeve për të zëvendësuar Shtetet e Bashkuara në rolin e fuqisë hegjemone për një kohë të gjatë. Ajo çka mund të duket më e realizueshme se çdo koalicion anti-amerikan i fuqive të mëdha dhe së cilës Joffe (2006b) i trembet më shumë, është nëse një vend si Rusia, duke shfrytëzuar pakënaqësitë, demoralizimin dhe sentimentet anti-amerikane të disa fuqive të mesme, kryesisht në Azinë Qendrore dhe në Lindjen e Mesme (si Irani apo Siria), organizon një koalicion anti-amerikan me to. Sidoqoftë, edhe pse një koalicion i tillë mund të ishte i rrezikshëm, ai nuk do të përbente një katastrofë për Shtetet e Bashkuara.

Këtë nalizë dëshiroj të mbyll duke u bashkuar me mendimin e shprehur nga William Wohlforth në një artikull titulluar “Stabiliteti i një bote njëpolare” (*The Stability of a Unipolar World*), i cili edhe pse është botuar disa vjet më parë, ruan aktualitet të plotë në ditët tona. Sipas këtij autori, asnjë fuqi e vetme dhe asnjë grup shtetesh nuk kanë mundur dhe nuk do të mundin për një kohë të gjatë të krijojnë një rival serioz ndaj Shteteve të Bashkuara, apo një “pol” të dytë, i cili do të bënte të mundur dhe të domosdoshëm ndryshimin e sistemit aktual të marrëdhënieve ndërkombëtare. Një gjë e tillë, natyrisht, nuk është absolutisht

e pamundur, por realizimi i saj do të kërkojë një periudhë kohe të gjatë. Sistemi aktual njëpolar “mund të zgjasë po aq kohë sa zgjati edhe Lufta e Ftohtë, apo sistemi dypolar” (Wholphorth 1999: 8). Deri në zëvendësimin eventual të tij me një sistem tjetër dy- apo shumëpolar, apo me një “koncert” të fuqive të mëdha, Amerika do të vazhdojë të mbetet superfuqia e vetme e globit.

Ngjarjet tragjike të 11 shtatorit 2001 ishin një goditje e rëndë për Amerikën dhe qytetërimin perëndimor. Ato ngjarje kishin dhe vazhdojnë të kenë një ndikim të madh në jetën e amerikanëve dhe në shumë zhvillime që kanë ndodhur dhe ndodhin në çdo skaj të globit. Edhe pse shumë njerëz menduan se 11 shtatori theu mitin e pathyeshmërisë së Amerikës dhe shënoi preludin e një epoke të re, pra edhe të një sistemi të ri global në marrëdhëniet ndërkombëtare, ky mendim do të provohet se është i gabuar. Siç shprehet një autor amerikan,

Ndoshta në të ardhmen bota do ta kujtojë 11 shtatorin e vitit 2001 ashtu siç kujtojnë japonezët 7 dhjetorin e vitit 1941: si ditën kur një Amerikë e përgjumur u zgjua për të ndryshuar botën (Donnelly 2004).

Referencat

- Barma, Naazneen, Ely Ratner & Steven Weber. 2007. “A World Without the West”, *The National Interest* 90 (July/August): 23-30.
- Bell, Coral. 2005. *Living with the Giants: Finding Australia's Place in a More Complex World*. Barton, Canberra: Australian Strategic Policy Institute.
- Bertram, Christopher. 1995. *Europe in the Balance: Securing the Peace Won in the Cold War*. Washington, D.C.: Carnegie Endowment for International Peace.
- Bertram, Christopher. 2003. “Europe’s Best Interest: Staying Close to Number One,” *Internationale Politik und Gesellschaft* 1: 61-70.
- Blomfield, Adrian. 2007. “Putin Praises Strength of ‘Warsaw Pact 2’”, *Daily Telegraph*, 20 August.
- Brooks, Stephen G. & William C. Wholphorth. 2002. “American Primacy in Perspective”, *Foreign Affairs* 81, 4 (July/August): 20-33.
- Chen, Rosalie. 2003. “China Perceives America: Perspectives of International Relations Experts”, *Journal of Contemporary China* 12, 35 (May).
- Cooper, Robert. 2002. “The New Liberal Imperialism”, *The Observer*, 7 April.
- Daadler, Ivo & James Lindsay. 2007. “Democracies of the World, Unite”, *The American Interest* 2, 3 (January/February): 5-15.
- Donnelly, Thomas. 2004. “The Proof of Primacy”, (February), Washington, D.C.: AEI.
- Dibb, Paul. 2006. “The Bear Is Back”, *The American Interest* 2, 2 (November/December): 78-85.
- Doyle, Michael W. 1982. “Kant, Liberal Legacies and Foreign Affairs”, *Philosophy and Public Affairs* 12: 205-235 dhe 323-353.
- Doyle, Michael W. 1995. “On the Democratic Peace”, *International Security* 19, 4: 164-184.
- Fukuyama, Francis. 1992. *The End of History and the Last Man*. New York.
- Fukuyama, Francis. 2006. “The Paradox of International Action”, *The American Interest* 1, 3 (Spring): 7-18.
- Fuller, Graham E. 2006. “Strategic Fatigue”, *The National Interest* 84 (Summer): 37-42.

- Giesbert, Franz-Olivier. 2006. *Tragédie du Président*. Paris: Flammarion.
- Haass, Richard N. 1998. *The Reluctant Sheriff: The United States after the Cold War*. Washington, D.C.
- Haass, Richard N. 2005b. *The Opportunity: America's Moment to Alter History's Course*. New York: Public Affairs.
- Hassner, Pierre. 2007. "The Fate of a Century", *The American Interest* 2, 6 July/August): 36-47.
- Hayward, Steven. 2006. "The Grand Alliance", *Claremont Review of Books* VI, 2.
- Huntington, Samuel P. 1999. "The Lonely Superpower", *Foreign Affairs* 78, 2 (March/April): 35-49.
- Ikenberry, G. John. 2006. "Liberal International Theory in the Wake of 9/11 and American Unipolarity", paper prepared for the seminar "IR Theory, Unipolarity and September 11th—Five Years On", NUPI (Norwegian Institute of International Affairs), Oslo, 4 March.
- Joffe, Josef. 1984. "Europe's American Pacifier", *Foreign Policy* 54 (Spring): 64-82.
- Joffe, Josef. 1995. "Bismarck or 'Britain'? Toward and American grand Strategy after Bipolarity", *International Security* 19, 4 (Spring): 94-117.
- Joffe, Josef. 2006a. *Überpower: The Imperial Temptation of America*. New York: W.W. Norton.
- Joffe, Josef. 2006b. The John B. Hurford Memorial Lecture (A Conversation with Josef Joffe), Council on Foreign Relations, New York, 16 June; (http://www.cfr.org/publication/10982/john_b_hurford_memorial_lecture.htm).
- Kagan, Robert. 2008. *The Return of History and the End of Dreams*. New York: Alfred A. Knopf.
- Kant, Immanuel. 1790 [1795]. "Perpetual Peace: A Philosophical Sketch", in M. Forsyth, H.M.A. Keens-Soper & P. Savigear (eds), *The Theory of International Relations: Selected Texts from Gentili to Treitschke*. London: Allen & Unwin.
- Kaplan, Robert D. 2005. *Imperial Grunts: The American Military of the Ground*. New York: Random House.
- Kennedy, Paul. 2002. "The Eagle has Landed". *The Financial Times*, 2 February.
- Krauthammer, Charles. 1990/91. "The Unipolar Moment", *Foreign Affairs* 70, 1 (Winter): 23-33.
- Krauthammer, Charles. 2002/03. "The Unipolar Moment Revisited", *The National Interest* 70 (Winter): 5-17.
- Kupchan, Charles A. 1999. "Life After Pax Americana", *World Policy Journal* 16, 3 (Fall): 20-27.
- Kurth, James. 2007. "Coming to Order", *The American Interest* 2, 6: 55-63.
- Layne, Christopher & Bradley A. Thayer. 2007. *American Empire: A Debate*. New York: Routledge.
- Leffler, Melvyn J. 1992. *A Preponderance of Power: National Security, the Truman Administration, and the Cold War*. Stanford, CA: Stanford University Press.
- Lieven, Anatol & John Hulsman. 2006. *Ethical Realism: A Vision for America's Role in the World*. New York: Pantheon.
- Lind, Michael. 2006. *The American Way of Strategy: U.S. Foreign Policy and the American Way of Life*. Oxford: Oxford University Press.
- Mandelbaum, Michael. 2002. *The Ideas that Conquered the World: Peace, Democracy, and Free Markets in the Twenty-first Century*. New York.
- Mandelbaum, Michael. 2006. *The Case for Goliath: How America Acts as the World's Government in the 21st Century*. New York: Public Affairs.
- Morgenthau, Hans J. 1948. *Politics among Nations: The Struggle for Power and Peace*. New York.
- Nye, Joseph S. Jr. 1990. *Bond to Lead: The Changing Nature of American Power*. New York: Basic Books.
- Oudenaren, John Van. 2004. "Unipolar versus Unilateral: Confusing Power with Purpose", *Policy Review* 124 (April March): 63-74.
- Pangle, Thomas L. & Peter J. Ahrensdorf. 1999. *Justice Among Nations: On the Moral Basis of Power and Peace*. Lawrence, Kansas.
- Peterson, Peter G. 2007. "No Free Lunch", *The National Interest* 90 (July/August): 19-22.

- Russett, Bruce. 1993. *Grasping the Democratic Peace: Principles for a Post-Cold War World*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
- Schmitt, Gary J. 2007. "To Be, or Not to Be...an Empire", AEI Online (June), (http://www.aei.org/docLib/20070622_21885JuneNSOg.pdf).
- Tarifa, Fatos. 2007. *Europe Adrift on the Wine-Dark Sea*. Chapel Hill, NC: Globic Press.
- Walker, Martin. 1996. "The Clinton Doctrine", *The New Yorker*, October 7.
- Walt, Stephen M. 2002. "American Primacy: Its Prospects and Pitfalls", *Naval War College Review* LV, 2 (Spring): 9-28.
- Wohlforth, William C. 1999. "The Stability of a Unipolar World", *International Security* 24, 1 (Summer): 5-41.
- Wohlforth, William C. 2007. "Unipolar Stability: The Rules of Power Analysis", *Harvard International Review* 29, 1 (Spring): 44-48.

Kufizimet e demokratizimit të imponuar: Qeverisja demokratike, shteti dhe OJF-të në Rumani

Antoine Heemeryck

ABSTRAKT. Ky artikull ka si qëllim të hedhë dritë mbi kufizimet e demokratizimit që burojnë nga imponimi i normave globale veçanërisht në rastin e Rumanisë. Në fillim artikulli synon të hedhë dritë mbi disa tipare të nocionit të transparencës ashtu siç është konceptuar në nivelet ndërkombëtare për vendet post-komuniste. Më pas, artikulli analizon rezultatet e një operacioni *monitorimi* të një ligji transparence të bërë nga një OJF në Rumani që më pas krahasohet me një çështje abuzimi me fondet, ku përfshihet një ministër në detyrë. Në këtë mënyrë do të nxjerrim në pah kufizimet dhe pasojat e papritura të një politike të tillë për shumë aktorë të përfshirë në politikë (OJF, shtet, parti politike). Sikurse vetë llogjika e demokratizimit edhe respekti i këtyre ligjeve (të transparencës) është më tepër pjesë e lojës së standartizimit ndërkombëtar sesa një shqetësim i orientuar drejt problematikave lokale.

Hyrje

Konjunktura aktuale e globalizimit dallohet nga një shtrirje e logjikave politike dhe ekonomike që pretendojnë se janë universale, që përthyhen normativisht në koncepte të tilla si “demokracia”, operacionalizimi i tregut, dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Kjo shtrirje, që prek praktikisht të gjitha shoqëritë, është fusha ku lexohen dhe ndeshen raportet ndërkombëtare të forcave si dhe rekomandimet në lidhje me politikën e “zhvillimit”¹. Shëndeti, mjedisi, arsimit, tematikat gjinore, ekonomia, demokracia, shoqëria civile, të drejta e të gjitha llojeve: të rralla janë fushat që mund të dhunojnë këto norma pa hasur në kundërshti. Mirëqeverisja, dimension i pashmangshëm i zhvillimit, është një nga treguesit që shumë qartë sintetizojnë të gjitha këto tematika. Në vendet e Europës Lindore ajo merr formën e veçantë “qeverisje demokratike”: përsëritja e shpeshtë e këtij nocioni në ligjërimitin e institucioneve ndërkombëtare nuk është rastësi, sepse në kuadrin e integritimit në Bashkimin Europian, kjo zonë gjeografike gjendet zyrtarisht në marrëdhënie ndërvarësie të

1 Bertrand Badie, *Një botë pa sovranitet. Shtetet midis dredhës dhe përgjegjësisë*, Paris, Fayard. 1999.

fortë me këtë hapësirë gjeopolitike dhe me NATO- n. Si pasojë, shtërëngimi për të ndjekur standartet ndërkombëtare të qeverisjes, këtu ushtrohet më ashpër se në zona të tjera. Për më tepër, duke qenë se këto shoqëri mbartin në shkallë të ndryshme stigmatizimin e të shkuarës së tyre komuniste, politikave të “zhvillimit” i shohin ato si objekte të “tranzicionit”. Ky prizëm ideologjik, që nuk është i huaj për forma të tjera të evolucionizmit (si për shembull zhvillimzëm, pozitivizëm) përkon me projektimin e një ideali të demokracisë së tregut sipas modelit të shoqërive perëndimore, edhe pse nuk kanë kriteret e përfaqësimit.¹ Në lidhje me sa u tha, Rumania është një rast shumë interesant sepse ndër vendet e Europës Lindore ajo (bashkë me Shqipërinë) shfaqet në sytë e institucioneve ndërkombëtare, si “nxënësi i keq”. Ka një tërësi stereotipesh, që mund të hasen në mediat franceze², të cilët e mbështesin këtë pozicion integrim/përjashtimi duke ushqyer një vizion që i për afrohet botës së tretë.

Rumania ka qenë vendi ku është shprehur më dhunshëm vullneti për të shkatërruar rregullatorët socialë dhe të opinionit publik, nga projekti totalizues i komunizmit ku të gjithë sektorët e shoqërisë duhet t’i nënshtroheshin dimensionit politik³. Në bashkësinë e normave të vendosura nga institucionet ndërkombëtare, Rumania shfaq pra, anën negative. Për këtë arsye, shteti rumun, organizatat joqeveritare, dhe aktorët ndërkombëtarë mblidhen për të diskutuar, zakonisht me nismën e këtyre të fundit⁴, mbi tema të tilla si “krijimi i shoqërisë civile” dhe demokratizimi që përfshijnë një bashkësi fushash ku mund të ndërhyhet: edukimi qytetar, pluralizimi, integrimi i minoriteteve, të drejtat e njeriut, liria e shprehjes, etj. Si rrjedhim, shumë OJF në Rumani⁵, ngarkohen me zbatimin e makro-politikave qofshin këto me logjikë shtetërore⁶, multilaterale⁷, para-shtetërore⁸ ose filantropike⁹. Kjo situatë e bën edhe më të vështirë të kuptuarin e

- 1 Për një kritikë të treguesve të masës së zhvillimit ekonomik, shih Jacques Sapir, *Vrimat e zeza të shkencës ekonomike. Ese mbi pamundësinë e të menduarit të kohës dhe parasë*, Paris, Albin Michel, 2000.
- 2 Vërejtja do të ishte e barazvlefshme edhe për sa i përket shtypit në Angli ose në Gjermani. Është interesante të vihet re se artikujt e shtypit që tregojnë imazhe inferioriteti për Rumaninë, popullsinë, qeverinë, ndërmarrjet ose qytetarët e saj, kthehen në objekte komentesh në mediat rumune.
- 3 Catherine Durandin, *Historia e Rumunëve*, Paris, Fayard, 1995; Gerard Althabe dhe Alina Mungiu – Pippidi, *Fshatra rumune, midis shkatërrimit komunist dhe dbunës liberale*, Paris, Harmattan, 2004; Katherine Verdery, *Çfarë ishte socializmi dhe çfarë erdhi më pas?* Princeton, Princeton University Press, 1996.
- 4 Për t’u bindur mjafton të vëzhgohet qarkullimi i fondeve monetare dhe origjinat e tyre.
- 5 Shih. Gautier Pirote, *Një shoqëri civile postrevolucionare. Sektori i ri OJF-ve në Rumani. Rasti i Iasi*, Louvain, Akademia Bruyaland, 2003. Prania dhe shumëfishimi i OJF-ve janë një fenomen i vëzhgueshëm edhe në vende të tjera. Shih në lidhje me këtë Paul Deler (et al): *OJF-të dhe zhvillimi. Shoqëria, ekonomia, politika*. Paris, Karthala, 1998.
- 6 Përmendim për shembull programin “Matra” të Ambasadës Hollandeze.
- 7 Si PNUD, fondet e *Planit Marshall gjerman të Sh.B.A –ve* dhe fondet “Phare” të Bashkimit Europian.
- 8 Rasti i fondacionit *National Endowment for Democracy* që ndër të tjera është një shtrirje e politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara në fushën e promovimit të demokracisë, in Nicolas Guilhot, *The democracy makers, Human Rights and International Order*, New York, Columbia University Press, 2005. Gjithashtu mund të përmendim statutin ambivalent të USAID si edhe atë të institutit të partive politike amerikane si *National Democratic Institute for Foreign Affairs*, dhe *International Republican Institute*.
- 9 Figura më e shquar është George Soros dhe fondacionet për një shoqëri të hapur të vendosur pothuaj në të gjithë vendet ish-komuniste; Nicolas Guilhot, *Financues, filantropistë. Prije etike dhe riprodhim i kapitalit të Wall Street që prej vitit 1970. Liber/ Arsye për të vepruar*, Paris 2004 dhe nga i njëjti autor “Një prije filantropike: George Soros shkencat shoqërore dhe rregullimi i tregut botëror” in “*Akte kërkimi në Shkencat Sociale*”. No 151-152.

realiteteve socio-politike. Kështu nga njëra anë, shteti ndihet i detyruar të priret drejt një pozicioni të standartizuar, të vendosur nga jashtë, dhe i duhet që në nivelin politik, si të brendshëm edhe të jashtëm, të sillet sipas kriterëve që partnerët e tij kërkojnë por që nuk është e lehtë të zbatohet në praktikë. Nga ana tjetër po këta partnerë, nëpërmjet fondacioneve dhe shoqatave, financimeve të OJF-ve, ndërhyjnë drejtpërdrejtë në fushën e veçantë të demokratizimit, për të mbikqyrur zbatimin e udhëzimeve të tyre të standartizuara. Sipas kësaj logjike, OJF-të kanë avantazhin, por që për shtetet është shpesh disavantazh, të shndërrohen në përbërës legjitim dhe të dosmosdoshëm të “qeverisjes së mirë”: gjë që do të thotë marrëdhënie bashkëpunimi të vazhdueshme midis këtyre dy tipeve të aktorëve. Ky bashkërendim, i dallueshëm në harmoninë e gjuhës së programeve të “zhvillimit”, nënkupton një ndarje të qartë, një pozicionim të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare në lidhje me mënyrën e zbatimit të politikave të ndryshimit ekonomik, social dhe politik¹. Sipas këtyre institucioneve ndërkombëtare (këtu po e skematizojmë), synimi i këtyre shoqatave dhe fondacioneve duhet të jetë formimi i shoqërisë civile që do t’i kundërvihet teprimeve të shtetit, duke administruar kështu “interesin e përgjithshëm” dhe të ndriçuar të qytetarëve, tashmë të edukuar me demokracinë nëpërmjet mësimin të OJF-ve. Logjika ku mbështetet kjo filozofi politike, në fakt është ana politike e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. E thënë ndryshe, kalimi i Rumanisë nga një shoqëri komuniste në demokraci është ana politike e transformimit të shoqërisë kolektivistike në ekonomi kapitaliste, duke qenë se këto dy dimensione janë të lidhur në perspektivën e zhvillimit.

Me qëllim nxjerrjen në dritë të implikimeve lokale të një konceptimi të tillë të politikës së zhvillimit, do të ndalemi te pasojat e miratimit të ligjit mbi transparencën e institucioneve publike në Rumani duke ndjekur rezultatet e një hulumtimi të kryer nga një OJF, në lidhje me zbatimin e këtij ligji. Më pas do të drejtojmë vëmendjen mbi një çështje përfitimi nga shteti të fondeve të dhëna nga Bashkimi European, që e vë në diskutim këtë ligj të transparencës. Në këtë mënyrë, kufizimet në importimin e ligjeve, por edhe pasojat e tyre të papritura, do të duken më qartë, sidomos nëpërmjet peshës së shtetit dhe mënyrës me anë të së cilës ai pozicionohet në lidhje me kërkesat e transparencës dhe të qeverisjes.

Qeverisje dhe transparencë në vendet post-komuniste: Rumania

Kur ndalemi tek implikimet e normave demokratike dhe pedagogjisë së tyre, nuk mund të mos befasonemi nga përdorimi i kudo ndodhur kohët e fundit i termit qeverisje, më shpesh e ashtuquajtur “qeverisje e mirë”. Institucionet dhe traktatet ndërkombëtare i refrohen vazhdimisht këtij nocioni që përmbledh rregulla me udhëzime dhe receta në fushën politike në kuptimin më të gjerë të termit. Banka Botërore ose Bashkimi European, i lënë pak vend

1 Gilbert Rist “Fjalët e pushtetit. Sense dhe non sense të politikës ndërkombëtare” Gjenevë, *Nouveaux Cahiers de l’IUED*, no 13, 2003.

iniciativës sovrane jashtë kësaj kornize. Bashkimi European, për shembull, pohon se: “qeverisja e mirë është përdorur përgjithësisht si një masë themelore e cilësisë dhe performancës së çdo sistemi administrativ ose politik¹”. Nën këtë term të qeverisjes, vizatohen në mënyrë të nënkuptuar konturet e politikës të shtetit. Në përgjithësi, ato kanë të bëjnë me fusha të ndryshme si: siguria, zhvillimi, zhvillimi i qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, varfëria, korrupsioni, investimet e huaja, politikat e migrimit, zhvillimi i shoqërisë civile.

Në konceptin e qeverisjes duket se sferat ekonomike, politike dhe sociale artikulojnë si pjesë e një lloj *pakete* administrimi të shoqërisë që presupozohet se është realizuar diku. Ndër akset që përshkojnë sektorët e përmendur, transparenca shfaqet e kudo ndodhur dhe gëzon një sukses të dukshëm në fjalorët e institucioneve ndërkombëtare që janë gjithashtu politika që synojnë transformimin e shoqërive. Në lidhje me këtë, Bashkimi European, duke iu referuar marrëveshjes së partneritetit të Cotonou, (neni 9, paragrafi 3) shprehet:

“në kuadrin e një mjedisi politik dhe institucional që i respekton të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës, qeverisja e mirë e çështjeve publike, përcaktohet si administrim transparent dhe i përgjegjshëm i burimeve njerëzore, natyrore, ekonomike, financiare, në të mirë të zhvillimit të duhur dhe të qëndrueshëm. Ajo nënkupton procedura të qarta të marrjes së vendimeve, në nivelin e pushtetit publik, institucione transparente dhe të nënshtruara ndaj detyrimit për të dhënë llogari, mbizotërimi i të drejtës në administrimin dhe ndarjen e burimeve” dhe përforcimi i aftësive për përpunimin dhe vënien në zbatim të masave që kanë si qëllim veçanërisht parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit²”.

Rimarrja e termave të kësaj marrëveshjeje në një artikull të Bashkimit European flet për rëndësinë që institucioni i jep transparencës. Citimi nuk lë vend për dyshim: transparenca është kthyer në një bosht themelor të demokracisë, demokratizimit, dhe të kapitalizmit me prirje administruese. Rëndësia e këtij elementi në kuadrin e demokracisë është e pamohueshme: Mikail Gorbaçev e ktheu atë në një kusht kyç për të justifikuar hapjen ndaj kapitilazmit në momentin kur hapja kishte ndodhur³. Megjithatë, koncepti mbetet polisemik. Me fjalë të tjera, është shumë e vështirë të “qartësohet” se çfarë është transparenca. Ky aspekt problematik i nocionit ka të bëjë me faktin se është virtualisht i zbatueshëm ndaj të gjithë sektorëve, të të gjitha shoqërive, duke marrë në të njëjtën kohë kuptime të ndryshme në varësi të kundërshtimeve ose të kërkesave që kanë aktorët që i referohen ose e mbështesin, dhe të pozicionit të tyre në fushën sociale. Për të kuptuar këtë nocion ndoshta duhet ta vendosim në perspektivën e shndërrimit politiko-ekonomik të shoqërive post-komuniste.

1 Komunikatë e komunitetit european, 20 tetor 2003: komunikatë e Komisionit për Këshillin, Parlamentin European dhe Komitetin Ekonomik dhe Social-European: qeverisje dhe zhvillim, 615, Bruksel.

2 *Idem*

3 Kujtojmë që parulla ishte në formë triptiku: ristrukturim, transparenca dhe përsheptim.

Në programet e “zhvillimit¹” kërkesa për transparencë është e lidhur drejtpërdrejtë me privatizimin: në Rumani, si në të gjithë vendet post-komuniste në përgjithësi, shndërrimi i elitave të vjetra politike në elita ekonomike, ka shoqëruar privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe mbërritjen e kapitaleve të huaja. Kjo dukuri nuk mundi të përshpejtohej në Rumani, sikundër u bë në Poloni²: natyra e shtetit-parti dhe mungesa e një konvergjence interesash gjeostrategjike nuk e lejuan³ një gjë të tillë. Kujtojmë këtu se ishte afërsia me qendrën e pushtetit, me shtetin, me rrjetet që sillëshin rreth familjes Çausheku⁴, me partinë dhe me normat e saj “politike” të sjelljes, që përcaktonin pozicionin në hierarkinë e pushteteve; ekzistonte një sistem i tërë informal klientelizmi dhe nepotizmi për të patur akses te burimet - e kufizuara - dhe në statutet sociale që rridhnin prej tyre. Pasuria e dukshme, në një kontekst të karakterizuar nga burime të kufizuara, përkonte me një pozicion të lartë në hierarkinë socio-politike. Gerard Althabe na kujton gjithashtu se: “Sistemi komunist ka qenë një përpjekje e jashtëzakonshme për të krijuar një shoqëri të bazuar mbi raportin politik nga i cili varej dimension i ekonomik⁵”.

Duke nisur nga viti 1989, në kontekstin e shndërrimeve hierarkike, të shkaktuara nga futja progresive e strukturave ekonomike kapitaliste, pozicioni i ndërmjetëm midis sferave politike dhe ekonomike, u bë shumë shpejt një faktor kyç për t’u futur (ose për të qëndruar) në sferat e larta të shoqërisë. Në këtë mënyrë një pjesë e politikanëve dhe funksionarëve e përdorën kapitalin e tyre social dhe politik – tejet i rëndësishëm në shpërndarjen e pushtetit në shoqëritë komuniste - për të përfituar një pozicion ekonomik të privilegjuar në shoqërinë rumune; ekzistojnë gjithashtu shembuj të kundërt: përdorimi i pushtetit ekonomik për të përfituar pushtet politik, si edhe procese të deklasimit (të humbjes së statusit social – shën. i red.). Për pasojë, një numër udhëheqësish gjenden të ngërthyer nga funksione politike dhe ekonomike: këto pozicione janë shpesh objekt denoncimesh dhe “aferat” për korrupsion tregojnë mirë se si rrjeti i marrëdhënieve që lidhte sferat politike dhe ekonomike në regjimin komunist, ka krijuar një lloj lobi. Ky ambiguitet i pozicioneve që përfshijnë të dy sektorët është bërë objekt i një vëmendjeje të veçantë dhe kritikash të vazhdueshme nga ana e donatorëve, institucioneve ndërkombëtare dhe mediave, sidomos shtypit të shkruar.

- 1 Termi zhvillim është vendosur vullnetarisht në thonjëza: sot ai është një referencë që duket si artificial kur vendoset në një perspektivë historike. Shih Gilbert Rist *Zhvillimi. Historia e një besimi perëndimor*, Presse de Science Po.
- 2 Georges Mink dhe Jean-Charles Szurek “Elita të vjetra dhe të reja në Europën Lindore dhe Perëndimore” in *Probleme politike dhe sociale*, no 703 Paris.1992.
- 3 Kujtojmë se ndryshimi i regjimit në Poloni i quajtur me të drejtë revolucion i kadifë, strategjia e përshtatjes e të cilit u konkretizua në tryezën e rrumbullakët, ishte një proces relativisht i qartë i ndryshimit të regjimit i negociuar nga elitat që po hynin dhe ato që po dilnin, ndërsa në Rumani kushtet e “revolucionit” mbeten ende të vagullta dhe janë ende objekt i shumë spekulimeve gazetareske.
- 4 Vullneti i partisë shtet për t’u imponuar me anë të kuadrit familjar dhe grupeve të të afërmeve çoi në krijimin e një sistemi të karakterizuar nga një solidaritet i fortë familjar real ose fiktiv. Shih Ioana Cristoceca “Detyra femërore midis normave komuniste dhe praktikës së përditshme: një studim rasti” in A. Ionescu dhe O. Tomescu-Hatto, *Politika dhe Shoqëria në Rumaninë bashkëkohore*, Paris, Harmattan, 2004,
- 5 G. Althabe, “Parathënie” in Bernard Hours, op, cit.

Në këtë optikë, nocioni i qeverisjes dhe ai i transparencës që e shoqërojnë, reflektojnë sidomos një mënyrë qeverisje të shtetit të riartikulluar në ekonominë kapitaliste¹ dhe e shkëputur nga periudhat e mëparshme të zhvillimit². Bëhet fjalë për një riorientim të raportit me shtetin që kanë sferat ekonomike sociale dhe politike. Në një perspektivë dinamike, këtu kemi të bëjmë me një përmbysje, sepse në komunizëm shteti kishte monopolin e ndërtimit të shoqërisë dhe të ekonomisë, ndërsa sot ai mundet vetëm të administrojë funksionimin e shoqërisë për të siguruar mbarëvajtjen e një sfere ekonomike ndaj të cilës ai duhet të ndërhyjë në minimum. Transparenca, si një gardian i vërtetë, ndërhyr si një instrument verifikimi i zbatimit korrekt të kësaj politike.

Këtu shfaqet një aspekt tjetër i qeverisjes dhe i transparencës: demokratizimi nëpërmjet qytetarëve. Këtij nocioni³ i referohen pothuaj të gjithë agjencitë e programeve të zhvillimit: flitet për shembull, “për qeverisjen e mirë me anë të përfshirjes aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes”. Pra, transparenta, duke vendosur kufijtë e sferave publike dhe private, duhet të pengojë që institucionet politike të shërbejnë si mjet pasurimi ekonomik, dhe anasjelltas, dhe e bën këtë duke ftuar OJF-të dhe qytetarët të kryejnë rolin e agjentit vëzhgues të reformave të shtetit. Këtu ndeshim përsëri idenë e *empowerment*, d.m.th përfshirjen e qytetarëve në politikat e futura nga jashtë, nocion ky që nuk mund të mos na kujtojë lidhjen me korrupsionin: mjafton të sjellim ndërmend eksperiencat e mëparshme të donatorëve, sidomos rastin e politikave të rregullimit strukturor në Afrikë dhe në Amerikën latine, kur merrej parasysh vetëm dimensionin ekonomik⁴. Nocioni i transparencës figuron në ballë të skemës së “reformave”, pikërisht sepse lejon bashkimin e funksionimit të ekonomisë kapitaliste dhe mënyrës *ad hoc* të ushtrimit të pushtetit.

Si mund të transformohet Shteti, në shtetin e një shoqërie sipas këtyre nocioneve të idealizuara – treg, ekonomi, demokraci, qeverisje? Duke i detyruar shtetet të modifikojnë arsenalin e tyre legjislativ dhe institucional? Kështu, në Rumani, politikat e ndryshimit që kanë si pikënisje transparencën, konceptohen nëpërmjet prizmit të së drejtës dhe të transformimeve institucionale: gjë që duhet të sillte një rritje ose një përforcim të pushtetit të qytetarëve ndaj shtetit dhe shmangien e çdo lloj tejkalimi të pushtetit të shkaktuar nga “reformat”.

Shtrohet pyetja se cilat janë pasojat e këtij programi politik ambicioz? Dinamika e shndërrimit, ashtu si dëshirohet, a zhvillohet vërtet ashtu si është treguar? Këto pyetje na bëjnë të shtrojmë çështjen e modaliteteve të futjes dhe zbatimit të këtyre programeve. Le të ndalemi konkretisht mbi ligjin nr.544 mbi transparencën e institucioneve publike, të miratuar në vitin 2001.

1 Gerard Althabe “Fundi i solidaritetit: mëshirë dhe financë” in Bernard Hours dhe Monique Selim (eds) *Solidaritet dhe kompetencë. Ideologji dhe praktikë*, Paris, Harmattan, 2003.

2 Gilbert Rist 1996, op, cit.

3 Në lidhje me këtë çështje lexuesi mund të shohë sitet e *Iris Center*, *National Democratic Institute* dhe *USAID*.

4 Shih Nicolas Guillhot “Financing the construction of “market democracies”: the World bank and the global supervision of “good governance” chap. VI in *The democracy makers. Human rights and International Order*, New York Columbia University Press, 2005.

Dy kohët e zbatimit të ligjit

Ligji nr.544 fillimisht, ishte një burim për mediat dhe OJF-të, një zgjatim i punës së tyre në drejtim të mbikqyrjes së partive politike. Ai u përdor nga këto aktorë për të denoncuar tejkalimet e pushtetit. Pati një prurje të madhe raportesh nga mediat dhe OJF¹-të në lidhje me frakturat e këtij ligji. Institucionet publike të ngarkuara me zbatimin e ligjit u bënë objekt i një fushate të gjerë mbikqyrjeje dhe verifikimi. Organizata për Demokratizimin e Rumanisë² (ODER) është një OJF rumune e specializuar në proceset e demokratizimit, d.m.th në mbikqyrjen e proceseve zgjedhore, të përdorimit të parave nga partitë politike gjatë zgjedhjeve, të reformës së ligjeve në shumë fusha, dhe sidomos atë zgjedhore, si edhe për vënien në zbatim të një “demokracie lokale”. Duhet nënvizuar këtu karakteri domethënës për temën tonë i njërit prej objektivave të shumtë të OJF-së:

“Sigurimi i transparencës në funksionimin e institucioneve publike dhe rritja e shkallës së tyre të përgjegjësisë në raport me qytetarin si përfitues direkt i këtyre shërbimeve publike”. Për shkak të historisë së saj, eksperiencës së saj në këto fusha, të rritjes së saj të gjerë në të gjithë Rumaninë dhe të lidhjeve të saj të forta me partnerët e huaj që prej vitit 1991, kjo organizatë u kërkua nga USAID dhe World Learning për të zbatuar këtë program mbikqyrjeje. Për këtë mision, u kontaktua si “partner” një organizatë tjetër e SH.B.A-ve pa degë në Rumani, (Iris Center³) e specializuar në drejtësi.

Para se të shkojmë më larg, le të ndalemi tek gjesti politik që çoi në miratimin e këtij ligji, gjest që u përgjigjet shumë faktorëve të cilët duhet t'i saktësojmë. Presionet e jashtme, sidomos ato të Komisionit Europian, ishin gjithnjë e më të forta, sa më shumë që afrohej data e anëtarësimit të Rumanisë në Bashkimin Europian. Qeveria e SH.B.A – ve, shpesh me anë të ambasadorit të saj, kritikonte shpesh dhe hapur në media, duke qenë se Rumania është pjesë eksplicite e programeve gjeostrategjike të SH.B.A – ve, dhe të NATO-s. Së fundmi, OJF-të dhe mediat nxjerrin herë pas here në dritë çështje korrupsioni, në ato raste kur këto nuk përdoren nga partitë politike si armë diskreditimi e dorës së parë. Miratimi i ligjit, në kohën kur presidencën dhe qeverisjen e kishte partia social-demokrate,⁴ është një formë përgjigjeje ndaj këtyre kritikave, një shenjë nënshtrimi ndaj normave ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, miratimi i ligjit synon të pakësojë kundërshtitë e brendshme dhe të jashtme në lidhje me legjitimitetin e qeverisjes.

Le të kthehemi te ligji nr.544. Ai ka të bëjë me institucionet publike në shkallë të gjerë - bashkitë, ministritë, administratën e presidentit, spitalet, shkollat, si edhe me organizmat që kanë marrë financime nga shteti. Sipas termave të këtij ligji, të gjithë

1 Shoqëria akademike rumune, Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Transparency Roumania për shembull.

2 Ky emër është i shpikur.

3 *Iris Center* është një organizatë shumë e çuditshme sepse është në të njëjtën kohë qendër kërkimi në shkencat sociale, *think tank* dhe OJF.

4 PSD trashëgimtare kryesore e partisë komuniste është në pushtet që prej zgjedhjeve të vitit 2000. Që prej fundit të vitit 2004, në pushtet është një koalicion i përbërë nga anëtarë të partisë demokrate dhe liberale.

institucionet, janë të detyruara të japin informacione që duhet të gjenden në selinë qendrore të institucionit. Informacionet që mund të kërkohen janë më tepër ato që kanë të bëjnë me vendimet që ka marrë institucioni, dispozitat me karakter normativ, buxhetin lokal, programet dhe strategjinë e institucionit, bilanci financiar si edhe rregulloret e ndryshme. ODER, e cila merret me këtë program të gjerë mbikqyrjeje, ka si qëllim vlerësimin e zbatimit dhe përdorimin e ligjit nr.544.

Për një periudhë prej 18 muajsh, 957 kërkesa iu dërguan institucioneve publike¹, 33 prej të cilave në nivel qendror, (17 prej tyre në ministri) dhe më tepër se 370 institucioneve publike në 6 departamente dhe në Bashkinë e Bukureshtit. OJF-ja mori vetëm 400 përgjigje. Kërkesat e ODER –ës kishin të bënin kryesisht me shpenzimet e institucioneve në paga, marrje me qera e makinave nga institucionet, telefona celularë, udhëtime të deputetëve brenda ose jashtë vendit, si edhe buxheti, burimet e financimit dhe pronat e patundshme të institucionit. Pjesa tjetër e këtyre kërkesave kishin të bënin me vetë zbatimin e ligjit: nga njëra anë, regjistri i kërkesave të informacionit në kuadrin e vetë këtij ligji, personat e caktuar në këtë detyrë dhe të kontaktuar për të dhënë informacionin, orët e hapjes për publikun, nga ana tjetër verifikimi i afateve të parashikuara për të marrë përgjigje për pyetjet². Ashtu si e nënvizonte presidenti i saj në shumë intervista, ODER-ës nuk ka si qëllim të testojë cilësinë e informacioneve, por reagimin e institucioneve. Megjithë këtë, përgjigjet me vështirësi arrijnë nivelin 50%. Si e justifikojnë institucionet refuzimin për t’u përgjigjur kërkesave të ODER-ës në lidhje me ligjet? Çfarë shpjegimesh mund të japin ato kur tregohen me gisht nga një OJF?

Fillimisht ata nxjerrin pretekstin se nuk janë institucione publike, gjë që mund të jetë rasti i një bashkie³, ose i një ndërmarrjeje tregëtare që i përket shtetit. Më pas, duke i përdorur me shkathtësi ligjet: punësimi i këshilltarëve lokalë për shembull, nuk kishte të bënte me informacionin publik por me kodin e punës, gjë që nga pikëpamja legjislative është krejt e gabuar. Kjo nuk e pengon institucionin të refuzojë t’u përgjigjet pyetjeve të lidhura me paratë dhe me shpenzimet publike. Një truk tjetër është referimi ndaj ligjit që në fakt dallon informacionet publike nga dokumentet publike: kategoria e dytë, që përmban informacione të klasifikuara dhe sekrete, nuk duhet, sipas ligjit, të shpërndahen në publik. Ky dallim është problematik sepse shumë dokumente përmbajnë si informacione me interes publik ashtu edhe të dhëna personale. Le të mendojmë vetëm për regjistrin e kërkesave për informacion që regjistron jo vetëm kërkesat por gjithashtu edhe personat që i kanë bërë. Kjo veçantësi e ligjit, hap edhe një problem tjetër: institucionet mund të kalojnë në kategorinë “të pashpërndarshme” edhe informacione që ligji i detyron të jenë publike. Shpenzimet e një njësie bashkiake

1 Rezultatet e cituara në vijim të tekstit janë rezultat i anketës të realizuar nga shoqata, anketuesi ka krahasuar versionin në gjuhën rumune dhe në gjuhën angleze.

2 5 ditë nëse është fjala për refuzim, 10 ditë nëse është përgjigje pozitive, 30 ditë nëse puna është “komplekse, e vështirë dhe me volum. Në rastin e fundit duhet që kërkuesi të vihet në dijeni brenda 10 ditësh.

3 “Një bashki nuk është një institucion publik. Është një strukturë funksionale me një aktivitet të përhershëm” “ Letër përgjigje për ODER”.

të Bukureshtit për shembull, gjatë një periudhe prej një viti, mund të shndërrohen në informacione që dalin nga kuadri i interesit publik, ashtu si edhe buxheti vjetor. Disa institucione, në nivelin qëndror, nuk iu përgjigjën asnjë kërkesë për të njëjtat arsye.

Për më tepër, për të patur këto dokumente, ligji parashikon se duhen paguar shpenzimet për prodhimin e tyre. Një komunë kërkoi thjesht dhe hapur pagesë për të lëshuar këto dokumente, kurse në disa raste, shumat e kërkuara i tejkalojnë ato reale, p.sh: 150 000 Lei¹ është çmimi që kërkohet për një fotokopje, ndërkohë që mund të gjenden në Budapest me 1000 Lei për faqe. Një agjenci sigurimesh mjekësore kërkoi shumën modeste prej 15 000 Lei. Por pak njerëz mund të përballojnë shumat të tilla. Cilatdo qofshin qëllimet fillestare të institucionit publik, shumat e kërkuara luan një rol shkurajues dhe pengon marrjen e informacioneve të kërkuara, duke dalë nga kuadri i ligjit më tepër me anë të parodisë, sesa për shkak të ndonjë pengese konkrete. Si mund të shpjegohet një numër i tillë refuzimesh? A mund të shpjegohet ky reagim si një parapritë për korrupsionin, për “kulturën e mosbesimit të funksionarëve”, duke përdorur termit e përdorur nga drejtori i përgjithshëm i ODER-ës?

Pas publikimit të këtyre rezultateve, ODER-së ka mbledhur institucionet e pyetura në tryeza të rrumbullakëta të organizuara në bazë departamentesh. U arrit në përfundimin se një numër i madh ndërmjet tyre, sidomos ndër institucionet publike, nuk kishin as dijeni për ekzistencën e këtij ligji dhe aq më pak për modalitetet e zbatimit të tij, pra ato nuk ishin në gjendje t’u përgjigjeshin kërkesave të ODER-ës dhe “qytetarëve”. Duke patur parasysh ndryshimet e ndodhura në tërësinë e ligjeve që ka miratuar shteti rumun që prej 15 vjetësh, dy vjet nuk mjaftojnë aspak për të vënë në zbatim një institucionalizim të konsideruar si themelor.

Megjithatë, sipas drejtorit të ODER-së, qëllimet e këtij projekti të mbikqyrjes janë arritur: organizata ka zbuluar praktika të mosrespektit dhe të mosfunktionimit të shtetit të së drejtës nga institucionet lokale, rajonale, kombëtare, tendencat e pakta dhe/ose aftësinë për të pranuar ndryshimet dhe për t’iu përgjigjur aktorëve të jashtëm. Dobësitë e institucionalizimit dolën në dritë, por me qëllim që operacioni i ODER-ës të mos ishte një “fluskë sapuni”, në vijim të kësaj pune, një OJF² mori përsipër vëzhgimin e shkeljeve ndaj ligjit nr.544, mbledhjen e ankesave dhe krijimin e materialeve të lidhura me këtë ligj.

Duke u ndalur te konsideratat e ODER-së, do të tundohej të besojmë se suksesi shumë relativ i ligjit varet nga kritere kohe, mjetesh, madje edhe zakonesh. Ndoshta mund edhe të mendojmë, duke qëndruar në nivelin e qëllimeve të ODER-së, se rezultatet përfaqësojnë një anë pozitive, në kuptimin se tregojnë një institucionalizim të pjesshëm të ligjit dhe vullnetin e disa administratave publike për ta marrë parasysh këtë. Megjithatë, një ngjarje që ndodhi në janar 2004 dhe ushqeu për më shumë se 6 muajsh komentet e shtypit, dhe ligji nr.544, në qendër të kësaj çështjeje, na tregon një tjetër aspekt të vendosjes së transparencës.

1 Vlera e një euro në atë kohë është midis 36000 e 42000 Lei.

2 OJF në fjalë (Qendër burimesh për akses të lirë në informacionin me interes publik) që ka pesë qendra rajonale, financohet për këtë program nga PNUD-i. Programi zhvillohet në “bashkëpunim” me agjencinë për strategjinë e qeverisë rumune.

Në kufijtë e ligjit, përtej normës

Që prej shumë muajsh, një parti politike – Aksioni Popullor (AP) – solli në vëmendjen e medias konfuzionin që rrethonte “rinovimin e pallatit të drejtësisë”: për të realizuar këto punë, qeveria e PSD u bë garant për një kredi prej afërsisht 34 milion euro të kërkuara BE-së. Çuditërisht, shumat e vlerësuara për rinovimin nuk janë as sa gjysma e shumës së kërkuar, gjë që nuk përbënte problem për Brukselin gjatë akordimit të kredisë. Pas hetimit të kryer nga AP, një parti që pothuaj nuk ekziston fare në planin elektoral, u konstatua një mungesë prej 18 milion euro. Në hetim u përfshinë shumë ministra për shkak të përfshirjes së ndërmarreve të tyre në punët e rinovimit, gjë që shtron edhe çështjen e legjitimitetit të thirrjeve për tender. AP mbledh firmat e anëtarave të saj, vendos të bëjë apel ndaj ligjit nr.544/2001 dhe kërkon kopjet e shpenzimeve në para për punët. Ministri i drejtësisë reagon pa vonesë: policia kryen një aksion të gjerë në Bukuresht, më shumë se 200 persona, që përfaqëson diçka më pak se numri i personave që kanë firmosur, u thirrën në komisariate pa ndonjë motiv të veçantë. Sipas shtypit dhe AP-së, gjatë shpërndarjes së thirrjeve për në komisariat në banesat e këtyre personave, policia e niste hetimin pranë fqinjëve, të afërmëve të personave të thirrur. Motivi që dha ministrja e drejtësisë për të justifikuar *a posteriori* hetimin gjyqësor, ishte akuza për falsifikim, pasi në dokumentat e petitionit u gjendën disa pasaktësi. AP do të reagojë nëpërmjet një ankimi ndaj drejtësisë me qëllim marrjen e informacioneve të kërkuara nëpërmjet ligjit nr.544.

Një muaj më vonë, BE reagon me një kritikë të ashpër ndaj zbatimit të reformave nga qeveria, sidomos në lidhje me korrupsionin dhe pavarësinë e drejtësisë. Si përgjigje, tre ministra, një prej të cilëve ministrja e drejtësisë Rodica Stanioiu¹, u detyruan të japin dorëheqjen, duke ndjekur këtu udhëzimet e BE-së. Megjithatë është vetëm një gjest “sa për të zënë sytë” sepse Rodica Stanioiu, e dorëhequr nga posti i ministres së drejtësisë, u emërua këshilltare e presidentit Iliesku dhe do të figurojë ndër pioneret e partisë social-demokrate gjatë zgjedhjeve presidenciale dhe legislative të vitit 2004: në këtë rast, më i përshtatshëm është termi rivendosje sesa sanksion.

Dhe në dhjetor të vitit 2004, ende nuk dihej se ku shkuan 18 milion eurot që mungonin².

Konkluzion: Demokratizim apo standartizim i hapësirës politike?

Le të përpiqemi të qartësojmë elementët e lidhur me integrimin e normave të qeverisjes së mirë, dhe më veçanërisht, me ato që kanë të bëjnë me transparencën. Së pari, në një konfigurim të tillë, OJF-të duket sikur ka

1 Rodica Stanioiu është një nga personazhet më të kundërshtuar të skenës politike rumune: e afërt me Ion Iliescu, (ish president i Rumanisë në vitet 1996 – 2004) është akuzuar për shumë çështje abuzimi pushteti dhe abuzim të mirash sociale.

2 Në momentin që kundërshtarja e PSD u zgjodh në fund të vitit 2004, pati shumë diskutime për t'i bërë publike informacionet në lidhje me këtë çështje.

një mision të dyfishtë: të institucionalizojnë ligjin dhe të kontrollojnë zbatimin e tij, mision që mund të duket i çuditshëm, sepse është misioni i vetë shtetit. Kështu OJF-ja ndërmerr një proces të tërheqjes së shtetit nga funksionet publike me qëllim që të bëjë me mbikqyrjen e këtij të fundit në lidhje me ligjet. Ligji i transparencës mendohet të favorizojë atë çka retorika e ligjërimit ndërkombëtar e quan parim “të përgjegjësive” (accountability) dhe përfshirjen e marrëdhënies midis të zgjedhurve dhe zgjedhësve. Mund të supozohet, edhe pse kjo është e vështirë për t’u verifikuar, se një OJF kontribuon në respektin të paktën relativ të transparencës: gjë që për shtetin do të thotë përfshirje në një marrëdhënie më të hapur me qytetarët nëpërmjet vendimeve më të lexueshme. Por, një konceptim i tillë i demokracisë do të thotë gjithashtu se qytetari nuk është i ftuar të marrë pjesë në marrjen e vendimeve, se është i përjashtuar nga ky proces mbi të cilin ka vetëm të drejtë vëzhgimi, duke mos patur pushtet. Edhe pse është fjala për favorizimin e përfshirjes së qytetarit në raport me shtetin, dhe bërjen e strukturave politike më të “përgjegjshme” ndaj popullsisë, kjo e fundit mungon krejtësisht në këtë proces. Në fakt, si për ODER-së, ashtu edhe për donatorët, çështja është të sigurohet nëpërmjet këtyre termave – qytetar (dhe gjithçka që përfaqëson ai) si parim legjitimiteti, një lobing në institucionet publike dhe si rrjedhim një formë pushteti (qoftë edhe e përkohshme). Kjo kërkesë për transparencë, me tendencë për tu bërë e përgjithshme dhe e skalitur pas qeverisjes së mirë, është pra e orientuar drejt normave normative të ardhura nga jashtë, por gjithashtu, edhe pse në një masë më të vogël, e artikuluar rreth kërkesave të brendshme të OJF-ve dhe mediave.

Prirja e dytë e ODER-së, duke u shndërruar në boshtin e mbikqyrjes së zbatimit të ligjit, është të zëvendësojë grupet sociale dhe në këtë mënyrë t’u përgjigjet pritshmërive të sistemit ndërkombëtar. Duke operuar në këtë mënyrë, organizata vepron në mënyrë të pavullnetshme në shumë fusha: nga njëra anë duke konstatuar të metat e ligjit ajo legjitimon mënyrën se si ky ligj është prodhuar si një zëvendësues i sovranitetit popullor, dhe nga ana tjetër, i siguron legjitimitet vetë veprimit të saj duke denoncuar mosfunksionimet që sjell ligji. Ajo vepron në kah të kundërt me atë që kërkon të realizojë, sepse prodhon argumente që lejojnë të relativizohet dështimi i qeverisjes rumune duke e parë atë thjesht si çështje “mosfunksionimi” për shkak të “reformave” dhe “tranzicionit”. Politika e transparencës për OJF-të mund të jetë prodhuar dhe riprodhuar si një instrument legjitim i transformimit të shoqërive post-komuniste, në përputhje me optikën që imponon në mënyrë të heshtur këtë mënyrë të menduarit të demokratizimit. (midis “progresit demokratik” dhe “mosfunksionimit”, “tranzicionit” drejt demokracisë së tregut).

Nënshtrimi i shtetit ndaj një udhëzimi të jashtëm në këtë situatë, është i dukshëm. Gjithashtu mund të vëmë re se devijimi nga kjo normë në përgjithësi bëhet nëpërmjet ligjeve. Kjo na bën të shtrojmë pyetjen se pse shteti reagoi në mënyrë aq të shpejtë dhe shkurajuese ndaj veprimit të AP-ës.

Kërkesa e Aksionit Popullor duket se del nga kuadri normativ i zënë nga ODER-së dhe nga shteti. Duke prekur drejtpërdrejtë shtetin dhe gjymtyrët e tij në fushën e marrëdhënies me Bashkimin Europian – me qëllim që të rinovim u dha nga ky

aktor politik- Aksioni Popullor, e preku qeverinë në pikën e saj të dobët, domethënë në legjitimitetin e saj në sytë e partnerëve ndërkombëtarë. Për më tepër, integrimi në Bashkimin European, i paraqitet popullsisë nga të gjitha elitat politike, si një objektivi që duhet arritur. Për të kuptuar këtë situatë, nuk është aq i rëndësishëm fakti se ligji nuk është respektuar: ky përfitim i supozuar fondesh në zemër të shtetit dhe në sytë të gjithëve, nuk mund të vendoset në kategorinë e zakonshme të “mosfunksionimeve” që do të “zgjidhen”, sikurse përsëriste vazhdimisht kryeministri PSD-ist (gjatë periudhës 2000-2004) Adrian Nastase. Duket pra se ushtrimi i dhunës ndaj personave që nënshkruan peticionin e AP-ës, shprehte frikën e PSD-së në lidhje me ilegjitimitetin që prek shtetin kur ky i fundit del nga kufijtë e lejuar të mosrespektimit të rregullave të qeverisjes, që nuk ka më justifikim. Sigurisht, nuk është ndonjë gjë e jashtëzakonshme që shteti të ndodhet jashtë standarteve ndërkombëtare në fushën e demokratizimit; por gjithsesi ndodh pak më rrallë që ai të mos mundë të justifikojë këtë moment. Kërkesat e AP-ës u përqëndruan mbi këtë pikë të dobët: rrugëdalja e vetme për t'i bërë ballë kësaj dobësie, për partinë në pushtet dhe në presidencë, ishte dorëheqja e ministres së drejtësisë.

Më në fund, shteti dhe OJF-ja e ndajnë bashkë këtë presion që vjen nga jashtë. Por nëse qeverisja e “mirë” është një mënyrë e importuar e administrimit të shoqërisë, nëse OJF dhe shteti duhet të raportojnë jashtë zbatimin e mirë të saj, a kemi të drejtë të flasim për një zhvillim demokratik? A mos është më e përshtatshme të flasim për një kufizim të autoritarizmit dhe të korrupsionit sipas drejtimeve të ndërkombëtarëve për “demokracinë”, që synojnë në të njëjtën kohë ecurinë e mirë të kapitalizmit? Në këtë kuptim, është momenti të kujtojmë se ligji nr.544 nuk ishte pasojë e një lëvizjeje sociale dhe nuk tregon raport forcash në shoqërinë rumune: ai nuk është në asnjë moment shprehje e një forme të çfarëdoshme të sovranitetit popullor, përkundrazi. Ky shembull mesa duket tregon mirë se politikat e demokratizimit të përfshira në termat e “qeverisjes së mirë” varen nga teknokracia politike dhe kanë si qëllim adoptimin kozmetik të një arsenali legjislativ dhe konstitucional demokratik. Ky konstatim është edhe më i qartë nëse marrim parasysh se, ligjet e miratuara ka shumë mundësi të mbeten të huaja për qytetarët rumunë.

*Në shërbim të imperializmit informal:
Instrumente të politikës
austro-hungareze ndaj Shqipërisë*

— Dr. Kurt Gostentschnigg* —

ABSTRAKT. *Prapambetja relative e Austro-Hungarisë në krahasim me vendet perëndimore industriale dhe kriza e brendshme ekonomiko-strukturore ishin shkaqet për përqendrimin e politikës komerciale dhe komunikative (të transportit) në drejtim të Evropës juglindore. Që nga Kongresi i Berlinit më 1878, Austro-Hungaria konkurronte me Italinë lidhur me kontrollin mbi rrugët detare dhe tokësore për të siguruar hegjemoninë komerciale dhe strategjike mbi Ballkanin perëndimor. Në këtë kontekst, territoret shqiptare kishin një rëndësi vendimtare. Mjetet për ta arritur këtë qëllim, ishin linja detare “Lloyd”, tregtia nga porti i Triestes, komitetit austriak “Shqipëria”, i mbështetur nga Ministria e jashtme, dhe konvikti i studentëve shqiptarë në Vjenë, i ndihmuar nga Ministria e jashtme dhe Ministria tregtare. Austro-Hungaria luante një rol të rëndësishëm për arritjen e pavarësisë së Shqipërisë, por njëkohësisht ajo pretendonte rritjen e influencës së saj politike, kulturore dhe ekonomike mbi këtë vend të vogël në periferinë e saj jugore nëpërmjet një imperializmi informal në bazë të dhunës strukturore.*

* Autori është pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër dhe Universitetin “Karl Franz” në Graz, Austri. Ai ka dhënë mësim gjithashtu edhe në Universitetin e Vjenës, në Institutin e Përkthimeve të Graz-it në Austri si dhe në Institutin e Historisë në Tiranë pranë Fakultetit të Histori – Filologjisë. Ai ka kryer doktoraturën në histori pranë Universitetit të Grazit, Austri ku ka marrë titullin doktor në vitin 1996. Kurt Gostentschnigg ka kryer edhe një sërë studimesh të tjera në fushën e marrdhënieve historike mes Austro-Hungarisë dhe Shqipërisë. Këtu vlen të përmendim punimet si “Die Verflechtung von Wissenschaft und Politik am Beispiel der österreichisch-ungarischen Albanologie”, botuar në: Südost-Forschungen 58 (1999), f. 221-245; “Pleksja e Albanologjisë austro-hungareze me interesat politike të Monarkisë së Dyfishtë” botuar në: Studime Albanologjike 2 (1997), Nr. 3, f. 44-52; “Protectorati i Kultit austro-hungarez mbi popullsinë katolike të Shqipërisë së Veriut” botuar në: Phoenix 4 (2000), Nr. 1-2, f. 36-43; “Kontributi i Austrisë (Austro-Hungarisë) për Shqipërinë e Veriut në fushën e arsimit. Në: Seminari i pestë ndërkombëtar “Shkodra në Shekuj”. 25-26 Tetor 2002. Vëll. 1. Shkodër: 2005, f. 168-174.

Interesat vitale të Austro-Hungarisë në Evropën Juglindore

Fundi i pushtetit dominues të Austro-Hungarisë në Gjermani e Itali si dhe hegjemonia ruse në Evropën Lindore e kthyen vëmendjen politike të Monarkisë së Dyfishtë drejt hapësirës së Evropës Juglindore. Pas sukseseve të para, politika e Austro-Hungarisë në Ballkan që prej Kongresit të Berlinit e deri tek Luftërat Ballkanike, pësoi në thelb një humbje të vazhdueshme të influencës ndaj vendeve ballkanike. Suksesi diplomatik i arritur në Kongresin e Berlinit mundi të ruhej deri në mesin e viteve '80-të përmes një politike të zhdërvjellët koalicionesh. Por tashmë, në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjetë, këto aleanca diverse tregoheshin si të brishta. Ripërtëritja e "*Lidhjes Treshë*" (*Dreibund*), më 1887, me përcaktimet e saj lidhur me Ballkanin, shënoi fillimin e humbjes së pozitës së Monarkisë Danubiane në Evropën Juglindore. Më pas Austro-Hungaria kërkoi mbështetje të re tek Aleanca Mesdhetare, e cila fillimisht e ndihmoi ta kapërcente mungesën e mbështetjes nga ana e Perandorisë Gjermane. Shkëputja e Anglisë prej politikës së Status Quo-së në Orient, në mesin e viteve '90, nuk i la Monarkisë zgjidhje tjetër përveçse të bashkëpunonte me kundërshtarët e saj më të fortë në Ballkan, Rusinë dhe Italinë. Vitet deri tek Kriza e Aneksimit u karakterizuan nga një përkeqësim i marrëdhënieve me Perandorinë Gjermane dhe me shtetet ballkanike, nga një rritje e vazhdueshme e rivalitetit me Italinë për Çështjen e Adriatikut dhe nga vështirësimi gjithnjë e më i madh i bashkëpunimit me Rusinë për Çështjen e Maqedonisë. Ndryshimi në dinastinë serbe më 1903 dhe konflikti doganor shumëvjeçar me Serbinë sollën emancipimin afatgjatë të Serbisë nga patronazhi austro-hungarez dhe aleancën ruso-serbe. Ndërrimet në kryesinë e Ministrisë së Jashtme dhe të Ushtrisë në vitin 1906 do të thonin një politikë më agresive në Ballkan, e cila solli me vete humbjen e pozicioneve të tjera diplomatike.¹ Aneksimi i Bosnje-Hercegovinës çoi në prishjen përfundimtare me Rusinë, e cila iu afrua Italisë dhe i bashkoi vendet ballkanike në një aleancë kundër Perandorisë Osmane dhe të Austro-Hungarisë. Izolimi ndërkombtar i Monarkisë Habsburgase që pas Luftërave Ballkanike e përjashtoi atë ndjeshëm nga procesi i ridimensionimit të raporteve në Evropën Juglindore. Në Ballkanin perëndimor asaj i mbeti në fund vetëm një partner aleat: Shqipëria që akoma nuk ekzistonte si shtet, ndaj së cilës Italia kishte pretendime hegjemone.

Një tablo e ngjashme mund të vërehet në fushën e politikës ekonomike. Prapambetja relative e ekonomisë austro-hungareze në krahasim me vendet industriale perëndimore dhe problemet në strukturën ekonomike të Monarkisë së Dyfishtë e bënë të domosdoshëm përqëndrimin e politikës tregtare dhe komunikative drejt vendeve të Ballkanit. Zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike të Austro-Hungarisë me Ballkanin deri në Luftën e Parë Botërore lë të kuptohet si një sprapsje e vazhdueshme e Monarkisë së Dyfishtë nga pozitat e saj të dikurshme ekonomike. Ajo nuk mundi të

1 Helmut Rumpler: Die rechtlich-organisatorischen und sozialen Rahmenbedingungen für die Außenpolitik der Habsburgermonarchie 1848-1918. Në: Die Habsburgermonarchie 1848-1918. Bd. VI. Die Habsburgermonarchie im System der internationalen Beziehungen. 1. Tbd.. Hg. v. Adam Wandruszka u. Peter Urbanitsch. Wien: Vlg. d. ÖAKWW 1989, f. 84-86.

realizonte siç dëshironte as pretendimin e saj hegjemon për lundrimin në Danub dhe as interesat e saja të rëndësishme në lidhje me ndërtimin e hekurudhave në Ballkan. Edhe kontratat tregtare, të nënshkruara që në vitet '70 me shtetet ballkanike Serbi, Rumani dhe Bullgari dokumentojnë tërheqjen graduale ekonomike të Monarkisë Habsburgase në fushën e saj fillestare. Tendenca e përgjithshme e transportit tregtar tregoi një reduktim gradual të pjesës austro-hungareze në totalin e tregtisë së jashtme të shteteve ballkanike, në një kohë që rritej vlera absolute e shkëmbimit të mallrave ndërmjet palëve përkatëse.¹ Emil Palotás rrok thelbin e çështjes kur shprehet se: “*Rreth fundit të shekullit ajo (Austro-Hungaria), jo vetëm ishte e detyruar të kalonte në një pozicion mbrojtës kundrejt shteteve të vogla, por dhe aleati i saj politik më i rëndësishëm (d.m.th. Perandoria Gjermane) u shfaq si konkurrent ekonomik në ‘tregun natyral’ të Monarkisë dhe me ndërhyrjen e tij agresive kontribuoi për minimin e mëtejshëm të pozitave të atjeshme austro-hungareze... Në vend të ekspansionit aq të dëshiruar ekonomik, mbrojtja e pozitave u bë tani detyra kryesore.*”² Thelbin e konceptit ekonomik të mbrojtjes së Monarkisë së Dyfishtë e përbënte hegjemonia ekonomike në përfundim të Gadishullit Ballkanik deri në Selanik, ku pikërisht territori shqiptar luante një rol kyç.

Funksioni tregtaro-politik i Shqipërisë për Austro-Hungarinë

Dobësimi i vazhdueshëm i pozicionit të saj politik dhe ekonomik në shtetet e Ballkanit, që po bëheshin gjithnjë e më të pavarura, nxiti në çerekun e fundit të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të interesin e veçantë të Monarkisë Austro-Hungareze ndaj territorit shqiptar, respektivisht ndaj formimit të shtetit shqiptar, në kuadrin e të cilit gjatë kësaj periudhe do të zhvilloheshin marrëdhënie intensive politike, ekonomike dhe kulturore ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Shqipërisë. Përpjekjet për influencë politike nga ana e Austro-Hungarisë hasën në një terren të frytshëm, pasi mes shqiptarëve nuk ekzistonte një ndjenjë e fortë bashkimi. Etnikisht ata ishin të ndarë në dy fiset kryesore të Gegëve dhe Toskëve, nga ana gjuhësore në dy dialektet kryesore: gegërisht dhe toskërisht, ndërsa nga ana fetare në katolikë, ortodoksë dhe myslimanë. Gegët e veriut të Shqipërisë përdornin shkronja latine ndërsa toskët e jugut shkronja greke. Toskët ortodoksë anonin nga Greqia, ndërsa gegët katolikë, për shkak të Protektoratit të Kultit (*Kultusprotektorat*), prireshin drejt Austro-Hungarisë.

1 Rumjana Prešlenova: Probleme der Handelsbeziehungen Österreich-Ungarns zu den Balkanstaaten am Ende des 19. und Anfang des 20. Jahrhunderts. Në: Wirtschafts- und Kulturbeziehungen zwischen dem Donau- und dem Balkanraum seit dem Wiener Kongress. Hg. v. Institut für Geschichte der Universität Graz. Abt. f. Südosteuropäische Geschichte. Graz: 1991. (= Zur Kunde Südosteuropas II/17), f. 89.

2 Emil Palotás: Die Rolle der Wirtschaftsbeziehungen zwischen Österreich-Ungarn und den Balkanländern in den letzten Jahrzehnten des 19. Jahrhunderts. Në: Wirtschafts- und Kulturbeziehungen zwischen dem Donau- und dem Balkanraum seit dem Wiener Kongress. Hrsg. v. Institut für Geschichte der Universität Graz. Abt. f. Südosteuropäische Geschichte. Graz: 1991. (= Zur Kunde Südosteuropas II/17), f. 80 v..

Myslimanët anonin nga Perandoria Osmane, por në rast se kjo do të shpërbëhej, ata do të angazhoheshin për një Shqipëri autonome nën protektoratin e Austro-Hungarisë. Ata preferonin Monarkinë Habsburgase kundrejt Fuqive të tjera, ngaqë e çmonin për tolerancën e saj ndërfetare dhe rezistencën ndaj Pansllavizmit.

Sa më shumë dobësohej pozita ekonomike e Austro-Hungarisë, sidomos në lindje të Gadishullit Ballkanik, aq më i madh bëhej interesi i saj tregtaro-politik dhe komunikativ ndaj Shqipërisë. Tregtia shqiptare ishte e rëndësishme për epërsinë austro-hungareze në bregun lindor të Adriatikut si dhe për rrugën tregtare nga Vjena dhe Budapesti për në Selanik.¹ Për Austro-Hungarinë, Shqipëria agrare ishte një vend ideal për investime kapitalesh dhe një treg i volitshëm, sepse ekonomia, komunikacioni dhe struktura shoqërore ishin ende në fazat fillestare të zhvillimit. Edhe pas shpalljes së pavarësisë, ishin Luftërat Ballkanike dhe kryengritjet kundër Princ Wied-it ato që penguan zhvillimin e qëndrueshëm të borgjezisë shqiptare. Në prag të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore rrjeti komunikativ vetëm sa ishte zgjeruar paksa – vetëm 182,5 km rrugë më 1912/13! – dhe për këtë arsye tregtia zhvillohej kryesisht në rrugë karvanesh.² Pikërisht fakti i mungesës së një infrastrukture dhe pasiguria politike i pengonte qarqet financiare dhe tregtare austro-hungareze të ndërmerrnin investime më të mëdha. Prandaj shkalla e marrëdhënieve tregtare të qëndrueshme dhe numri i filialeve të firmave dhe bankave austro-hungareze mbeteshin të ulët.³ Njëri prej sipërmarrësve më aktivë austriakë ishte Paul Siebertz, drejtor i Shoqërisë Tregtare Austro-Shqiptare. Ai ngriti një hotel, një shtypshkronjë dhe një magazinë tregtare në Vlorë dhe planifikoi më 1914 ndërtimin e objekteve të tjera në Durrës, Tiranë dhe Shkodër.⁴ Vetëm në fillim të shekullit të 20-të u konstatua një hov i përgjithshëm i tregut shqiptar, pasi u përmirësua organizimi i rrjetit tregtar dhe u rrit kërkesa për mallra të lira industriale, sidomos për tekstilet, si pasojë e rritjes së numrit të popullsisë.⁵

Që nga Paqja e Sistovit më 1791 tregtia shqiptare ra gradualisht nën varësinë e Monarkisë Habsburgase. Në çerekun e parë të shekullit të 19-të tregtia veneciane dhe evropiano-lindore u zhvendosën gjithnjë e më shumë për në Trieste.⁶ Në vitin 1877 qeveria austro-hungareze nënshkroi një marrëveshje me shoqërinë e transportit detar “Lloyd” për zgjerimin e transportit në Adriatik, veçanërisht me Shqipërinë. U ra dakort për krijimin e tri linjave të rregullta: dy linja vajtje-ardhje nga Triestja

1 Zef Prela: Mbi politikën austro-hungare në Shqipëri në çerekun e fundit të shek. XIX-të. Në: Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës. Ser. Shkenc. Shoq. (1960), 1, f. 209.

2 Një përshkrim të detajuar të marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë në fillim të shek. të 20 na jep: Gazmend Shpuza: Aspekte nga gjendja ekonomike dhe shoqërore e Shqipërisë në fillim të shekullit XX. Në: Studime Historike 14 (1977), 1, f. 93-121.

3 Michael Behnen: Rüstung-Bündnis-Sicherheit. Dreibund und informeller Imperialismus 1900-1908. Tübingen: Niemeyer 1985. (= Bibliothek des Deutschen Historischen Instituts in Rom 60), f. 405.

4 Guido Freiherr von Sommaruga: Meine Wahrnehmungen in und über Albanien. Në: Albanien. Mitteilungen des österreichischen Vereins zur Förderung Albaniens. (Albanienkomitee) 1 (1914), Nr. 1, f. 8.

5 Zef Prela: Aspekte ekonomike të depërtimit paqësor të Austro-Hungarisë në Shqipëri (1900-1912). Në: Studime Historike 3 (1966), 2, f. 80.

6 Po aty, f. 78.

drejt Shqipërisë me 52 lundrime në vit dhe një linjë vajtje-ardhje nga Fiumja (sot Rjeka) drejt Shqipërisë me 26 lundrime në vit.¹ Më 1904 *Lloyd*-i vendosi një linjë direkte nga Fiumja për në Obot. Megjithë uljen, Austro-Hungaria mund ta ruante pozicionin e saj dominues në Shqipëri përsa i përket lundrimit detar dhe importit të mallrave me avullore nga dhe drejt Shkodrës, Durrësit dhe Vlorës.² Nga Triestja kryhej ekskluzivisht importi i sheqerit dhe i kafes dhe në pjesën dërrmuese ai i orizit, miellit, pijeve alkoolike, vajgurit, lëndëve ndezëse, hurmave, portokalleve, limonëve dhe frutave të tjera ekzotike si dhe i lëndëve drusore për përpunim.³ Në importin e tekstileve (mallra pambuku dhe li) drejt Shqipërisë, Monarkia e Dyfishtë konkurronte me Britaninë e Madhe dhe Italinë, kundrejt të cilave në periudhën 1900 deri 1912 ajo humbte terren. Gjithashtu importoheshin në Shqipëri këta artikuj austro-hungarezë: oriz, miell, alkool, hekur, çelik, metale dhe nënprodukte metalike, gozhdë, tel, vajgur, mallra porcelani, prodhime qelqi, sapunë, qirinj, artikuj farmaceutikë, letër duhani, karton, lëndë druri për ndërtim dhe produkte drusore.⁴ Artikulli kryesor i eksportit shqiptar ishte vaji i ullirit ku pjesa më e madhe shkonte për në Trieste. Krahas kësaj eksportoheshin nëpërmjet Triestes të paktën në masën 50% edhe drithëra, misër, duhan, mish pule, vezë, bagëti, lëkurë, gëzofë, lesh deleje, kocka, brirë, krifë kali, sanë dhe asfalt.⁵ Pjesa e Austro-Hungarisë në volumin e gjithë tregtisë së jashtme (import dhe eksport) të Shqipërisë, ishte mesatarisht 50% në vit. Por këtu nuk përfshihen ato mallra, të cilat hynin në Shqipëri prej Monarkisë përmes rrugëve të tjera. Italia, me një pjesë prej 25%, ishte konkurentja më e fortë e Monarkisë.⁶ Me gjithë rritjen absolute, tregtia e Austro-Hungarisë me Shqipërinë kishte shënuar një ulje relative, sepse Perandoria Osmane nuk ndërmerre masa gjithëpërfshirëse për përmirësimin ekonomik e social dhe rivaliteti në fushën tregtare dhe kulturore me Italinë kishte një efekt pengues.⁷ Monarkia mund ta ruante dominimin e saj në Shqipëri, mirëpo asaj i duhej të pranonte humbjen e monopolit të saj relativ që kishte pasur në shekullin e 19-të. Pjesa e Austro-Hungarisë në tregtinë e jashtme të Shkodrës dhe Durrësit pësoi një rënie nga 70% në vitin 1880 në 40% më 1910.⁸ Shkodra ishte tregu më i rëndësishëm shqiptar për Monarkinë. Tregtarë shqiptarë nga Shkodra ishin vendosur në Trieste dhe kryenin transaksionet ndërmjet fabrikantëve austro-hungarezë dhe konsumatorëve shqiptarë.⁹ Konsulli Král që i mendimit se nuk ishte vetëm një çështje e politikës tregtare por edhe një çështje nderi, që flamuri austro-hungarez shpalohej

1 Po aty, f. 78 v..

2 Po aty, f. 91, 96 v. dhe 99 v..

3 Ignaz Rippel: Der Anteil Österreich-Ungarns am Wirtschaftsleben Albaniens und dessen Ausgestaltung. Në: Albanien. Mitteilungen des österreichischen Vereins zur Förderung Albaniens. (Albanienkomitee) 1 (1914), Nr. 2, f. 31.

4 Prela: Aspekte ekonomike, f. 85 dhe 89.

5 Po aty, f. 87, 91 dhe 98.

6 Rippel, Nr. 1.

7 Prela: Aspekte ekonomike, f. 82 dhe Shpuza: Aspekte nga gjendja ekonomike, f. 110.

8 Prela: Aspekte ekonomike, f. 78 dhe 81.

9 Po aty, f. 87.

deri në tregun e Shkodrës.¹ Por pjesa e linjës lundruese italiane Puglia në futjen e mallrave në Shkodër u rrit në fillim të shekullit të 20-të nga 15,5% në 62%.² Në tregtinë e eksport-importit të Durrësit, Austro-Hungaria arriti ta ruante supremacinë e saj. Një rënie pati në vitin 1908/09 për arsye të të korrave të këqija dhe të bojkotit të Turqisë, ndërsa në vitin 1911/12 për shkak të kryengritjeve shqiptare dhe Luftës së Tripolit.³ E njëjta gjë vlente dhe për tregtinë me Vlorën, e cila nuk kishte përmasat e asaj me Shkodrën dhe me Durrësin, sepse një pjesë e mallrave dërgohej me anije nëpër Durrës dhe sistemi i transportit prej brendësisë së vendit e deri tek porti ishte i pamjaftueshëm.⁴ Si përfundim mund të thuhet se, përsa i përket politikës tregtare dhe lundruese deri në fund të shekullit të 19-të, Monarkia mbretërore-perandorake arriti të siguronte nëpërmjet vaporeve të Lloyd-it dominimin e padiskutueshëm në transportin tregtar ndërkombëtar me Shqipërinë. Por ofensiva tregtare e Italisë që prej vitit 1901 solli me vete konstatimin e dhimbshëm, se më 1906 linja lundruese *Lloyd* mund të mbronte pozitën e saj të privilegjuar kundrejt linjave italiane realisht vetëm në Shqipërinë e Mesme dhe se as gjatë Luftës Italo-Turke 1911/12 nuk ishte në gjendje të shfrytëzonte avantazhin e saj të qartë.⁵ Kështu, një nga qëllimet e okupacionit të Bosnje-Hercegovinës në vitin 1878, d.m.th., hegjemonia komerciale deri në Selanik, po bëhej gjithnjë e më e përcaktueshme.⁶ Në mars 1914 oficerit të zbulimit të Marinës mbretërore-perandorake në Vlorë iu komunikua nga një burim i informuar mirë, se tregtia e ullinjve që deri atëherë kryhej përmes Triestes, kishte kohë që për në Itali bëhej përmes Brindisit dhe Barit, ndërsa kafja, sheqeri si dhe mallra të tjerë koloniale nuk vinin më në Vlorë nga Triestja, por nga Brindisi.⁷

Funksioni komunikativo-politik i Shqipërisë për Austro-Hungarinë

Për shkak të pozitës, si një pikë kyçe tepër e rëndësishme nga ana gjeografike dhe e sigurisë politike, Shqipëria zinte një vend të rëndësishëm në konceptin e politikës së komunikacionit të Monarkisë për Ballkanin.⁸ Jo vetëm rrugët detare por dhe rrugët tokësore luanin një rol të rëndësishëm për sigurimin e dominimit strategjik e ekonomik në Ballkanin perëndimor. Ngritja e një rrjeti hekurudhor deri në Selanik kryesisht me kapitalin financiar të Austro-Hungarisë do të kishte qenë një bazë e mirë për influencën ekonomike dhe politike të Monarkisë dhe me një rëndësi të

1 HHSTA, PA. ALB., dos. XIX.XX/54.

2 Behnen: Dreibund, f. 377.

3 Prela: Aspekte ekonomike, f. 93 v..

4 Po aty, f. 97 v..

5 Shpuza: Aspekte nga gjendja ekonomike, f. 113 v. na jep një statistikë të hollësishme të transportit detar të Lloyd.

6 Hanns Dieter Schanderl: Die Albanienpolitik Österreich-Ungarns und Italiens 1877-1908. Wiesbaden: Harrassowitz 1971. (= Albanische Forschungen 9), f. 123 dhe 133-140;

7 AVA, k. u. k. Min. f. Cult. dhe Unt., Präsidialakten, Präs. Nr. 1244, 21. 3. 1914.

8 Behnen: Dreibund, f. 379.

madhe strategjike. Përkatësisht Qeveria Austro-Hungareze zhvilloi disa projekte komunikativo-politike. Në Maj 1906 bankat *Bodenkreditanstalt* dhe *Wiener Bankverein* shprehën gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në zbatimin e një projekti hekurudhor të subvencionuar nga shteti austriak.¹ Rrjeti ekzistues hekurudhor dalmatin nisur nga Zelenika duke kaluar nëpër Sutomore/Spizza duhej të lidhej me Virpazarin në liqenin e Shkodrës. Madje tri ministri treguan interesin e tyre për këtë projekt: Ministria Perandorake e Luftës, Ministria e Tregtisë dhe Ministria e Hekurudhave. Kështu shpeshohet në hapjen e rrugës përmes Malit të Zi drejt Shqipërisë, ku Monarkia kishte për të mbrojtur interesa të rëndësishme.² Si përfundim projekti dështoi, sepse Qarqet e Larta Financiare të Vjenës u tërhoqën përsëri pas refuzimit të pagimit nga ana e Malit të Zi dhe Ministrisë mbretëro-perandorake të Financave. Shtysën për një program më ambicioz e dha projekti hekurudhor Danub-Adriatik, i planifikuar nga Italia së bashku me Francën dhe Rusinë, i quajtur ndryshe dhe si projekti hekurudhor transballkanik. Dy destinacionet përfundimtare të mundshme të kësaj hekurudhe ishin Antivar (Bar) dhe San Giovanni di Medua (Shëngjini) në Shqipëri. Për t'i larguar këto dy pika nga influenza italiane, ministri i jashtëm Aehrenthal hartoi projektet e tija komunikativo-politike:³ 1. ndërtimin e një hekurudhe bregdetare dalmato-malazeze-shqiptare (Cattaro-Sutomore/Spizza-Antivari-Shkodra) 2. marrjen e koncesionit nga Turqia për ndërtimin e një hekurudhe nga Shkodra për në Shëngjin dhe 3. një projekt vetiak hekurudhor Danub-Adriatik të Austro-Hungarisë, i quajtur ndryshe projekti hekurudhor transversal boshnjak. Programi tregtaro-financiar dhe komunikativo-politik i Aehrenthal-it do të shërbente për arritjen e një hegjemonie politike të qartë në Ballkanin perëndimor. Të parashikuar ishin lundrimi në Bunë dhe në liqenin e Shkodrës, themelimi i një banke në Shkodër me filiale në tregjet e tjera shqiptare, zgjerimi i portit të Shëngjinit si dhe ndërtimi i urave, rrugëve dhe kanaleve.⁴ Përkrahësit më të zjarrtë të këtij plani ishin ministri i financave István (Stefan) Burián von Rajecz, ambasadori austro-hungarez në Stamboll, Johann Pallavicini dhe sekretari i parë i Dhomës së Tregtisë dhe të Zanatit së Austrisë së Ulët (*Niederösterreich*) Richard Riedl.⁵ Ky i fundit mendonte se vetëm me Shëngjinin në dorë të Habsburgasve do të mund të realizohej zhvillimi ekonomik i Shqipërisë me anë të një linje hekurudhore që të nisej nga Shkodra e nëpër Dibër të shkonte në Manastir duke lidhur kështu Shkodrën me Selanikun.⁶ Konferenca ndërministrorë në korrik 1907 i dha përparësi projektit hekurudhor të Sanxhakut, për shkak të rëndësisë së tij më të madhe strategjike

1 Po aty, f. 414.

2 Protokoll i konferencës së zhvilluar më 1.5.1906 në Ministrinë e Jashtme Mbretëro-Perandorake mbi çështjen e aktivitetit të sindikatës italiane në Mal të Zi dhe të ndërtimit të hekurudhës Antivari-Virpazar, sekret, HHSTA, AR, F 19/16, *Bahnbau Montenegro*, 2. Teil.

3 Behnen: Dreibund, f. 421.

4 HHSTA, AR, F 19/15, *Bahnbau Montenegro* 3. Kështu Aehrenthal iu kthye sërish një plani më të hershëm të Konsullit Král, të cilin Ministria e Jashtme nuk e kishte përfshirë.

5 Riedl konsiderohej si autoritet në çështjet e tregtisë dhe komunikacionit në Ballkan dhe kishte ndikim të madh mbi Ministrinë e Jashtëm Aehrenthal.

6 Behnen: Dreibund, f. 424.

- që ishte hyrja e Monarkisë në Selanik në mënyrë të pavaruar nga Serbia! - kundrejt hekurudhës bregdetare dhe asaj transversale boshnjake.¹ Bashkëvendimtare për hedhjen poshtë të këtyre dy projekteve ishin kostot e lart, të cilat nuk donin t'i merrnin përsipër as Qeveria dhe as Qarqet e Larta Financiare. Pas miratimit nga Porta e Lartë, në fund të janarit 1908, për studimin paraprak të ndërtimit të hekurudhës së Sanxhakut, projekti i hekurudhës bregdetare u hoq përfundimisht nga axhenda. Kundër realizimit të hekurudhës transversale boshnjake pati disa arsye të forta:² *së pari*, shkaqet teknike lejonin vetëm ndërtimin e një hekurudhe me një binar të ngushtë; së dyti, projektin e kundërshtonte Qeveria Hungareze, sepse nuk donte t'ua lëshonte Bosnje-Hercegovinës dhe Dalmacisë qarkullimin tranzit nga vendet ballkanike që kalonte nëpër Hungarinë; dhe *së treti*, do të krijohesh në këtë mënyrë një lidhje hekurudhore midis Malit të Zi dhe Serbisë, gjë që binte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin politik që qëndronte në ndarjen e këtyre dy shteteve. Me hedhjen poshtë të të dy projekteve politika austro-hungareze e komunikacionit në Ballkan kishte shkuar në nivelin e vitit 1904, d.m.th., në zero. Tashmë në fundvitin 1906, Alexandër Musulini, i Ministrisë së Jashtme, u ankua për qëndrimin refuzues të Ministrisë austriake të Tregtisë dhe për mungesën e interesit nga ana e shoqërive të transportit.³ Shpallja publike e Aehrenthal-it mbi iniciativën e hekurudhës së Sanxhakut dhe paraqitja e saj tek Porta e Lartë më 27 janar 1908, çuan në bashkimin përfundimtar të Ruisë, Serbisë, Francës dhe Italisë në një bashkësi interesash komunikativo-politike antihabsburgase.⁴ Pas mbarimit të bisedimeve të Parisit mbi themelimin e sindikatës financiare për projektin hekurudhor Danub-Adriatik të të katër fuqive Rusia, Serbia, Franca dhe Italia, publicisti austriak për çështje ballkanike, Baroni Leopold Freiherr von Chlumecky reagoi në këtë mënyrë: *“Hegjemonia ekonomike në Adriatik dhe në detin Egje duhet të jetë qëllimi, të cilin e ndjekim, megjithëse një qëllim i madh dhe për një të ardhme të largët, dhe që sot duhet ta mbajmë parasysh së paku për sa kohë u kundërvihemi atyre planeve, realizimi i të cilave do të na e mbyllte një herë e përgjithmonë rrugën për atje. Në qoftë se Austro-Hungaria dëshiron të ketë jo vetëm një të shkuar, por dhe një të ardhme, atëherë ajo duhet të mbajë përgjegjësi për pozicionin e saj gjeografik dhe ekonomik, dhe të mbrohet kundër çdo rrezikimi të pozitës së saj në Juglindje duke e konsideruar atë si një sulm ndaj interesave të saj jetikë. Nuk është etja për ekspansion territorial, as imperializmi shovinist, por është thjesht instinkti për mbijetesë, ai që na bën të synojmë rolin e fuqisë udhëbëqese në Ballkan.”*⁵ Këto fjalë i drejtoheshin njëkohësisht qëndrimit duarkryq të politikës së jashtme të Vjenës në Ballkan. Një përpjekje të fundit e ndërmori Monarkia në nëntor të vitit 1912 me *“Programin për Marrëveshjet Ekonomike me Shtetet e Ballkanit”*. Në këtë ishte parashikuar të ndërtohej një linjë hekurudhore përmes Malit të Zi dhe Shqipërisë që

1 Po aty, f. 425.

2 Po aty, f. 430 v.

3 HHSTA, PA XIV/25 Liasse XIX, 1.

4 Behnen: Dreibund, f. 434 v., 441 v. dhe 456.

5 Parathënie në artikullin “Projekte hekurudhore në Shqipërinë e Veriut” (gjerm. *Bahnprojekte in Nordalbanien*) Në: Österreichische Rundschau, 1.8.1908, f. 149.

do të bashkohej me rrjetin hekurudhor grek, dhe një hekurudhë tjetër prej Manastirit deri tek ndonjë port shqiptar. Për qëllim të domosdoshmërisë së ushtrimit të influencës mbi rrjetin e ardhshëm hekurudhor, këto linja duhej të ishin në pronësinë private të Ndërrmarrjes së Hekurudhave Orientale (*“Betriebsgesellschaft der Orientalischen Bahnen”*).¹ Por Revolucioni Xhonturk dhe Luftrat Ballkanike penguan realizimin e planeve komunikativo-politike si të Monarkisë ashtu dhe të Fuqive të Antantës.

Konvikti i shqiptarëve në Vjenë

Propozimi i parë, i neglizhuar nga Ministria e Jashtme, për ngritjen e një instituti edukativ për shqiptarët në Austro-Hungari, ishte ai i konsullit të përgjithshëm në Shkodër, Lippich, në vitin 1886.² Në vitin 1897 kjo ide u parashtrua sërish nga konsulli Ippen. Por u deshën të kalonin dhe pesë vite të tjera rivaliteti kulturor dhe komercial me Italinë në Shqipëri, gjersa Ministria e Jashtme dhe ajo e Tregtisë vendosën së bashku për të sjellë nxënësit e parë shqiptarë në Vjenë. Në vitin 1908 të gjithë konviktorët shqiptarë u strehuan në Konviktin e Shqiptarëve të sapongritur në Vjenë. Qeveria austriake mori përsipër të gjitha shpenzimet: udhëtimin, veshmbathjen, pushimet, pajisjet dhe qëndrimin. Në periudhën kohore 1908 deri 1918 u arsimuan kështu rreth 80 nxënës shqiptarë në Austri.³ Përzgjedhja e konviktorëve bëhej nga konsullata austro-hungareze nën moton e përfitimit maksimal politik, pasi ata ishin rekomanduar nga personalitetet shqiptare me influencë.⁴ *Së pari*, ata duhej të kryenin një kurs përgatitor dhe në gjuhën gjermane, përpara se të mund të ndiqnin një gjimnaz të përgjithshëm, një shkollë profesionale⁵ ose të fillonin praktikën në ndonjë ndërmarrje. Në qoftë se nxënësit kishin sjellje dhe rezultate të mira, u jepej një bursë nga shteti për një studim profesional. Sidomos Ministria e Tregtisë mbështeste arsimimin komercial të shqiptarëve në Austri, *“në mënyrë që këta, me njohuritë e marra mbi jetën ekonomike austriake, të shërbenin pas këhimit në vendlindjen e tyre për nxitjen e marrëdhënieve tregtare mes vendit tonë dhe Shqipërisë.”*⁶ Për këto arsye politike konviktorët trajtoheshin shumë mirë, dhe nëse ndodhte që ata shkelnin rregulloren e konviktit ose të shkollës, ndëshkoheshin butë. Dr. Roberto von Kéler, mbikqyrës i konviktit, i shkroi si më poshtë drejtorisë së Shkollës Bujqësore *Edelhof im Stift Zwettl*, ku në mësim merrnin pjesë edhe pesë shqiptarë: *“Duke marrë parasysh rëndësinë, se bursistët shqiptarë duhet të ruajnë edhe në të ardhmen një kujtim*

1 Löding: Balkanpolitik, f. 50 dhe 57.

2 Engelbert Deusch: Das Albanerkonvikt in Wien. Në: Österreichische Osthefte 24 (1982), H. 3, f. 331.

3 Po aty, f. 344.

4 Po aty, f. 341.

5 Tek shkollat profesionale bëhej fjalë kryesisht për shkolla tregtare dhe bujqësore.

6 Pro domo, K. u. K. Handelsministerium, P.Z. 16262, 6.5.1914, AV Fasc. 1304/1915 AK.. Ministria e Tregtisë gjeti mbështetje të plotë prej Ministrisë për Punë Publike, e cila lëshonte deklarata të ngjashme. Për këtë shih: AVA, k. u. k. Min. f. Cult. u. Unt., Präsidialakten, Präs. Nr. 2501, 2. 9. 1913. Gjatë administrimit ushtarak austro-hungarez në Shqipëri nxënësit shqiptarë të arsimuar në Austri u angazhuan p.sh. si përkthyes.

të mirë për kohën e studimeve të tyre përkatëse në Austri, nuk është njësoj, nëse një djalosh shqiptar largohet nga Austria si i ndëshkuar apo jo.¹ Kur disa konviktore shqiptarë plotësisht të vetëdijshëm për “fuginë” që kishin, u ankuan në letrat drejtuar prindërve të tyre për kushtet e këqia dhe për mungesën e përkujdesjes, pala austriake filloi të merakosej së tepërmi për pasojat e mundshme negative në Shqipëri. Edhe vetë brenda Monarkisë u ngritën kryesisht zëra hungarezë e çekë kundër trajtimit zemërgjerë dhe shkollimit falas të nxënësve dhe studentëve shqiptarë. Paratë për Konviktin e Shqiptarëve lëvroheshin brenda Ministrisë së Tregtisë fshehurazi nën emërtimin “për qëllime të ndryshme të nxitjes së eksportit”. Në gazetën çeke të fshatarëve “Selské listy” të datës 24.9.1913 mund të lexohej: “Vjena, kjo Vjenë armike e çdo gjëje sllave, e cila nuk ka aspak mirëkuptim për nevojat kulturore të fëmijëve tanë, e cila duron veprimet e dhunshme që u ushtruan mbi pasurinë e institucioneve tona shkollore nacionale, kjo Vjenë është e gatshme të shpërdorojë mijëra (lekë) për përkujdesjen e fëmijëve të një populli, me të cilin nuk kemi asgjë të përbashkët... Çdo vit harxhohen shuma të konsiderueshme për shkollimin e fëmijëve shqiptarë, të cilët Austria i ka më për zemër se fëmijët e popullit çek, që janë megjithatë pjesë e kësaj monarkie të përçarë... Për mbështetjen e nënshtetasve të Vjenës zor se janë planifikuar nga arkat shtetërore disa qindra (lekë). Kurse për Shqipërinë, shkëmbinjtë e së cilës banohej nga disa fise hajdutësh, qëndrojnë vazhdimisht miliona në dispozicion.”²

Komiteti austriak për Shqipërinë

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në korrik të vitit 1913, u dha një hov të ri aspiratave politike dhe ekonomike të Austro-Hungarisë në Shqipëri. Tashmë, më shumë se një muaj më parë, më 6 qershor 1913, u themelua në Vjenë me mbështetjen e plotë të Ministrisë së Jashtme³ “Shoqata Austriake për Mbështetjen e Shqipërisë”, e quajtur ndryshe dhe si “Komiteti për Shqipërinë”.⁴ Për legjitimimin e këtij akti, një nga anëtarët themelues iu referua marrëdhënieve historike dhe etnografike të Austrisë me Shqipërinë duke përmendur Luftën e Madhe kundër osmanëve, gjatë së cilës disa qindra familje shqiptare ishin shpërngulur në zonën e Kufirit Ushtarak austriak, ku ishin përzier me popullsinë kufitare ose kishin krijuar kolonitë e veta, si p.sh. Borgo Erizzo e Zara-s.⁵ Përveç kësaj ai theksoi dhe arritjet e rëndësishme të Monarkisë për zënien shkencore të vendeve Ballkanike, sidomos

1 Deusch: Albanerkonvikt, f. 340.

2 AV Fasc. 1241/1913 AK, fol. 293 v. sipas një përkthimi të asistentit të atëhershëm të Bibliotekës në Ministrinë e Tregtisë, Dolezal.

3 Në vijim ministritë kontaktonin gjithnjë “Komitetin për Shqipërinë”. Për këtë shih: AVA, k. u. k. Min. f. Cult. u. Unt., Präsidialakten, Präs. Nr. 2501, 2. 9. 1913.

4 Alexander Salkind: Was wir taten und was wir wollen. [Çfarë bëmë dhe çfarë duam]. Në: Albanien. Mitteilungen des österreichischen Vereins zur Förderung Albaniens. (Albanienkomitee) 1 (1914), Nr. 1, f. 10 vv.

5 Arthur Breycha: Österreich-Ungarn und Albanien. Në: Albanien. Mitteilungen des österreichischen Vereins zur Förderung Albaniens. (Albanienkomitee) 1 (1914), Nr. 1, f. 3 v.

nëpërmejt Institutit për Studime Ballkanike në Sarajevë (i quajtur shkurt “*Instituti për Ballkanin*”). Si president u zgjodh konti Franz Harrach. Zëvendësi i tij ishte publicisti i shquar mbi Ballkanin dhe këshilltari administrativ i Lloyd-it, baroni Leopold Freiherr von Chlumecky. Më tej u krijuan katër seksione: ai ekonomik (që në qershor), ai letrar dhe shkencor (në dhjetor) si dhe seksioni humanitar. Seksioni letrar kishte këto tri detyra: publikimi i raporteve periodike të Shoqatës në formë të një reviste, mbajtja e referateve në Austro-Hungari për të prezantuar detyrat e Shoqatës dhe për sigurimin e ithtarëve si dhe për nxitjen e ekspertëve mbi Shqipërinë për të bashkëpunuar me Shoqatën. Për shkak të nevojës së reklamimit të Shoqatës së re, pesha kryesore e aktiviteteve rëndonte së pari mbi seksionin letrar, i cili mbajti disa manifestime. Ndarja e posteve drejtuese të seksioneve të veçanta qe domethënëse: zëvendëskryetar i seksionit letrar ishte publicisti i njohur mbi Ballkanin dhe ish-konsulli i përgjithshëm i Bosnje-Hercegovinës Carl Ritter von Sax. Seksionin ekonomik e kryesoi fillimisht guvernatori i Bankës Kombëtare të Bosnjes Carl Freiherr von Pitner, funksionin e të cilit e mori në dhjetor presidenti i Lloyd-it Dr. v. Derschatta. Seksioni shkencor drejtohej nga personaliteti shumë i shquar, siç ishte presidenti i Shoqatës Gjeografike mbretëro-perandorake, Eugen Oberhammer, dhe nga zëvendësi i tij Eduard Sueß. Seksioni humanitar mbeti përkohësisht, për shkak të mungesës së parave, i pathemeluar.

Detyrat e përgjithshme të Shoqatës qëndronin në konsolidimin e Shqipërisë dhe në zgjerimin e marrëdhënieve të mira reciproke mes Austro-Hungarisë dhe Shqipërisë. Ky qëllim kryesor u formulua disa herë në numrin e parë të revistës së Shoqatës me emrin “*Albanien*” (Shqipëria). Arthur Breycha theksoi se tani - pas hyrjes së qeverisjes së Wied-it – mund të fillonte rimëkëmbja ekonomike. “*Do të pasojnë porosi shtetërore dhe private të çdo lloji. Huazimi i 75 milionëve, kontrolli i financave nga Fuqitë, pronat e mëdha dhe pasuria e pashfrytëzuar e vendit premtojnë një të ardhme më të mirë. Komiteti austriak për Shqipërinë ia ka vënë vetes qëllimin që ta mundësojë këtë të ardhme më të mirë, të kontribuojë, që shteti më i ri i Evropës të krijojë marrëdhënie të mira me Monarkinë tonë të vjetër, dhe ka besim, se do të gjejë miq dhe përkrabës gjithandej.*”¹ Shoqata synonte të ishte qendër ndërlidhëse për investitorët dhe tregtarët austro-hungarezë: “*Ne duam të ndihmojmë industrinë tonë, tregtarët tanë, që të realizojnë detyrën e tyre të rëndësishme, dhe i ftojmë që të na drejtohen neve për çdo rast, ku mund t’i këshillojmë dhe mbështesim.*”² Zyrtarisht synohej për të ndërhyrë për një Shqipëri të fortë dhe të pavarur, në të cilën Monarkia do të mund të siguronte tregjet e saj: “*Shqipëria duhet t’u përkasë shqiptarëve. Për produktet tona duhet të sigurojmë tregje në Shqipëri. Kapitali austro-hungarez duhet të bashkëpunojë në ndërtimin e ekonomisë së Shqipërisë. Specialistët tanë të çdo fushe, të punës dhe dijes, duhet të jenë drejtues dhe këshilltarë të kombit shqiptar në krijimin e shtetit dhe institucioneve të tij. Por asnjë austriak nuk duhet t’i marrë një shqiptari vendin e punës që i takon, ose bukën që ai mund ta fitojë vetë. Një mënjanim i tillë i fuqisë punëtore vendase do të kishte pasojë negative për marrëdhëniet e Austro-Hungarisë me Shqipërinë. Prej Shqipërisë, për ekzistencën shtetërore të së cilës Monarkia është angazhuar me gjithë forcën*

1 Po aty, f. 4.

2 Salkind, f. 13.

e saj, duam të krijohet një formacion shtetëror i fortë dhe i pavarur. Prandaj motoja jonë duhet të jetë: Shqipëria e shqiptarëve.¹ Ngaqë pala austro-hungareze do të respektonte ndjenjën e fortë të nderit dhe vetëdijen kombëtare të shqiptarëve, populli shqiptar do të ushqente një ndjenjë mirënjohjeje dhe simpatie ndaj Monarkisë, gjë që nga ana tjetër do t'u siguronte tregtarëve austriakë në Shqipëri një avantazh ndaj konkurrentëve të tjerë, me përjashtim të Italisë.² Shqiptarët në Austri që ktheheshin sërish në atdhe, do të ushtronin një ndikim pozitiv politik dhe kulturor ndaj bashkështetasve të tyre në Shqipëri dhe do të bëheshin përkrahës të zjarrtë të qeverisë së Wied-it.

Shoqata shpалosi menjëherë një veprimtari të gjallë dhe të shumëllojshme. Anëtarët e shoqatës ndërmorën disa udhëtime nëpër Shqipëri, mbi të cilat raportonin gazetat e përditshme austriake. Komiteti shfrytëzoi raporte të konsullatës mbi tregtinë, bujqësinë dhe transportin, në mënyrë që të krijohej një tablo e pjesës së Monarkisë në jetën ekonomike të Shqipërisë, dhe u mor gjithashtu me çështjen e gjendjes së eksportit aktual drejt Shqipërisë.³ Në një raport drejtuar Komitetit për Shqipërinë, konsullata e përgjithshme në Shkodër nxiti themelimin e ndërmarrjeve bujqësore model në afërsi të famullive katolike si dhe të magazinave model me mjete ndihmëse për bujqësinë. Ky raport u përcoll nga Ministria e Jashtme tek ajo e Tregtisë me shpresë që qarqet e interesuara industriale nuk do të linin t'u ikte ky rast për të zënë vend në Shqipëri, dhe që industria austriake për makina bujqësore – e aftë për konkurrim – do të dinte të pushtonte shumë shpejt tregjet e reja në Shqipëri.⁴ Me iniciativën e seksionit ekonomik, u krye nën drejtimin e inxhinierit Karl Steinmetz në Sarajevë, një ekspertizë bujqësore në Shqipëri. Në prill të vitit 1914 Komiteti për Shqipërinë së bashku me Shoqërinë për Turizëm të landit Austri e Ulët (Niederösterreich) ndërmorën një udhëtim për në Shqipëri, gjatë të cilit u krijua përshtypja se nga ana ekonomike Italia nuk e kishte kaluar ende Austro-Hungarinë.⁵ Për të lehtësuar aktivitetet e komitetit, të gjithë anëtarët e shoqatës përpiqeshin të lidhnin kontakte të mira me të gjitha personalitetet e rëndësishme të jetës publike. Kështu ata zhvilluan takime me Princin Wied-in, Esad Toptanin, Eqrem Bej Vlorës, me anëtarë të Komisionit të Kontrollit dhe të konsullatës si dhe me përfaqësues të klerit katolik (Mjedja, Fishta).⁶

Në revistën e shoqatës dhe në shkrimin propagandistik të titulluar “Çfarë kërkon Komiteti austriak për Shqipërinë”, Komiteti për Shqipërinë bëri disa propozime për ndërtimin e Shqipërisë dhe për përmirësimin e marrëdhënieve ekonomike austro-shqiptare. Marrëdhëniet ekonomike midis Austro-Hungarisë dhe Shqipërisë do të ishin e natyrës reciproke: nga njëra anë shqiptarët do të mund të plotësonin me ndihmën e

1 Leo Freundlich: Albanien Golgotha. Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes. [Golgota e Shqipërisë. Akte paditëse kundër shfarosësve të popullit shqiptar]. Wien: Roller 1913, f. 15.

2 Sommaruga, f. 7 v. dhe Artur Lemberger: Die Aufgaben der österreichischen Kaufmannschaft in Albanien. [Detyrat e sipërmarrësve austriakë në Shqipëri]. Në: Albanien. Mitteilungen des österreichischen Vereins zur Förderung Albanien. (Albanienkomitee) 1 (1914), Nr. 1, f. 9.

3 Salkind dhe Rippel, Nr. 1.

4 AVA, k. u. k. Min. f. Cult. u. Unt., Präsidialakten, Präs. Nr. 2712, 18. 9. 1913.

5 Generalversammlung, f. 12 v..

6 Sommaruga.

Monarkisë nevojat e tyre materiale dhe të modernizonin vendin e tyre. Ndërsa nga ana tjetër vizioni i një Shqipërie moderne do të kishte një rëndësi të madhe edhe për jetën ekonomike të Austro-Hungarisë. Do të ndërtoheshin porte moderne, qytete të reja, rrugë dhe linja hekurudhore si dhe do të shfrytëzoheshin pasuritë e shumta tokësore të vendit. Zvillimi i vendit do të sillte punë dhe përfitime për popullsinë, do të rriteshin kërkesat materiale dhe shpirtërore, fakt që përsëri do të krijonte tregje të reja për industrinë dhe zanatin.¹ Cilësia e mirë e produkteve të saj duhej t'i siguronte Monarkisë një avantazh në luftën paqësore për pushtimin e tregjeve shqiptare. Nga zhvillimi tregtar në muajt e parë të pavarësisë shqiptare Ignaz Rippel nxori konkluzionin se Shqipëria tashmë e pavarur do të ishte shumë herë më fitimprurëse sesa ka qenë Shqipëria turke. Gjendja politike duhej të stabilizohej patjetër, në mënyrë që të vazhdonte emigrimi i inteligjencës shqiptare nga jashtë vendit për të rritur fuqinë blerëse dhe për të çuar përpara zhvillimin ekonomik të vendit.² Me anë të bisedave me tregtarë të huaj dhe njohës të vendit informohej për mundësinë e investimeve në tregti dhe industri. Shtyrë nga kjo gjë, u bënë disa propozime konkrete si p.sh. për ndërtimin e mullinjve për drithërat, të hoteleve dhe të bujtinave. U rekomandua me ngulm hapja e shpejtë e një filiali të një banke austriake, përpara se shtete të tjera të shfrytëzonin konjunkturën perkohësisht të volitshme.³ Artur Lemberger propozoi udhëtime informuese nëpër Shqipëri për të hulumtuar kërkesën për produkte, mundësinë e kreditimit dhe konditat e shlyerjes. Më tej ai përmendi produktet që ishin të përshtatshme për importim në Monarki. Potenciali ekonomik i Shqipërisë ia vlente përpjekjen për të zënë vendin e parë ndër shtetet importuese.⁴ Një propozim tjetër bënte fjalë për vendosjen e sllavëve austro-hungarezë në Shqipëri. *“Pa dyshim që sllavët austro-hungarezë nuk do të kishin synime politike në Shqipëri, sepse sidomos çeku katolik, hanaku, slllovaku dhe polaku megjithë theksimin e vëllazërisë qëndrojnë larg sllavëve të Ballkanit, nga se rezulton vetvetiu rezervimi i tyre ndaj veprimtarisë politike.”*⁵ Tendenca e atëhershme e përgjithshme për emigrim në Evropë do t'i vinte në ndihmë popullimit të Shqipërisë me të huaj që kishin kapital të fuqishëm. Por kusht për popullimin e Shqipërisë me familje sllave dhe italiane do të ishte ndërtimi i një infrastrukture funksionale si hekurudha dhe një rrjet rrugor. Për këtë do të ishte i nevojshëm sërish një program ekonomik ambicioz që do të kërkonte një investim të madh kapitali. Një vëmendje të veçantë komiteti u kushtonte tregtarëve shqiptarë të vendosur në Trieste, të cilët luanin një rol të rëndësishëm për tregtinë e mallrave koloniale dhe atë të frutave ekzotike të Triestes dhe Fiumes. Një rritje e këmbimit tregtar me Shqipërinë do të ishte e mundur vetëm atëhere, në qoftë se dhe importit nga Shqipëria do t'i jepej rëndësia që i takon.⁶ Por nuk duhej t'u tërhiqej vëmendja konkurrentëve me anë të botimeve të zhurmshme për sukseset e tregtisë së Monarkisë në Shqipëri.

1 Freundlich.

2 Rippel, Nr. 3.

3 Sommaruga dhe Lemberger.

4 Lemberger, f. 10.

5 Albanienkomitee, Nr. 2, f. 28.

6 Rippel, Nr. 2, f. 31.

Një vend të gjerë në revistën e shoqatës zinte lufta konkurruese ekonomike me Italinë. Franz Harrach theksoi funksionin mbrojtës të Italisë dhe Austro-Hungarisë të legjitimuar nga Fuqitë e Mëdha dhe nga afërsia kufitare. Nga konkurenca e pastër me Italinë Shqipëria duhej të kishte vetëm përfitime: *“Nëqoftëse e duam vërtet, atëherë edhe do t’ia arrijmë që ne dhe produktet tona në Shqipëri të shihen me sy të mirë dhe që Monarkia Austro-Hungareze të ruajë dhe të zhvillojë më tej në të ardhmen pozitën e favorshme, që ajo tashmë e zotëron. Sepse ne nuk do t’i presim rrugën asnjë fuqie tjetër të madhe, ne duam vetëm t’i ftojme aleatët tanë të dashur e besnikë në një luftë të gëzueshme për cilësinë e produkteve, ku askush nuk do të pësojë dëm dhe Shqipëria vetëm do të fitojë.”*¹ Marrëdhëniet midis përfaqësuesve të konsullatave austro-hungareze dhe italiane do të ishin tepër miqësore dhe të bazuara në besimin reciprok.² Prapë se prapë Komiteti për Shqipërinë mbante nën vëzhgim aktivitetet ekonomike të italianëve në Shqipëri. Në fushën e importit drejt Shqipërisë vinin në pyetje si konkurentë seriozë vetëm Austro-Hungaria dhe Italia. Në bazë të interesave të përbashkëta politike të të dyja shteteve të Lidhjes Treshe, që të dyja palët do të ishin të gatshme për akordimin e interesave ekonomike në Shqipëri. Në këtë pikë Rippel ishte për një bashkëpunim të të dyja shteteve bregdetare të Adriatikut në ndërtimin e Shqipërisë.³

Por, me gjithë këto përpjekje nga ana e qarqeve të caktuara të Monarkisë, kishte një sërë faktorësh të brendshëm që pengonin ose vështirësonin krijimin e një imperializmi komercial dhe financiar të mbështetur nga Financa e Lartë, sipërmarrësit dhe tregtarët si dhe të favorizuar nga ministritë e tregtisë dhe Ministria e Jashtme:⁴ 1. marrëdhëniet politike vetëm të lehta të Austro-Hungarisë me shqiptarët; 2. shtytja e zhvillimit industrial brenda Monarkisë së Dyfishtë gjatë periudhës së dytë të themelimit 1904-1908, ku bankat e mëdha të Vjenës merrnin pjesë në financimin afatgjatë të industrisë; 3. pjesëmarrja e bankave të mëdha në aksionet financiare të bankave të huaja në Evropë dhe matanë oqeanit; 4. kapitali i investuar me afate të gjata ose i lidhur për momentin; 5. preferimi i disa instituteve bankare për degë të caktuara të industrisë dhe 6. shkallët e ndryshme ekonomike brenda për brenda Austro-Hungarisë si dhe përpjekjet për reduktimin e tyre nëpërmjet nxitjes përkatëse të industrisë. Të gjithë këta faktorë forcuan tendencën për të hequr dorë nga investimet e rrezikshme në zonat me një të ardhme politike të pasigurtë ose në zonat periferike konfliktuale me një strukturë ekonomike të pazhvilluar. Mos interesi i përgjithshëm i Financës së Lartë vjeneze për investime kapitali në Evropën juglindore shpjegon gjithashtu pse nuk pati asnjë qendër koordinimi politiko-ekonomik dhe asnjë bashkëpunim në fushën e marrëdhënieve financiare me jashtë.⁵ Kështu bashkëkohësi Chlumecky u ankua për bashkëpunimin e pamjaftueshëm të qarqeve më të gjera të ekonomisë për vënien në jetë të aksioneve

1 Franz Graf Harrach: Das Albanienkomitee und dessen Mitteilungen. Në: Albanien. Mitteilungen des österreichischen Vereins zur Förderung Albaniens. (Albanien-Komitee) 1 (1914), Nr. 1, f. 2 v..

2 Sommaruga.

3 Rippel, Nr. 1, f. 17.

4 Behnen: Dreibund, f. 406 v..

5 Po aty, f. 411.

ekonomike të propozuara nga *Ballhausplatz-i* (= zyra kancelare, d.m.th. qeveria). Shkaku për këtë, sipas tij, do të qëndronte kryesisht në faktin se publiku dhe qarqet ekonomike me influencë nuk do të ishin informuar më parë mbi domosdoshmërinë e aksioneve të tilla.¹

Qendra dhe periferia – imperializmi informal në bazë të dhunës strukturore

Politika e Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë vlerësohet nga historiografia komuniste në mënyrë më të favorshme në krahasim me politikat përkatëse të Fuqive të tjera të Mëdha. Megjithatë politika austro-hungareze ndaj Shqipërisë gjykohet në përgjithësi negativisht sepse Monarkia Habsburgase vepronte deri më 1912 në interes të Status Quo-së dhe të Perandorisë Osmane, gjë që përputhej me interesat vetiakë të Monarkisë, në vend që të mbështeste pa interesa Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Në studimin e tij *“Problemi kombëtar shqiptar dhe Kultusprotektorati austro-hungarez”*, Zef Prella e cilëson kultusprotektoratin thjesht si vegël të imperializmit austro-hungarez dhe konstaton se veprimtaria e tij i kishte sjellë vetëm dëme Lëvizjes Kombëtare.² Ai e shikon kishën katolike në veri të Shqipërisë si armikun e Lëvizjes Çlirimtare Kombëtare, të drejtuar nga Vatikani dhe rrethet feudale e klerike të Monarkisë Habsburgase.³ Prandaj Prella i njeh klerit katolik meritat e mëdha në zhvillimin e sistemit shkollor, por thekson njëkohësisht dhe karakterin “feudal, fetar dhe reaksionar” të këtyre shkollave.⁴ Në veprën e tij *“Politika e Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë” (Albanienpolitik Österreich-Ungarns)*, Hanns Dieter Schandler është i mendimit të kundërt: Austro-Hungaria dha ndihmë të vërtetë për zhvillim dhe i qëndroi gjithnjë besnike popullit shqiptar. Kultusprotektorati në përgjithësi do të ishte aplikuar më shumë si ndihmë humanitare për zhvillim sesa për qëllime politike, gjë që do të thoshte mos marrje e masave real-politike. Schwanke e mbështet këtë pikëpamje duke argumentuar se Austro-Hungaria ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për bashkimin gjuhësor në Shqipëri, fakt që nuk do të ishte vlerësuar akoma sa duhet nga filologët shqiptarë.⁵ Ndërsa Engelbert Deusch shprehet në lidhje me Konviktin e Shqiptarëve: *“Me anë të konviktit u dha ndihmë moderne për zhvillim dhe iu parapri*

1 Leopold Freiherr von Chlumecky: Österreich-Ungarn und Italien. Das westbalkanische Problem und Italiens Kampf um die Vorherrschaft in der Adria. 2. Aufl..Leipzig, Wien: Deuticke 1907, f. 229 v.

2 Robert Schwanke shprehet në lidhje me këtë se ai zotëronte të gjitha aktet, në të cilat mbështetet artikulli i Prelës dhe të cilat do të na jepnin një tjetër tablo të përpjekjeve austriake. Robert Schwanke: Österreich-Ungarn und der albanische Sprachkongress zu Manastir (Bitola) im Jahre 1908. [Austro-Hungaria dhe Kongresi Gjuhësor shqiptar në Manastir (Bitola) në vitin 1908]. Në: Gjurmime albanologjike (1969), Nr. 1, f. 75.

3 Zef Prella: Problemi kombëtar shqiptar dhe Kultusprotektorati austro-hungarez. (Fund i shek. XIX - Fillim i shek. XX). Në: Studime historike 2 (1965), 3, f. 153.

4 Po aty, f. 154.

5 Robert Schwanke: Österreich-Ungarns Beitrag zur Gestaltung der albanischen Schriftsprache. Në: Akten des internationalen Kolloquiums Innsbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl. Innsbruck: 1977. (= Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Sonderheft 41), f. 708.

*arsimimit falas të ditëve tona. Për shkak të rezultatit të Luftës së Parë Botërore Austria nuk mund të përfitonte më nga këto investime.*¹ Megjithatë ky pohim i Deusch-it mund të hidhet poshtë lehtë, sepse nëqoftëse Lufta e Parë Botërore kishte përfunduar në favor të Monarkisë, atëherë kjo do të ishte bërë me siguri përfituesja e këtyre shpenzimeve. H. Schwanda mban një qëndrim ndërmjetës midis këtyre dy pozicioneve ekstreme të Prelës dhe Schanderl-it: Monarkia diti të mendonte për avantazhin e saj dhe në të njëjtën kohë të sakrifikojë për një popull tjetër.² Vetë pala shqiptare duhet t'i jetë mirënjohëse Monarkisë, e cila filloi për herë të parë luftën kundër analfabetizmit në Shqipëri duke u përpjekur të implementonte një arsimim modern.³

Pas studimit të kujdesshëm të materialeve të disponueshme mund të arrihet në përfundimin se në marrëdhëniet e Austro-Hungarisë me Shqipërinë bëhet fjalë për një lidhje imperialiste të formës indirekte ose informale, që qëndron midis pozicionit ekstrem të Prelës dhe atij ekuilibruës të Schwanda-s. Por sipas cilit model mund të përshkruhet më së miri kjo lidhje? Teoria e imperializmit të tregtisë së lirë në fillim të viteve '50 solli nocionin e "imperializmit informal". Një mori formash informale të sundimit imperialist do të paraprinte, të shoqëronte ose madje të bënte të panevojshme vendosjen e sundimit formal ose direkt. Sundimi politik formal nuk do të ishte rregulla, por thjesht forma më specifike e varësisë imperialiste.⁴ John Gallagher dhe Roland Robinson⁵ dallojnë tri instrumente të imperializmit informal: shkëmbim intensiv tregtar nën shfrytëzimin e epërsisë teknologjike të vendit amë, penetrimi i ekonomisë përkatëse me ndihmën e investimeve të mëdha jashtë vendit, si dhe tërheqja e qarqeve të interesuara dhe elitave vendase për bashkëpunimin me metropolin përkatës (shteti imperialist).⁶ Megjithatë për David Landes jo thjesht çdo formë e varësisë, që çon në shfrytëzimin e grupeve të popullsisë indigjene ose të klasës punëtore, mund të quhet imperializëm. Në vend të kësaj ai propozon një përkufizim të imperializmit, i cili mbetet i lidhur me ushtrimin e sundimit politik të formës formale ose informale.⁷ Termi "*imperializëm informal*" haset sërish në teoritë e imperializmit "*të orientuara drejt periferisë*".⁸ Sipas këtyre teorive, faktori më i rëndësishëm për imperializmin nuk janë proceset dhe krizat brenda Evropës vetë, por ato në "*periferinë*" e saj. Pjesërisht, si rrjedhojë e penetrimit evropian informal në mënyrë politike, kulturore dhe ekonomike, do të krijoheshin kriza në shoqëritë indigjene

1 Deusch: Albanerkonvikt, f. 349.

2 H. Schwanda: Das Protektorat Österreich-Ungarns über die Katholiken Albanien. Diss. 1965, f. 75.

3 Robert Schwanke: Das albanische Schulwesen und Österreich-Ungarn während des 1. Weltkriegs. Nö: Dissertationes Albanicae. München: Trofenik 1971, f. 75.

4 Wolfgang J. Mommsen: Imperialismustheorien. Ein Überblick über die neueren Imperialismusinterpretationen. 1. Aufl. Göttingen: Vandenhoeck u. Ruprecht 1977, f. 69 vv..

5 The Imperialism of Free Trade. Nö: The Economic History Review, 2. Serie 6 (1953), f. 1-25.

6 Mommsen, f. 73.

7 David Landes: Some Thoughts on the Nature of Economic Imperialism. Nö: Journal of Economic History 21 (1961), f. 499. (Përkthimi gjerm.: Imperialismus. Hg.v. H.-U. Wehler. Köln: 1972, f. 66-82.).

8 John Gallagher dhe Ronald Robinson: Africa and the Victorians. The Official Mind of Imperialism. London: 1961; David K. Fieldhouse: Economics and Empire 1830-1914. London: 1973; Ronald Robinson: Non-European Foundations of European Imperialism: Sketch for a Theory of Collaboration. Nö: Studies in the Theory of Imperialism. Hg. v. R. Owen/B. Sutcliffe. London: 1972.

dhe rivalitete mes Fuqive të Mëdha evropiane, gjë që do të çonte në kolapsin e formave të trashëguara të bashkëpunimit informal midis elitave vendase dhe paleve të interesuara evropiane. Kështu imperializmi formal do të ishte kryesisht një reagim ndaj kësaj situatë jo të kënaqshme në periferi dhe thjesht një përgjigje ndaj faktorëve krejtësisht të jashtëm.¹ Me njëfarë mbitheksimi të faktorëve “periferikë”, David K. Fieldhouse ka drejtuar i pari vëmendjen e shkencës mbi rolin e popullsisë vendase e veçanërisht të elitave të saj, ndërsa me konceptin e “*subimperializmit*” ka nxjerrë në pah saktësisht rëndësinë e aventurierëve, tregtarëve, ushtarëve dhe konsujve kolonialë në periferi, të cilët, megjithëse të paktë në numër, kishin pasur dorë kudo dhe kishin ushtruar një ndikim pa vend e shpesh vendimtar mbi proceset imperialiste.² Në fillim të viteve ‘70 Robinsoni e shikonte imperializmin si një produkt ndërveprimi midis proceseve politike evropiane dhe atyre jashtevropiane, ku peshën kryesore do ta kishin faktorët periferikë, megjithëse krizat në periferi do të ishin shkaktuar pjesërisht nga ndikimet evropiane informale. Sundimi i drejtpërdrejtë imperialist do të ishte i nevojshëm vetëm atëherë, në qoftë se ekspansioni ekonomik dhe strategjik evropian do të haste në rezistencën e elitave vendase ose do të gjendej në konkurrencë me fuqitë e tjera të mëdha evropiane.³ Por në të shumtën e rasteve grupet udhëheqëse sociale të periferisë do të ishin të interesuara për modernizimin e vendit të tyre dhe si rrjedhojë do të ishin të gatshme për bashkëpunimin informal me evropianët. Këtu theksohet në veçanti rëndësia strategjike që ka sjellja e të ashtuquajturve “kolaboracionistë” për pikësynimin dhe caktimin kohor të proceseve imperialiste të përvetësimit të territoreve.⁴

Teoria e *imperializmit informal në bazë të dhunës strukturore*, e zhvilluar nga Johan Galtung⁵, më duket, për shkak të repertorit të saj teorik, më e përshtatshme për të ndriçuar strukturat imperialiste në marrëdhëniet e Monarkisë së Dyfishhtë austro-hungareze me kolektivin e organizuar në territorin shqiptar, i cili deri më 1913 ishte pjesë e Perandorisë Osmane. Por çfarë duhet kuptuar me “*dhunë*” dhe “*dhunë strukturore*”? Galtungu na e ofron këtë përkufizim të mëposhtëm: *dhunë* është manipulimi i njeriut mbështetur mbi faktin që realizimi i tij aktual fizik (trupor, somatik) e psikik është më i vogël se realizimi i tij potencial (i mundshëm). Me fjalë të tjera: në qoftë se gjendja potenciale është më e madhe sesa gjendja aktuale dhe nëqoftëse kjo e fundit është e evitueshme, atëherë mund të flitet për *dhunë*.⁶ Një shembull: jetëzgjatja prej vetëm 30 vjetësh ishte normale dhe e arsyeshme për kushtet e epokës së gurit. Por e njëjta jetëzgjatja sot - qoftë për shkak të konflikteve luftarake, të shtypjes shoqërore ose të të djave – do të klasifikohet sipas këtij përkufizimi si dhunë. Tipi i dhunës me një veprues ose aktor (*Akteur*) emërtohet

1 Fieldhouse: *Economics and Empire*, f. 77-79.

2 Mommsen, f. 87.

3 Robinson: *Non-European Foundations*, f. 119.

4 Mommsen, f. 88 v..

5 Johan Galtung: *Gewalt, Frieden und Friedensforschung. Në: Kritische Friedensforschung*. Hg. v. Dieter Senghaas. Frankfurt a. Main: Suhrkamp 1971, f. 55-104; po ky.: *Eine strukturelle Theorie des Imperialismus. Në: Imperialismus und strukturelle Gewalt. Analysen über abhängige Reproduktion*. Hg. v. Dieter Senghaas. Frankfurt a. Main: Suhrkamp 1972, f. 29-104.

6 Galtung: *Gewalt*, f. 57 v..

si *dhunë personale* ose direkte, kurse dhuna pa asnjë aktor emërtohet si *dhunë strukturore* ose indirekte. Në rastin e dhunës strukturore nuk ka një person konkret, i cili i shkakton drejtpërdrejt dëme një tjetri. Në këtë rast dhuna është më tepër pjesë përbërëse e sistemit dhe shprehet në raporte forcash të pabarabarta dhe si rrjedhojë gjithashtu në shanse jetësore të pabarabarta. Resurset dhe pushteti vendimmarrës mbi to janë të ndara në mënyrë të pabarabartë. Si shembuj për këtë mund të sillen pabarazia e ndarjes së të ardhurave dhe e shanseve për arsimim.

Pikënisja e teorisë së imperializmit strukturor të Galtung-ut është modeli *Qendër-Periferi*, sipas të cilit bota përbëhet nga kombe në qendër dhe kombe në periferi, dhe çdo komb ka një qendër e një periferi të vetën. Një rol kryesor në këtë model luan i ashtuquajtimi „*Brückenkopf*“ si baza e ndikimit të kombit në qendër ndaj një kombi në periferi. Është fjala për një klasë elitare vendase, e cila është e gatshme për kooperim dhe i përshtatet gjerësisht botëkuptimit të metropolit, me interesa vetiake për ruajtjen e raporteve ekzistuese. Këtë *Brückenkopf* ose bazë e vendos qendra e kombit qendror në qendrën e kombit periferik për të mirën e përbashkët të të dyjave. Ai është pika rrotulluese në rrafshin e marrëdhënieve ndërvepruese vertikale, ku shprehen edhe efektet midis vepruesve të kombit qendror dhe atyre të kombit periferik (*inter-actor effects*), edhe efektet e brendshme mbi vepruesit vetë (*intra-actor effects*). Shkëmbimi tregtar midis dy kombeve është simetrik, dmth. mbështetet në të njëjtat kushte, në rast se të gjitha efektet midis vepruesve (*Inter-Akteur*) dhe ndër vepruesit (*Intra-Akteur*) janë njësoj tek të dyja palët.¹ Nga kjo mësohet se ndërveprimi vertikal, d.m.th. ndarja e punës është shkak i parë i pabarazisë, qoftë në formë të grabitjes së dhunshme direkte, të shkëmbimit ekstremisht të pabarabartë ose të ndarjes tejet asimetrike të „*spin-off*“² në të gjitha fushat për shkak të shkallëve të ndryshme të përpunimit.³ Thellimi i hendekut midis niveleve të përpunimit industrial dhe rrjedhimisht edhe i hendekut midis niveleve të standardit të jetesës të dy kombeve çon detyrimisht në një „*konflikt interesash*“ ose në „*mospërputhje të interesave*“ ndërmjet këtyre të dyjave.⁴ Prandaj imperializmi informal në bazë të dhunës strukturore i mundëson kombit në qendër të ushtrojë pushtet mbi kombin në periferi, duke krijuar një raport të mospërputhjes së interesave.⁵ Kjo marrëdhënie vartësie shprehet p.sh. në faktin se në periferi nxirret, si rregull, ajo lëndë e parë, që është shpejt e disponueshme dhe që nevojitet më shumë në qendër, gjë që përsëri ka si pasojë një strukturë sociale të caktuar, rrugë të përcaktuara ndërlidhëse për tek vendburimet dhe struktura tregtare fikse.

1 Galtung: Strukturelle Theorie, f. 47.

2 „spin-off“ është zinxhiri i kërkesës, i përfutur nga kërkesa në një fushë të caktuar, në fusha të tjera si atë ekonomike, politike, ushtarake, komunikative dhe kulturore.

3 Galtung: Strukturelle Theorie, f. 49.

4 Po aty, f. 31 dhe 43.

5 Po aty, f. 35.

Konkluzion: Imperializmi informal i Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë

Fuqia qendrore, Austro-Hungaria, ishte përpjekur jo më vonë se që prej fillimit të shekullit të 20-të, ta bënte Shqipërinë një periferi politikisht besnike dhe të varur nga ana ekonomike e kulturore. Vetë ekzistenca e një qendre ekonomikisht shumë të zhvilluar dhe e një periferie pak të zhvilluar, çon tek krijimi i marrëdhënieve të pabarabarta, edhe pse prapa kësaj nuk qëndrojnë ende qëllime imperialiste. Që prej shekullit të 16-të janë formuar brenda Evropës marrëdhënie *Qendër-Periferi*.¹ Studime të reja lidhur me Perandorinë Osmane tregojnë se edhe territoret e saj perandorake në Evropë u përfshinë që nga fundi i shek. të 16-të si rajone periferike në ekonominë botërore të Evropës, duke u ndryshuar masa e përfshirjes nga rajoni në rajon.² Në këtë kontekst Shqipëria ishte e vënë në një trysni periferizuese të dyfishtë: nga njëra anë prej ekonomisë botërore të Evropës dhe në anën tjetër prej ekonomisë osmane. Përfaqësuesit kryesorë të ekonomisë botërore të Evropës, për sa i përket Shqipërisë, ishin Italia dhe Austro-Hungaria. Metodrat e përdorura për këtë qëllim ndaj Shqipërisë ishin ato të imperializmit informal ose indirekt, të bazuara në dhunën strukturore. Por përpjekjet informale të Austro-Hungarisë në Shqipëri karakterizoheshin nga mungesa e drejtimit qendror dhe e vendosmërisë për të arritur qëllimin.³ Penetrimi paqësor (*Pénétration pacifique*) – një nocion përmbledhës për të gjitha përpjekjet dhe aksionet imperialiste informale me anën e linjave të lundrimit, zyrave postare, konsullatave, agjensive tregtare, shkollave, institucioneve për përkujdesjen sociale, bankave për dhënien eventuale të kredive për ndërtimin e hekurudhave etj. – kishte vetëm pak sukses, sepse prej planeve të shumta vetëm një numër i vogël mund të realizohej deri më 1912. Për këtë arsye, deri në Luftën e Parë Ballkanike bëhet fjalë vetëm për një imperializëm informal „*potencial*“ të Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë.

Chlumecky paralajmëroi që më 1907, në mënyrë bindëse, për të ashtuquajturin “altruizëm” të politikës së Monarkisë së Dyfishtë ndaj Ballkanit: *“Kështu krenohemi ende sot me ‘vetëmohimin’ e politikës sonë. Pa nxjerrë asnjë mësim nga përvojat e hidhura të kohëve të shkuara, ne mbahemi pas principeve, të cilat janë braktisur me kohë nga të tjerët. Sjellja egoiste e Anglisë mund të mos ngjallë shumë simpati nga ana njerëzore, por sukseset materiale*

1 Fernand Braudel: Sozialgeschichte des 15.-18. Jahrhunderts. Aufbruch zur Weltwirtschaft. München: 1986; Immanuel Wallerstein: Das moderne Weltsystem - die Anfänge kapitalistischer Landwirtschaft und die europäische Weltökonomie im 16. Jahrhundert. Frankfurt am Main: Syndikat 1986; Dieter Senghaas: Von Europa lernen. Entwicklungsgeschichtliche Betrachtungen. Frankfurt am Main: 1982; Iván Berend u. György Ranki: The European periphery and industrialization 1780-1914. Budapest: 1982; Karl Kaser: Im Schatten der europäischen Weltwirtschaft. Die Verfestigung der Agrarstrukturen und die Peripherisierung Südosteuropas im 16. Jahrhundert. Në: Südosteuropafallstudien. 20 Jahre Südosteuropäische Geschichte in Graz Graz: 1990, f. 49-81.

2 Huri Islamoglu dhe Çağlar Keyder: Agenda for Ottoman history. Në: The Ottoman empire and the World-Economy. Hg. v. Huri Islamoglu-Inan. Cambridge etj.: 1987, f. 63-87; Immanuel Wallerstein, Hale Decdeli, Resat Kasaba: The incorporation of the Ottoman Empire into the world-economy. Në: The Ottoman empire and the World-Economy. Hg. v. Huri Islamoglu-Inan. Cambridge etj.: 1987, f. 88-99.

3 Behnen: Dreibund, f. 365.

dhe kulturore gjigande që shënon kjo politikë, duken se kanë vlerë më shumë se përruljet e sjellshme dhe mirënjohja platonike të cilat ia shfaq bota e jashtme altruizmit tonë.¹ A mund të flitej vërtet për një politikë me karakter vetmohues të Austro-Hungarisë ndaj Ballkanit? Duhet bërë dallim midis linjës zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe qëllimeve e veprimeve të shumta shqiptaro-dashamirëse të përfaqësuesve austro-hungarezë në Shqipëri. Shkenca shqiptare pretendon se disa diplomatë si p.sh. Ippeni, Kvjatkovski dhe Králi kanë qenë seriozisht të interesuar në zgjidhjen e problemit të alfabetit përkundër qëndrimit zyrtar austro-hungarez.² Një person i vetëm mund të veprojë si altruist, kurse shteti sakrifkohet vetëm në atë rast për një komunitet tjetër, kur përfiton edhe vetë nga kjo gjë. Kështu Monarkia nuk angazhohej vetëm për hir të shqiptarëve për një Shqipëri të pavarur, por edhe për shkak të interesave të saj si fuqi e madhe në Ballkanin perëndimor. „Jo për hir të shqiptarëve, por për të mirën tonë na duhet një Shqipëri e fortë. Kjo Shqipëri duhet që në përputhje me politikën austro-hungareze e si rrjedhim dhe me atë gjermane, të përmbushë funksionin e bastionit të fundit kundër depërtimit të pansllavizmit deri në Adriatik; dhe më në fund Shqipëria paraqitet si ura e fundit përmes së cilës Evropa Qendrore mund të mbartë influencën e saj në mënyrë gati të papenguar në Ballkanin perëndimor“³, bën të qartë Chlumecky, më 1913, kur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër Monarkia luftonte për interesat e saj në Shqipëri.

Në fushën politike diplomacia austro-hungareze përpigëj vazhdimisht që prej Kongresit të Berlinit, në interes të qëllimit të vet për forcimin e Shqipërisë si bastion kundër ekspansionit serb dhe italian në Ballkan, të ushtronte dhunë strukturore ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Gjithnjë sipas nevojës së interesave të saj, ajo mbështeste herë Lidhjen Shqiptare e herë Portën e Lartë. Pas shtypjes së Lidhjes Monarkia kaloi në politikën e Status Quo-së, e cila ishte më e volitshmja për „depërtimin paqësor“ (pénétration pacifique) të Austro-Hungarisë në Shqipëri. Kur nga fundi i shek. 19-të filluan lëvizjet kombëtaro-çlirimtare në Shqipëri dhe Maqedoni, Ballhausplatz-i përpigëj të ndikonte qarqet udhëheqëse shqiptare nëpërmjet Kultusprotektoratit, i cili ishte i përfshirë si një ndër mjete të tjera në Aksionin për Shqipërinë (Albanien-Aktion) të viteve 1896/97. Në çështjen e reformave të Maqedonisë, Vjena ndiqte një politikë luhatëse të rafinuar midis shqiptarëve dhe turqve, sepse ishte shumë e sigurt që Shqipëria kishte nevojë për ndihmën e Austro-Hungarisë, nëse donte të evitonte fatin e një „Polonie ballkanike“ pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Kjo lojë e luhatjes së vazhdueshme të Ballhausplatz-it u përsërit gjatë kryengritjeve shqiptare të viteve 1909-12 kundër regjimit xhonturk. Nga njëra anë, diplomacia vjeneze ndërhyri për shpëtimin e Perandorisë Osmane, nga ana tjetër, doli si „mbrojtëse e interesave shqiptare,“ duke ngritur zërin fort për plotësimin e kërkesave të shqiptarëve. Pra, Shqipëria që ndodhej akoma nën autoritetin e qeverisë osmane, ishte gjithnjë politikisht e varur nga dashamirësia dhe interesat vetiakë të mbrojtëses dhe zëdhënëses së saj të madhe Austro-Hungaria. Ky raport i pabarabartë midis të dy

1 Chlumecky: Österreich-Ungarn und Italien, f. 70.

2 Schwanke: Österreich-Ungarn und der albanische Sprachkongress zu Manastir, f. 76.

3 Leopold Freiherr von Chlumecky: Österreich-Ungarns und Deutschlands Interesse an einem starken Albanien. Në: Österreichische Rundschau 34 (1913), f. 255 v..

palëve doli plotësisht në pah gjatë dy luftërave ballkanike. Austro-Hungaria luante një rol vendimtar ose së paku bashkëvendimtar në të trija çështjet që ishin me rëndësi tepër të madhe për Shqipërinë e ardhshme: në çështjen e statusit ndërkombëtar, të vendosjes së kufijve dhe në atë të organizimit të shtetit të ri Shqipëria. Kur u desh të zgjidhej delegati shqiptar për në Komisionin Ndërkombëtar, ishte e qartë që Ballhausplatz-i do t'i imponohej qeverisë provizore shqiptare. Të gjithë shembujt e renditur këtu shprehin dhunën strukturore të fuqisë mbrojtëse - Austro-Hungaria- ndaj së mbrojturës së saj të vogël- Shqipëria. Monarkia e ka bërë fatin politik të popullit shqiptar pjesë të konceptit të saj politik dhe i ka përputhur gjithnjë marrëdhëniet bilaterale me këtë. Hapësira e veprimit për Rilindjen shqiptare krijohej atje ku pajtoheshin interesat afatshkurtër ose afatmesëm të të dy palëve.¹ Por me afat të gjatë synohej shtypja e më të dobët prej më të fortit – qoftë me mjete informale ose formale – siç u konfirmua nga politika hegjemoniste e Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë gjatë regjimit të shkurtër të Wied-it dhe nga administrimi ushtarak mbretëror-perandorak dyvjeçar i Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore.

Në fushën kulturore *Kultusprotektorati* është një shembull klasik për dhunën strukturore midis Qendrës dhe Periferisë: fqinji i fuqishëm, Austro-Hungaria, merr përsipër mbrojtjen e një pjese të popullsisë (të katolikëve) të vendit të dobët, Shqipëria. Në këtë kuadër Monarkia nuk ngurronte të bënte presion mbi Vatikanin, kur bëhej fjalë për të larguar ipeshkëvij të padëshirueshëm nga Shqipëria. Ushtrimi i ndikimit mbi popullatën shqiptare dhe nxitja e vetëdijes kombëtare shqiptare në interes të Monarkisë Habsburgase, nëpërmjet pagesave të bajraktarëve me influencë dhe të çifligarëve nga ana e konsullatave, u përkitnin detyrave më të rëndësishme „jozyrtare“ të Kultusprotektoratit. Një nga instrumentet kryesore për të ushtruar ndikim ishte sistemi arsimor. Fuqia qendrore, Austro-Hungaria, përcaktonte në parim mësuesit dhe lëndën mësimore, ndërsa Periferia e varur prej saj, Shqipëria, mund të paraqiste vetëm nxënësit dhe mësuesit që ishin arsimuar në Qendër (Austri). Kostot e kësaj politike kulturore ishin vërtet shumë të mëdha për Monarkinë, por ishte vetëm ajo që vendoste për përdorimin e mjeteve financiare.² Një shembull tjetër për dhunën strukturore në kuadër të politikës kulturore është Konvikti i Shqiptarëve në Vjenë. Të gjitha shpenzimet e këtij programi arsimor u morën përsipër nga Ministria mbretërore-perandorake e Tregtisë, në mënyrë që të përforcohej pozita ekonomike e Austro-Hungarisë në Shqipëri dhe të parapërgatitej terreni për vendosjen e ardhshme të firmave në Shqipëri. Shqiptarët e arsimuar në Monarki do të duhej të mbronin më vonë interesat mbretërore-perandorake në Shqipëri. Dhe, bile, çështja e alfabetit shqiptar u përdor si shkas për të ndikuar në dhënien e subvencioneve, në punësimin e mësuesve dhe në emërimin e ipeshkëvijve sipas interesave të Habsburgasve. Madje pas 1908 Ballhausplatz-i ishte i gatshëm të pranonte një letërsi kombëtare të hartuar në

1 Qarqet shqiptare të interesuara për bashkëpunim me Monarkinë ishin borgjezia e pasur dhe çifligarët, të cilët shërbyen si bazë shoqërore për infiltrimin ekonomik dhe politik të Austro-Hungarisë në Shqipëri. Shih Shpuza: Aspekte nga gjendja ekonomike, f. 115 v..

2 Mbi përdorimin e donacioneve nga buxheti i kultit dhe fondi disponibël politik shih Schanderl: Albanienpolitik, f. 145-162.

alfabetin arab, përderisa kjo gjë mund të nxiste vetëdijen kombëtare të myslimanëve shqiptarë, të cilët kishin mbetur deri tani të paafrueshëm.

Në fushën ekonomike dhuna strukturore e Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë manifestohej në përpjekjen për të kontrolluar rrugët detare e tokësore, që ishin aq të rëndësishme për sigurimin e hegjemonisë ekonomike e strategjike në Ballkanin perëndimor. Gjatë shekullit të 19-të Lloyd-i e gëzonte pozitën monopoliste në tregtinë detare me Shqipërinë përmes Triestes dhe Fiumes. Importi i sheqerit dhe i kafes bëhej ekskluzivisht nga Triestja dhe eksporti i artikullit kryesor shqiptar, vaji i ullirit, shkonte në pjesën dërrmuese për në Trieste. Përveç kësaj, shumica e artikujve të tjerë të eksportit shqiptar eksportohej, të paktën, në masën 50% përmes Triestes. Pra pjesa e Monarkisë në tërë biznesin e import-eksportit të Shqipërisë ishte mesatarisht 50% në vit. Megjithë humbjet relative Monarkia Danubiane mbeti deri në vitin 1914 partneri kryesor i tregtisë së jashtme të Shqipërisë. Me anë të marrëdhënieve tregtare të pabarabarta synohej nga Ballhausplatz-i varësia ekonomike e popullit të vogël ballkanik prej Monarkisë dhe kjo u arrit deri diku,¹ edhe pse jo në atë masë që ishte shpresuar. Shumë projekte për ndërtim hekurudhash mbetën në fazën e planifikimit, pasi, nga njëra anë, ministritë përgjegjëse dhe Financa e Lartë nuk ishin të gatshme të paguanin dhe, nga ana tjetër, u spostuan prej projekteve konkurruese të Fuqive të tjera të Mëdha. Kur kushtet e brendshme më në fund u bënë të favorshme, ishin faktorët e jashtëm, si Luftrat Ballkanike, ato që penguan fillimin e punimeve. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në Londër, Vjena i vari shpresat të Komitetit për Shqipërinë, i përbërë nga përfaqësues të rangut të lartë të politikës, ekonomisë, publicistikës dhe shkencës, qëllimi i të cilit ishte zgjerimi dhe thellimi i marrëdhënieve ekonomike dhe sigurimi i tregjeve. Që në muajt e parë të krijimit, anëtarët udhëheqës të komitetit vendosën lidhje të ngushta me personalitetet më të rëndësishme shqiptare të jetës publike. Pas fillimit të detyrës së Princ Wied-it u prit për porosi shtetërore e private të çdo lloji, të financuara nëpërmjet huasë shtetërore shqiptare të garantuar nga Fuqitë e Mëdha.² Kapitalit austro-hungarez i duhej të merrte pjesë në vijë të parë në rindërtimin e principatës së re. Modernizimi i Shqipërisë do të rriste kërkesën për produkte cilësore dhe do të krijonte tregje të reja për Monarkinë. Ndërhyrja e Austro-Hungarisë për një Shqipëri të pavarur e të pacënuar nga ana territoriale bëri të priste simpatinë e shqiptarëve ndaj tregtarëve austro-hungarezë. Udhëtimet studimore nëpër Shqipëri, të kryera nga Komiteti për Shqipërinë, duhet të jepnin një tablo të qartë të jetës ekonomike shqiptare dhe të mundësive për investime të Monarkisë Habsburgase.

Ngaqë të gjitha këto objektiva dhe masa orientoheshin nga një qëllim i vetëm i madh, pra nga hegjemonia ekonomike e Austro-Hungarisë mbi principatën e re, Shqipëria, ato duhen klasifikuar si aspekte të menduara mirë të dhunës strukturore. Megjithatë, deri më 1913, në Monarkinë e Dyfishtë mbizotëronte në përgjithësi

1 Kapitali austro-hungarez siguroi pozicione kyç, që i lejuan Monarkisë të kontrollonte tërë jetën ekonomike të Shqipërisë dhe madje të ndërhynte në politikën e vendit. Shih Shpuza: Aspekte nga gjendja ekonomike, f. 98.

2 Breycha, f. 4.

mosinteresimi për marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë. Më 1907 Chlumecky u ankua se nuk kishte një trajtim publik serioz të këtyre çështjeve dhe se ndihej mungesa e angazhimit të Financës së Lartë, tregtarëve dhe industrisë.¹ Në dekadën e parë të shekullit të 20-të ekonomia austro-hungareze nuk kishte në dispozicion rezerva të mjaftueshme kapitali për investime riskante jashtë vendit, sepse kapitali ishte i lidhur nga pjesëmarrja në biznese të huaja dhe nga prioriteti për nxitjen e industrisë në zonat e prapambetura të Monarkisë.² Studimet më të fundit pajtohen në pikëpamjen se burrat e shtetit dhe diplomatët e Fuqive të Mëdha kanë përkrahur thuajse gjithnjë vetëm në mënyrë hezituese pushtime territoriale imperialiste.³ Por duhet vërejtur se në rastin e Austro-Hungarisë ka ndodhur e kundërta: një lob ekonomik i mirëfilltë, që shtyn drejt një zgjerimi imperialist në Ballkan, nuk ka ekzistuar kurrë. Kanë qenë pothuajse ekskluzivisht burrat e shtetit dhe ushtarakët ata që hartonin programe politike dhe koncepte imperialiste në lidhje me Shqipërinë. Mungonte një bashkësi e fortë interesash midis drejtuesve të bankave dhe ekonomisë private, nga njëra anë, dhe ministrive shtetërore, nga ana tjetër. Prandaj imperializmi ekonomik informal i Monarkisë Habsburgase në Shqipëri nuk arriti t'i tejkalonte fillimet aq shumë premtuese.⁴ Megjithëse ofensiva ekonomike e Aehrenthal-it në Ballkan, me pretendimin e saj politik për hegjemoni, dështoi për shak të mos interesit të Financës së Lartë të Vjenës për investime në zona periferike të pazhvilluara, topos-i i *"Shtytjes drejt Juglindjes"* nga ana e Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë gjeti kulmin në publistikën bashkëkohore brenda dhe jashtë vendit (para së gjithash në Francë dhe Itali).⁵ Kështu u shpreh Lemberger-i akoma më 1914 në lidhje me interesat e Austro-Hungarisë në Shqipëri: *"Futja me çdo çmim që lyp nevoja, në këto tregje, të cilat edhe gjeografikisht shihen si pjesa jonë, nuk më duket vetëm një urdhër për çdo industrialist dhe tregtar të interesuar për tregun e jashtëm, por para së gjithash paraqitet si një obligim patriotik."*⁶ Vërtet Monarkia e Dyfishtë arriti në Luftën e Parë Botërore ta ndryshonte për dy vjet imperializmin informal në atë formal⁷, por përfundimi i luftës dhe si pasojë, shpërbërja e shtetit shumëpopujsh, sollën me vete fundin e të gjitha aspiratave të saj imperialiste në Ballkanin perëndimor dhe në Shqipëri.

1 Behnen: Dreibund, f. 405.

2 Po aty, f. 406.

3 Mommsen, f. 61.

4 Behnen: Dreibund, f. 406 dhe 458-460.

5 Po aty, f. 460.

6 Lemberger, f. 9.

7 Helmut Schwanke: Zur Geschichte der österreichisch-ungarischen Militärverwaltung in Albanien (1916-1918). Wien: Diss. 1982.

Vartësia paradoksale e globalizmit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut

Aurora Guxholli¹

ABSTRAKT. *Kjo ese bazohet në supozimin se globalizimi është një proces pa kthim pas. Duke pranuar si të mirëgenë ndikimin kontradiktor të globalizmit mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut krahasuar me rezultatet e premtuara, ky hulumtim kërkon një mundësi për të përmirësuar ndikimin e globalizmit mbi këto dy fenomene, rrjedhimisht mbi mirëqenien shoqërore. Globalizmi dhe demokracia janë të ndërlidhur në mënyrë të tillë që edhe pse transformimet globale ndodhin në terrene demokratike lokale, ato i kapërcejnë kufijtë kombëtarë. Këtu dhe shfaqet kundërshtia mes dy fenomeneve, e mishëruar në paqartësinë se kush duhet t'i japë llogari kujt. Nga ana tjetër, integrimi ndërkombëtar ka ndikuar pozitivisht mbi të drejtat e njeriut, duke lehtësuar lindjen e lëvizjeve në mbrojtje të tyre, jo vetëm në aspektin e ndërgjegjësimit por edhe në marrjen e masave mbrojtëse konkrete. Megjithatë, mungesa e një sistemi të konsoliduar qeverisjeje globale pa një qeveri globale ka ndikuar negativisht zhvillimin, veçanërisht atë të vendeve që po globalizohen e zhvillohen rishtazi. Këta tregues mbështesin idenë e vartësisë reciproke të kombit-shtet dhe aktorëve ndërkombëtarë në të gjitha aspektet e rendit global. Në vend që të hidhet poshtë qoftë koncepti i kombit-shtet apo i rendit global, ose i vetë globalizmit, demokracia kozmopolite mund të ofrojë një sistem të ri politik ku mund të harmonizohen të tria këto fenomene.*

1 Aurora Guxholli është diplomuar në vitin 2007 me gradën MA nga programi i përbashkët i Universitetit të Sarajevës, Bosnje-Hercegovinë dhe atij të Bolonjës, Itali, në temën e të drejtave të njeriut e demokracisë në vendet e Europës Juglindore. Aurora ka përfunduar në vitin 2003 studimet e larta në degën e Psikologjisë pranë *Middle East Technical University* në Ankara, Turqi. Ka marrë pjesë në disa praktika pune ku vlen të përmenden ajo në Komitetin e Helsinkit në Beograd, Serbi dhe pjesëmarrja si vullnetare në organizimin e Festivalit të filmit për të drejtat e njeriut *Ljudski Pravo* në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë. Që prej vitit 2005 ka punuar kryesisht në sektorin e shoqërisë civile. Njëkohësisht ajo është edhe lektore në Universitetin Europian të Tiranës.

Hyrje

Qëllimi i kësaj eseje është të analizojë shkaqet e ndikimit kontradiktor të globalizimit krahasuar me premtimet e tij për zhvillim e mirëqenie të gjithanshme. Për këtë arsye do të merret në shqyrtim lidhja e ndërsjelltë ndërmjet procesit të globalizimit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Edhe pse këto tre fenomene do të trajtohen kryesisht në aspektin teorik, shembujt ilustrues dëshmojnë se rëndësi e veçantë i është kushtuar pasojave të globalizimit në vendet në zhvillim. Panorama e paraqitur i përket kryesisht dy dekadave të fundme, ku procesi i globalizimit përfshiu edhe vendet e Europës Juglindore, të sapo dala nga sistemi komunist. Në këto kushte, vështirësitë në procesin e demokratizimit, së bashku me kërkesën për respektimin e të drejtave të njeriut si pjesë e këtij procesi, u theksuan edhe më tej nga transformimet e reja globale, prurje këto të pashmangshme pavarësisht kufijve ende të rëndësishëm në rolin e tyre kufizues të këtyre vendeve.

Është dëshmuar tanimë se globalizmi ka ndikuar thellësisht si mbi demokracinë ashtu edhe mbi të drejtat e njeriut, kryesisht si rezultat i vetë natyrës së ndryshueshme të këtij procesi gjatë historikut të zhvillimit të tij. Debatet akademike kanë nxjerrë në pah edhe natyrën e ndryshueshme të sistemit demokratik në erën globale. Në mënyrë të veçantë, këto debate i mëshojnë rëndësisë së rolit të sovranitetit të kombit-shtet, i cili nga ana e tij ndikon në regjimin e të drejtave të njeriut. Bazuar në sa më sipër, ndikimi qoftë pozitiv apo negativ i globalizimit mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut është thelbësor në ravijëzimin e jetës së sotme, duke përfshirë njëzëri aspektin ekonomik, politik dhe social.

Kjo ese kërkon t'i përgjigjet pyetjes që lind si pasojë e kundërshtive ekzistuese ndërmjet aspiratës dhe ndikimit aktual të procesit të globalizimit: *Cilët janë faktorët shkaktues të ndikimit kontradiktor të globalizimit mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut, krahasuar me rezultatet e premtuara dhe çfarë mund të bëhet për të përmirësuar ndikimin e globalizimit mbi këto dy fenomene, rrjedhimisht mbi jetën e qytetarëve?* Analiza e paraqitur në këtë ese ndërtohet mbi ilustrime si teorike ashtu edhe praktike, duke thelluar kështu të kuptuarit e tre fenomeneve të sipërpërmendura. Për më tepër, kjo ese paraqet zgjidhje të mundshme për rritjen e ndikimit pozitiv të globalizimit në të ardhmen, duke argumentuar se si një model i përshtatshëm për këtë është *demokracia kozmopolite*. Debatet akademike mbi lidhjen ndërmjet këtyre tre koncepteve përbëjnë gurët me të cilët është punuar mozaiku analitik i temës.

Pjesa e parë e esesë paraqet një tablo teorike të globalizimit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe pasohet nga një prezantim i ndikimit të të parit si proces i vazhdueshëm mbi dy konceptet e tjera. Pjesa e dytë është një analizë e detajuar e ndikimit të dy perspektivave të globalizimit mbi të drejtat e njeriut: globalizimit-nga-sipër dhe globalizimit-nga-poshtë. Këtu diskutohet dhe raporti i pozicionimit karshi njëri-tjetrit i globalizimit, shoqërisë civile dhe pushtetit ekonomik e politik. Pjesa e fundit e esesë hedh dritë mbi marrëdhënien ndërmjet demokracisë dhe të drejtave të njeriut, duke argumentuar se demokracia kozmopolite, e propozuar nga David Held, është një zgjidhje e kontradiktave të shtjelluara më sipër.

Çështje globalizmi; ndikimi i tij mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut

Globalizmi është procesi bashkëkohor i cili përfshin një gamë të gjerë aspektesh, duke nisur nga ai social, ekonomik, ushtarak, ligjor e shumë të tjerë. Ai karakterizohet nga qarkullimi ndërkombëtar i njerëzve, prodhimit, investimit, informacionit, ideve dhe autoritetit, tanimë në një mënyrë më të shpejtë e më të fuqizuar. Thënë ndryshe, ndryshimi në ritmin dhe ndikimin e qarkullimit e jo qarkullim tërësisht i ri, përbën procesin e globalizimit.¹ Rrjedhimisht, për shkak të natyrës së tij gjithëpërfshirëse, fenomeni i globalizimit karakterizohet nga qasje kontradiktore të analistëve të ndryshëm, të cilët u mëshojnë aspekteve të ndryshme mbizotëruese të tij. Globalizmi është konsideruar nga Greider dhe Korten si një proces kryesisht ekonomik, bazuar në kapitalizmin global, ndërkohë që Ruggie e përshkruan si një proces më tepër kulturor e social, i cili fokusohet në përhapjen e gjerë të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare. Sipas Kearney dhe Sassen, ky proces socio-kulturor karakterizohet edhe nga qarkullime ndërkombëtare demografike, mjedisore dhe kulturore.²

Fatkeqësisht, mëshimi i ri mbi dimensionin ekonomik të globalizmit, ku theksohen veçanërisht marrëdhëniet e tregut, ka lënë në hije aspekte të tjera të tij gjithashtu të rëndësishme, si ai kulturor, social dhe ekonomik.³ Ajo çka ka ndodhur është se aspekti ekonomik i globalizmit ka theksuar efektin kontradiktor të këtij fenomeni, krahasuar me rezultatet e premtuara. Në vend të rritjes dhe stabilitetit ekonomik të premtuar, shumë vende, kryesisht ato në zhvillim, po përjetojnë mungesë stabiliteti ekonomik e për më tepër përqindje të larta varfërie. Shumë kritika janë bërë edhe për kërcënimin që paraqet globalizmi për vlerat tradicionale, normat shoqërore dhe identiteteve kulturore. Shumë shpesh kundërshtuesit e globalizmit parashtrojnë *njëanshmërinë perëndimore* të globalizmit, kurse ata më ekstremët e quajnë *imperializmi perëndimor*, duke e barazuar me kapitalizmin triumfues i cili i bën jehonë stilit amerikan. Ata e konsiderojnë fenomenin e globalizmit si një imponim të vlerave dhe marrëdhënieve kapitaliste në vende të tjera.

Megjithatë, sipas përkufizimit të Jan Arte Scholte “globalizmi është një gërshetim zhvillimesh që e bëjnë botën një vend të vetëm, duke ndryshuar kuptimin dhe rëndësinë e largësisë dhe identitetit kombëtar në çështjet botërore”.⁴ Në fakt është vërtetuar se hapja ndaj tregtisë ndërkombëtare ka pasur ndikim mbresëlënës në shumë vende ekonomia e të cilëve po rritet shumë herë më shpejt seç do të kishte ndodhur në rast të kundërt; shumë njerëz jetojnë më gjatë se më parë dhe standardi i jetesës është shumë herë më i lartë;

1 Brysk, Alison. “Transnational Threats and Opportunities”. Në Brysk, Alison (red). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

2 Brysk, Alison. “Transnational Threats and Opportunities”. Në Brysk, Alison (red). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

3 “The realization of economic, social and cultural rights: Globalization and its impact on the full enjoyment of human rights”. *United Nations Economic and Social Council*, 15 qershor 2000.

4 Brysk, Alison. “Transnational Threats and Opportunities”. Në Brysk, Alison (red). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

ndjesia e izolimit e përjetuar nga njerëzit e vendeve në zhvillim, veçanërisht atyre ish-komuniste, është ulur; aksesit në informacion është më i thjeshtë për shkak të mundësisë së qarkullimit përtej kufijve të teknologjisë dhe informacionit; deri dhe protestat kundër globalizmit janë rezultat i kësaj lidhjeje të pahasur më parë, ku aktivistët nga gjithë bota merren vesh dhe organizohen me njëri-tjetrin me anë të lehtësive të ofruara nga globalizmi, si për shembull lidhja në internet.¹ Këto të dhëna janë prova të pathyeshme të ndikimit thelbësor të globalizmit si një proces tanimë i paevitueshëm nisur nga shkalla e lartë e transformimeve që vihen re në shoqëritë e ditëve të sotme.

Për sa i përket rëndësisë historike të ndryshimeve që globalizmi sjell në botën e sotme, sipas Howard - Hassman ato mund të përmbledhen nën termin *transformimi i dytë i madh* pas ndryshimeve ekonomike, sociale dhe kulturore që ndodhën në Europë, veçanërisht në Britaninë e Madhe, që prej fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë deri në prag të Luftës së Dytë Botërore, të quajtura ndryshe nga Karl Polyani *transformimi i madh*.² Revolucioni industrial i kësaj periudhe solli një transformim radikal të jetës së njerëzve, ku aspekti ekonomik mori rëndësi të veçantë në përkufizimin e roleve njerëzore e për pasojë marrëdhëniet mes tyre, të fokusuar jo më në aspektin social të jetës por në fitimin. Marrëdhëniet e reja u ravijëzuan bazuar në konceptin e tregut. Komuniteti si qendër e jetës sociale u zëvendësua nga individi. Globalizmi si *transformimi i dytë i famshëm* përfaqëson “goditjen e fundit të kapitalizmit në të gjitha ato zona të globit që kanë shpëtuar deri tani për shkak të politikave komuniste dhe socialiste tejet mbrojtëse apo shpëputëse nga ekonomia botërore, ose sepse kapitalizmi nuk pati interes në rajon si burim kapitali apo rezervash, burim punonjësish apo në vetë tregun”.³ Megjithatë, studiues të tjerë mendojnë se edhe pse shoqëritë e njerëzve janë ndikuar thellësisht nga globalizmi, rëndësia e transformimeve nuk është e njëjtë për të gjithë.

Në shtjellimin e ndikimit të globalizmit, Held thekson natyrën e tij diferencuese, duke argumentuar se globalizmi ka ndikim të ndryshëm mbi individë, grupe apo shoqëri të ndryshme. Sipas Held:

“Edhe pse globalizmi lejon akses në lehtësi të shumë fushave, mbetet pengesa e aksesit të diferencuar për shkak të pushtetit - aftësia për të transformuar rrethanat materiale, qoftë ato sociale, ekonomike apo politike, dhe për të arritur qëllime bazuar në mobilizimin e burimeve, krijimin e sistemit të rregullit dhe në kontrollin e infrastrukturës dhe institucioneve. Marrëdhëniet e pushtetit në globalizëm kanë akses hierarkiko-asimetrik në rrjetin global, si dhe karakter të pabarabartë; efektet asimetrike të këtyre rrjeteve mbi fatin dhe mirëqenien e njerëzve, klasave, grupimeve etnike dhe sekset”.⁴

1 Stiglitz, Joseph. E. *Globalization and its Discontents*. W. W Norton and Company. Inc 2002.

2 Cituar nga Howard-Hassmann, Rhoda E. “The Second Great Transformation: Human Rights Leapfrogging in the Era of Globalization” *Human Rights Quarterly* 27.1.2005.4.

3 Cituar nga Howard-Hassmann, Rhoda E. “The Second Great Transformation: Human Rights Leapfrogging in the Era of Globalization” *Human Rights Quarterly* 27.1.2005.5.

4 Held, David. “Democracy and Globalization”. Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998. 14.

Njerëzit që i përkasin shtresës elitare të ekonomisë, politikës, shkencës etj., kanë më tepër akses në lehtësitë e ofruara nga globalizmi, në krahasim me mundësitë që kanë njerëzit të cilët jetojnë në vendet në zhvillim, në veçanti ata në zonat rurale të Afrikës, për shembull. Këta të fundit, sipas kësaj teorie strukturore jetojnë në skajin më të fundmë të strukturave pushtetare në rendin global.¹ Por cilët janë këta faktorë që gjenerojnë natyrën diferencuese të ndikimit të globalizmit? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet më parë të biem në gjurmë të forcës e cila përhap ndikimin e globalizmit në të gjithë botën.

Demokracia në globalizëm

Të kuptuarit e regjimit politik në të cilin funksionon globalizmi është një kusht i domosdoshëm për të kuptuarin e vetë globalizmit e për më tepër për përpunimin e një reagimi të arsyeshëm ndaj tij. Duke iu referuar rëndësisë së aspektit politik të globalizmit, është e qartë se ai nuk mund të jetë një rezultat vetëm i forcave të tregut, sepse konteksti ku ndodh procesi i globalizimit caktohet prej kufijsh politikë, të tillë si negociatat ndërmjet qeverive, korporatat apo organizatat ndërkombëtare, institucionet ndërkombëtare si Bashkimi Europian etj.² Gjatë shekullit të njëzetë, fenomeni i globalizmit u fuqizua dhe u mbështet në regjimin demokratik, një sistem i adoptuar nga pothuajse të gjitha rajonet kryesore të botës. Ky është një tregues se numri i vendeve me sistem demokratik ka ardhur në rritje, duke e kthyer kështu demokracinë në standardin themeltar të legjitimitetit politik.

Një sistem demokratik është ai i cili kërkon të fuqizojë njerëzit në mënyrë që ata të vetëudhëhiqen, çka do të thotë se në një sistem të tillë njerëzit konsiderohen si sovranë, thënë ndryshe sipas Deklaratës së Vjenës: “të lirë të përcaktojnë sistemet e tyre politike, ekonomike, sociale dhe kulturore”.³ Sistemi demokratik mundëson shtrirjen e plotë të kapitalizmit, një mënyrë kombëtare paradoksale e organizimit politik. Polemika me temë: demokracinë në kontekstin e globalizmit, bazohet në pyetjen nëse vetë kombi-shtet mund të mbesë në qendër të mendimit demokratik.⁴ Kjo polemikë është trajtuar nga shumë studiues. Disa prej tyre edhe kanë ofruar zgjidhje të mundshme për të ardhmen e ekzistencës së përbashkët të demokracisë dhe globalizmit.

Njëri prej tyre, Held, ka trajtuar ndikimin e transformimeve globale në natyrën e demokracisë. Si fillim, sipas tij, ka ndodhur një zhvendosje e pushtetit nga qeveritë

1 Held, David. “Democracy and Globalization”. Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

2 United Nations Economic and Social Council. *The realization of economic, social and cultural rights: Globalization and its impact on the full enjoyment of human rights*. 15 qershor 2000.

3 Cituar nga Donnelly, Jack. “Human Rights, Democracy, and Development” *Human Rights Quarterly* 213.1999.615.

4 Stiglitz, Joseph. E. *Globalization and its Discontents*. W. W Norton and Company. Inc 2002.

kombëtare të një pushteti i ndarë mes forcash të ndryshme në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Së dyti, komuniteti vetëvendosës nuk ndodhet më brenda kufijve të një kombi-shteti. Së treti, autonomia dhe sovraniteti i shteteve është ndikuar thellësisht nga transformimet globale. Së fundmi, ai ka shtruar pyetjen e *kush duhet t'i japë llogari kujt*, e cila lind si pasojë e një rendi të ri botëror, ku forcat ndërkombëtare u bien përmes kufijve të komuniteteve kombëtare dhe ku shtetet e fuqishme marrin vendime jo vetëm për popujt përkatës, por dhe për të tjerët.¹

Duke u ndalur në çështjen e trajtuar më parë, të kufijve, sfida e sjellë prej procesit të globalizimit ngre pyetje thelbësore edhe për demokracinë. Përfshirja dhe përjashtimi i njerëzve nga pjesëmarrja në vendime që kanë të bëjnë me jetën e tyre është caktuar gjithmonë nga kufijtë tradicionalë, ndërkohë që në regjimin global vendimet merren përtej kufijve kombëtarë.² Në këtë prizëm, demokracia nuk është më një sistem politik vetëm i një komuniteti apo kombi-shteti, por deri diku një sistem ku ndodhin transformimet globale. Ky paradoks ilustron më së miri me anë të shembullit të një vendi evropian që synon të integrohet në Bashkimin Evropian. Komuniteti ndërkombëtar në këtë rast është BE, një aktor padyshim vendimmarrës për politikën dhe ekonominë e vendit në fjalë, i cili kthehet automatikisht në zbatues të mirëfilltë të politikave të BE-së, të vendosura si kushte për integrimin e synuar. Është e qartë se sovraniteti i propaganduar nga vlerat demokratike nuk ndodh ashtu si parashikohet brenda kufijve shtetërorë, ndërkohë që vetë aspirata për integrim është pasojë e procesit të globalizimit, i cili gjithashtu ka premtuar përhapjen e demokracisë. Ky paradoks është edhe hendeku ndërmjet premtimeve dhe ndikimit konkret të procesit të globalizimit mbi vlerat shoqërore demokratike.

Detaje të mëtejshme të modelit të ri të demokracisë kozmopolite të Held-it do të shtjellohen në pjesën e fundit të kësaj eseje. Ky model është propozuar si zgjidhje e mundshme e kontradiktave të sipërpërmendura, mes demokracisë dhe globalizimit. Ai sjell në mendje filozofinë e të drejtave të njeriut, sipas së cilës kufizimi i lirisë individuale është i nevojshëm në mënyrë që gjithkush t'i gëzojë këto të drejta barazisht. Po kështu, filozofia e demokracisë kozmopolite thekson nevojën e kufizimit të sovranitetit të shtetit, në mënyrë që të fuqizohet regjimi global. Nga paralelet e mësipërme, është e qartë se sfidat me të cilat përballlet demokracia në rrethanat e transformimeve globale kanë ushqyer gjithashtu me të njëjtat kontradikta edhe regjimin e të drejtave të njeriut.

1 Held, David. "Democracy and Globalization". Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

2 Held, David. "Democracy and Globalization". Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

Të drejtat e njeriut në globalizëm

“**T**ë drejtat e njeriut janë një bashkësi pohimesh në funksion të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor nga detyrimet e paligjshme, zakonisht të vëna në skenë nga agjentë shtetërorë.”¹ Si të tilla, çdokush ka të drejtën t’i gëzojë ato thjesht prej shkakut të të qenit njeri. Për pasojë, “kemi të drejtë t’i gëzojmë barazisht të gjitha të drejtat, sepse ne jemi barazisht qenie njerëzore”.² Për herë të parë ato u paraqitën në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNj) në vitin 1948, e cila u shkrua si reagim ndaj Holokaustit. Aty u adresuan teknikat dhe kushtet çnjerëzore të imponuara nga regjimi nazist para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.³ DUDNj theksoi të drejtat e individëve për kushte minimale politike, sociale dhe ekonomike. Kjo Deklaratë i dha rëndësi mbrojtjes së barabartë të çdo individi për sa i përket këtyre të drejtave, ndryshe nga theksi në të drejtat e grupit gjatë periudhës para Luftës së Dytë Botërore. Që prej asaj kohe të drejtat e njeriut kanë përshkruar trajektore të qenësishme ndryshimesh deri në formimin e regjimit të të drejtave të njeriut.

Pas fundit të kolonializmit në vitet 1950, fokusi i të drejtave të njeriut u zhvendos përsëri, duke u mëshuar të drejtave të njerëzve (jo më të njeriut, pra nga njëjësi sërish në shumës), pakicave dhe komuniteteve të ndryshme, duke u bërë kështu pjesë e dy Konventave të reja Ndërkombëtare (1966), njëra mbi të drejtat civile dhe politike si dhe tjetra mbi ato ekonomike, sociale dhe kulturore. Këto Konventa njohin të drejtën e njerëzve për vetëvendosje, duke përfshirë këtu të drejtën për të përcaktuar ata vetë statusin e tyre politik dhe për të ndjekur gjithashtu vetë udhën drejt zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor.⁴ Vetë Deklarata mbi të Drejtën për Zhvillim (1986) e përkufizon zhvillimin si “një proces gjithëpërfshirës ekonomik, social, kulturor dhe politik, i cili synon përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së të gjithë popullatës”. E drejta e njerëzve për zhvillim, po sipas kësaj Deklarate, përfshin “sovrانيتet të plotë mbi të gjitha burimet dhe pasuritë e tyre”.⁵

Në erën globale, regjimi i të drejtave të njeriut është pashmangshmërisht i ndikuar nga procesi i globalizimit, për shkak të themelit të përbashkët të këtyre dy fenomeneve, natyra e tyre universale. Duke qenë se të drejtat e njeriut janë “pothuajse të identifikueshme me politikën globale”, aspirata universale e regjimit të të drejtave të njeriut gërshetohet me transformimet globale.”⁶ Pavarësisht natyrës së tyre globale,

1 Brysk, Alison. “Transnational Threats and Opportunities”. Në Brysk, Alison (red.). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002. 3.

2 Donnelly, Jack. “Human Rights, Democracy, and Development” *Human Rights Quarterly* 21.3 (1999). 612.

3 Twiss, Sumner B. “History, Human Rights, and Globalization” *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

4 Twiss, Sumner B. “History, Human Rights, and Globalization” *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

5 Twiss, Sumner B. “History, Human Rights, and Globalization” *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

6 Beetham, David. “Human Rights as a Model for Cosmopolitan Democracy”. In Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998. 59.

jo çdo individ dhe shoqëri i gëzon të drejtat e njeriut njësoj. Atëherë kush e zotëron pushtetin për të kontrolluar, zhvilluar dhe sanksionuar regjimin universal të të drejtave të njeriut?

Ndikimi i globalizmit mbi të drejtat e njeriut është i lidhur ngushtë me llojin e shtetit dhe historinë e tij.¹ Duke iu rikthyer diskutimit të mëparshëm për rolin e vazhdueshëm të kombit-shtet, faktet tregojnë se shteti është makina kryesore e promovimit, zhvillimit, deri dhe dhunimit të të drejtave të njeriut. Regjimi i të drejtave të njeriut është i brishtë në vendet e demokratizuara rishtazi, ku shteti nuk është ende i konsoliduar dhe ka hapësirë për institucione të dobëta dhe ekonomi të kontrolluara nga elita, si për shembull Rusia, Amerika Latine, Azia Juglindore, Europa Qëndrore dhe ajo Juglindore etj. Rritja e tregjeve globale dhe qarkullimeve ekonomike, lëvizshmëria globale dhe qarkullimi i informacionit janë të gjitha fenomene të reja për këto shoqëri, të cilat si pasojë reagojnë ose me anë të mobilizimit etnik, duke sjellë si rezultat kërkesën për vetëvendosje, ose me anë të abuzimeve kolektive në mbrojtje të grupit dominues.²

Përveç rendit politik bazuar në kombin-shtet, regjimi i të drejtave të njeriut përfshin masa ndërkombëtare për monitorimin, zhvillimin dhe sanksionimin e dhunimit të të drejtave të njeriut. Studimi i Burgeman dhe Sikkink mbi efektshmërinë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi shtetin tregoi se zhvillimi mund të arrihet kur shtetet janë të aksesueshëm në terma strukturore, ekziston bashkëpunimi ndërmjet institucioneve ndërkombëtare dhe shtetit dhe kur në këtë shtet ka aktivistë të të drejtave të njeriut.³ Bazuar në sa më sipër, është e qartë se zhvillimi dhe fuqizimi i të drejtave të njeriut në mbarë botën është i nevojshëm jo vetëm vullneti shtetëror por edhe ai ndërkombëtar.

Përveç nevojës së përpjekjeve të përbashkëta kombëtare e ndërkombëtare, ka edhe argumente kundërshtuese për sa i përket ndikimit të tyre mbi të drejtat e njeriut. Debatet rreth ndikimit të globalizmit formëzohen në dy kahe të kundërta. Optimistë si Falk dhe Rosenau theksojnë ndikimin pozitiv të integritimit ndërkombëtar, duke sugjeruar se ai do të fuqizojë qytetarët të sfidojnë pushtetin e shtetit. Nga ana tjetër, revizionistë si Bhabha, Burbach, Brecher, Costello, Mander, Goldsmith etj. kritikojnë shfrytëzimin kombëtar dhe/ose atë të tregut.⁴ Siç shihet edhe nga argumentet, në njërin anë qëndrojnë qytetarët kurse në tjetrën shteti dhe tregu. Sipas kësaj perspektive, ndikimi i globalizmit mbi të drejtat e njeriut duhet parë në dy aspekte: globalizmi nga sipër përkundërt globalizmit nga poshtë, të konsideruara si mundësi të reja për të sfiduar shtetin si nga poshtë ashtu dhe nga sipër, për të kërkuar mbrojtje për të drejtat e njeriut të qytetarëve.

1 Brysk, Alison. "Transnational Threats and Opportunities". Në Brysk, Alison (ed). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

2 Brysk, Alison. "Transnational Threats and Opportunities". Në Brysk, Alison (red.). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

3 Brysk, Alison. "Transnational Threats and Opportunities". Në Brysk, Alison (red). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

4 Brysk, Alison. "Transnational Threats and Opportunities". Në Brysk, Alison (red). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

Sfida e të drejtave të njeriut në erën globale

Të drejtat e njeriut ndikojnë në të dyja perspektivat e globalizmit, të quajtura globalizëm-nga-sipër dhe globalizëm-nga-poshtë. Këto dy koncepte datojnë më 1993-in, kur Richard Falk iu referua përkatësisht bashkëpunimit ekonomik dhe politik ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe agjentëve financiarë dhe atyre korporativë dhe me të dytin bashkëpunimit social, politik dhe kulturor ndërmjet agjencive vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare.¹

Globalizmi-nga-sipër

Sipas Paul Streeten, globalizmi mund të vijë nga sipër në formën e firmave shumëkombëtare, qarkullimeve ndërkombëtare të kapitalit dhe tregjeve botërore.² Ky aspekt i globalizmit është i lidhur ngushtë me tregtinë, financën dhe investimet ndërkombëtare bashkëkohore, duke operuar brenda kornizës ligjore të ofruar nga ligji ekonomik ndërkombëtar dhe të zbatuar nga mekanizma të veçantë institucionale, si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB) dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT).

Hendeku mes ndikimit të diskutueshëm të globalizmit dhe premtimeve të tij, siç u përmend dhe më sipër, i atribuohet aspektit ekonomik, të menaxhuar nga institucione ndërkombëtare, në veçanti Banka Botërore, FMN dhe OBT. Në analizën e tij rreth rolit të këtyre institucioneve në arenën globale, Stiglitz fajëson politikat e tyre për vendet në zhvillim dhe i konsideron këto politika si shkaktoare të dështimit të globalizmit, dështim që ka shkakuar papunësi masive, shpërbërje shoqërore dhe konflikte etnike. Rezultati për shumëkënd ka qenë varfëria, kurse për shumë vende kaosi social dhe ekonomik.

Arsyeja pse një sistem *qeverisjeje globale pa qeveri globale* ka dështuar, pavarësisht faktit të pamohueshëm se globalizmi është progres, ka të bëjë me marrëdhëniet e pushtetit. Në shtjellimit e ndikimit të marrëdhënieve pushtetare në vendet në zhvillim, Stiglitz krahason modelin rus të ekonomisë liberale të tregut, të hartuar nga rregullat e institucioneve ekonomike ndërkombëtare dhe modelin vetërregullues aziatik. Ndërkohë që në vitin 1990 prodhimi vendor bruto i Kinës ishte 60% më i ulët se ai rus, nga fundi i dekadës Rusia përjetoi një rritje pashoqe të varfërisë, kurse Kina krejt të kundërtën, një rënie drastike të saj. Ky shembull pasqyron qartazi pasojat negative të ndikimit të fuqive ndërkombëtare mbi vendet në zhvillim.

Po kështu, edhe politikat perëndimore të udhëhequra nga FMN dhe Banka Botërore i kanë detyruar vendet e varfëra të eliminojnë barrierat ekonomike, por kanë ruajtur të tyret, në një kohë kur eksporti ka rëndësi thelbësore për rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim. Sipas Stiglitz, kjo situatë nuk është tjetër veçse një mënyrë e re kolonizimi nga ana e fuqive të vjetra kolonizuese europiane. Hapja e tregjeve ka qenë njëkahëshe, në avantazh të mirëqenies së vendeve të zhvilluara e jo anasjelltas. Këto të dhëna bien ndesh me misionin parësor të FMN-së dhe BB-së, të dy të themeluar në fundin e periudhës së Depresionit Global, për të parandaluar një tjetër depresion global, përkatësisht duke

1 Twiss, Sumner B. "History, Human Rights, and Globalization" *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

2 Twiss, Sumner B. "History, Human Rights, and Globalization" *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

ushtruar trysni ndërkombëtare mbi shtetet, që ata të kenë politika ekonomike më tepër të zgjeruara dhe duke rindërtuar dhe zhvilluar vendet e pas-depresionit. Thënë shkurt, FMN-ja duhet të ruante qëndrueshmërinë globale, kurse BB të zhdukte varfërinë. Misioni i tyre duhet të vazhdonte në ato vende që sot i quajmë vende në zhvillim.

“Konsensusi i Washingtonit” - një konsensus i arritur ndërmjet FMN-së, BB-së dhe Thesarit të SHBA-ve mbi politikat e duhura për vendet në zhvillim - cyti hapjen ndaj tregut të lirë të vendeve në zhvillim, edhe pse nuk ka fakte që tregojnë se kjo cytje sjell rritje ekonomike. Dështimi i këtij Konsensusi, sipas Stiglitz, ndodhi për shkak të natyrës imperialiste të të tria fuqive, në një kohë kur ato duhet të kishin udhëhequr në mënyrë demokratike tranzicionin e vendeve nga komunizmi në ekonominë e tregut, duke stimuluar kështu liberalizimin e parakohshëm të kapitalit, i cili për pasojë kontribuoi në mungesën e qëndrueshmërisë globale. Në vend që të zbatohet modeli i liberalizimit të përshtatshëm-për-të gjithë i politikave të tregut të kapitalit, Stiglitz mendon se duhej të ishin marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë si faza e zhvillimit dhe të tjera aspekte të tranzicionit të çdo vendi. Në mënyrë që të gjendet modeli i duhur, është kusht i domosdoshëm bashkëpunimi me përfaqësues të çdo vendi dhe jo imponimi i politikave të hartuara nga ekspertë të cilët kanë përvojë me vendet e zhvilluara, por nuk njohin trajektoren e zhvillimit të vendit për të cilin ata punojnë. Kjo procedurë do rezultonte në një qasje individuale të çdo vendi ndaj globalizimit, një model ky suksesi i të cilit është vërtetuar si i suksesshëm në Azi.¹ Thënë ndryshe, që procesi i globalizimit-nga-sipër të jetë më i drejtë, duhet të ndryshojnë si strukturat institucionale ndërkombëtare, ashtu edhe mendësia. Vetëm kështu do të mund të arrihet ndikimi pozitiv i globalizimit.

Globalizmi-nga-poshtë

Ndryshe nga globalizmi-nga-sipër, globalizmi-nga-poshtë ka të bëjë me përpjekje të të drejtave të njeriut, të shfaqura në formën e lëvizjeve për të drejtat e njeriut. Regjimi i të drejtave të njeriut, ashtu si siguron Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), shtrihet përtej sistemit kombëtar, për shkak të tiparit natyror të tij të të qenit universal. Të drejtat dhe liritë themelore i përkasin mbarë njerëzimit, pavarësisht dallimeve fetare, gjinore, etnike, të moshës apo të tjera veçantive të identitetit. Për këtë arsye, lëvizjet e të drejtave të njeriut pretendojnë të kenë mision globalizues, duke u dhënë zë njerëzve jeta e të cilëve ndikohet nga procesi i globalizimit, qoftë nga poshtë apo nga sipër.² Pavarësisht se kanë shprehur aspirata të përbashkëta që synojnë zhvillimin, të dyja perspektivat e globalizimit kanë gjithsesi ndikime të ndryshme mbi të drejtat e njeriut. Fushatat e OJF-ve, si ato ndërkombëtare ashtu edhe kombëtare, kanë luajtur një rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimit dhe organizimin e këtyre lëvizjeve. Ato gjithashtu kanë treguar se janë veçanërisht efikase kundër aktorëve ndërkombëtarë.³

1 Stiglitz, Joseph. E. *Globalization and its Discontents*. W. W Norton and Company. Inc 2002.

2 United Nations Economic and Social Council. *The realization of economic, social and cultural rights: Globalization and its impact on the full enjoyment of human rights*. 15 qershor 2000.

3 Brysk, Alison. “Transnational Threats and Opportunities”. Në Brysk, Alison (red.). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.

Historia e popullit indigjen, ndryshe të njohur si njerëzit e parë që populluan toka të cilat më vonë u kolonizuan nga të tjerë, është një shembull i pastër i ndikimit diferencues të dy formave të globalizimit. Nga njëra anë, procesi i globalizimit-nga-sipër, qoftë qëllimisht apo jo, ka ngritur politika dhe procedura që shpejtojnë shkatërrimin e këtyre njerëzve, ambientin e tyre, ekonominë dhe kulturën, duke përafuar kështu zhdukjen e plotë të tyre. Nga ana tjetër, procesi i globalizimit-nga-poshtë lehtëson zhvillimin e strategjive të rezistencës së këtyre komuniteteve me anë të komunikimit, informimit, OJF-ve dhe udhëtimit.¹

Si rezultat i këtij procesi, më 1994 të drejtat e njerëzve indigjenë u morën seriozisht në konsideratë, duke u listuar në Projekt-Deklaratën e të Drejtave të Njerëzve Indigjenë. Ky projekt shënon një hap para për njohjen e të drejtave kolektive, i cili sipas fjalëve të Twiss përbën “një moment të ri historik në zhvillimin konceptual të të drejtave të njeriut, të shkaktuar prej globalizimit: mundësinë për të njohur të drejta të nevojshme kolektive përveç atyre individuale”.² Plot lëvizje të tjera kanë theksuar gjithashtu nevojën e kolektivitetit, kur kanë kërkuar të drejtat e grupeve të veçanta, si për shembull lëvizjet feministe, lëvizjet ambientaliste etj.

Për shkak të ndikimit të globalizimit-nga-poshtë, lëvizjet e çlirimit të grave kanë mundur të bashkërendisin përpjekjet e tyre në përpjekje për t'i çliruar gratë nga kushtet dhe praktikimi i shtypjes, i cili rezulton në diskriminim dhe trajtim të pabarabartë. Si rezultat i këtyre strategjive, janë shënuar arritje të mëdha, si miratimi i *Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundra Grave* (1981), e cila paraqet një bashkësi të drejtash dhe masash mbrojtëse të posaçme për gratë, organizimi i *Konferencës së Pekinit më 1995-ës mbi të Drejtat e Grave dhe Platforma e saj për Veprim*, vënia në udhë e dialogut ndërkulturor për interpretimin vendor të të drejtave të grave, për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive praktike dhe për përhapjen e tyre në mbarë botën, si dhe fuqizimi i shumë organizatave jofitimprurëse në dobi të grave.³

Në vazhden e ilustrimit të zhvillimit të perspektivës së globalizimit-nga-poshtë, një tjetër shembull është edhe ndikimi i Kombeve të Bashkuara dhe lëvizjes ambientaliste mbi të drejtën për shëndet. Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) reagoi ndaj lëvizjes ambientaliste në rritje, duke rishikuar përkufizimin e shëndetit. Si përfundim, nenit 25 të DUDNj-së, që njeh “të drejtën e gjithsekujt për të gëzuar standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit fizik dhe mendor”, iu shtua imponimi i disa detyrimeve të veçanta për të gjitha shtetet, për realizimin e zbatimit të kësaj të drejte.⁴

Si pasojë e lehtësimit në organizim që ofron globalizmi, ndikimi i tij ka qenë tejet pozitiv në përhapjen, fuqizimin dhe mbrojtjen e regjimit të të drejtave të njeriut. Komunikimi i shpejtë, aksesimi në informacion dhe popullarizimi i kulturës, ku televizioni dhe radioja luajnë një rol vendimtar në përhapjen e informacioneve të reja, e të tjera karakteristika të procesit të globalizimit kanë mundësuar me efikasitet bashkërenditjen

1 Twiss, Sumner B. “History, Human Rights, and Globalization” *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

2 Twiss, Sumner B. “History, Human Rights, and Globalization” *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004. 47.

3 Twiss, Sumner B. “History, Human Rights, and Globalization” *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

4 Twiss, Sumner B. “History, Human Rights, and Globalization” *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.49.

e lëvizjeve të të drejtave të njeriut. Ndërkohë që sistemi i qeverisjes globale ka dështuar, misioni global i lëvizjeve të të drejtave të njeriut është fuqizuar hap pas hapi.

Demokracia dhe të drejtat e njeriut në erën globale

Besohet gjerësisht se koncepti i demokracisë është i lidhur ngushtë me atë të të drejtave të njeriut, duke nënkuptuar se aty ku respektohen parimet demokratike aty respektohen edhe parimet e të drejtave të njeriut, ose e thënë ndryshe sipas Evans, “demokracia dhe të drejtat e njeriut janë simbiotike”.¹ Duke qenë se globalizmi, demokracia dhe të drejtat e njeriut janë fenomene të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, studimi i raportit demokraci-të drejtat e njeriut, ka rëndësi të veçantë për të kuptuar ndikimin e mbrapshtë të globalizmit. Të drejtat e njeriut dhe demokracia, si shtylla funksionale të regjimit të sotëm politik, ekonomik dhe social, të prirur sa vjen e më shumë ndaj hapjes globale, janë dhe “të ndikuarit” kryesorë nga kjo hapje. Ndryshimet që lindin në konceptimin e këtyre dy fenomeneve në kuadër të globalizmit pasqyrohen më tej në nivelin e mirëqenies së popujve. Marrja në shqyrtim e marrëdhënieve të sipër përmendura ndihmon rrjedhimisht në krijimin e mundësisë për të parashikuar rezultate pozitive të procesit të globalizimit.

Po të vëmë re Nenin 21 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, i cili thotë se “vullneti i popullit do të jetë baza e autoritetit të qeverisë”, ekziston një afërsi e qartë ndërmjet demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Duke qenë se qenia njerëzore është elementi thelbësor si i demokracisë ashtu edhe i të drejtave të njeriut, mund të pohohet se për t’u vënë në jetë, normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kanë nevojë për qeverisje demokratike.² Edhe Deklarata e Vjenës e përkufizon demokracinë si “të bazuar në vullnetin e lirë të popullit, në përcaktimin e sistemeve të tyre politike, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe të pjesëmarrjes së plotë në të gjitha aspektet e jetës”. Sipas Held, demokracia mund të përkufizohet edhe si “një mënyrë qeverisjeje në të cilën, në dallim nga monarkitë dhe aristokracitë, qeveris populli”. Kjo ndodh për shkak të natyrës kundërshtuese të demokracisë ndaj autoritetit, duke e zëvendësuar këtë të fundit me konkurrencën e klasave shoqërore. Nga ana tjetër, filozofia e të drejtave të njeriut nënkupton fuqizimin e individit. Në mënyrë që gjithsekush të gëzojë liritë dhe të drejtat individuale, është e pamundur që kjo të arrihet pa kufizuar të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Si rrjedhojë, për të mbrojtur të drejtat e njeriut është e rëndësishme të dihet se *si qeveris populli* dhe *jo kush duhet të qeverisë*.³

Zbërthimi i pyetjes *si qeveris populli* nxjerr në pah dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të demokracisë dhe raportin e secilit lloj me të drejtat e njeriut. Donnelly pohon se shteti i mirëqenies demokratike liberale është modeli që ekuilibron pjesëmarrjen demokratike me efikasitetin e tregut dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Shembuj

1 Evans, Tony. “If democracy, then human rights?” *Third World Quarterly* 22.4.2001.623.

2 Donnelly, Jack. “Human Rights, Democracy, and Development” *Human Rights Quarterly* 21.3.1999.

3 Ibid.

të këtij lloji demokracie janë vendet e Europës Perëndimore, Japonia dhe Amerika e Veriut. Sipas tij, të drejtat e njeriut rrezikohen së tepërmi në mungesë të efikasitetit të tregut dhe politikës së zgjedhjeve demokratike, por pavarësisht kësaj, as tregu dhe as demokracia të marra veçmas nuk sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë. Vetëm gërshetimi ndërmjet zhvillimit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut mund të lehtësojë në të njëjtën kohë si përforcimin ashtu edhe kufizimin reciprok.¹

Përpos gjithë ngjashmërive të paraqitura më sipër, debatet e fundme mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut kanë nxjerrë në sipërfaqe kundërshtinë teorike që mbart raporti i marrë si i qenësishëm ndërmjet universalitetit të të drejtave të njeriut dhe profilit kombëtar të demokracisë. Për shumë studiues demokracia liberale dhe të drejtat e njeriut konsiderohen si dy anët e së njëjtës monedhë, kurse për të tjerë këto fenomene nuk përfshihen detyrimisht në një raport simbiotik. Për shembull, Beetham ka studiuar rëndësinë e kombi-shtet. Sipas tij, kombi-shtet është instrument i domosdoshëm për të siguruar sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Kombi-shtet është po ashtu dhe një mjet i plotfuqishëm për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Edhe pse perspektiva universale e këtyre të fundit është e varur nga niveli i vendosjes së standardeve për monitorimin e regjimit të të drejtave të njeriut, zbatimi dhe mbrojtja e tyre janë gjithashtu tejet të varura nga qeveritë e shteteve sovrane.²

Në shumë studime të tjera rëndësi e veçantë i është kushtuar aspektit ekonomik, ku koncepti i demokracisë besohet të përdoret si legjitimues i mënyrave të sjelljes që mbështesin interesa të caktuara politike të lidhura me globalizimin.³ Ky debat ka përfshirë pashmangshmërisht edhe procesin e globalizimit, si një faktor kryesor në krijimin e rrethanave të reja ku formëzohen frytet e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut. Por, për të analizuar demokracinë nga perspektiva globaliste, duhet, sipas Held, një përkufizim i ri i procesit të globalizimit. Ai nuk duhet konsideruar as si një zëvendësues i sistemit të shtetit, as si një nevojë e re e shoqërisë globale. “Në të vërtetë, globalizmi është një fenomen hapësinor, i cili mund të konsiderohet si një vazhdimësi e *vendores* në njërin anë dhe *globales* në anën tjetër”.⁴ E mesmja e përpjesshme e kësaj vazhdimësie, sipas Held, përkon me modelin prej tij të quajtur *demokraci kozmopolite*.

Demokracia kozmopolite

Sic u pasqyrua dhe më sipër, procesi i globalizimit ka shkaktuar intensifikimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve ndërmjet shteteve dhe shoqërive. Në këtë marrëdhënie të re faktorët ndërkombëtarë ndërthuren me ata kombëtarë,

1 Ibid.

2 Beetham, David. “Human Rights as a Model for Cosmopolitan Democracy”. Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

3 Evans, Tony. “If democracy, then human rights?” *Third World Quarterly* 22.4.2001.

4 Held, David. “Democracy and Globalization”. Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998. 13.

ose ndryshe vendorë. Por pavarësisht kësaj risie, globalizmi në vetvete nuk është një fenomen i vonë. E vërteta është se ai ka ekzistuar gjithmonë. Në ditët e sotme ai parashtron një sfidë të re, rëndësinë e rolit të kombit-shtet si njësi gjeopolitike në rendin e ri të integruar, ku proceset e reja sociale dhe ekonomike kryhen tanimë në nivel global.¹ Globalizmi ka vënë në pikëpyetje sovranitetin e kombit-shtet, duke zhvendosur fuqinë vendimmarrëse nga qeveria tek aktorët ndërkombëtarë.

Held ofron një model racional, sipas të cilit natyra e demokracisë dhe për pasojë ajo e kombit-shtet duhet të rishikohet në mënyrë të tillë që të kuptohen më qartë transformimet globale dhe ndikimi i tyre mbi regjimin demokratik. Ndryshimet e vëna re si pasojë e globalizmit tregojnë se natyra e demokracisë ka ndryshuar dhe sot ne jetojmë në një moment kyç tranzicioni drejt një bote ndërkombëtare, globale. Kultura politike ka marrë trajta të reja, si pasojë e shfaqjes së institucioneve globale dhe rajonale, të cilat përforcojnë bashkëpunimin ndërmjet shteteve në zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta, shembull i së cilës janë Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian. Shembuj të lëvizjeve sociale mund, gjithashtu, të konsiderohen si institucionet e reja të shoqërisë civile në tranzicion.

Ky rishikim i rendit të ri global në të gjitha aspektet e tij nxjerr në pah vartësinë dypalëshe të kombeve-shtete dhe aktorëve ndërkombëtarë, vartësi e cila sipas Held duhet të konsiderohet si forma e re e demokracisë, e quajtur demokracia kozmopolite.² Demokracia kozmopolite ofron një zgjidhje për paqartësinë e rendit të sotëm global, demokratizimin e sistemit ndërkombëtar paralelisht me demokratizimin vendor të shteteve. Edhe pse ka hedhur shumë hapa para, demokracia nuk ka arritur ende suksesin e plotë. Për këtë, ajo duhet t'u përshtatet marrëdhënieve ndërkombëtare. Sipas Archibugit, sot momenti është më i përshtatshëm se kurrë.³ Kjo formë demokracie fuqizon shtetin në zhvillimin e demokracisë në nivel vendor dhe global, ashtu si dhe institucionet demokratike në nivelin e kombit-shtet, pa përjashtuar rëndësinë e faktorëve ndërkombëtarë. Kjo arrihet me anë të kufizimit të sovranitetit të shtetit, kusht i domosdoshëm për arritjen e legjitimitetit të institucioneve globale që bashkëjetojnë me sistemin shtetëror. "Ky koncept i demokracisë bazohet në njohjen e vazhdimësisë së rëndësisë së kombit-shtet, ndërkohë që propozon kufizimin e sovranitetin kombëtar."⁴

Ndikimi i pashmangshëm që ka sot në botë çdo vendim politik i njërit shtet mbi aspektet shoqërore, ekonomike dhe politike të shteteve të tjera hedh poshtë iluzionin e vendimarrjes autonome të komuniteteve për çështje që lidhen me fatin e tyre.

1 Held, David. "Democracy and Globalization". Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

2 Held, David. "Democracy and Globalization". Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

3 Archibugi, Daniele. *Principles of Democracy*.
<http://209.85.129.132/search?q=cache:XumFBqDb7c8J:www.danielearchibugi.org/downloads/papers/Principles.PDF+Archibugi,+Daniele.+Principles+of+Democracy.&hl=en&ct=clnk&cd=1&client=firefox-a>

4 Held, David. "Democracy and Globalization". Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

Në këtë situatë, ajo çka mund ta shpëtonte demokracinë është zgjerimi i saj në rang ndërkombëtar. Kjo do të siguronte një sistem ndërkombëtar paqësor dhe gjithashtu do të krijonte hapësira për bashkëjetesë të qytetëruar të komuniteteve, ku gjithsekush do të mund të adresonte në mënyrë demokratike problemet që shqetësojnë të tjerët. Kështu, demokracia kozmopolite siguron që demokracia të mos jetë vetëm një sistem politik vendor, por edhe global. Kjo arrihet duke u përkujdesur për demokratizimin e mëtejshëm të vetë shtetit, të botës mbarë dhe gjithashtu të marrëdhënieve ndërkombëtare.¹

Përfundime

Kjo ese bazohet në supozimin se globalizimi është një proces pa kthim pas! Pasi ai të pranohet si i përhershëm, hapi i dytë kryesor është të merren në shqyrtim faktorët që fshihen pas ndikimit kontradiktor të globalizmit, krahasuar me rezultatet e premtuara. Diskutimi përqendrohet në konceptet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, si fusha kryesore me të cilat procesi i globalizimit hyn në marrëdhënie reciproke përforcuese dhe kufizuese në të njëjtën kohë. Në këto rrethana, kundërshtitë që karakterizojnë vartësinë reciproke kanë ndikim të qenësishëm mbi shoqërinë. Qëllimi i këtij hulumtimi është të gjejë zgjidhje të mundshme për përmirësimin e ndikimit të globalizmit mbi jetën e qytetarëve.

Pavarësisht faktit se globalizmi po përhapet kudo në botë, ndikimi i tij ka qenë i ndryshëm në shoqëri të ndryshme. Kjo ese argumenton sesi ndikimi i ndryshueshëm i globalizmit varet më së shumti nga regjimi politik ku ndodh globalizmi. Këtu paraqiten dëshmi të cilat tregojnë se globalizmi ka sfiduar natyrën e demokracisë, duke kërkuar zhdukjen e kufijve shtetërorë brenda të cilëve zhvillohet demokracia. E vërteta është se globalizmi dhe demokracia janë të ndërlidhur në mënyrë të tillë që edhe pse transformimet globale ndodhin në terren demokratik, ato i kapërcejnë kufijtë brenda të cilëve shtrihet përgjegjësia e regjimit demokratik të çdo shteti. Këtu dhe shfaqet kundërshtia mes dy fenomeneve, e cila vë në pikëpyetje rolin e aparatit qeveritar demokratik si në shtrirje gjeografike ashtu dhe në pushtet vendimmarrës e kontrollues.

Edhe regjimi i të drejtave të njeriut është i ndërlidhur me kundërshtitë të ngjashme me globalizmin. Ai ndan me këtë të fundit natyrën mbarëbotërore, por njëkohësisht përballet me domosdoshmërinë e rolit të shtetit si mjet fuqiptotë në garantimin e të drejtave të njeriut në shoqëritë demokratike. Në të vërtetë regjimi i të drejtave të njeriut fuqizohet nga bashkëpunimi e jo nga rënia ndesh e përgjegjësisë së shtetit - si makineria kryesore që promovon, mbron dhe respekton, pa përjashtuar këtu edhe shkëljen e të drejtave - me përgjegjësinë e aktorëve ndërkombëtarë - të cilët

1 Archibugi, Daniele. Principles of Democracy.
<http://209.85.129.132/search?q=cache:XumFBqDb7c8J:www.danielearchibugi.org/downloads/papers/Principles.PDF+Archibugi,+Daniele.+Principles+of+Democracy.&hl=en&ct=clnk&cd=1&client=firefox-a>

paracaktojnë standardet dhe kanë rol po aq të rëndësishëm në monitorimin dhe ndëshkimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Dallimet mes rolit të shtetit dhe atij të faktorëve ndërkombëtarë mbi të drejtat e njeriut në globalizëm shihen qartazi në trajtimin e globalizmit në dy perspektiva të ndryshme: globalizmi-nga-lart dhe globalizmi-nga-poshtë. Integrimi ndërkombëtar ka ndikuar pozitivisht mbi të drejtat e njeriut, duke lehtësuar lindjen e lëvizjeve në mbrojtje të tyre, jo vetëm në aspektin e ndërgjegjësimit por edhe në marrjen e masave mbrojtëse konkrete, siç janë hartimi i konventave të ndryshme, platformave të veprimit etj. Nga ana tjetër, mungesa e një sistemi të konsoliduar qeverisjeje globale pa një qeveri globale ka ndikuar negativisht zhvillimin, veçanërisht atë të vendeve që po globalizohen e zhvillohen rishtazi. Është pikërisht aspekti ekonomik i globalizmit, i menaxhuar nga institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore, FMN etj. që shfaq më hapur ndikimin negativ të procesit të globalizmit.

Këta tregues mbështesin idenë e vartësisë reciproke të kombit-shtet dhe aktorëve ndërkombëtarë në të gjitha aspektet e rendit global. Në vend që të hidhet poshtë qoftë koncepti i kombit-shtet apo i rendit global, ose i vetë globalizmit, i cili siç u tha dhe më sipër është këtu për të qëndruar, demokracia kozmopolite mund të ofrojë një sistem të ri politik ku mund të harmonizohen të tria këto fenomene. Sistemi i demokracisë kozmopolite fuqizon institucionet demokratike si në nivelin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Kjo arrihet me anë të kufizimit e jo të shpërfilljes tërësore të sovranitetit të shtetit në të mirë të legjitimitetit demokratik të institucioneve globale. Kështu shteti, si aktori përgjegjës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nuk humb, duke ruajtur natyrën universale të të drejtave të njeriut me anë të ofrimit të mundësive për zhvillimin e globalizmit në vend.

Edhe pse modeli i demokracisë kozmopolite paraqet një zgjidhje të arsyeshme për rritjen e ndikimit pozitiv të globalizmit mbi individët dhe shoqëritë, ai nuk mund të jetë e vetmja zgjidhje. Ndikimi i kundërshtive me të cilat përballen të tria këto fenomene në bashkëjetesë me njëra-tjetrën është i një rëndësie të veçantë ndaj si i tillë i duhet kushtuar vëmendje e mëtejshme me anë të studimeve e kombinimeve të tjera në dobi të shoqërisë njerëzore. Përpunimi i mëtejshëm i modeleve demokratike do të përshpejtonte gjetjen e sistemit më të përshtatshëm politik, në të cilin procesi i globalizimit do të mund të ofronte barazinë e shumëkërkuar për çdo qytetar.

Bibliografia

Burime parësore

Archibugi, Daniele. *Principles of Democracy*.

<http://209.85.129.132/search?q=cache:XumFBqDb7c8J:www.danielearchibugi.org/downloads/papers/Principles.PDF+Archibugi,+Daniele.+Principles+of+Democracy.&hl=en&ct=clnk&ccd=1&client=firefox-a>
(Parë për herë të fundit më 30.11.2008).

- Brysk, Alison. "Transnational Threats and Opportunities". Në Brysk, Alison (red). *Globalization and Human Rights*. Berkley: University of California Press, 2002.
- Donnelly, Jack. "Human Rights, Democracy, and Development" *Human Rights Quarterly* 21.3.1999.
- Evans, Tony. "If democracy, then human rights?" *Third World Quarterly* 22.4.2001.
- Held, David. "Democracy and Globalization". Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.
- Howard-Hassmann, Rhoda E. "The Second Great Transformation: Human Rights Leapfrogging in the Era of Globalization" *Human Rights Quarterly* 27.1.2005.
- Stiglitz, Joseph. E. *Globalization and its Discontents*. W. W Norton and Company. Inc 2002.
- United Nations Economic and Social Council. *The realization of economic, social and cultural rights: Globalization and its impact on the full enjoyment of human rights*. 15 qershor 2000.
- Twiss, Sumner B. "History, Human Rights, and Globalization" *Journal of Religious Ethics* 32.1.2004.

Burime dytësore

- Beetham, David. "Human Rights as a Model for Cosmopolitan Democracy". Në Archibugi Daniele et al. (red.). *Re-imagining Political Community: Studies in Cosmopolitan Democracy*. Cambridge: Polity Press, 1998.

Marrëdhënie shqiptaro-gjermane 1987-2007¹

Prof. Dr. Paskal Milo

ABSRAKT. Historia e marrëdhënieve shqiptaro-gjermane është shumë më e hershme se 20 vjet të historisë sonë bashkëkohore. Ky punim është një përpyetje e parë për të rrokur dinamikën e këtyre marrëdhënieve nga këndvështrimi historik. Por jam i ndërgjegjshëm, se ai do të ketë mangësi për shkak se historia e këtyre viteve akoma nuk është maturuar dhe, se historiani ndihet gjithnjë më i sigurt e më i mirë informuar në zanatin e vet, si një shijues i mirë i verërave të vjetra, kur ngjarjet dhe dokumentet gjykohen nga një distancë e mjaftueshme kohore. Privilegji im është t'ju sjell këtu burime dokumentare të pabotuara shqiptare të nomenklaturës së lartë komuniste, por edhe të institucioneve politike-bërëse shqiptare të 15 viteve të fundit. Por ky avantazh, megjithë rëndësinë që ka, është i kufizuar për të pretenduar se studimi i marrëdhënieve shqiptaro-gjermane në 20 vitet e fundit është i plotë. Atij i mungon mbështetja burimore gjermane për këtë kohë që është e kuptueshme dhe jashtë mundësive tona. Unë shpresoj që ky boshllëk do të plotësohet me kontributet e studiuesve gjermanë të çështjeve shqiptare.

Problemi i reparacioneve

Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane pas Luftës së Dytë Botërore në një masë të konsiderueshme mbetën peng i Luftës së Ftohtë, ku “çështja gjermane” ishte një shkak i saj, por që me kalimin e viteve nuk u zgjidh si rrjedhojë e saj. Shqipëria e rreshtuar në bllokun sovjetik deri në 1960 zbatoi në mënyrën më dogmatike politikën e jashtme të kampit komunist të diktuar nga Moska. Ajo njohu e vendosi marrëdhënie diplomatike me Gjermaninë Lindore të kontrolluar nga sovjetikët dhe refuzoi të bënte të njëjtin veprim edhe me Republikën Federale të Gjermanisë. Kërkesave konstante të bllokut lindor për nënshkrimin e Traktatit të Paqes me të dy Gjermanitë dhe retorikës politike për konsum të brëndshëm populist që bëhej kundër qeverive të Bonit, regjimi komunist i Tiranës i shtoi edhe pretendimet

1 Referat i mbajtur në Berlin, 16 Tetor 2007 në konferencën e organizuar në Akademinë Europiane.

e saj jo pa arsye për pagimin e dëmshpërblimeve për dëmet që Shqipëria kishte pësuar gjatë pushtimit nazist në Luftën e Dytë Botërore. Këto pretendime ajo i paraqiti rregullisht deri në sesionin e fundit të Agjencisë Ndërraleate të Reparacioneve (IARA) në nëntor 1959, ku përfaqësuesi shqiptar deklaroi në emër të Tiranës zyrtare se “nuk ishte dakort me trajtimin që iu bë pretendimeve shqiptare dhe se qeveria shqiptare i rezervonte vetes të drejtën që t’i kthehej më vonë kësaj çështjeje.”¹

Në vitin 1961 Shqipëria u shkëput nga blloku sovjetik, largoi bazat ushtarake sovjetike nga territori i saj, de facto u përjashtua nga Traktati i Varshavës dhe marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik u ndërpre. Ishte një moment oportun që Enver Hoxha dhe gjithë udhëheqja komuniste shqiptare të reflektonte e të riorientohej drejt. Sinjalet nga Perëndimi nuk munguan, ndonëse ishin të vakëta. Regjimi shqiptar e mori kthesën, por jo në drejtimin e duhur, drejt botës demokratike perëndimore. Ai u orientua më në Lindje, bëri aleancë me Kinën e Mao Ce Dunit. Enver Hoxha nuk mund të bënte ndryshe, ai kishte një formim tipik stalinist. Ndarja e tij me Hrushovin nuk u bë për motive kombëtare as edhe ideologjike, ndonëse ato janë përdorur si alibi. Ajo u bë për t’u mbijetuar spastrimeve të udhëheqjeve staliniste që Hrushovi kishte ndërmarrë në Evropën Lindore që në vitin 1956.

Edhe pasi u shkëput nga orbita e influencës sovjetike, udhëheqja shqiptare nuk ndryshoi qëndrimin e saj ndaj “çështjes gjermane”. Madje edhe në gjysmën e dytë të viteve 60-të e në fillim të viteve 70-të kur “Ostpolitika” e Vili Brandit solli afrimin dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike të R.F.GJ me disa vende të Evropës Lindore, ora e Tiranës kishte mbetur prapa. Me një stil bolshevik, qeveria shqiptare nëpërmjet ministrit të saj të jashtëm iu rikthye siç edhe kishte premtuar çështjes së dëmshpërblimeve, këtë herë nga tribuna e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në sesionin e saj të 28-të, në shtator 1973.² Dy vjet më vonë, në qershor 1975-ës, Qeveria Shqiptare i dorëzoi Qeverisë së R.F.Gjermane zyrtarisht e direkt përmes kanaleve diplomatike një memorandum për dëmshpërblimet që ajo duhej t’i paguante Shqipërisë. Shuma e kërkuar ishte tepër e madhe, *mbi 2 miliard dollarë për dëmet e shkaktuara nga pushtimi nazist dhe mbi 2.5 miliard nga interesat që rridhnin nga mosshlyerja e dëmshpërblimeve*, llogari këto të bëra me kursin e dollarit të vitit 1938.³ Disa vjet më vonë, përballë argumenteve e fakteve të palës gjermane, udhëheqja shqiptare i uli ndjeshëm këto shifra të pretenduara.

Qeveria e R.F.GJ e vonoi përgjigjen, por edhe kur e dha në tetor të vitit 1975 solli tre argumente kundërshtuese: që kërkesa për dëmshpërblime i kërkohej Rajhut gjerman dhe jo R.F. të Gjermanisë; se në bazë të marrëveshjes mbi borxhet e jashtëme gjermane të përfunduar në Londër në shkurt 1953 shqyrtimi për kërkesa ishte shtyrë deri në

1 Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ). Viti 1959. Dosja 537 “Dokumente mbi Agjencinë Ndërraleate të Dëmshpërblimeve për Gjermaninë”. Udhëzime për qëndrimin e delegacionit shqiptar.

2 AMPJ, Viti 1973. Dosja nr. 548. Fjalimi i Nesti Nases në sesionin e 28-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

3 Po aty. Viti 1975. Dosja 667. Memorandum “Mbi reparacionet që Republika Federale e Gjermanisë duhet të shlyejë në favor të Republikës Popullore të Shqipërisë për dëmet e shkaktuara pushtimi gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore”. 28 qershor 1975.

përfundimin e një Traktati Paqeje me Gjermaninë, ndaj edhe kërkesa shqiptare nuk mund të merrej në shqyrtim; meqënëse Shqipëria nuk kishte aderuar në Marrëveshjen e Londrës ajo nuk mund të përfitonte një trajtim preferencial të ndryshëm nga ai i vëndeve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.¹ Vonesa e përgjigjes gjermane dhe përmbajtja e saj shkaktuan nervozizëm në Tiranë. Enver Hoxha porositi që të kthehej një përgjigje edhe më e ashpër. Nota gjermane në përgjigjen që ktheu Qeveria shqiptare në janar 1976 cilësohej krejtësisht e padrejtë e pa baza, mospërfillëse, se arsyet që nxirrte qeveria gjermane nuk kishin asnjë vlerë dhe ajo ishte e papranueshme për të.² Komunikimet e mëvonshme midis dy qeverive nuk lëvizën nga pozicionet e marra. Çështjen e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike regjimi shqiptar e kishte lidhur ngushtë me pagimin e dëmshpërblimeve. Madje Enver Hoxha hodhi edhe idenë për të parë nëse ishte e mundur që kjo çështje të dërgohej në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës.³

Prishja e marrëdhënieve me Kinën pas vdekjes së Mao Ce Dunit dhe ndërprerja e ndihmave kineze për Shqipërinë e çoi ekonominë shqiptare në vështirësi të mëdha dhe e zhyti vendin në një izolim edhe më të thellë. Në këto rrethana udhëheqja komuniste u përpoq që pa tradhëtuar dogmën e vet, të gjente në rrugë e mënyra të ndryshme burime financiare që të mbante në këmbë ekonominë autarkike që kishte ngritur. Pikërisht, duke filluar nga viti 1979 Enver Hoxha porositi që të riaktivizohej çështja e dëmshpërblimeve me R.F. të Gjermanisë, të bisedohet me palën gjermane duke ulur edhe kërkesat dhe mënyrat e pagimit të dëmshpërblimeve. Mesazheve të ardhura nga Tirana, në vitet 1979-1980, Boni u ishte përgjigjur se ishte i gatshëm të hynte në bisedime për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, por pa vënë kushte paraprake. Në gusht dhe dhjetor 1980, Qeveria Federale Gjermane i çon dy mesazhe të rëndësishme Tiranës: i pari se “vendosja e marrëdhënieve diplomatike do të stimulojë zgjidhjen e problemeve në planin ekonomik e financiar” dhe i dyti që “për hir të progresit dhe të lëvizjes nga vendi të bisedimeve, të mos përdoret termi dëmshpërblime, por “çështje që rrjedhin nga Lufta e Dytë Botërore”.⁴

Mesazhet gjermane u diskutuan gjërësisht në kupolën e udhëheqjes komuniste shqiptare për mjaft kohë. Përgjigjja ndaj tyre, që shënonte edhe një kthesë në qëndrimet shqiptare, erdhi në Kongresin e 8-të të Partisë së Punës në Nëntor 1981, kur Enver Hoxha deklaroi se midis Shqipërisë dhe R.F. të Gjermanisë “nuk ekzistojnë pengesa të pakapërcyeshme për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Ne besojmë se me një mirëkuptim nga ana e të dy palëve për disa çështje të mbetura pezull që nga Lufta e Dytë Botërore, kjo gjendje mund të rregullohet”.⁵ Me këtë deklaratë kreu i regjimit

1 Po aty. Viti 1975. Dosja 667/1. Notë e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë për çështjen e reparacioneve. 27 tetor 1975. Viti 1975. Dosja 667/1.

2 Po aty. Viti 1976. Dosja 793/1. Korrespondencë mbi problemin e reparacioneve dhe mbi marrëdhëniet me RFGJ. Notë e Ambasadës së Republikës Popullore të Shqipërisë dërguar Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Beograd. 07.01.1976. Dosja 667/1.

3 Enver Hoxha. “Të aktivizojmë kërkesën për dëmshpërblimet nga Gjermania Federale”. Ditar për çështje ndërkombëtare (1978), Vëllimi 11. Tiranë 1984. Faqe 305-306.

4 Shpëtim Çausi. Diplomacia shqiptare në normalizimin e marrëdhënieve me Gjermaninë. OMBRA GVG. Tiranë 2002. fq. 158-159

5 Enver Hoxha. Raport në Kongresin e 8-të PPSH. Tiranë 1981, fq. 208

shqiptar respektoi kërkesën e parë gjermane. Dy muaj më vonë, në Janar 1982, në një mbledhje të Byrosë Politike, Enver Hoxha hodhi hapin tjetër për të mos vënë parakushte për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve që ishte edhe kërkesa e dytë gjermane. Ai thotë se Shqipëria “me Qeverinë e sotme të Bonit dëshiron të lidhë marrëdhënie diplomatike...Çështja e reparacioneve vjen në radhë të dytë. Ky problem duhet të shikohet, pasi të lidhen marrëdhëniet diplomatike”.¹

Deklaratat e Enver Hoxhës në Kongresin e Partisë së tij u vlerësuan nga Qeveria Federale “si një hap përpara drejt zgjidhjes së problemit për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve” dhe se qëndrimi i Shqipërisë ishte i qartë.² Por pala gjermane kërkoi nga ajo shqiptare një deklaratë zyrtare me shkrim ku ajo në vijim të qëndrimeve të Enver Hoxhës në Kongres, të angazhohej se nuk e kushtëzonte vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me çështje të tjera. Kjo kërkesë u vendos si kusht për vazhdimin e mëtejshëm të bisedimeve.³ Në fillim në Tiranë kërkesa gjermane shkaktoi irritim, por përballë këmbënguljes së Bonit për të patur një deklaratë të tillë, me udhëzime të posaçme të E.Hoxhës, MPJ shqiptare e hartoi tekstin dhe ai iu dorëzua përmes kanaleve diplomatike Qeverisë së R.F.GJ. Deklarata dilte jashtë kornizës së kërkuar, ishte e gjatë dhe më tepër ishte hartuar si një traktat për çështjen gjermane. Jo pa qëllim pasi u jepej satisfaksion kërkesave gjermane për të ndarë çështjen e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike nga ajo e dëmshpërblimeve, me një gjuhë të zgjedhur u kërkohej autoriteteve federale në lidhje me dëmshpërblimet “që ju të paguani dhe të gjeni mënyrat dhe format e përshtatshme të pagimit, të cilat t’u përgjigjen si ligjeve tona ashtu edhe ligjeve tuaja”.⁴ Përgjigja gjermane që erdhi në fund të marsit 1982 ishte e prerë, madje shënonte një hap prapa në krahasim me qëndrimet e mëparshme. “Bisedimet -theksohej aty- do të kenë kuptim, atëhere kur pala shqiptare do të heqë dorë duke i lidhur ato me kërkesën për reparacione. Republika Federale e Gjermanisë nuk do të bisedojë për kërkesa të tilla, as para dhe as pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike”.⁵ Qeveria shqiptare e cilësoi të papranueshme notën gjermane dhe nuk i ktheu përgjigje. Ashpërsimi i toneve dhe zgjedhjet e reja parlamentare në Gjermani që sollën një koalicion të ri qeverisës i minimizuan kontaktet zyrtare për këtë çështje deri në verën e vitit 1983.

Qeveria e re gjermane e Kancelarit H. Kohl në qershor 1983 i përcolli Qeverisë shqiptare një Promemorie në të cilën ajo i tërhiqte vëmendjen Tiranës se nuk i është përgjigjur notës gjermane të marsit 1982 dhe informonte se ajo ndante të njëjtat qëndrime me qeverinë e mëparshme në lidhje me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe çështjen

1 Arkiv Qëndror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë(AQSH-RSH).Diskutimi i Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike, 16.01.1982.Fondi Nr. 14/AP.Lista Nr.1.Dosja Nr.5.Viti 1982

2 AMPJ.Radiogram i Ambasadës së RP:të Shqipërisë në Vjenë dërguar MPJ.13.01.1982.Dosja 637. Viti 1982

3 Po aty

4 AQSH-RSH. Diskutimi i E.Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike.16.01.1982.Fondi nr. 14/AP.Lista nr.1.Dosja nr.5.Viti 1982;AMPJ.Deklaratë drejtuar Ambasadorit të Republikës Federale të Gjermanisë në Vjenë 26.02.1982. Dosja 1214/1.Viti 1982.

5 AMPJ.Deklaratë e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.25.03.1982.Dosja 1214/1.Viti 1982

e dëmshpërblimeve.¹Por në mënyrë të mjegullt, në këtë kohë, pala gjermane hodhi dy ide të reja, mundësinë e trajtimit të kërkesave individuale për viktimat e nazizmit dhe të bashkëpunimit ekonomik me terma lehtësuese. Në fund të vitit 1983, pasi janë ezauruar dhe disa takime në nivelin e ambasadorëve të të dy vendeve në Vjenë, Qeveria Gjermane propozoi zhvillimin e bisedimeve direkte në Bon në prill 1984, midis përfaqësuesve të të dy Ministrive të Punëve të Jashtme.²Udhëheqja shqiptare e pranoi propozimin dhe në nivelet më të larta të saj u përpunuan qëndrimet që do të mbaheshin në bisedimet zyrtare të Bonit. Në udhëzimet që iu dhanë delegacionit shqiptar, Enver Hoxha personalisht e porosiste me shkrim drejtuesin e tij (Sofokli Lazri): “U thuaj gjermanëve për detyrimin që kanë për të na paguar si reparacion për dëmshpërblimin nga lufta dhe nëqoftëse ata të japin fjalën që do të na paguajnë diçka, vetëm kaq mjafton; po të dhanë këtë përgjigje u thuaj se ne jemi gati menjëherë të vendosim marrëdhënie diplomatike”.³

Bisedimet e Bonit shënuan një hap përpara në njohjen e qartësimin e qëndrimeve të të dy palëve dhe në paraqitjen e alternativave për të kapërcyer bllokimin e negociatave për shkak të çështjes së dëmshpërblimeve. Pala gjermane nuk refuzoi apriori si më parë, por i njohu palës shqiptare të drejtën për të ngritur këtë çështje, ashtu sikurse dhe ajo ruante të drejtën të jepte shpjegime nga këndvështrimi i saj. Elementi i ri në këto bisedime ishte se përfaqësuesit e MPJ gjermane deklaruan se vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve do të krijonte kushte për përfitime ekonomike për Shqipërinë dhe përcaktuan drejtimet kryesore se si mund të realizoheshin këto favore.

Në harkun kohor të dy viteve që pasuan pas takimit të parë në Bon, u zhvilluan edhe tre takime të tjera në Vjenë, në nëntor 1984, në tetor 1985 dhe në mars 1986. Në çdo njërin prej këtyre takimeve hidheshin variante, që pa cënuar pozitën juridike të palëve, të gjendeshin elementët e kompromisit që do të çonin përfundimisht në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Gradualisht u krijua një klimë më e ngrohtë e besimit reciprok ku një kontribut të çmuar dha kryeministri i Bavarisë Franc Jozef Shtraus (Franz Josef Strauß). Ndërkohë udhëheqësi i ri i Shqipërisë, pas vdekjes së Hoxhës në prill 1985, Ramiz Alia, në rrethanat e rrëshqitjes së vendit në një krizë gjithnjë e më të thellë ekonomike, ishte i interesuar për t’i gjetur oksigjen ekonomisë së asfiksuar shqiptare.

Në mesin e vitit 1986 u duk se të dy palët erdhën afër kompromisit përfundimtar. Vizita e dytë e F.J.Shtrausit në maj 1986 që nuk mund të quhej se ishte private si ajo e vitit 1984, shënoi një hap të rëndësishëm përpara. Tirana zyrtare kishte mbetur e pakënaqur nga qëndrimi i delegacionit gjerman në bisedimet e fundit në muajin mars në Vjenë, ku kishte marrë një JO kategorike për çështjen e dëmshpërblimeve dhe vetëm një premtim për katër-pesë milion marka ndihmë si një gjest dashamirës nga ana e RF të Gjermanisë.⁴ Pritshmëria e udhëheqjes shqiptare për një pagesë gjermane me çfarëdo forme ishte e madhe, ndaj ajo edhe u deziluzionua kur dëgjoi një shifër

1 Po aty. Radiograme të Ambasadës të RPS të Shqipërisë në Vjenë dërguar MPJ.21.06.1983

2 Po aty.Dosja 1155/1.Viti 1984

3 AQSJ-RSH.Diskutimi i Ramiz Alisë në mbledhjen e Byrosë Politike.17.06.1986. Fondi 14/AP.Lista nr.1.Dosja nr.65.

4 Po aty

të tillë kaq të ulët. F.J.Shtrausi erdhi për të sqaruar udhëheqjen shqiptare dhe për të shërbyer si një urë komunikimi midis Tiranës dhe Bonit. Kërkesës që i bëri A. Çarçani për “satisfaksion moral”, që nënkuptonte gjetjen e rrugëve e të formave të tjera që R.F.GJ të shlyente dëmet që pësoi Shqipëria gjatë pushtimit nazist, Kryeministri Bavarez iu përgjigj se kjo është rrugë e gabuar dhe është e pamundur që Republika Federale e Gjermanisë të hyjë në bisedime për këtë çështje.¹ Si rrugë të mundshme për zgjidhjen e kërkesës shqiptare, Shtrausi sugjeroi nënshkrimin e dy marrëveshjeve midis dy vendeve: **e para** për bashkëpunimin ekonomik e tekniko-shkencor në bazë të së cilës i tha ai Çarçanit “ju do të merrni një ndihmë shumë më të madhe materiale se sa shuma qesharake prej 4-5 milion marka”; **e dyta**, një marrëveshje 10 vjeçare, e ndarë nga marrëveshja për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike e cila mund të nënshkruhej menjëherë ose pas shkëmbimit të ambasadorëve midis të dy vendeve. “Vendosja e marrëdhënieve diplomatike-deklaroi më tej ai-janë shinat e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Shina tjetër është Ministria Federale për Bashkëpunimin Ekonomik (ku ministri ishte nga partia e tij). “Në qoftë se do të nisjet treni në shinat e para, unë do të shtyp gishtin që të fillojë të nisjet treni tjetër, ndoshta në të njëjtën kohë, edhe në shinat e dyta”.² Për t’i hequr çdo dyshim palës shqiptare Shtrausi u tregua shumë i drejtpërdrejtë kur i tha kryeministrit shqiptar A.Çarçani se: “unë jam dhe do të jem i ndershëm ndaj jush dhe nuk kam asnjëherë ndër mend që të them ndonjë gjë për ta dredhur ose për të gënjyer.....”.³

Efektet pozitive të vizitës së Shtrausit në Tiranë u ndjenë menjëherë. Një javë më vonë pala gjermane i propozoi asaj shqiptare rifillimin e bisedimeve. Udhëheqja shqiptare pas bisedimeve me Shtrausin u ndje më e qetë dhe më e predispozuar për t’i parë më me realizëm pretendimet e saj. Ofertës së re gjermane nuk iu dha menjëherë përgjigje. Në qershor 1986 u mbledh Byroja Politike për të diskutuar posaçërisht këtë çështje. Fryma që mbizotëroi mbledhjen ishte ndryshe nga herët e tjera. Vendimi që u mor autorizonte MPJ që të vepronte për çështjen e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Republikën Federale të Gjermanisë.⁴ Në korrik 1986 pala shqiptare i ktheu përgjigje propozimit gjerman të muajit maj për rifillimin e bisedimeve, por ato u zgjatën mbi një vit për të gjetur formulimet e duhura të kompromisit për dy-tri çështjet e mbetura pezull si ajo për statusin e Berlinit Perëndimor, të dëmeve shkaktuar Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore dhe të bisedimeve të ardhshme për marrëdhëniet ekonomike e tekniko-shkencore. Në shtator 1987, në Tiranë, midis përfaqësuesve të të dy qeverive u nënshkrua Protokollin për vendosjen e Marrëdhënieve Diplommatike, i cili pas miratimit të tij nga qeveria shqiptare dhe ratifikimit nga Parlamenti gjerman, në 2 tetor u bë publik njëkohësisht në kryeqytetet e të dy vendeve.⁵

1 Po aty

2 Po aty

3 Po aty

4 Po aty

5 Po aty. Proces-Verbali i Mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 24.tetor.1987 për bisedimet e zhvilluara me ministrin e jashtëm të RFGJ, H.D.Gensher. Fondi nr.14/AP. Lista nr.1. Dosja nr.12,24.10.1987

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike ishte e rëndësishme për të dy vendet, por në mënyrë asimetrike. Për Republikën Federale të Gjermanisë, Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë me të cilin nuk kishte marrëdhënie diplomatike. Lidhja e tyre ishte një çështje prestigji për një shtet me zë të fuqishëm në Evropë e në botë. Prania diplomatike në Shqipëri ishte një pikë vëzhgimi në një rajon që nuk ishte larg interesave ekonomike e kulturore gjermane dhe që gjithnjë e më tepër po shfaqeshin simptomat e një rënieje në krizë të thellë të regjimeve komuniste aty. Nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike padyshim që Shqipëria ishte përfituesja më e madhe. Ajo forconte pozitën e saj ndërkombëtare, hapej ndaj një shteti të madh evropian, anëtar i Tregut të Përbashkët Evropian e NATO-s, krijonte mundësi përfitimi siç edhe ishte premtuar nga bashkëpunimi ekonomik, teknik e financiar, e bënte R.F.të Gjermanisë më të interesuar për çështjen e shqiptarëve të Kosovës, ndaj të cilëve, siç vlerësohej në Tiranë, qëndrimet kishin qënë korrekte e dashamirëse. Normalizimi i marrëdhënieve me R.F.GJ sillte në Shqipëri një faktor potencial që mund të ndikonte me peshën e vet në amortizimin e presioneve që i bëheshin nga vende të tjera si dhe mund të shërbente si një nxitje edhe për Britaninë e Madhe për të zgjidhur çështjen e arit monetar dhe vendosjen e marrëdhënieve midis dy vendeve.

Menjëherë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis të dy vendeve, në 23 tetor 1987, Tiranën e vizitoi Ministri i Jashtëm i Qeverisë së RFGJ, H.D.Gensher. Mesazhi që ai u përcollti udhëheqësve shqiptarë ishte po ai i Shtrausit (Strauß) i dhënë mbi një vit më parë dhe i përmbledhur në keto fjalë: “Ju do të gjeni tek ne një partner me seriozitetin më të madh. Ju e dini që ne gjermanët atë që bëjmë e bëjmë me themel. Fjalën që themi e mbajmë. Këtë duam të bëjmë edhe me ju.”¹ Gensheri premtoi nënshkrimin e marrëveshjeve midis dy vendeve në fushën tregtare, kulturore, tekniko-shkencore, për vendosjen e linjës ajrore “Lufthansa”, për dhënie bursash, për shkëmbime shkencore, pedagogësh, etj.

Propozimeve konkrete të ministrit federal të punëve të jashtme, Ramiz Alia, iu përgjigj me formulën standarte shqiptare të pagesës së dëmshpërblimeve si një detyrim i R.F.GJ. ndaj Shqipërisë në rrugët që ajo do t’i quante të përshtatshme. Duke përsëritur të njëjtat qëndrime si edhe më parë, ndonëse ishte i bindur se ato nuk shkonin më, udhëheqësi shqiptar me tepër ishte i preokupuar se mos vendosja e marrëdhënieve diplomatike me R.F.GJ. dhe vizita e Gensherit në Tiranë, si dhe disa hapa të tjerë në politikën e jashtme të vendit, interpretoheshin si lëshime të Shqipërisë, si hapje të saj, etj. Prandaj, ditën tjetër të vizitës së Gensherit, në 24 tetor, në një mbledhje të posaçme të Byrosë Politike, Ramiz Alia bëri një apologji që sot tingëllon qesharake dhe për t’u mbrojtur nga çdo akuzë nxjerr përpara emrin e Enver Hoxhës. Ai nxiton të thotë se “Nuk kemi shkuar ne tek të tjerët, por të tjerët kanë

1 Po aty

ardhur te ne”, se “u detyrua gjermani të pranojë marrëdhëniet diplomatike me ne, bile të pranojë edhe zgjidhjen e problemeve ekonomike, jo me rrugën e reparacioneve, por duke gjetur forma e rrugë të tjera; u detyrua ai të vijë në Shqipëri, që është prap një fitore e jona politike” dhe se “për të tëra këto probleme është diskutuar që kur ishte gjallë shoku Enver.”¹

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike hapi rrugën e bashkëpunimit ekonomik midis të dy vendeve, treni siç ishte shprehur Shtrausi (Strauß), filloi të lëvizë edhe në shinën e dytë. Në qershor 1988 ishte nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim ekonomik, industrial dhe teknik, në të cilën u përcaktuan fushat bazë të bashkëpunimit, ndërsa në tetor u nënshkrua marrëveshja kuadër për bashkëpunim financiar dhe teknik. Në bazë të marrëveshjes së parë RFGJ përveç shumës prej 6 milion marka që kishte dhënë për vitin 1987 i akordoi Shqipërisë 20 milion marka për vitet 1988-1989 pa të drejtë kthimi, kryesisht për blerje pajisjesh industriale e makineri bujqësore. Marrëveshja e dytë vuri në dispozicion të Shqipërisë një sasi markash (10 milion marka për 1989) për blerjen e objekteve e mallrave të ndryshme (jo materiale ushtarake e sende luksi).² Kjo shumë ishte me kthim pas 10 vjeçarit të parë. Shqipëria ishte në pragun e një kolapsi të plotë ekonomik në vitin 1989 dhe udhëheqja shqiptare e shihte ndihmën gjermane si një barkë shpëtimi. Por ajo nuk mund të ishte e tillë qoftë për shkak të natyrës së regjimit politik në Shqipëri, por edhe për arsye se angazhimet financiare gjermane pas ndryshimeve të vullshme demokratike në Evropën Qëndrore e Lindore e sidomos në Gjermaninë Lindore në vitin 1989 u bënë shumë të mëdha dhe kishin përparësi strategjike në raport me vendin e vogël komunist ballkanik.

Këto ndryshime epokale që u simbolizuan në rënien e Murit të Berlinit e shokuan regjimin tashmë të drobitur komunist në Tiranë që për t'i shpëtuar sindromës Çausheku shpiku një inovacion politik që nuk e besonte as vetë, se Shqipëria nuk ishte as Lindje dhe as Perëndim. Mbledhjet e Byrosë Politike ngjanin si ambiente mortore në shtëpinë e një njeriu të varur, ku askush nuk merrte guximin të përmendte litarin. Pa vizion të qartë për rrugën që duhej ndjekur e në panik e sipër, në përpjekje për të mbijetuar në muajt që pasuan gjysmën e parë të vitit 1990, regjimi komunist shqiptar hoqi dorë nga mjaft parime e qëndrime dogmatike që i kishte mbrojtur me fanatizëm deri në këtë kohë në politikën e brendshme e të jashtme. U kërkua afrim me Tregun e Përbashkët Evropian dhe me Konferencën për Bashkëpunim e Sigurim në Evropë (KSBE) dhe u shpall gadishmëria për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britaninë e Madhe dhe Bashkimin Sovjetik.³

1 Po aty

2 Po aty. Fjala e R. Alisë në mbledhjen e Byrosë Politike, 1.04.1989. Fondi nr.14/AP. Lista nr.46. Dosja nr.6. Viti 1989.

3 Po aty. Fondi nr.14/AP. Lista nr.1. Dosja nr.6

Impakti i ndryshimeve demokratike

Në gjysmën e dytë të vitit 1990, Shqipëria u fut në rrugën e pakthyeshme të ndryshimeve të thella demokratike. Zhvillimet shqiptare po ndiqeshin nga afër dhe me shumë vëmendje nga demokracitë perëndimore. R.F e Gjermanisë ishte një nga vendet që i takoi të angazhohej drejtpërsëdrejti më shumë se çilitdo tjetër me ngjarjet e 2 korrikut 1990, që është njohur edhe si kriza e Ambasadeve në Tiranë. Këtë ditë dhe në të tjerat në vijim, mbi 3000 qytetarë shqiptarë u futën dhe u strehuan në Ambasadën e R.F. Gjermane dhe disa mijëra të tjerë në ambasadat e tjera evropiano-perëndimore. Kjo ditë shënoi fillimin e rënies së “Murit të Berlinit” të Tiranës. Në atë kohë por edhe më vonë u shtruan disa pyetje: Pse hyrja në ambasada filloi në Ambasadën Gjermane dhe pse atje u drejtuan shumica e të rinjve shqiptarë? Ishte rastësi apo e parapërgatitur? Këto pyetje kanë marrë edhe përgjigje, diku afër të vërtetës, diku naive, por edhe të gabuara. Udhëheqja komuniste e zënë në befasi dhe në panik zhvilloi skenarin e konspiracionit të huaj, nga ana qeverive e të agjencive të shërbimeve inteligjente.

Hyrja e mijëra qytetarëve shqiptarë në Ambasadën Gjermane që ishte dhe zanafilla e ngjarjeve kishte një simbolikë tjetër dhe në një kuptim nuk ishte rastësi. Grupi i parë i njerëzve që u futën aty rrëzuan murin e Ambasadës me një makinë transporti që erdhi nga rruga qendrore e bllokut të ndërtesave të ambasadave të huaja. Ky mur i thjeshtë në një kuptim figurativ ishte kufiri midis dy botëve, midis asaj demokratike dhe asaj totalitare, pra ishte “Muri i Berlinit”. Rrëzimi i këtij muri në Berlin ishte bërë edhe për shqiptarët simboli i lirisë nga regjimi komunist, modeli i aksionit demokratik për të sjellë ndryshimet e ëndërruara. Në sy të shqiptarëve R.F. e Gjermanisë ishte e perceptuar si bota e shpresës, bota e së ardhmes, e bollëkut, vendi i njerëzve të lumtur, i yjeve të futbollit gjerman e botëror aq shumë të ndjekur në Shqipëri, i Bekenbauerit, i Gert Mylerit apo i Rumeniges me shokë. Pra, ishte një perceptim ku ndërthurej realiteti me naivitetin, dëshira me mosdijen, ëndrra së bashku me varfërinë. Kur këta njerëz me ndërhyrjen e qeverive evropiane e institucionet ndërkombëtare u larguan nga Tirana për të kërkuar azil politik në vendet respektive, të gjithë e kuptuan se regjimit komunist shqiptar po i vinte fundi. Pas këtyre ngjarjeve ambasada gjermane u mbyll përkohësisht, marrëdhëniet diplomatike u ngrinë dhe ndihmat gjermane të bashkëpunimit ekonomik e financiar u ndërpre. Ata mijëra shqiptarë që erdhën në Gjermani 17 vjet më parë e që më vonë u shtuan e krijuan një komunitet të vogël nuk duhet të kenë harruar nga erdhën dhe si erdhën, si u pritën e si u trajtuan, si u strehuan e si u punësuan e u shkolluan. Shumica e tyre janë tashmë shtetas gjermanë që respektojnë vendin që i mirëprititi dhe ligjet e tij. Kjo është edhe mirënjohja më e madhe për popullin gjerman që iu gjend atyre në ditët e vështira të agonisë së një regjimi që nuk e donin dhe u ishte imponuar.

Lëvizja studentore e dhjetorit 1990 e detyroi regjimin komunist të tërhiqej përfundimisht nga pozita monopol e partisë shtet. Ai u detyrua të lejojë pluralizmin

politik dhe të drejtat e liritë e njeriut. Shqipëria u nda nga epoka e diktaturës komuniste për të hyrë në një etapë të re zhvillimi demokratik. Ajo nuk do të ishte e lehtë, por me dhimbje, që ishin krizat e lindjes e të zhvillimit të demokracisë së brishtë shqiptare.

Periudha e tranzicionit

Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane pas viteve 90-të morën dimensione dhe përmbajtje të re. Në qershor 1991, pas votëbesimit të Qeverisë së Stabilitetit në Shqipëri që ishte edhe qeveria e parë e koalicionit në vend, ministri i jashtëm gjerman Gensher bëri një vizitë të dytë në Tiranë që shënoi edhe çbllokimin e marrëdhënieve shqiptaro-gjermane dhe nisjen e një faqe të re të tyre. Por këto marrëdhënie morën dimensione të reja pas vizitës së tretë të Gensherit, në Tiranë, në prill 1992, një muaj pas zgjedhjeve të reja parlamentare ku fituese doli Partia Demokratike. Ato u zhvilluan në të gjitha fushat, në kuadër dypalësh, por edhe në planin shumëpalësh, në marrëdhëniet me BE, NATO, Këshilli i Evropës, KSBE (më vonë OSBE), etj., ku roli dhe pesha e Gjermanisë është nga më të rëndësishmet e nga më përcaktueset. Ato u çliruan nga paragjykimet ideologjike dhe filluan të zhvillohen mbi baza e principe të reja, kur në Shqipëri me vështirësi, por edhe vullnet të qartë politik po ndërtoheshin institucionet e reja pluraliste, shteti ligjor, ekonomia e tregut dhe po bëheshin hapa para në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Të gjitha qeveritë shqiptare të periudhës demokratike deri sot e kanë parë dhe çmuar R.F. të Gjermanisë si një nga vendet më dashamirëse për Shqipërinë, ashtu sikurse të gjitha qeveritë gjermane pavarësisht nga ngjyra politike e kanë ndihmuar atë që të zhvillohet, kapërcejë krizat dhe të integrohet gradualisht në institucionet Euro-Atlantike. Bashkëpunimi dhe dialogu politik ka qënë i vazhdueshëm e në nivel të lartë. Presidentë, kryeministra e parlamentarë shqiptarë disa herë radhazi kanë vizituar Gjermaninë në këto 15 vitet e fundit, kanë zhvilluar bisedime të dobishme e kanë marrë mbështetje të konsiderueshme për projektet zhvilluese të demokracisë, të ekonomisë së tregut dhe për integrimin e Shqipërisë në NATO e BE. Po kështu Shqipërinë në këto kohë e kanë vizituar Presidenti Herczog (mars 1995, kur u nënshkrua edhe Deklarata e Përbashkët që kishte vlerën e një traktati miqësie e bashkëpunimi midis të dy vendeve) dhe kancelari G. Schröder (1999). Vizitat e ministrave të jashtëm apo dhe të ministrave të tjerë të dy qeverive kanë qënë të shpeshta. Është krijuar tashmë një bazë e një tradite solide që ky nivel i lartë i shkëmbimeve dhe i dialogut politik të vazhdojë me sukses tani e në të ardhmen.

Qeveritë gjermane kanë qënë gjithnjë të interesuara për stabilitetin politik të Shqipërisë dhe që e kanë parë gjithnjë të lidhur ngushtë me stabilitetin rajonal. Ato nuk kanë munguar të shfaqin shqetësim, të tërheqin vëmendjen e të japin mesazhe për deformime të proceseve demokratike, për shkelje të lirive e të drejtave të njeriut, për

krizat e rënda politike e qeveritare si në vitet 1996,1997,1998,2001, e 2007. Stabiliteti politik i vendit u është referuar si një kusht i domosdoshëm të gjitha forcave politike shqiptare për zhvillimin e marrëdhënieve edhe në fusha të tjera.

Një nga fushat më të rëndësishme të marrëdhënieve midis dy vendeve është bashkëpunimi ekonomik, financiar e teknik. R.F e Gjermanisë që kur u përcaktuan linjat e këtij bashkëpunimi në fundin e viteve 80-të e deri tani u është përmbajtur angazhimeve të saj në vija të përgjithshme. Në këto marrëdhënie ka patur dhe ka një asimetri të dukshme e të njohur: mundësitë gjermane për të dhënë ndihma e kredi, për të bërë investime e për të zbatuar projekte në Shqipëri janë të mëdha, ndërkohë aftësitë absorbuese dhe kapacitetet administrative e teknike shqiptare kanë qënë jo në nivelin e duhur.Ka patur një mospërpurthje midis vullnetit politik shqiptar të shprehur në nivelin më të lartë për të parë në Shqipëri investime serioze nga kompani të fuqishme e të mirënjohura gjermane dhe zbatimit të politikave konkrete për t'u krijuar atyre lehtësira të nevojshme, kuadrin ligjor të përshtatshëm dhe transparencën e domosdoshme në procesin e konkurimit. Kur kemi ngritur në bisedime zyrtare me qeveritarët gjermanë shtimin e ndihmave e të projekteve gjermane disa herë na është thënë së R.F. e Gjermanisë është e gatshme ta bëjë këtë veprim por “ju nuk i absorboni ndihmat që ju jepen”.¹

Pa marrë në konsideratë këto dobësi shqiptare që rrjedhin nga mungesa e një administrate e të kapaciteteve teknike të trajnuar në kushtet e ekonomisë së tregut dhe nga deformimet që këta faktorë pësuan nga ndërhyrja e politikës, bashkëpunimi ekonomik midis të dy vendeve ka patur arritje të kënaqshme. Që nga vit 1988 e deri tani Gjermania i ka akorduar Shqipërisë rreth 367 milion euro ndihmë e kredi.² Kjo e radhit atë pas Italisë, po në qoftë se merren në konsideratë edhe kontributet e Gjermanisë në kuadrin e ndihmave që Shqipëria përfiton nga Bashkimi Evropian dhe nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare, atëherë ajo klasifikohet ndoshta si donatori kryesor i saj për frymë të popullsisë. Bashkëpunimi me Gjermaninë nuk është vetëm financiar, por edhe reformues edhe transformues. Me dhjetëra ekspertë gjermanë kanë kontribuar në hartimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme në Shqipëri dhe në trajnimin e shqiptarëve për t'i aftësuar në përdorimin e normave, koncepteve e metodave të ekonomisë së tregut e të arritjeve bashkëkohore teknologjike, si dhe në përafrimin e legjisllacionit me atë të BE-së. Sektorët kryesorë të bashkëpunimit dypalësh kanë qënë e mbeten energjitika, ujësjellës-kanalizime, administrimi i mbetjeve urbane si dhe mbështetja e sipërmarrjeve të vogla e të mesme. Bashkëpunimi në këto fusha përcaktohet në Protokollat e përvitshme të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe realizohet në praktikë nga dy agjensi: Banka për Rindërtim e Zhvillim (KFW) për asistencën financiare dhe Shoqata për Bashkëpunim Teknik (GTZ) për asistencën teknike.

1 AMPJ.Informacion mbi vizitën e MPJ të Shqipërisë në Bon 14.11.1997.

2 Informacion i Ministrisë së Ekonomisë shtator 2007.

Konkluzion

Qeveritë shqiptare të periudhës së pas viteve 90-të përpos njohjes së detyrimeve të tyre për të plotësuar kushtet e pranimit, kanë bërë përpjekje që të fitojnë edhe ndihmën e mbështetjen e vendeve anëtare në BE e në NATO. Në këtë kuadër ato gjithnjë kanë vlerësuar si faktor parësor dhe kanë kërkuar edhe mbështetjen e qeverive federale të Gjermanisë. Arkivi diplomatik shqiptar i ka të plota dosjet që reflektojnë këto përcapje në fillim në Bon e më vonë në Berlin, ashtu siç ka të reflektuar edhe përgjigjet e mesazhet gjermane të këtyre viteve. Është me vend të përsëritet edhe njëherë pikërisht këtu, se mungesa e justifikuar e burimeve diplomatike arkivore gjermane mund të mos e japë plotësisht të saktë fotografinë e qëndrimeve gjermane për këto çështje, por nuk pengon të shohë thelbin e tyre.

Republika Federale e Gjermanisë e ka mbështetur që në fillim aspiratën e Shqipërisë për integrimin në BE. Kërkesën ajo e ka konsideruar legjitime dhe në mënyrë konstante u ka përcjellë shqiptarëve mesazhe inkurajuese në përpjekjet e tyre për t'u bashkuar me familjen evropiane. Qeveritë gjermane janë ndodhur në mjaft raste edhe në kërkesa të pambështetura për një proces të përshpejtuar integrimi të Shqipërisë në BE. Por gjithnjë me kujdes, krahas afirmimit të përkrahjes parimore dhe të hapave realiste integruese sipas procedurave të miratuara nga Brukseli, qeveritë gjermane përmes përfaqësuesve të tyre i kanë bërë të njohur palës shqiptare se integrimi evropian është një proces i gjatë e i vështirë, se "Shqipëria ekonomikisht është shumë e dobët dhe pa arritur parametrat e duhura nuk mund të hyjë në BE", (30) se "Shqipëria duhet të plotësojë një sërë detyrash me qëllim që perspektiva e saj në BE të bëhet reale."¹

Gjermania ashtu si edhe vendet e tjera kryesore të BE, anëtarësimin e Shqipërisë e lidhin ngushtë me perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor e cila u përcaktua në Samitin e Selanikut në qershor 2003. Hapja e negociatave në janar 2003, përfundimi i tyre dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) midis Shqipërisë e vendeve anëtare të BE në qershor 2006 u bë në frymën e kësaj strategjie integruese evropiane për Ballkanin Perëndimor. Nënshkrimi i MSA-së dhe ratifikimi i saj nga parlamentet e vendeve anëtare të BE është një stacion i rëndësishëm në rrugën jo të lehtë të integritit të plotë të Shqipërisë në familjen evropiane. Ratifikimi i pritshëm i MSA-së nga Bundestagu do të jetë një konfirmim tjetër i qartë i vullnetit politik të R.F.GJ në mbështetje të aspiratave shqiptare si dhe një inkurajim tjetër për të vazhduar pa u lodhur në plotësimin e angazhimeve të marra në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.

Shqipëria dhe Gjermania pavarësisht se kanë pozicione gjeografike të ndryshme në raport me rajonin e Kosovës, e para fqinjë e drejtpërdrejtë dhe e dyta afër ose në kufi referuar BE-së (kufijtë aktualë të BE-së me Ballkanin Perëndimor janë: Sllovenia, Hungaria, Rumania, Bullgaria dhe Greqia), ndonëse nuk mund të kenë të njëjtat interesa themelore të sigurisë kombëtare, gjeopolitike, ekonomike e shpirtërore kanë

1 AMPJ. Informacion mbi vizitën e delegacionit parlamentar të Shqipërisë në Berlin , 4-5.04.2006

qënë në një bashkëpunim aktiv shumëvjeçar për këtë çështje. Shqipëria e ka vlerësuar Gjermaninë si një nga faktorët më të mëdhenj ndërkombëtarë në përpjekjet që janë bërë e po bëhen për të gjetur një zgjidhje të drejtë, të sigurt dhe afatgjatë për Kosovën. Qeveritë shqiptare e kanë vlerësuar politikën gjermane në adresë të Kosovës jo thjesht e vetëm nga këndvështrimi nacional e interesimi i ligjshëm për shumicën shqiptare që popullon këtë vend. Ka një simpati në opinionin e përgjithshëm në Ballkan për kombin gjerman që është krijuar që gati një shekull përpara kur Shqipëria u bë shtet i pavarur. Shqipëria dhe shqiptarët kanë besim te koherenca politike gjermane, në angazhimin e pandërprerë diplomatik për të hapur një perspektivë sigurie për Kosovën e rajonin, që kalon përmes respektimit e realizimit të aspiratave e të vullnetit të shumicës, por mbi bazën edhe të respektimit e të garantimit të të gjitha të drejtave të pakicave në nivele e standarte evropiane.

Edhe Republika Federale e Gjermanisë e ka vlerësuar Shqipërinë si një partnere të rëndësishme në Ballkanin Perëndimor dhe si një nga faktorët rajonalë kryesorë për të përballuar sfidën e Kosovës. Dialogu politik për këtë çështje ka qënë i pandërprerë, veçanërisht në vitet 1997-1999 kur ajo i dominonte të gjitha takimet dypalëshe. Ajo mbeti prioritare në axhendën e bisedimeve shqiptaro-gjermane edhe në vitet e mëvonshme duke përfshirë këtu edhe bisedimet në takimin e muajit shtator të dy ministrave të jashtëm në Berlin apo edhe në ato që zhvilloi në fillim të muajit Tetor Sekretari i Shtetit në MPJ gjermane me autoritetet shqiptare në Tiranë.

Konsultimet dhe dialogu aktiv shqiptaro-gjerman për çështjen e statusit të ardhshëm të Kosovës janë mbështetur në disa principe e vlera të pranuar nga shumica e faktorëve kryesorë ndërkombëtarë. Diplomacia gjermane është treguar të jetë e kujdesshme për të mos kapërcyer linjat e përcaktuara në forumet evropiane apo në Grupin e Kontaktit rreth statusit të ardhshëm të Kosovës madje ndonjëherë ajo ka qënë më e rezervuar në raport me partnerët e saj evropianë duke këmbëngulur në gjetjen dhe në zhvillimin e mundësive për krijimin e urave të komunikimit midis Prishtinës dhe Beogradit. Gjithsesi nuancat nuk prekin thelbin e pozicionit gjerman për bazat se ku do të mbështetet zgjidhja e statusit të ardhshëm të Kosovës që janë dhe ato të Grupit të Kontaktit, tre JO-të e njohura si dhe "Plani Ahtisari".

Në kontekstin global të bashkëpunimit, Shqipëria dhe Gjermania kanë mjaft hapësira të pashfrytëzuara si në OKB, në Këshillin e Evropës, në OSBE, etj. Statusi i Gjermanisë si një shtet i madh evropian e mik i Shqipërisë kërkon që qeveritë shqiptare, cilado qoftë në pushtet, të mirëkuptojnë pozitën dhe synimet e saj në organizatat ndërkombëtare. Partnerët kryesorë ndërkombëtarë të Shqipërisë, midis të cilëve edhe Gjermania e dinë se Shqipëria e vogël nuk mund t'u prishë punë të mëdhenjëve dhe as nuk mund të hyjë mes tyre. Mirëkuptimi edhe në këtë rast është i dobishëm. Në sytë e shqiptarëve Gjermania është një mik i madh dhe i pazëvendësueshëm.

Ky rrugëtim i shkurtër në historinë 20 vjeçare të marrëdhënieve shqiptaro-gjermane ndoshta do të bëhet shkas për një studim më të gjerë e më të thelluar në të ardhmen. Komentet dhe sugjerimet për çka u referua do të jenë të dobishme e të mirëpritura.

Ballkani perëndimor dhe shkaqet historike të destabilizimit të tij

Klodiana Beshku¹

ABSTRAKT. *Gjatë këtij njëzet vjecari të fundit, Ballkani Perëndimor ka qenë terren konfliktesh ndër-shtetërore dhe brenda-shtetërore dhe ende zona konsiderohet pjesërisht e paqëndrueshme nga imazhi kolektiv i popujve dhe politikanëve të vendeve perëndimore të Bashkimit Evropian. Ky artikull, me anë të një përshkrimi të së kaluarës historike dhe institucionale të këtij territori, kërkon të hedh dritë mbi ngjashmëritë dhe ndryshimet që karakterizojnë shtetet e dala nga ish-Jugosllavia si dhe mbi faktorët ekonomik dhe social që kanë ndikuar në atë kulturë demokratike ende të pakonsoliduar të këtyre vendeve. Njëkohësisht, gjatë kësaj panorame të shpejtë historike vendoset theksi edhe mbi disa momente të cilat përbëjnë bazat e konflikteve etnike dhe të armiqësive të vjetra në Ballkanin Perëndimor dhe hidhet ideja për një bashkëpunim më të madh rajonal me qëllim zbutjen e plagëve të së shkuarës të cilat mbajnë peng të gjithë zonën.*

Hyrje

Vendet e Ballkanit Perëndimor² janë parë gjithmonë si stereotip vendesh të destabilizuara, të cilët kanë prodhuar ndër shekuj vetëm luftra dhe konflikte³. Ky stereotip bëhet gjithnjë e më i pajustificueshëm në rast se merret parasysh

- 1 Autorja është diplomuar në Shkencë Politike/Politikë Nderkombetare në Universitetin e Sienes, Itali. Ka kryer Master in European Studies “The Process of Building Europe” pranë këtij Universiteti dhe Universitetit Robert Schuman në Strasburg, France. Aktualisht është doktorande në Gjeopolitikë në Universitetin e Pizes, Itali.
- 2 Në këtë artikull do të konsiderohen vetëm ato vende të cilat ishin pjesë e konflikteve ballkanike pas vitit 1990, pra: Sllovenia, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Serbia-Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia. Për Maqedoninë është përdorur emri i vjetër i saj si përpara viteve '90 dhe edhe pas kësaj periudhe është vazhduar me këtë emër për arsye praktikiteti.
- 3 Në një studim të periudhës 1492 – 1992 të kryer mbi kontinentin evropian, rezultonte se vetëm në gadishullin e Ballkanit ka pasur 83 revolucione, përkundrajt 15 të gadishullit iberik, 41 në France, 56 në ishujt britanikë, 56 në Rusi dhe vetëm 4 në Vendet e Uletë. Është interesant fakti se ndërsa në pjesën tjetër të kontinentit revolucionet kanë qenë për shkaqe të ndryshme kulturore-sociale, në Ballkan ato kanë ndodhur kryesisht për motive nacionale-etnike. Studimi gjendet në Charles Tilly, “States and Nationalisms in Europe”, Theory and Society, Vol. 23, No. 1 (Feb., 1994).

pozicioni i tyre gjeografik, pra afrimiteti me Europën Perëndimore, demokratike e të civilizuar. Ti shpjegosh një evropiani shkaqet e “civilizimit të vonuar” të këtyre popujve mund të kthehet në një mision të pamundur pikërisht për faktin se idealet demokratike në bazë të civilizimit perëndimorë janë rrënjësor shumë thellë dhe panjohur historinë e Ballkanit bëhet e pamundur toleranca dhe mirëkuptimi i këtyre popujve “rebelë” që gjenden tek porta. Natyrshëm lind pyetja, a mund të eksportohet ose të kopjohet demokracia? Për ti kthyer përgjigje kësaj pyetje, në rastin e Ballkanit Perëndimor bëhet e paevitueshme njohja e background-it të tyre kulturor dhe të shkaqeve të atyre konflikteve të cilët kanë mbajtur në ajër të gjithë rajonin. Stërzgjatja pothuajse dhjetëvjeçare e ceshjes së Bosnje-Hercegovinës, Maqedonisë dhe Kosovës, mund të konsiderohen si shembulli më tipik se si e kaluara e një populli po mban peng të tashmen e tij. Jo rastësisht, studiues si Edgar Hösch në librin e tij kushtuar Ballkanit e konsideron historinë e Ballkanit si një element themelor që qendron në bazë të memorjes kolektive të këtyre popujve pikërisht për faktin se historia konsiderohet prej tyre si një element i cili shërben për të legjitimuar të tashmen nepërmjet së kaluarës.¹ Në mënyrë që ky element legjitimiteti të kthehet në një faktor kohezioni dhe paqeje, duhet në rradhë të parë të kuptohet historia që mbart memorja kolektive e këtyre popujve.

Shkaqet e konflikteve etno-nacionaliste në Ballkanin Perëndimor janë të shumta. Në një vështrim të shpejtë historik duket sikur Sllovenia, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova kanë të përbashkët përplasjet ndërmjet Romës dhe Bizantit, perandorisë austro-hungareze dhe asaj osmane, tendencave hegjemoniste të fuqive të mëdha perëndimore dhe lindore, diktaturën komuniste të tipit stalinist dhe tranzicionin pas një regjimi të tillë. Disa studiues kanë gjetur një farë “uniformiteti” në zhvillimet e këtij rajoni pikërisht si rrjedhojë e këtyre pasazheve të ngjashme historike, duke dalë në përfundimin se ato shtete që kanë qenë në varësi të perandorisë romake të perëndimit dhe të asaj austro-hungareze kanë pasur një prirje më të qendrueshme drejt ndërtimit të institucioneve demokratike, të shtetit të drejtës dhe të ekonomisë së tregut.² Megjithatë, do të ishte shumë përgjithësuese të merreshin për bazë karakteristikat social-kulturore të këtyre dy perandorive pasi i gjithë territori i Ballkanit është karakterizuar ndër shekuj nga “fluksi euroaziatik”³ Për këtë arsye nuk mund të flasësh për kufij të qartë ndarjeje, por për një shkrirje të shumë elementeve të kulturës bizantine, perëndimore, europiane dhe orientale. Së paku, me siguri mund të flasësh për ndjenjën e fortë nacionaliste që i karakterizon shtetet e Ballkanit Perëndimor, një ndjenjë që është theksuar akoma më tepër nga përplasjet e vazhdueshme ndërmjet vendasve dhe pushtuesve të huaj, por edhe nga konfliktet etnike ndërmjet vetë popujve ballkanas gjatë një lufte të vazhdueshme për ekzistencë. Ky nacionalizëm mendohet se është ushqyer ndër shekuj nga sfondi shumë-shtresor etniko-kulturor i territorit të Ballkanit, shtresëzimet e para të të cilit e kanë origjinën qysh në antikitet.

1 Edgar Hösch, *Storia dei Balcani*, Bologna: Il Mulino, 2006. Fq. 34.

2 Behet fjale për Slloveninë dhe Kroacinë, dy shtetet me të zhvilluara të Ballkanit perëndimor. Sllovenia anetare e BE-së qysh prej vitit 2004, ndërsa Kroacia tashme me statusin e kandidatit qysh prej mesit të vitit 2004.

3 Edgar Hösch, *Storia dei paesi balcanici. Dalle origini ai nostri giorni*. Torino: Einaudi, 2005, fq. 57

Origjina e popujve në Ballkan, një faktor përcaktues?

Në gadishullin ballkanik vetëm disa prej popujve e konsiderojnë veten se i përkasin paraardhësve të tyre autoktonë; grekët të cilët rrjedhin prej akejve, shqiptarët prej ilirëve dhe rumenët prej trakeve. Ilirët dhe trakët mendohet se gjendeshin në gadishullin ballkanik rreth tre mijë vjet para lindjes së Krishtit. Bëhet fjalë për popuj të origjinës indo-europiane të cilët kanë lënë shumë pak gjurmë të ekzistencës së tyre, por studimet e shumta dhe në vecanti gjuha shqipe dhe ajo rumene janë dëshmitarë të fortë të prejardhjes së këtyre dy popujve.¹

Duke filluar që nga mijëvjeçari i parë p.l.K gadishulli ballkanik ka qenë një objektivi final për shumë fise të prejardhjeve të ndryshme, kjo për shkak të kushteve të mira klimatike si edhe afërsisë me detin. Fise si gotët me origjinë gjermane, unët me origjinë bullgare si edhe avarët me origjinë turko-bullgare kanë kaluar më parë në territorin ballkanas. Mund të thuhet se asnjë prej këtyre fiseve nuk ka lënë gjurmë aq domethënëse në këto zona sa fiset sllave. Gjatë shekullit V-VI p.l.K, gadishulli ballkanik u përfshi nga i ashtuquajti “dyndje e sllavëve”. Bëhet fjalë për popullsi tribale të cilat mund të ndahen në sllavë të qendrës (polake, ceke, sllovaqe, sllovene) dhe sllavë të jugut (serbe, kroate dhe një pjesë e bullgarëve). Dyndjet e fiseve të ndryshme vazhduan deri në shekullin XII në Ballkan e sidomos në Ballkanin Perëndimor duke sjellë spostime të shpeshta të popullsisë vendase, sidomos gjatë periudhës së perandorit bizantin Justinian (527-565) nën të cilin qytetet ballkanase kishin njohur një zhvillim shumë domethënës.

Një prej momenteve të cilët ja vlejnjë të theksohet është ai i shekullit të VII p.l.K, kur fiset avarë me origjinë turke, të njohura për agresivitetin në luftë, arritën në portat e Bizantit dhe duke kërcënuar seriozisht ekzistencën e tij. Perandori bizantin i asaj kohe kërkoi ndihmën e fiseve sllave (kroate dhe serbe) të cilat njiheshin gjithashtu për zotësi në luftë. Të dyja këto fise u vendosën më pas në territoret e braktisura nga avarët; kroatët në Kroacinë bashkëkohore dhe në Bosnjën perëndimore, ndërsa serbet në kufi me Kosovën veri-perëndimore dhe në territorin e Malit të Zi. Që nga ky moment depërtimi i sllavëve ka ardhur gjithnjë duke u rritur derisa ata shtyhen nëpërmjet Malit të Zi deri në zonat bregdetare të Dyrrahut e të Skutarit ku hasin rezistencën e popullsisë vendase.

Një moment tjetër i përket shekullit IX deri XI, periudhe në të cilën sllavët bëhen një element shumë prezent në zonat bregdetare të Malit të Zi dhe të Kosovës aktuale duke mos depërtuar dot në qytetet e mëdha dhe në zonat malore të thella të këtyre territoreve. Ka edhe antiteza të këtyre migracioneve një prej të cilave për shembull mbron idenë se territori i Kosovës është populluar nga shqiptarët në shekullin XVII të

1 Nje prej botimeve qe mbeshtet kete teze eshte edhe Noel Malcolm, Malcolm, *Storia del Kosovo*, Milano: Bombiani, 1999. Autori aty ben nje analize shume interesante linguistike-historike mbi mbijetesën e gjuhes shqipe dhe asaj rumene si edhe te prejardhjes se tyre nga ilirishtja, duke shpjeguar levizjet e popullsive ne Ballkan nepermjet transformimeve gjuhesore dhe njekohesisht autoktonizmin e kosovareve, shqiptareve, rumuneve dhe romeve, fq. 53-72.

cilët përfituan nga emigrimet e serbeve të shkaktuara nga kaosi i perandorisë osmane.¹ Por sic shkruajnë studies të tjere përvec Malcolm e Vickers të cilët njihen si mbrojtës të tezave pro-kosovare, edhe sikur të ketë ndodhur kjo zhvendosje e popullsisë kosovare në atë periudhë, kosovarët aktuale janë “identikë” me ata që gjendeshin në këto treva përpara dyndjeve të serbëve², ndaj nuk ka si të jetë e mundur një “shfaqje” e papritur e tyre në këto zona. Gjithashtu ka interpretime të ndryshme ndaj migracioneve ballkanase nga botime historike të simotrave të Akademive Shkencore zyrtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Debati historik mbi këtë temë është shumë i gjerë dhe për të mos u thelluar më tej ne na vjen në ndihmë pohimi i studiuesit Malcolm, i cili vë duart përpara duke thënë: *Nuk do të persëritet asnjëherë mjaftueshëm që ceshtjet e prioritetit kronologjik (kush ka qenë i pari në një vend të caktuar) janë komplet të pavlefshme për të vendosur se kush ka të drejtë ose ka faj në çfarëdo situatë politike të ditëve tona.*³ Në fund të fundit të gjitha origjinat bëhen misterioze në qoftë se kërkohet shumë thellë ne kohë. Pothuajse të gjitha popullsitë rezultojnë të kenë ardhur nga një territor tjetër.⁴ Ky lloj arsyesimi do të ishte shumë funksional në mos-justifikimin e politikës violente serbe ndaj Kosovës të cilën e konsideron si djepin e simboleve kulturore të saj dhe në rastin e përplasjeve serbo-kroate në territorin boshnjak. Tashmë është një fakt që jo të gjithë kufijtë e shteteve nacionale moderne përkojnë me kufijtë kulturor të tyre, një fakt para të cilit duhet të dorezohen të gjithë nationalistët e betuar.

Formimi i mbretërive ballkanase, paraardhëse të shteteve ballkanike.

Formimi i bërthamave para shtetore në gadishullin ballkanik u krye nën ndikimin e dy sferave të influencës: dominimi i karilongëve në veri, pra i Perandorisë së Shenjtë Romake të Perëndimit dhe dominimi i Perandorisë Bizantine në jug, pra i Perandorisë Romake të Lindjes. Kufiri i këtyre dy influencave mendohet të ketë qenë përafersisht lumi i Danubit. Përpara krijimit të shteteve të para kombëtare, përvec dyndjeve të fiseve të ndryshme, territori i Ballkanit Perëndimor karakterizohet nga prezenca e disa territoreve autonome të quajtura “zupanate” (territori i ish-jugosllavisë) me në krye një “zupan” i cili ishte njëkohesisht edhe prijësi i klaneve udheheqëse dhe nga principatat (Shqipëri e Kosovë) të udhehequra nga prijësit përkatës.

Në vitin 623 p.k, pas një lufte të ashpër të slovenëve me avarët, u formua Mbretëria e Katarania-s nga ana e këtyre të parëve. Kjo mbretëri u vendos nën influencën e

1 Jose Pirjevec, *Serbi, croati, sloveni. Storia di tre nazioni*. Bologna: Il Mulino, 1995, fq.23.

2 Robert Bideleux, Ian Jeffries, *The Balkans. A Post-Communist History*, New York: Routledge, 2007, fq: 513-514.

3 Noel Malcolm, *Storia del Kosovo. Dalle origini ai nostri giorni*. Milano: Bompiani 1999, fq. 53 (Shenim: Perktimi është i autorit të ketij shkrimi)

4 Po aty.

karolingëve dhe të vasalëve të tyre; bavarezëve, friulianëve dhe istrianeve. Pra, bërthama e parë e një shteti të ardhshëm në Ballkanin Perëndimor i përket Sllovenisë në shekullin e shtatë të erës sonë.

Ndërkohë, në territorin e Mesia-s (Serbia aktuale) dhe të Dalmacisë (Kroacia aktuale) po bëhej gjithnjë e më e fortë influenca e Perandorisë Romake të Lindjes. Të gjetur përballë influencës së dy perandorive dhe të rrezikuar nga asimilimi kulturor në veri e në jug të territorit, kroatët ishin të dytët ata që formuan mbretërinë e tyre. Kështu lindi Mbretëria kroate në periudhën 924 – 925 të erës së re, e cila më vonë do të bashkohej mbretërisë së Hungarisë me anë të “Bashkimit të kurorave” më 1102.¹ Qyteti i Dubrovnikut u krijua mbi model të qyteteve bregdetare italiane dhe do të mbetej për shumë kohë një komunë e pavarur ndërmjet Venecias dhe Turqisë.

Krijimi i bërthamës së tretë shtetërore i përketë Maqedonisë, diku aty ndërmjet shek.X - shek.XI. Rreth një shekull më parë, territori i Maqedonisë ishte bërë arenë e një emigrimi pa masë të magjarëve, fise nomade me origjinë turke dhe bullgarëve të cilët u vendosën në mes të sllavëve të jugut dhe atyre të perëndimit. Në këtë pikë, Bizanti nuk mund të toleronte prezencën gjithnjë në rritje të bullgarëve në këtë zonë, ndaj vendos të ndërhyjë duke ripushtuar një pjesë të madhe të ish-perandorisë bullgare dhe të principatave serbe. Maqedonia lihet formalisht e pavarur dhe kjo pavarësi e cila do të zgjase deri në shekullin XII shënoi lindjen e një shteti me dopjo-identitet: bullgarët e quajne si krijimin e një shteti bullgar perëndimor, ndërsa serbet e quajne si krijimin e shtetit të parë sllavo-maqedonas.

Gjatë shek.X-XI edhe territori serb u bë terren sulmesh nga ana e Bizantit, e Perandorisë Bullgare dhe e hungareze. Territoret e Mesia-s së vjeter ishin grupuar në dy entitete: ai i Zetës (Mali i Zi aktual) dhe ai i Rashës (Raška, Serbia aktuale). Në vitet 1037-1038 u njoh “polity” i parë serb nën kontrollin e Stefan Nemanjës që e quante veten “zupani i madh i Rashës”. Në vitin 1159, Stefan Nemanja i bashkoi të dy territoret dhe në vitin 1190 mori pavarësinë nga Bizanti, duke formuar mbretërinë e Serbisë. Ndërkohë, në saj të aftësive të tij politike ai arriti të shtrinte dominimin e tij deri në Kosovë, Maqedoni dhe në principatën e Zetës. Perandoria e krijuar do të dobesohej shumë pas vdekjes së tij më 1199 dhe kjo do të sillte një avancim të Perandorisë osmane në këtë territor.

Gjatë shekullit të XII do të kemi krijimin e një shteti vasal të Hungarisë, atë të Bosnjes. Në shekullin e X-të Bosnja ishte e përfshirë nën mbretërinë kroate dhe do të shfaqet si një shtet më vetë në periudhën 1168 – 1326 nën pushtetin e prijësit të rreptë Ban Kulin. Rreth gjysëm shekulli më vonë do të kemi përpjekje të Hungarisë katolike për të pushtuar Bosnjën dhe do të jetë vetëm sulmi mongol ndaj Hungarisë ai i cili do të shpëtoj Bosnjën nga shkatërrimi i plotë. Shteti Boshnjak do të konsolidohet nën

1 Nje historik shume te qarte e te detajuar per secilin nga vendet e Ballkanit Perendimor gjendet ne Robert Bideleux, Ian Jeffries, *The Balkans. A Post-Communist History*, New York: Routledge, 2007, Elizabeth Pond, *Endgame in the Balkans. Regime Change, European Style*, Washington, D. C: Brookings Institution Press, 2006, John R. Lampe. *Yugoslavia as History. Twice there was a Country*. Cambridge: Cambridge University Press, 2000.

pushtetin e Ban Stjepan Kotromanic (1318 – 1353) i cili do të aneksonte edhe rajonin e Hum-it (Hercegovina e sotme) dhe do të krijonte një aleance të fortë me mbretin Anzhu të Hungarisë. Kjo aleancë do të karakterizojë shtetin boshnjak deri në rënien e tij nën perandorinë osmane.

Kosova është territori i cili ndryshe nga popujt e tjerë sllave, mund të thuhet se e ka prejardhjen nga fiset dardane (ilire). Territori i Kosovës gjatë periudhës mesjetare ishte i përfshirë në territorin e mbretërisë serbe të udhëhequr nga Stefan Nemanja. Boshllëku që la shkatërrimi i kësaj mbretërie do të mbushet shumë shpejt nga avancimi i ushtrisë osmane, sidomos pas betejës së Kosovës më 1389. Pas një oshilacioni ndërmjet Portës së Lartë dhe Serbisë, Konferenca e Londrës e vitit 1913 e cila konkludoi luftrat ballkanike, ndërkohe që do të njoh pavarësinë e shtetit shqiptarë, do ta vendosë Kosovën nën Serbinë. Sic vëren edhe studiuesja Pond, ndryshe nga serbët, kroatët apo boshnjakët, kosovarët nuk kanë eksperimentuar ndonjëherë një shtet qoftë edhe me një qeverisje autoritare ose gjysëm autoritare si fqinjët e tyre, duke pasur pas vetes vetëm një traditë patriarkale klanore.¹

Pas rënies së perandorisë bizantine që përkon me rënien e Kostandinopojës në vitin 1453 fillon edhe dominimi i perandorisë osmane në Ballkanin Perëndimor i cili do të përfundojë plotësisht me fundin e luftës së parë botërore në vitin 1918. Edhe gjatë kësaj periudhe territori i ballkanit do të kthehet në një teater lufte, pushtimesh dhe tendencash nënshtrimi socialo-kulturor nga ana e perandorisë osmane. Bërthamat e para të shteteve ballkanike do të shkatërrohen pak nga pak si rrjedhojë e luftës për pushtet dhe konflikteve të dinastive të ndryshme. Këto mbretëri pas copëzohimit në principata, gjatë rregjimit osman do të copëzohen më tej në *milet-e*². Në vija të përgjithshme, Valakia (Rumania aktuale) dhe Moldavia do të jenë shtete vasale të Portës së lartë dhe do të udhëhiqen nga elita fanariote me prejardhje greke, Kroacia dhe Sllovenia do të jenë nën pushtimin austro-hungarez, Bosnja-Hercegovina do të luhetet ndërmjet influences austro-hungareze dhe asaj osmane dhe pjesa tjetër e territori të Ballkanit Perëndimor do të jetë nën pushtimin osman.

Qysh në fillimet e mesjetës së largët, Ballkani Perëndimor nuk do të ketë një zhvillim institucional homogjen në kornizat e një shtete të qetë politike. Sic do e shohim edhe më tej, krijimi i shtet-kombeve në Ballkan do të fillojë më vonë në krahasim me pjesën tjetër të Europës dhe i shoqëruar gjithnjë me një fluks demografik dhe migrator i cili do të kontribuoj më tepër në krijimin e *puzzle*-it ballkanik. Ky territor do të jetë terreni i tre lufra ballkanike, i shumë përplasjeve nacionaliste si edhe i forcimit dhe rënies së perandorisë

1 Elizabeth Pond, *Endgame in the Balkans. Regime Change, European Style*, Washington, D. C: Brookings Institution Press, 2006.

2 Milet quheshin komunitetet fetare autonome, ato te cilat praktikonin nje fe te ndryshme nga ajo myslimane nen pushtimin osman. Zakonisht drejtoreshin nga nje patriark i cili ishte i varur nga sulltani, por administronte ne menyre autonome ligjet dhe taksat. Ky lloj sistemi beri te mundur ruajtjen e fese ortodokse e katolike ne Ballkan gjate pushtimit osman. Nje autor shkruan se ky lloj sistemi nuk u shpik nga hici prej osmaneve, por ne nje fare menyre u desh te zbatohet prej tyre ne nje pushtimin e nje terreni te perbere prej disa vecorive sociale (si ai i Ballkanit). Stanford J. Shaw "The aims and achievements of ottoman rules in the Balkans", *Slavic Review*, Vol. 21, No. 4, (Dec., 1962).

osmane e cila do të lerë shume gjurmë. Gjatë shtatë shekujve që nga formimi i mbretërive të para ballkanase, evenimentet do të jenë të shumta por ne do të ndalemi vetem tek disa prej tyre të cilat do mund të na ndihmojnë të kuptojmë krizën jugosllave të viteve '90 dhe prapambetjen në drejtim të institucioneve shtetërore të Ballkanit Perëndimor.

Beteja e Kosovës dhe simbolet e tjera të cilat qëndrojnë në bazë të nacionalizmit serb.

Mbrojtësit më të zjarrtë të tezës serbe ndaj Kosovës e quajnë këtë të fundit si “Jeruzalemi” i serbisë ose si “djepi i kulturës” serbe për shkak se në territorin kosovar janë hedhur themelet e kishës ortodokse në Pejë dhe është zhvilluar e ashtuquajtura beteja e Kosovës, humbja e së cilës shënoi edhe nënshtrimin serb ndaj perandorisë osmane.

Në kufijtë e Kosovës, pranë liqenit të Ohrit, rreth fundit të shekullit IX ishte krijuar një zonë influente e krishtërit si rrjedhojë e dërgimit të disa misionareve greke e latinë nën iniciativën e Bizantit dhe të Romës. Misioni i përhapjes së katolicizmit u vu në jetë nga dy shenjtore, merita më e madhe e të cilëve ishte përkthimi i teksteve të shenjta në gjuhën sllave-maqedonase me anë të një alfabeti i cili do të kthehej më vonë në alfabetin sirilik që do të bëhej baza e gjuhës së sllavëve ortodoks që i bashkon e njëjta gjuhë, si në fe ashtu edhe në kulturën kombëtare të tyre. Nga ana tjetër, Stefan Nemanja, pasi e kishte shtrirë sundimin e tij deri në Kosovë e Maqedoni, rreth vitit 1196 vendos të strehohet në një manastir në malin Athos ku më parë kishte gjetur qetësinë shpirtërore djali i tij i vogël Sava. Pas pushtimit të Bizantit nga kryqëzatat dhe pas rënies së tij, djali i madh i Nemanjës, Stefani iu drejtua Venecias dhe njohu patriarkatën (sundimin) e Hungarisë mbi territorin që udhëhiqte. Vëllai i tij, Sava, u zhvendos në Nicea, territor i patriarkatit ekumenik. Në vitin 1219, patriarku i Hungarisë i jep atij titullin Autoqefal Metropolit i Kishës Serbe duke vendosur si qendër kombëtare të kësaj kishe qytetin e Pejës. Ky vendim u kundërshtua energjikisht nga arqipeshkvi i Ohrit dhe krijoi një kufi preciz ndërmjet botes ortodokse dhe asaj katolike në Ballkan. Njohja e një qendre kombëtare të kishës serbe në zemër të Kosovës, e cila do të kishte dhe heronjtë e saj Stefan dhe Sava Dushani, do të kthehej shumë shpejt në një element shumë të fortë të identitetit historik, fetar dhe kulturor të popullit serb. Siç shkruan historiani Pirjevec, aq i fortë do të ishte ky element sa do të privonte këtë popull nga dallimi ndërmjet sferës së të shenjtës dhe realitetit.¹

Në sferën e së shenjtës në memorjen kolektive të popullit serb do të hyje edhe beteja e Fushë-Kosovës. Kjo betejë tregohet si një përleshje ndërmjet shteteve serbe të Lllazarit dhe Vuk Brankovicit dhe shtetit osman. Është e vërtetë që beteja e vitit 1389 në Fushë-Kosovë do të shënojë rënien e Ballkanit Perëndimor nën zgjedhën osmane pas humbjes së ushtrisë së drejtuar nga këta dy princër kundër ushtrisë së sultan Muratit I. Ajo që

1 Jose Pirjevec, *Serbi, croati, sloveni. Storia di tre nazioni*. Bologna: Il Mulino, 1995, fq.11.

nuk është e plotë, është fakti që bëhej fjalë për një rezistencë ballkanase që përfshinte shumë popuj të ballkanit dhe jo vetëm atë serb, pasi në rradhët e kësaj ushtrie gjendeshin trupa kroatë, bullgarë, boshnjakë, romë dhe shqiptarë. Kësaj beteje i janë kushtuar shumë legjenda dhe mite popullore nga ana e popullit serb, të cilat lartësojnë figurën e princit serb Llazar e ndërkohë nuk mund të merren si burime të mirëfillta historike ndonëse përmendin aty këtu ekzistencën e ushtrive të tjera ballkanase. Në këtë drejtim vijnë më së shumti në ndihmë burimet historike osmane dhe ato të studiuesve të huaj të cilat vërtetojnë ekzistencën e koalicionit ballkanik ndaj ushtrisë osmane¹. Megjithatë këto burime historike nuk i kanë mjaftuar nacionalizmit modern serb dhe ortodoksisë serbe të cilat kanë arritur në njëfarë obsesioni shpirtëror dhe simbolik ndaj Kosovës.

Krijimi i Mbretërisë së Jugosllavisë dhe elementet që do të transmetohen në federatën jugosllave.

Ballkani Perëndimor kaloi pesë shekuj nën sundimin osman dhe herë pas herë nën përplasjen e perandorisë osmane nga njëra anë, e asaj austro hungareze nga ana tjetër.

Pas vitit 1878, si konsekuencë e njohjes nga fuqitë e mëdha të një shteti serb, rumun, malazez dhe bullgar, Bosnja-Hercegovina ra nën pushtetin e perandorisë austro-hungareze. Gjatë këtij pushtimi u favorizua shumë minoranca serbo-kroate (katolike) në krahasim me pjesën tjetër myslimane dhe ortodokse. Ky fakt solli protesta të shumta nga ana e këtyre dy grupimeve të fundit dhe njëkohësisht edhe akumulimin e pakënaqësisë e cila do të krijonte rrënjët e para të konflikteve më bazë etnike në Bosnje-Hercegovinë. Këto konflikte do të gjejnë prehje fillimisht vetëm nën idenë e Jugosllavisë, pra e bashkimit të të gjithë sllavëve të jugut dhe do të rikthehen dhunshëm pas viteve '90.

Kurora e Mbretërisë së Serbisë e krijuar në fillim të viteve 900 do të kalojë deri në fillimin e luftës së parë botërore në duart e dy familjeve rivale; atë të Obrenovic dhe atë të Karaxhorxhevic² duke u shoqëruar nga qëllime expansioniste të cilat, për ironi, do të kontribuojnë më tepër në idenë e jugosllavizmit.

Ideja e pan-jugosllavizmit mori më shumë hov paralelisht me fillimin e luftës së parë botërore. Një tjetër element që influencoi në këtë hov ishte edhe vrasja e pasardhësit në fron të Perandorisë Austro-Hungareze në Sarajevë, Francesco Ferdinando-s. Boshllëku i krijuar nga kjo vrasje solli idenë e një shtate të pasigurt për të gjithë popujt sllavë dhe përfaqimin nga ana e tyre të idesë së Jugosllavizmit. Për sllovenët, bashkimi i

1 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, *Beteja e Kosovës 1389 (përmbledhje studimesh)*, Tirane: Mesonjtorja, 2005.

2 Nje studim i hollesishem mbi idene e pan-jugosllavizmit dhe mbretërisë jugosllave gjendet ne John R. Lampe. *Yugoslavia as History. Twice there was a Country*. Cambridge: Cambridge University Press, 2000, Tim Judah, *The Serbs: History, Myth and the Destruction of Yugoslavia*, New Heaven: Yale University Press, 1997, Sabrina P. Ramet, *The Three Yugoslavias: The Dual Challenge of State-Building and Legitimation among the Yugoslavs, 1918—2004*, Bloomington, Ind. & Washington D.C: Indiana University Press & The Wilson Center Press, 2006.

të gjithë sllavëve të jugut përfaqesonte të keqen më të vogël duke pasur parasysh se ata kërcënoheshin nga interesat italiane në kufi, për kroatët përfaqesonte një alternativë më të mirë duke e krahasuar me agresivitetin kulturor të hungarezëve, për Bosnje-Hercegovinën ishte gjithashtu një alternativë shumë e mirë pasi ajo gjendej në mes të dy perandorive në rënie, Mali i Zi nga ana e tij e kishte përqafuar gjithnjë idenë e bashkimit me Serbinë, ndërsa Maqedonia e cila ishte karakterizuar gjithnjë nga një numër i madh etnish dhe grupesh, sapo kishte përjetuar një pushtim nga Bullgaria përgjatë luftrave ballkanike të viteve 1912-1923 dhe kishte parë ti mohohet autonomia administrative-politike, ndaj e shihte me një sy shume të mirë idenë e jugosllavizmit.

Kjo ide u konkretizua me takimin e disa përfaqësuesve sllavë në Korfuz në vitin 1917, ku u shpallën principet bazë të jugosllavizmit; federalizëm për qark dinastisë së Karaxhorxhevic. Mbretëria e re do të bazohej në bashkëjetesën paqësore dhe autonominë e të gjitha etnive dhe feve. Kjo ide u mbështet fuqishëm nga Franca e cila shihte me anë të saj një frenim të ekspansionizmit italian në rajon si edhe nga Britania e Madhe e cila shihte një pengesë ndaj rikthimit të interesave austro-hungareze, osmane dhe bullgare në rajon. Negociata për krijimin e mbretërisë së re u zgjatën shumë në kohë, sidomos për shkak të mosmarrveshjeve serbo-kroate në lidhje me krijimin e qeverisë së re.¹ Të gjithë delegatët do të gjenden dakort në miratimin e Kushtetutës së Shen-Vitos e cila do të shënojë edhe krijimin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve në vitin 1918, nën udhëheqjen e mbretit Alessandro Karadjordjević dhe kryeministrit të tij serbo-ortodoks, Pasic.

Jeta e mbretërisë së re nuk do të jetë ne asnje moment e lehtë. Fundi i luftës së parë botërore shënoi një destabilizim më të madhë për Ballkanin Perëndimor. Rënia e dy perandorive dhe gërmadhat që ato lanë pas sëbashku me lojrat e interesave të Fuqive të Mëdha kontribuan në rritjen e nacionalizmit etnik në këtë rajon. Në Zagreb e në Kosovë pati kryengritje të shpeshta për shkak të tendencave favorizuese të kryeministrit Pasic në drejtim të Serbisë, në kundërshtim me principet e Kushtetutës së Shën Vitos. Kryengritje pati edhe në Slloveni për shkak të fushatës mbretërore e cila prekte interesat e minorancave austriake në veri të vendit.

Nga viti 1918 deri në vitin 1928, Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene kaloi shumë kriza qeveritare duke ndërruar rreth 23 kryeministra.² Në vitin 1928, mbreti Aleksandër vendos ta përqëndrojë të gjithë pushtetin në duart e tij. Ai hodhi poshtë Kushtetuten e Shën Vitos dhe shpërndau parlamentin në emër të shpëtimit të mbretërisë. Të gjitha këto u ndoqën nga një sërë reformash shtetërore dhe ekonomike të frymëzuara nga totalitarizmi fashist. Në vitin 1929 ai do të shpallte Mbretërinë e Jugosllavisë e cila do të karakterizohej nga autoritarizmi deri në fundin e luftës së dytë botërore. Në fakt,

1 Keto ferkime serbo-kroate do të karakterizojnë gjithnjë marrëdhëniet ndërmjet këtyre shteteve edhe për faktin e një prezence të fortë të minoritetit serb në Kroaci, në krahinën e Krajina-s.

2 Dicka tjetër që e karakterizoi këtë mbretëri ishte edhe prezenca e ustasheve, kroate të cilët të udhëhequr nga Ante Pavelić, kërkonin një Kroaci të pavarur qysh në atë kohë. Gjate luftës së dytë botërore u bene të njohur aaktet e tyre terroriste dhe raciste edhe ndaj vete popullsisë kroate. Ata besonin se slovene ishin thjeshtë "kroate malesore" ndërsa muslimanet e Bosnjes ishin "kroate që duhej të ktheheshin në rrugën e duhur".

autoritarizmi do të jetë tendenca e të gjithë shteteve të Ballkanit juglindorë. U krijuan monarki të cilat krijuan aleanca ose me fashizmin ose me nazizmin. Ky do të jetë rasti i Shqipërisë me Mbretin Zog, i Rumanisë me mbretin Karol, i Greqisë me gjeneralin Metaksa dhe i Bullgarisë me mbretin Boris.

Këto monarki, në dukje parlamentare, do të influencojnë edhe në krijimin e shtet-kombeve në atë periudhë¹ e njëkohësisht edhe në theksimin e disa tensioneve etnike në rajon. Në rastin konkret, shtyrjet nacionaliste dhe shtet-komb-formuese të mbretërisë jugosllave më të udhëhequra nga nevoja gjithnjë e më e vazhdueshme nga ana e serbëve për predominim, do të vinin seriozisht në rrezik shumë rajone etno-kulturale në Ballkanin juglindorë.

Gjatë luftës së dytë botërore, mbretëria do të dobësohej nga lufta klandestine partizane dhe nga terrorizmi i ustashevë.² Ngjarjet e luftës së dytë botërore qenë të ndryshme dhe komplekse. Jugosllavia u bë fillimisht aletate e boshtit nazist sëbashku me Bullgarinë, Rumaninë dhe Hungarinë, për të ndryshuar më pas drejtim në politikën e jashtme në vitin 1941, duke u afruar me Britaninë e Madhe. Si rrjedhojë trupat gjermane, italiane, hungareze dhe bullgare sulmuan Mbretërinë e Jugosllavisë duke e copëzuar atë midis tyre; Gjermania aneksoi Slloveninë, Italia Kroacinë, Hungaria pjesë të territorit në kufi ndërsa Bullgaria Maqedoninë veriore. Në këtë situatë kaotike, Ante Pavelic gjeti terren të përshtatshëm për të shpallur pavarësinë e shtetit kroat duke ushtruar një politikë raciste shumë të ngjashme me atë naziste. Nga ana tjetër, kaosi dhe përcrja e krijuar e lehtësuan rrugën për marshallin Tito drejt personifikimit si “shpëtimi i popullit jugosllav” në rrjedhën e ngjarjeve së pas luftës së dytë botërore.

Konsequencat historike që do të përcillen në Federatën Jugosllave dhe më pas në konfliktet e viteve '90.

Pas luftës së dytë botërore, figura e Tito-s ishte ajo që personifikoi më së miri vetë idenë e jugosllavizmit dhe të barazisë së popujve sllavë në kuadrin e Republikës Socialiste Federale Jugosllave.³ Me aftësinë e tij politikëbërëse, ai arriti

1 Ne pjesen tjetër të Europës formimi i shtet-kombeve do të marrë jete përafërsisht me shumë se një shekull më parë, kryesisht pas vitit 1789, viti I revolucionit francez. Shtet-kombet evropiane do të karakterizoheshin qysh asokohe nga dhenia e të drejtave civile qytetareve në emer të kombit dhe të integritetit të tij dhe nga zgjerimi i të drejtave ndaj minorancave kombetare, perseri në emer të kombit.

2 Sic është thënë edhe më parë, ustashtet mbronin idenë e një Kroacie të pavarur e dominuese në rajon. Gjate luftës së dytë botërore ata u bënë të njohur për akte çnëzore terroriste të drejtuara si ndaj minorancës serbe ashtu edhe ndaj popullsisë civile kroate. Sic shkruan Krulić, Kroacia e ustashevë ishte shteti evropian që ka masakruar ose ka lënë të masakrohet përqindjen më të lartë të popullsisë së saj. Në Jože Krulić *Storia della Jugoslavia dal 1945 ad oggi*. Milano: Bompiani, 1997.

3 Një veper shumë e plotë mbi këtë argument është edhe Jože Krulić *Storia della Jugoslavia dal 1945 ad oggi*. Milano: Bompiani, 1997. Gjithashtu edhe Sabrina P. Ramet, *Balkan Babel: The Disintegration of Yugoslavia from the Death of Tito to the Fall of Milošević*, 4th ed, Boulder: Westview Press, 2002, Misha Glenny, *The Fall of Yugoslavia, The Third Balkan War*, New York: Penguin, 1992, Stefano Bianchini (a cura di), *Lenigma jugoslavo, le ragioni della crisi*, Milano: Franco Angeli, 1989.

ti siguronte vendin e duhur feve dhe minorancave të ndryshme në gjirin e federatës dhe njëkohësisht edhe një vend neutral të vetë federatës në mes të dy blloqeve. Tito qe shumë i aftë në ruajtjen e një ekuilibri social dhe ekonomik të republikave jugosllave, por pushteti i tij politik identifikohet shumë fort me personalitetin e tij karizmatik¹, ndaj vdekja e tij në vitin 1980 shënoi edhe fillimin e fundit të federatës jugosllave.

Shperberja e kësaj federate nuk mund të kuptohet plotësisht në qoftë se nuk konsiderohet boshti ideologjik i cili mbështillete federatën jugosllave nën udhëheqjen e Titos. Ky bosht përfaqësohet nga Kushtetuta e miratuar në vitin 1963 e cila parashikonte barazinë e popujve, vetëmenaxhimin ekonomik dhe decentralizimin institucional të republikave. Vetëm Kosovës dhe Vojvodinës nuk iu dha statusi i republikës në gjirin e federatës, por ai i provincave autonome, ndërkohe që Mali i Zi gëzonte një sipërfaqe rreth tri here më të vogël se ajo e Kosovës mori statusin e republikës. Kjo binte në kundërshtim me principin e nacionalitetit dhe të barazisë së popujve në gjirin e federatës, por arsyt që shtyn në këtë vendim politik e kishin një bazë. Shumë prej studiuesve e shpjegojnë kështu: përveç prirjeve separatiste që në fund të fundit kishin shfaqur të gjitha fraksionet e federatës, Kosova kishte treguar edhe prirje të bashkimit me Shqipërinë, ndërkohë që një “Shqipëri e Madhe” nuk i interesonte asnjë force kombëtare ose ndërkombëtare në rajon. Ky ishte principi bazë që përdorën arkitektet e kushtetutes jugosllave. Ai u argumentua me faktin që statusi i republikës duhej të jepej kombeve (narodit) dhe jo kombësive (narodnosti). Në grupin e parë bënin pjesë ato entitete që konsideronin si atdhe të tyre Jugosllavinë, ndërsa në grupin e dytë ato që konsideronin si të tillë një shtet jashtë saj.²

Kushtetuta e vitit 1963 u pasua nga një sërë modifikimesh, për të arritur më pas në kushtetuten e vitit 1974 e cila do të zgjeronte pushtetin dhe autonominë si të republikave, ashtu edhe të dy provincave të pavarura. Sistemi politik që krijonte kushtetuta ishte larg federalizmit tradicional dhe shumë pranë një konfederate. Nga njëra anë respektohej nevoja për autonomi e republikave të ndryshme, nga ana tjetër vihej re mungesa në praktikë e disa elemneteve koagulative të cilët do të garantonin unitetin e Jugosllavis në një të ardhme³. Dhe mekanizmi nuk vonoi të bllokohej. Kushtetuta parashikonte zëvendesimin e figurës së Titos pas vdekjes së tij me një organ kolegjal i cili do të përbëhej nga një përfaqësues i çdo republike dhe i provincave autonome, të cilët do të vinin në pushtet me rotacion. Do të ishte pikërisht ky rotacion i cili do të bllokohej keqas në fillim të viteve '90 dhe krahas krizës ekonomike do të sillte edhe krizën e vetë federatës jugosllave⁴.

1 Alessandro Marzo Magno (a cura di) (2001), *La guerra dei dieci anni. Jugoslavia 1991-2001: I fatti, i personaggi, le ragioni dei conflitti*. Milano: Il Saggiatore, fq. 471.

2 Caplan, Richard. “International Diplomacy and the Crisis in Kosovo.” *International Affairs* 74(4): 745-761, October 1998.

3 Tito Favaretto, “Origini e sviluppi della crisi jugoslava: un tentativo di interpretazione”, ne Stefano Bianchini (a cura di), *L'enigma jugoslavo. Le ragioni della crisi*, Milano: Franco Angeli, 1989.

4 Do të jene serbet ata që do të bllokojnë me çdo kusht ardhjen e rradhes në pushtet të kroatit Stipe Mesic, i cili konsiderohej si eksponenti kryesor i nacionalizmit kroat.

Kjo krizë do të fillojë me luftimet serbo-slllovene gjatë vitit 1991 të cilat do të zgjasnin shumë pak kohë. Kjo për faktin e thjeshtë se Sllovenia kishte një popullsi shumë homogjene me një prezence minimale serbe, nuk kishte lidhje tokësore me Serbinë dhe gëzonte mbështetjen e fortë të Gjermanisë e Austrisë. Më pas luftimet do të përcillen në Kroaci për shkak të krahinës së Krajina-s me mazhorancë serbe, për të kulmuar në vitet 1994-1995 në Bosnje Hercegovine ku presidenti serb Miloshevic dhe presidenti kroat Tuxhman do të synojnë ndarjen e Bosnje-Hercegovinës. Në vitin 1999 konflikti serbo-kosovar i filluar qysh në fund të viteve '80 me përndjekje e këqtrajtim të popullsisë kosovare nga qeveria serbe, do të përfundojë me bombardimin e Serbisë nga forcat NATO nën mandatin e OKB-së. Konflikti në Maqedoni do të kulmojë në vitin 2000 si pasojë e përlëshjeve të popullsisë maqedonase e asaj shqiptare. Ai do të ketë si bazë përbërjen shumë-etnike të këtij shteti (sllavë, shqiptarë, turq, bullgarë, rom etj), por konflikti i fund shekullit të XX-të do të bazohet kryesisht në faktin se popullsia shqiptare, e cila në fakt vjen e dyta për nga përqindja pas asaj maqedonase, do të ndihet e këqperfaqësuar në institucionet dhe administratën e këtij shteti pas viteve '90.

Sic shihet nga e kaluara e koklavitur e historise ballkanase, në bazë të këtyre konflikteve qendron nacionaliteti dhe etnia e identifikuar me fenë. *Historia etnike është mallkimi i Ballkanit*, shkruan Noel Malcolm në librin tjetër të tij kushtuar Bosnje-Hercegovinës e cila ka vuajtur një luftë çnjerëzore në territorin e saj. Ai vazhdon duke thënë se *të studiosh historinë e rajonit do të thotë të kuptosh që një politikë moderne e bazuar në origjinë antike, edhe sikur të jetë e drejtë, nuk do të ishte kurrsesi e mundur*¹.

Konkluzione

Viti 1878 quhet si fillimi i periudhës bashkëkohore për Ballkanin. Ky vit përkon me Kongresin e Berlinit i cili shënon edhe fillimin e shpërbërjes së perandorisë osmane pas një jetëgjatësie prej rreth pesë shekujsh në territorin ballkanas, që prej vitit 1453 të rënies së Kostandinopojës e deri në fund të luftës së parë botërore, më 1918. Të gjitha shtetet aktuale të Ballkanit Perëndimor kanë qenë nën influencën e Portës së Lartë, ndërsa Kroacia dhe Sllovenia² nën perandorinë Austro-Hungareze dhe për një periudhë më të shkurtër edhe Bosnje-Hercegovina. Influenca hungareze në Kroaci karakterizohej për një tolerancë më të vogël drejt popullsisë vendase në krahasim me atë austriake në Slloveni të quajtur edhe “austroslavizëm”, duke përmbledhur me këtë term faktin që Austria ka pasur rolin e kombit udhëheqës në jetën sllovene. Megjithatë, nuk duhet harruar fakti që të dyja republikat kanë qenë teatër luftrash dhe konfliktesh që u përgjigjeshin rivalitetit

1 Noel Malcolm, *Storia della Bosnia. Dalle origini ai nostri giorni*, Milano: Bompiani, 1994.

2 Ne kete pike nuk duhet harruar fakti se ne periudhen 1805 – 1809 territoret kroate dhe sllovene u pushtuan nga ushtria e Napoleonit. Ne kete periudhe aty u aplikua jurisdiksioni francez dhe territori quhej me emrin “les provinces illyrienes”, nderkohe qe u krijuan kontaktet e para me barazine civile perpara ligjit e cila qendronte ne baze et ketij jurisdiksioni.

të mbretërisë dykrerëshe austro-hungreze. Nga ana tjetër, lëkundja ndërmjet këtyre dy fraksioneve të perandorisë, kufizoi në mënyrë të konsiderueshme përhapjen e myslimanizmit në këto dy territore duke favorizuar prezencën e katolicizmit në Kroaci dhe përhapjen e reformës protestante në Slloveni. Në Bosnje-Hercegovinë u përhap në mënyre masive islamizmi, ndoshta si përgjigje ndaj konvertimit masiv të *bogomileve*¹ në këtë territor, ndërsa në Serbi-Mal të Zi islamizmi u përhap në mënyrë shumë të reduktuar për shkak të rrënjëve të thella të fesë ortodokse në kulturën dhe historinë e kësaj popullsie. Megjithatë, bazë për kontrollin e territorit në shtetet ballkanike ka qenë gjithnjë “zotërimi kombëtar”, i cili nga njëra anë influenconte popullin mbizotërues të secilit rajon ti shihte të tjerët si ndërhyrës apo pushtues, ndërsa nga ana tjetër influençoi në mënyrë të konsiderueshme kalimin nga kontrolli fetar në atë laik në nivelin qeverisës.²

Le ti rikthehemi paksa republikave nën influencën e perandorisë osmane. Pesë shekuj nën këte perandori kanë lënë gjurmë të pakthyeshme në Ballkanin Perëndimor, duke pasur parasysh prapambetjen e sistemit feudal të kësaj perandorie. Një historian i studimeve orientale shkruante që në fund të viteve ‘700, prapambetja ekonomike e Ballkanit perëndimor nuk mund të krahasohej me asnjë shtet tjetër evropian, as me provincat më të prapambetura të perandorisë austro-hungareze.³ Në këtë sens, Kroacia dhe Sllovenia ekonomikisht dhe institucionalisht do të jenë një hap më përpara që në atë kohë, ndërsa Bosnje-Hercegovina (në mes të dy perandorive), Maqedonia dhe Serbia në perandorinë osmane do të kenë më pak mundësi të bien në kontakt me pjesën tjetër të Europës, me risitë e revolucionit francez e idetë iluministe. Megjithatë, faktori ekonomik mbetet më decisivi sesa ai politik. Në të njëjtin përfundim kanë arritur edhe dy studiuesit e Ballkanit Perëndimor Jelavich të cilët i përshkruajnë shtetet ballkanase pas periudhës osmane pa një klasë të mesme të gatshme për të influencuar vendimarrjen dhe pa një qeveri në gjendje të taksonte popullsinë tejet të varfëruar dhe të tërhiqte kapital të mjaftueshëm të huaj për investim.⁴ Kësaj shtate i shtohet edhe skarsiteti në bujqësi, tokat e djerra si rezultat i largimit të popullsisë për shkak të rrëmujës që po shoqëronte dobësimin gjithnjë e në rritje të Portës së Lartë, epidemite dhe luftat. Shumë fshatarë braktisnin territoret fushore në drejtim të perandorisë habsburge, të kodrave ose të pyjeve. Si rrjedhojë, aktiviteti kryesor i këtyre vendeve në shekullin XVII u bë bujqësia.⁵

1 Bogomilet janë një sekt i konsideruar si heretik nga autoritetet krishtere. Ky sekt lindi rreth shekullit të X-te dhe u përhap në Ballkan nga shekulli XII, sidomos në Bosnje-Hercegovinë. Disa autore ia atribuojnë presencën se këtij sekt konvertimin masiv në muslimanë të boshnjakeve, por ka debate të ndryshme mbi këtë argument.

2 Charles dhe Barbara Jelavich. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit, 1804 – 1920*, Tirane: Dituria 2004, fq 294-300.

3 Guido Franzinetti. *I Balcani: 1878-2001*. Roma: Carocci Editore, 2001, fq. 56.

4 Charles dhe Barbara Jelavich. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit, 1804 – 1920*, Tirane: Dituria 2004, fq 294-300.

5 John R. Lampe, “Varieties of Unsuccessful Industrialization: The Balkan States Before 1914”, *Journal of Economic History*, Vol. 35, No. 1, The Tasks of Economic History (Mar., 1975).

Vartësia e shteteve ballkanike nga faktori ndërkombëtar u vu re në mënyrë të theksuar që nga fillimi i dy luftimeve botërore e deri në fund të tyre. Fuqitë e mëdha jo vetëm kanë përcaktuar kufijtë territoriale të vendeve ballkanike, por edhe kanë influencuar në krijimin e monarkive kushtetuese në këto vende. Po këta studiues bëjnë një vëzhgim shumë interesant kur thonë se ai lloj regjimi përfaqësonte një udhë të mesme ndërmjet dëshirave të perandorive Habsburge dhe Ruse për regjime konservatore dhe atyre të Francës dhe Britanisë për forma me regjimi më liberalë.¹

Pas konsumimit të historisë në lufta e konflikte etnike pa fund të këtyre shteteve, u dukë sikur hasmëritë e vjetra gjetën njëfarë paqe nën Jugosllavinë e Tito-s, i cili diti me shumë mjeshtri ti lëmonte ato. Pas vdekjes së tij gjërat ndryshuan, por ndërkohë Tito i kishte lënë trashëgim këtij territori një ndarje territoriale në mënyrë të tillë që nacionalitetet të mos përkonin me kufijtë e republikave duke sjellë konfliktet e luftat e viteve '90 të shpjeguara më sipër. Për ironi të fatit, pikërisht në një rajon ku etniciteti dhe nacionalizmi zënë një vend parësor në kulturën e një populli, nuk do të zbatohen dy prej doktrinave mbizotëruese të shekullit të XX-të; ajo e së drejtës së popujve për vetëvendosje dhe ajo e barazisë së shteteve përballë së drejtës ndërkombëtare. Edhe sot e kësaj dite, Kosova është shembulli më i mirë dhe testi më i pastër se si komuniteti ndërkombëtar mund të transformojë një shoqëri pa eksperiencë në institucionet shtetërore në një shtet që funksionon, por rruga drejt njohjes së pavarësisë nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar duket akoma e gjatë.

Tre fjalët kyce të cilat mund të shpjegojnë konfliktet ballkanike, përveç faktorit ekonomik dhe atij të jashtëm, janë: nacionalizëm, konflikte etnike dhe elite politike jo-efektive. Nacionalizmi ishte ai që solli bashkimin e Italisë më 1861, atë të Gjermanisë më 1871 dhe shpërbërjen e perandorisë Austro-Hungareze më 1918. Ky proces ishte i sukseshëm aty ku qeveritë dhe elitat qeverisëse ishin të konsoliduara dhe popullsia nuk ishte thellësisht e ndarë², të dy këto elemente që mungojnë në background-in historik të Ballkanit Perëndimor. Kur nacionalizmi mbështetet edhe nga etniciteti, atëherë përzierja bëhet akoma më e rrezikshme. Një nga argumentet me të cilat Milosheviçi arriti të mobilizonte mbështetjen publike të popullit të tij në luftën kundër Kroacisë ishte kujtimi i krimeve të ustasheve kroate ndaj minorancës serbe gjatë luftës së dytë botërore dhe rievokimi i mitit të betejës së Kosovës e të djepit të kulturës ortodokse serbe në Pejë. Mitet e shkëputura nga e kaluara bëhen lehtësisht simbole rreth të cilave mobilizohen grupet etnike, duke legjitimuar dhunën ndër-etnike³. Këto dy faktorë nuk arrijnë të tejkalohen nga elitat politike, roli i të cilave është ai i neutralizimit të faktorëve destabilizues. Në fakt, elitat politike ballkanase janë karakterizuar gjithnjë për nga dhënia e përparësisë ndaj interesit personal në drejtimin e zgjerimit të bazës

1 Charles dhe Barbara Jelavich. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit, 1804 – 1920*, Tiranë: Dituria 2004, fq 294-300.

2 Marina Ottaway, "Nation Building", *Foreign Policy*, No. 132, (Sep. – Oct., 2002)

3 Frank P. Harvey, "Primordialism, Evolutionary Theory and Ethnic Violence in the Balkans: Opportunities and Constraints for Theory and Policy", *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*, Vol. 33, No. 1 (Mar., 2000).

së pushtetit që i ushqen e jo nga principi i “të mirës së përgjithshme”, kjo ndoshta për faktin se u është dashur gjithnjë të mbijetojnë në një ambient kaq agresiv e të luhatshtëm si ai i mozaikut të komplikuar ballkanik. Prandaj, dobësimi i pushtetit qendror i cili sjell gjithnjë një situatë pothuajse revolucionare pasi përcjell pasiguri ndërmjet një grupi kompakt e të mirëpërcaktuar dhe qendrës¹ do të jetë gjithnjë fatal për shtetet ballkanike. Në rastin e Ballkanit Perëndimor, grupet e mirëpërcaktuara të cilave u luhaten interesat dhe privilegjet do të jenë jo vetëm pakicat kombëtare, por edhe elitat të cilat do të heqin dorë shumë shpesh nga roli i tyre drejtues.

Jo më kot, eksperiencia ka treguar se nga të gjithë vendet në tranzicion, ai i vendeve të Ballkanit Perëndimor ka qenë më i vështiri, ndoshta për shkak se këto vende e kanë pasur shumë të vështirë shpëputjen nga hijet e së kaluarës. Një prej arsyeve mund të jetë edhe fakti se akoma nuk është verifikuar një zëvendësim i plotë i elitave drejtuese. Në disa ambiente ekziston akoma nomenklatura e vjetër, ndërkohë që akoma nuk është kryer një studim dhe një përpunim kritik i së kaluarës komuniste ndërkohë që dominon një mentalitet populist dhe etnonacionalist. Rekuperimi i një mentaliteti evropian në drejtimin e institucioneve demokratike dhe e shtetit të së drejtës, duket akoma i vështirë.

Sipas tezave provokuese të Huntington, popujve të Ballkanit juglindor të cilët kanë qenë nën sundimin osman u mungojnë disa “arritje” të qytetërimit evropiano-perëndimorë si për shembull feudalizmi, rilindja, iluminizmi, revolucioni industrial e ai francez². Disa historianë e kanë quajtur Ballkanin si “Europa antike”, pra ajo pjesë e Europës ku historia ka filluar rreth dy mijë vjet më parë. Është interesant një këndvështrim tjetër i cili e quan territorin ku ka dominuar perandoria romake e lindjes pikërisht si vendi ku është prodhuar ajo sintezë ndërmjet antikitetit klasik dhe krishtëritimit nga njëra anë dhe e kulturës greke e traditës shtetërore romake nga ana tjetër, elementë këto që në fund të fundit janë në bazë të identitetit evropian.³

Në ditët e sotme duket sikur i vetmi qëllim i përbashkët i vendeve të Ballkanit Perëndimor është integrimi në Bashkimin Evropian. Pjesa gri e hartës së Europës kërkon të lyhet me blu, por rruga duket shumë e gjatë dhe me shumë pengesa. Përveç problemeve ekonomike, këto vende karakterizohen edhe nga probleme të njëjta sociale si korrupsioni dhe favoritizmat të cilat reflektohen edhe në institucionet e brishta demokratike të këtyre vendeve. Vendet e Ballkanit Perëndimor kërkojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian, jo vetëm sepse ndjehen pjesë e identitetit evropian, por edhe ndoshta sepse shohin në këtë institucion supranacional të vetmin subjekt ndërkombëtar të cilit do të mund ti besonin një pjesë të sovranitetit të vetë. Nuk duhet harruar që këto vende kanë përjetuar luftën, masakrat dhe terrorizmin mbi bazë etnike dhe vetëm nën çatinë evropiane do të mund të harronin ose të kalonin, ashtu sic ndodhi me Francën dhe Gjermaninë pas luftës së dytë botërore.

1 Charles Tilly, “States and Nationalisms in Europe”, *Theory and Society*, Vol. 23, No. 1 (Feb., 1994).

2 Samuel P. Huntington, *Lo scontro delle civiltà e il nuovo ordine mondiale*. Milano: Garzanti, 2000, fq.86.

3 Edgar Höscher, *Storia dei Balcani*, Bologna: Il Mulino, 2006, fq. 92.

Bibliografia

- Hösch E., (2006). *Storia dei Balcani*. Bologna: Il Mulino.
- Hösch E., (2005). *Storia dei paesi balcanici. Dalle origini ai nostri giorni*. Torino: Einaudi.
- Franzinetti G., (2001). *I Balcani: 1878-2001*. Roma: Carocci Editore.
- Malcolm N., (2000). *Storia della Bosnia: dalle origini ai nostri giorni*. Milano: Bompiani.
- Malcolm N., (1999). *Storia del Kosovo. Dalle origini ai nostri giorni*. Milano: Bompiani.
- Pirjevec J., (1995). *Serbi, croati, sloveni. Storia di tre nazioni*. Bologna: Il Mulino.
- Castellan G., (1991), *Storia dei Balcani. XIV-XX secolo*. Lecce: Argo.
- Magno A. M., (a cura di) (2001), *La guerra dei dieci anni. Jugoslavia 1991-2001: I fatti, i personaggi, le ragioni dei conflitti*. Milano: Il Saggiatore.
- Krulić J., (1997), *Storia della Jugoslavia dal 1945 ad oggi*. Milano: Bompiani.
- Lampe J., (1996), *Yugoslavia as history. Twice there was a country*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Huntington S.P., (2000), *Lo scontro delle civiltà e il nuovo ordine mondiale*. Milano: Garzanti.
- Oliver I., (2005), *War & Peace in The Balkans. The Diplomacy of Conflict in the Former Yugoslavia*. London : I.B. Tauris.
- Silber L., Little A., (1996), *Yugoslavia. Death of a Nation*. New York : TV Books, Inc.
- Caplan, Richard. "International Diplomacy and the Crisis in Kosovo." *International Affairs* 74(4): 745-761, October 1998.
- Robert Bideleux, Ian Jeffries, *The Balkans. A Post-Communist History*, New York: Routledge, 2007.
- Akademia e Shkencave e Shqiperise, Instituti i Historise, *Beteja e Kosoves 1389 (permbledhje studimesh)*, Tirane: Mesonjtorja, 2005.
- Misha Glenny, *The Balkans 1804-1999. Nationalism, War and the Great Powers*, London: Granta Books, 1999.
- Charles dhe Barbara Jelavich. *Themelimi i shteteve kombetare te Ballkanit, 1804 – 1920*, Tirane: Dituria 2004, fq 294-300.
- Elizabeth Pond, *Endgame in the Balkans. Regime Change, European Style*, Washington, D. C: Brookings Institution Press, 2006.
- Stefano Bianchini (a cura di), *L'enigma jugoslavo. Le ragioni della crisi*, Milano: Franco Angeli, 1989.
- Stanford J. Shaw "The aims and achievement of ottoman rules in the Balkans", *Slavic Review*, Vol. 21, No. 4, (Dec., 1962).
- Marina Ottaway, "Nation Building", *Foreign Policy*, No. 132, (Sep. – Oct., 2002)
- Frank P. Harvey, "Primordialism, Evolutionary Theory and Ethnic Violence in the Balkans: Opportunities and Constraints for Theory and Policy", *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*, Vol. 33, No. 1 (Mar., 2000).
- Charles Tilly, "States and Nationalisms in Europe", *Theory and Society*, Vol. 23, No. 1 (Feb., 1994).
- John R. Lampe, "Varieties of Unsuccessful Industrialization: The Balkan States Before 1914", *Journal of Economic History*, Vol. 35, No. 1, The Tasks of Economic History (Mar., 1975).
- Tim Judah, *The Serbs: History, Myth and the Destruction of Yugoslavia*, New Heaven: Yale University Press, 1997.
- Sabrina P. Ramet, *The Three Yugoslavias: The Dual Challenge of State-Building and Legitimation among the Yugoslavs, 1918—2004*, Bloomington, Ind. & Washington D.C: Indiana University Press & The Wilson Center Press, 2006.
- Sabrina P. Ramet, *Balkan Babel: The Disintegration of Yugoslavia from the Death of Tito to the Fall of Milošević*, 4th ed, Boulder: Westview Press, 2002.
- Misha Glenny, *The Fall of Yugoslavia, The Third Balkan War*, New York: Penguin, 1992,

Politika e jashtme e Rusisë: Në kërkim të identitetit

Enri Hide¹

ABSTRAKT. *Lufta e gushtit 2008 midis Rusisë dhe Gjeorgjisë nxjerr në pah dy aspekte të politikës së jashtme ruse: qëllimet politike ruse në ish-hapësirën sovjetike, të lidhura ngushtë me vizionin e kabershëm gjeopolitik rus që ka përshkuar të gjithë shekullin e njëzetë, atë të dominimit të Rusisë në të ashtuquajturin “brez jetik të sigurisë ruse”; dhe kontekstin më të gjerë ndërkombëtar: mënyrën se si Rusia post-sovjetike e sheh veten e saj në sistemin ndërkombëtar, veçanërisht në marrëdhëniet e saj me aleancën perëndimore. Eseja që vijon do të ravigëzohet pikërisht drejt hulumtimit të këtyre dy shtyllave bazë konceptuale të politikës së jashtme ruse. Në këtë rrugëtim të tij, artikulli do të ngërthejë vazhdimisht gjeostrategjinë globale dhe vërtetimin empirik, duke i ndërthurur këto dy parametra bazë të analizës së marrëdhënieve ndërkombëtare, për të prodhuar një përjasje sa më reale dhe më konkrete, për ta parë botën ashtu siç është, e jo siç duhet të jetë.*

Hyrje

Këtë dhjetor do të shënohen 17 vjet nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik. Është e pamundur të analizohet sjellja e Rusisë në politikën e jashtme pa përmendur pritshmëritë jorealiste të liderëve të Rusisë nga arena ndërkombëtare në vitet e fundit përpara shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe menjëherë pas saj. Gorbaçovi, pasardhësi i tij Jelcin dhe qarqet e këshilltarëve të tyre e bazuan politikën e tyre të jashtme mbi premisa që rezultuan menjëherë dhe krejtësisht të keqllogaritura.² Ideja e tyre fillestare ishte se sapo të arrihej dhe të ruhej barazia

- 1 Autori është pedagog i brendshëm i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Evropian të Tiranës. Ai është MSc në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Strategjike”, si dhe MA në “Marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me Vendet në Zhvillim” (Universiteti “Panteion”, Athinë), pasi është diplomuar në fushën e “Marrëdhënieve dhe Organizatave Ndërkombëtare”. Fushat e tij të kërkimit shkencor përfshijnë, midis të tjerave, gjeostrategjinë dhe gjeopolitikën globale, teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare, çështjet e sigurisë ndërkombëtare si dhe terrorizmin ndërkombëtar.
- 2 Në lidhje me perceptimet dhe keqperceptimet në politikën e jashtme dhe vizionet e lidhshme të fuqive të mëdha, shih Robert Jervis, “Perceptions and Misperceptions in International Politics”, Princeton, NJ: Princeton University Press, viti 1976, ff. 7-9, për më përgjithësisht shih Kapitujt 1, 6 dhe 9.

strategjike midis Ruisë dhe Shteteve të Bashkuara, do të garantohej automatikisht edhe statusi ndërkombëtar i Ruisë si një superfuqi e barabartë me Shtetet e Bashkuara – madje kjo do të ndodhte në një epokë pa përplasje globale. Traktati i Parë i Armëve Strategjike (i njohur si START-1),¹ i nënshkruar vetëm pak ditë pas grushtit të pasuksesshëm të shtetit në Kremlin –katër muaj përpara kolapsit total të Bashkimit Sovjetik–, rikodifikoi barazinë strategjike midis dy superfuqive, pas një shkurtimi të madh të ndërsjellë të rezervave respektive të armëve bërthamore.

Në këto kushte, Kozyrev, ministri i jashtëm i qeverisë Jelcin deri në vitin 1996, përpigje në mënyrë konstante të krijonte përfytyrimin imagjinar se Rusia dhe Shtetet e Bashkuara përbënin liderët kyç të rendit të ri botëror.² Por, siç e provoi historia e Pasluftës së Ftohtë, Kozyrev ishte gabuar rëndë. Kur Rusia u zgjua pas kolapsit të perandorisë sovjetike, e pa veten të ngërthyer në një realitet krejt të ndryshëm ndërkombëtar prej atij të imagjinuar nga liderët e saj. Megjithëse ajo mbetej “i vetmi vend në botë në gjendje të shkatërronte Shtetet e Bashkuara”³, nëse faktorizoheshin të gjithë indikatorët e tjerë të fuqisë, Rusia binte në vendin e katërt (ose në të pestin, në rastin më të mirë), midis fuqive me aftësi globale politikëprodhimi (sigurisht pas SHBA, Bashkimit Evropian dhe Kinës).⁴ Në mungesë të mundësisë për ndonjë përplasje eventuale ushtarake globale pas Luftës së Ftohtë, si dhe për shkak të spiralit tatëpjetës të ekonomisë ruse⁵, pretendimi rus për të qenë superfuqi dukej tepër patetik, qoftë edhe për vëzhguesin më të thjeshtë të politikave globale.

Liderët rusë filluan të kuptonin me kalimin e viteve se realiteti ndërkombëtar po i largohej me shpejtësi vizionit gjeopolitik dhe atij të sigurisë të përfytyruar nga “baballarët” e Ruisë post-sovjetike. Prandaj, përpara tyre u shfaq domosdoshmëria e një ri-vlerësimi dhe rikonfigurimi të prioritetëve ruse, duke këmbyer në politikën e jashtme qendërsinë e qasjes globale (dhe të dominimit euroaziatik⁶) me atë të fokusimit fillimisht në brezin e menjëhershëm jetik, atë të Rimlandit rus. Ideologu i versionit të ripërpunuar të doktrinës gjeopolitike ruse ishte Evgjëni Primakov, i cili në vitin 1996 zëvendësoi Kozyrev-in si ministër i jashtëm. Në kujtimet e tij Primakov shpjegon se,

- 1 Traktati për Pakësimin e Armëve Strategjike (START-1), synonte pakësimin e rezervave të armëve strategjike të superfuqive në masën 30 për qind të Luftës së Ftohtë. Ndërsa START-2 (1992) hodhi idenë e shkurimit të armëve të mbetura në më shumë sesa gjysma e tyre për dhjetëvjeçarin që vijonte.
- 2 Për më shumë rreth këtij vizioni shih Andrei Kozyrev, “*The Lagging Partnership*”, Foreign Affairs Vol. 73, No. 3 (1994).
- 3 Shih Richard Nixon, “*How to Lose a Cold War*”, New York Times, Mars 19, 1992.
- 4 Në lidhje me kuptimin e fuqisë dhe indikatorët e saj, shih Hans Morgenthau, “Politika midis Kombeve”, AIIIS – për botimin në shqip, Tiranë 2008, Kapitulli 3.
- 5 E cila në fillim të viteve 1990 arriti në një shifër mjaft të ulët PBB-je (Produkti të Brendshëm Bruto), rreth 250 miliardë USD. Shih <http://indexmundi.com/russia/gdp.html>. Konsultuar për herë të fundit në 2 dhjetor 2008.
- 6 Koncepti gjeopolitik i Euroazisë ka hyrë herët në terminologjinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe mund t’i atribuohet studiuesve të hershëm të gjeopolitikës në gjysmën e parë të shekullit të njëzetë. Për të mund të shihni më gjerësisht: Nicholas Spykman, “*The Geography of Peace*”, Harcourt, Brace and Co., botimi i parë 1944. Spykman përdor i pari termin *Rimland*, për t’iu adresuar brezit unazor të tokës që gjendet përreth *Hearland* (zembrës së tokës). Kjo e fundit përdoret prej Sir Halford Mackinder, “*The Round World and the Winning of the Peace*”, Foreign Affairs, Vol. XXI, Korrik 1943, f. 601.

përpara se ai të merrte postin, Moska e kishte pranuar idenë se marrëdhëniet ruso-amerikane mund t'i ngjanin modelit të marrëdhënieve të SHBA me Gjermaninë dhe Japoninë pas Luftës së Dytë Botërore, kur këto kombe të mposhtura në luftë u bënë aleatët e rinj të Uashingtonit. Sipas Primakov-it një partneritet i tillë midis Ruisë dhe Perëndimit ishte totalisht i papranueshëm¹, prandaj politika e jashtme ruse nën lidërshpin e tij u bë e ashpër dhe më kërkuese. Rikonceptimi i ri i politikës së jashtme pranoi faktin se shumë prej interesave ruse përkonin me ato të Shteteve të Bashkuara, duke kuptuar se ekzistonin disa fusha ku interesat e të dyja vendeve ishin në kundërshtim të dukshëm mes tyre.

Gjatë këtyre viteve riorientimi i marrëdhënieve të Ruisë me jashtë ka krijuar një prirje në shumë studiues për ta interpretuar politikën e jashtme ruse si në një gjendje të vazhdueshme tensioni midis dy prirjeve të ndryshme: asaj rajonale *vis-à-vis* asaj ndërkombëtare.² Ky lloj teorizimi paraqet argumentin se, pas përmbysjes së regjimit komunist totalitar, Rusia është rrekur vazhdimisht të gjejë identitetin e saj të ri si komb, duke u lëkundur midis mëdyshjes së “përkatësisë lindore dhe perëndimore”³. Por, në 31 dhjetor 1999, një ditë përpara ngjites së tij në pushtet, kryeministri Putin shkroi se: “Nuk ka për të ndodhur kurrë, edhe pse besoj se s’ka ndodhur asnjëherë, që Rusia të bëhet varianti i dytë i Shteteve të Bashkuara, i Britanisë së Madhe, apo i kujtqo qoftë... Për rusët një shtet i fuqishëm nuk përbën një anomali prej të cilës duhet të çlirohemi. Përkundrazi, rusët e shohin atë si garantuesin e rendit, iniciatorin dhe forcën kryesore udhëheqëse të çfarëdolloj ndryshimi”⁴. Reagimi agresiv rus ndaj ofensivës gjeorgjiane në Osetinë e Jugut vërtetoi pikërisht qasjen e dytë, atë të shpallur prej presidentit Putin në fjalimet kur sapo erdhi në pushtet, duke bërë të rilind debati publik dhe akademik rreth ecjes ose jo të Ruisë dhe Perëndimit nëpër të njëjtin monopati interesash globale.⁵

Tashmë po duket gjithnjë e më qartë se koncepti i politikës ruse, si e luhatur midis orientimeve të ndryshme, është i ndryshkur. Deri-diku, vetë kjo qasje përbën një reminishencë të një qasjeje interpretative epistemike të mbetur nga Lufta e Ftohtë dhe pasqyron një mungesë të të kuptuarit të rrethanave aktuale. Siç e dëshmojnë të dhënat, shumica e popullsisë ruse nuk e shohin vendin e tyre si pjesë të Perëndimit: madje ata

1 Shih Yevgeny Primakov, “*Russian Crossroads: Toward the New Millennium*”, New Heaven: Yale University Press, 2004, ff. 126-7.

2 Shih Zbigniew Brzezinski, “*The Great Chessboard*”, NY: Basic Books, 1997, Kapitulli 4.

3 Shih Henry Kissinger, “Does America Need a Foreign Policy”, US: Simon & Schuster Inc., 2001, ff. 74-79. Gjithashtu, për më gjerë, shih: R. H. Donaldson dhe J. L. Noguee, “*The Foreign Policy of Russia*”, Londër: M. E. Sharpe, 2005, Kapitulli 5.

4 Shih Vladimir Putin, “Russia at the Turn of the Millenium”, 31 Dhjetor 1999, cituar në “Henry Kissinger, “Does America Need a Foreign Policy”, US: Simon & Schuster Inc., 2001, f. 75.

5 Putin i riafirmoi në mënyrën më eksplicite traditat perandorake ruse në fjalimin që do inaugurate ngjitjen e tij në pushtet, në maj 2000, në të cilin shprehej se: “Duhet ta njohim historinë tonë, të dimë se cila ishte vërtetë ajo, të nxjerrim mësimë prej saj dhe të kujtojmë gjithmonë ata që e krijuan shtetin rus, që u bënë flamurtarë të dinjitetit të tij dhe që e shndërruan atë në një shtet të madh e të plotfuqishëm.”. Shih fjalimin inaugurate të presidentit Putin, 7 maj 2000. Shih gjithashtu “*Russia’s National Security Concept*”, Janar 2000, në Arms Control Today, Janar/Shkurt 2000, f. 18.

nuk kanë as vetëdijen e përkatësisë në “familjen e popujve perëndimorë” dhe as shfaqin ndonjë aspiratë për t’u përfshirë në to.¹ Kjo ndjenjë ka qenë gjithnjë e pranishme midis rusëve dhe nuk ka gjasa të ndryshojë në të ardhmen. Megjithëse gjatë viteve 1990 aleanca euroatlantike i ka shtrirë shpeshherë dorën me dashamirësi Ruisë (ndër të cilat ia vlen të përmendim përfshirjen në G-8; bashkëpunimin e zgjeruar midis Ruisë dhe NATO-s; përfshirjen në Kuartet; ndihmë financiare, pavarësisht nëse kjo u konsiderua nga rusët si e papërshtatshme; etj.), vendet e aksit strategjik euroatlantik nuk e kanë konsideruar asnjëherë Ruisë si “*djalin* e tyre plëngprishës”. Natyrshëm, anëtarësimi i Ruisë në NATO dhe në Bashkimin Evropian nuk duket as në horizontin e të ardhmes. Kjo do të thotë që ndoshta ndjenja e ftohjes dhe largimit është e ndërsjelltë.

Situatën aktuale mund të përpiqemi ta kuptojmë nën një perspektivë historike disa qindra vjeçare, kur Rusia u shkëput dyfish nga trangu i qytetërimit evropiano-perëndimor, fillimisht me ndarjen midis kishës Katolike dhe Ortodokse, e pastaj me pushtimin tataro-mongol të saj në shekujt 13-15. E pranueshme mund të ishte edhe një qasje psikoanalitike, e përqendruar në frustrimin dhe poshtërimin e egos së Ruisë si një komb i madhërishtë, i dalë fitimtar nga Lufta e Dytë Botërore, por i mposhtur në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë nga SHBA, kundërshtari i saj më i madh.

Këto qasje analitike kanë kufijtë e tyre interpretativë, por ajo çka është edhe më e rëndësishme të kuptohet se çfarë ndodhi pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik që e bëri brezin aktual të lidërshiptit dhe opinionit publik rus ta shoh me mosbesim të tillë Perëndimin. Parimet e reja që udhëhoqën sjelljen ruse që prej vitit 1996 në marrëdhëniet ndërkombëtare po konsolidohen pas vitit 2000. Ato përbëjnë në thelb të vetmin ndryshim real në doktrinën ruse të strategjisë ndërkombëtare. Megjithatë ndër vite mund të vërehen edhe nuanca të tjera sjelljeje gjeopolitike (ku mund të përmendim miratimin që dha Putin për një “prani të përkohshme amerikane” në Azinë Qendrore, bazuar në interesin e përbashkët për të luftuar terrorizmin islamik që buronte nga Afganistani, me kusht sigurisht që SHBA dhe Perëndimi në përgjithësi të mos ndërhynte në punët e brendshme ruse, sidomos në krizën Çeçene, të cilës këto vitet e fundit iu dha herë pas here një ngjyrim i theksuar ekstremist fetar nga ana e propagandës zyrtare dhe gjysmë-zyrtare ruse).

Putin nuk e vuri kurrë në dyshim vlefshmërinë e doktrinës strategjike të 1996-ës, duke iu rikthyer bindjes historike gjeopolitike të Ruisë, sipas të cilës kërkohet: minimalisht garantimi i brezit jetik të vendeve fqinje, për t’u siguruar nga sulme të drejtpërdrejta të jashtme dhe influencat perëndimore gjeostrategjike; kurse maksimalisht rikthimi i aurës së dikurshme perandorake dhe statusi i superfuqisë dominuese [ose *quasi* dominuese] në Euroazi. Sipas Zbigniew Brzezinski-t: “...tre ishin zgjedhjet gjeostrategjike që iu shpallën Ruisë në vitet 1990: a) t’i jepte përparësi një “marrëdhënieje të pjekur strategjike midis partnerësh” me Shtetet e Bashkuara, mendim i cili fitoi disi terren në fillim të viteve 1990, dhe që do përbënte kusht të domosdoshëm përcaktues të bashkëdominimit global; b) të përqendronte interesin e saj në “brezin jetik”, duke zëvendësuar

1 Siç dëshmohet nga sondazhet e shumta të opinionit publik, në fillim të shekullit të njëzetënjë. Shih YLC (Yuri Levada Center) Press-Release: 6 dhjetor 2001; dhe 3 nëntor 2004, <http://www.levada.ru/eng>.

kontrollin perandorak të sovranitetit me kontroll dhe integrim ekonomik, i cili mund të formësojë, në kushtet e globalizimit, një dinamikë fuqie më të aftë të balancojë fuqinë e SHBA dhe të Evropës; c) të krijojë ndonjë formë kundër-aleance euroaziatike antiamerikane, me qëllim përçarjen e dominimit amerikan në “Ishullin e Botës”.¹ Ndër to, duket qartazi se zgjedhja që u bë ishte e dyta, duke i bashkëngjitur asaj një formë të lehtë kundër-aleance balancuese me Kinën, si dhe një tjetër alternativë, të cilën Brzezinski nuk e përmend, atë të rimëkëmbjes së imazhit të superfuqisë, sidomos pas luftës së kësaj vere kundër Gjeorgjisë.

Rusia dhe territoret e ish-Bashkimit Sovjetik

Ndonëse shpërbërja e perandorisë sovjetike i dha një goditje e madhe egos nacionaliste ruse, sot vështirë se gjen ndonjë element të përmalluar brenda klasës politike ruse për “ditët e dikurshme të lavdishme”, kur hegjemonia e Moskës shtrihej nga lumi Elba në Gjermani, deri në Bullgari në Evropën Jugore. Të paktë janë ata sot që ëndërrojnë ende ripërtëritjen e zotërimeve perandorake ruse në këtë rajon. Nga ana tjetër, mospranimi i humbjes së sundimit mbi republikat perëndimore të Bashkimit Sovjetik (veçanërisht Ukrainës), në Kaukaz dhe në Azinë Qendrore, është mjaft intensiv dhe nuk është dobësuar aspak. Elita politike (madje edhe opinioni i gjerë publik) vazhdon ta shohë humbjen e këtyre territoreve si një katastrofë kombëtare e shkallës më të lartë, duke mos e pranuar kurrë atë, si emocionalisht ashtu dhe intelektualisht.² Gjithashtu nuk mund të lihet pa u përmendur fakti se shpërbërja e Bashkimit Sovjetik nuk ishte paqësore: ajo solli pesë luftëra civile (një në Moldavi, dy në Gjeorgji, një midis armenëve e azerëve, dhe një në Taxhikistan). Prej tyre mbetën të vrarë njëqind mijë njerëz, gjysmë milionë të plagosur dhe miliona të tjerë të pastrehë.³

Në çdo rast që i jepet Rusia përsërit qartazi se njëmbëdhjetë republikat e ish-Bashkimit Sovjetik⁴ janë prioriteti më i lartë i interesit të saj kombëtar. Por kjo listë nuk përfshin vendet baltike. Sa herë që përmendet sjellja politike ruse ndaj republikave të reja, qasja e Moskës është mjaft pragmatiste, gjithmonë në përsiatje të objektivave realistë. Rasti më i fundit është ai i luftës kundër Gjeorgjisë për kontrollin e Osetisë së Jugut, ku rusët arritën të shfrytëzojnë masat e keqlloraritura dhe aspak të matura të presidentit gjeorgjian. Rusia lëshoi një ofensivë ushtarake dhe njohu pavarësinë e Osetisë së Jugut, por njëkohësisht

1 Shih Zbigniew Brzezinski, *The Great Chessboard*, versioni i përkthyer në gjuhën greke, Shtëpia Botuese Libani, 1997, Athinë, f. 173.

2 Madje Putin ka pohuar dikur se ky zhvillim është një fatkeqësi me proporcione historike, duke iu referuar asaj si një “katastrofë” (fjala për të cilën në rusisht është sinonimi i “holokaustit”). BBC – 25 Prill, 2005. Teksti i plotë i deklaratës mund të gjendet në arkivat e BBC-së, <http://www.bbc.com>.

3 Shih artikullin e Emil A. Pain, *Contagious Ethnic Conflicts and Border Disputes Along Russia's Southern Flank*, në vëllimin e edituar nga Rajan Menon et al, “Russia and the Caucasus and Central Asia”, Nju Jork: M. E. Sharpe, 1999.

4 Ukraina, Bjellorusia, Moldavia, Gjeorgjia, Armenia, Azerbajxhani, Turkmenistani, Uzbekistani, Kazakistani, Kirgistani dhe Taxhikistani.

shmangu pushtimin e kryeqytetit Tbilisit dhe të territoreve të gjera gjeorgjiane. Jo se këto të fundit nuk ishin brenda mundësive ushtarake ruse, porse me to do të ishte kaluar çdo linjë e kuqe ndërkombëtare si në terma politikë ashtu dhe ushtarakë. Njëkohësisht, politikëbërësit në Moskë kanë besuar gjithnjë se republikat e reja, për shkak të përmasave të tyre të vogla (me përjashtim ndoshta të Ukrainës) dhe afrimitetit territorial gjeografik me gjigandin rus, nuk kanë shumë opsione ekonomike dhe politike, përveçse të tërhiqen brenda sferës së influencës ruse, si përmes strategjive të tilla si ato të kamxhikut e karotës¹, ashtu dhe përmes përdorimit *in extremis* të forcës ushtarake, kur diplomacia imponuese do dështojë të japë frytet e dëshiruara. Prandaj, kuptohet fare mirë përse kanë dështuar të gjitha alternativat dhe ofertat e tjera realiste që i janë ofruar Moskës nga lojtarë të jashtëm – të cilat Rusia i ka parë gjithnjë si përpjekje për t'i larguar këto shtete nga influenca e saj. Prandaj, që prej shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Rusia ka vepruar me përpikmëri konstante në promovimin e interesave të saj rajonale, duke penguar rregullisht afrimitetin e vendeve të reja me fuqitë përëndimore, veçanërisht Shtetet e Bashkuara.

Kësisoj mund të pohohet se rajoni i ish-Bashkimit Sovjetik është bërë fusha kryesore e përplasjeve midis interesave ruse dhe qëllimshmërisë gjeostrategjike euroaziatike amerikane.² Ky është konteksti që mundëson realisht analizën e reagimit rus ndaj planeve të propozuara përëndimore për integrimin e Ukrainës dhe Gjeorgjisë në NATO, të cilat u panë si mjaft kërcënuese për interesat tradicionale të sigurisë ruse. Akoma sot e kësaj dite, ekspertët ushtarakë rusë e konsiderojnë kufirin e vjetër sovjetik si perimetrin rus. Ata besojnë se ky konceptim justifikon vendosjen e forcave ruse në këto vende (në 2008-ën, në rajonin midis kufirit aktual rus dhe atij të dikurshëm sovjetik, Rusia ka ende mbi dhjetë baza ushtarake, dhjetëra mijëra ushtarë dhe mbi 20.000 teknikë)³. Në fjalimin e tij përpara forumit të përvitshëm të diplomatëve rusë, në korrik 2004, Putin theksoi se ish territoret sovjetike kanë rëndësi supreme për Rusinë dhe shpalli botërisht të drejtën e Ruisë për të ndërhyrë në këto rajone dhe për të përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë forcën ushtarake, për të mbrojtur qytetarët rusë që ndodhen atje.⁴

Sjellja e politikës së jashtme ruse karshi këtyre rajoneve bazohet në dy parime bazë. I pari është “integrimi” (Moska nuk e përdor me vetëdije termin “riintegrim” dhe “rikthim të territoreve tek ‘pronarët’ e tyre të vërtetë historikë”, për shkak të konotacioneve imperialiste që lidhen me to). “Koncepti i Politikës së Jashtme i Federatës Ruse”, i publikuar korrikun e shkuar, bën të qartë se është i papranueshëm cilido orientim politik i vendeve të reja –përveç përpjekjes së përbashkët për të rivendosur marrëdhëniet e ngrohta miqësore me Rusinë, vendin amë.⁵ Parimi i dytë

1 Mbi diplomacinë imponuese dhe aplikimet e saj shih, P. V. Jakobsen, “*Coercive Diplomacy*”, në Alan Collins (ed.) “*Contemporary Security Issues*”, Oxford: Oxford University Press, 2006, ff. 225-228.

2 Shih Kapitullin “*Living with Russia*” në Zbigniew Brzezinski, “*The Geostategic Triad*”, CSIS, 2000.

3 Shih Zdzislaw Lachowski, “*Foreign Military Bases in Eurasia*”, Sipri Policy Paper, No. 18, Korrik 2007, ff. 51-54, sidomos Tabelën 5.1.

4 Për këtë fjalim të Vladimir Putin, shih “*Eurasia Daily Monitor*”, 19 Korrik, 2004.

5 Megjithatë dokumenti në fjalë anashkalon shprehjen e opsioneve të ndryshme ndëshkuese në rast të kundërt. Dokumenti mund të gjendet në adresën e internetit <http://www.brookings.edu>.

i politikës ruse në hapësirën e saj jetike është ai i legjitimitetit ndërkombëtar. Fill pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, liderët rusë kanë qëmtuar rregullisht të garantojnë legjitimitetin ndërkombëtar –qoftë ai dhe thjesht nominal– për çdo doktrinë dhe qëllim strategjik, me synim mbrojtjen e interesave të tyre në këto rajone. Nevoja për njohjen e komunitetit ndërkombëtar e ka detyruar Rusinë të vërë në përdorim një gamë të gjerë metodash operacionale. Në ditët e para të presidencës Jelcin disa prej politikëbërësve në Moskë besonin se Perëndimi do i jepte dorë të lirë Ruisë në politikat e saj në Azinë Qendrore dhe në Kaukaz, sepse Rusia përbën murin mbrojtës të Evropës kundër ekstremizmit islamik dhe destabilitetit politik që prodhonin këto rajone.¹ Kurse sot është e qartë që Ruisë nuk i jepet dorë e lirë mbi këto çështje, ndonëse ajo i ka bërë vetë të gjitha përpjekjet e nevojshme si në nivel doktrinar ashtu dhe aftësi ushtarake implementuese të doktrinave, siç u pa në rastin më të fundit të Luftës së Gjeorgjisë, por dhe nga paralajmërimet e vazhdueshme drejtuar Ukrainës, e cila po ‘flirton’ vazhdimisht me orientimin e saj drejt NATO-s. Të paktë në një rast, atë të mbikëqyrjes së armëpushimit në konfliktin midis Armenisë dhe Azerbajxhanit, Moska arriti të siguronte njohje ndërkombëtare të statusit të saj hegjeonik rajonal. Forca paqeruajtëse që u vendos në Azerbajxhan ishte njësi ushtarake ruse që operonte nën siglën e OKB-së dhe OSBE-së. Komuniteti ndërkombëtar njohu dhe pranoi faktin se interesi kombëtar rus në këtë çështje ishte mjaft i fuqishëm dhe se Rusia ishte pala që mund të ndërhynte me efikasitet më të lartë.

Derimë tani, marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe me republikat e pavarura të ish-Bashkimit Sovjetik i kanë shërbyer Ruisë si bazë për statusin e liderit në teatrin strategjik të brezit të saj jetik, duke i siguruar asaj trajta të ndryshme legjitimiteti për ndërhyrjet e kryera. Jo më kot Rusia i ka kushtuar rëndësi të madhe organizatave zyrtare me natyrë strategjike për Moskën, si: Komonuelthit të Shteteve të Pavarura; Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive, e cila koordinon politikën e përbashkët ushtarake midis Ruisë, Kazakistanit, Uzbekistanit, Kirgistanit, Takhikistanit, Armenisë dhe Bjellorusisë; apo Komonuelthit Ekonomik Euroaziatik, i cili promovon integrimin ekonomik midis gjashtë vendeve anëtare dhe Ruisë. Nëse këtij rrjeti marrëveshesh multilaterale i shtojmë dhe traktatet bilaterale me vende specifike (si ai midis Ruisë dhe Kazakistanit, i cili i lejon Ruisë të testojë raketa bërthamore dhe të përdorë kapacitetet e tjera hapësinore të Kazakistanit; apo ai midis Ukrainës dhe Ruisë, ku flotës së kësaj të fundit i lejohet të përdorë bazat detare në Sevastopol dhe Krime).

Vitet e fundit, Rusia, si dhe disa fuqi të tjera të mëdha (ndër të cilat spikat Kina) e kanë përdorur me ‘efikasitet’ rrezikun global terrorist, duke e integruar atë artificialisht brenda qëllimshmërisë së doktrinave të tyre strategjike, për të rritur legjitimitetin e këtyre të fundit. Kështu, ajo i karakterizon zyrtarisht rreziqet aktuale në këtë rajon si terrorizëm ndërkombëtar dhe ekstremizëm islamik (listë të cilës mund t’i bashkohen itinerari i trafikut të drogës nga Afganistani dhe emigracioni i jashtëligjshëm), duke i fshehur nën këtë petk rreziqet që i vijnë nga influencat e huaja dhe përpjekjet nga

1 Shih Vladimir P. Lukin, “*Remaking Russia: Our Security Predicament?*”, Foreign Policy, No. 88, Vjeshtë 1992.

palë të jashtme për të penetruar politikisht dhe ushtarakisht (pra strategjikisht) në republikat e reja. Në vitet e para të presidencës Jelcin, vëmendja u drejtua nga Turqia, e cila besohet se synonte të rriste ndikimin e saj në popujt turkfolës të Azisë Qendrore dhe të Kaukazit. Më pas, vëmendja gjeostrategjike u kthye nga Irani, i cili shihej si rrezik për eksportin e Revolucionit Islamik në republikat myslimane.

Por dy janë faktorët që aktualisht mund të përbëjnë rrezik për hegjemoninë ruse në brezin jetik të sigurisë së saj: Kina (veçanërisht në Azinë Qendrore) dhe Aleanca Perëndimore (e cila po zgjeron rrezet e saj gjeopolitike në të gjithë rajonin, veçanërisht në Ukrainë dhe Gjeorgji). Kina tregon interes të madh në vendet e Azisë Qendrore pikësepari si vende me resurse të mëdha energjetike, duke rritur paralelisht vëllimin tregtar dhe duke intensifikuar kontaktet diplomatike me to. Megjithatë, rritja e interesit nuk përkthehet automatikisht në përpjekje për të larguar dominimin rus nga rajoni. Kështu, në perceptimin rus, sfida gjeopolitike e SHBA dhe NATO mbetet kryesorja, duke e shtyrë politikën ruse drejt rritjes së bashkëpunimit me Pekinin për të krijuar një kundër-balancë në rajon. Në këtë pikë duket se po vërtetohet deri-diku zgjedhja e tretë që paraqiti Brzezinski (1997) për Rusinë, ajo e krijimit të ndonjë kundër-aleance në Euroazi (shih më lartë). Këtij qëllimi i përket krijimi i Organizatës së Bashkëpunimit të Shangait në 2001 (anëtarët e të cilës përfshijnë Rusinë, Kinën, Kazakistanin, Uzbekistanin, Taxhikistanin dhe Kirgistanin), ideuar nga Kina dhe Rusia, dy superfuqitë rajonale, për të krijuar një axhendë të tyre rajonale me qëllim bllokimin e përfshirjes perëndimore.

Kurse situata në republikat perëndimore është më komplekse. Katër prej tyre kanë aspiruar gjithnjë t'i largohen kontrollit rus, duke vështruar ngultazi drejt Perëndimit: Gjeorgjia, Ukraina, Azerbajxhani dhe Moldavia. Por Rusia ka në duart e saj mjete efikase influencimi të sjelljes së tyre gjeopolitike, pasi këto shtete vuajnë nga "defekte serioze gjatë lindjes", në aspektin e unitetit kombëtar.¹ Rusia i ka shfrytëzuar shpeshherë këto kompleksitete, për të imponuar tempin e saj gjeostrategjik, ndonëse me shumë kujdes, pasi Kremli e ka të qartë interesin e fuqishëm euroatlantik në këto rajone. Suksesi i "revolucioneve me ngjyra" në Gjeorgji (2003) dhe në Ukrainë (2004-'05), si dhe mundësia e integritit të këtyre vendeve në të ardhmen në NATO, ka sjellë shqetësime shumë të forta për Rusinë, e cila po përpiket në të gjitha mënyrat të ndikojë në punët e brendshme të tyre, për t'i penguar në rrugën e integritit euroatlantik.

Nga ana tjetër, në Ballkan, përpjekjet rigjallëruese të Rusisë morën një goditje fatale definitive pas deklaratës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës në 18 shkurt. Megjithëse kjo ishte një çështje e rëndësishme për Shtetet e Bashkuara dhe shumicën e shteteve të Evropës Perëndimore, për Rusinë pavarësia e Kosovës ishte (dhe vazhdon ende të jetë) shumë më tepër: ajo përbën një kërcënim madhor ndaj përpjekjes së Rusisë për të demonstruar, fituar dhe, për rrjedhojë, stabilizuar kthimin e saj në statusin e superfuqisë (pra të një fuqie të madhe fjala e së cilës dëgjohet me kujdes) në sistemin e marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare. Për Rusinë dhe ish-presidentin e saj Vladimir

1 Kështu: Ukraina vuan nga një ndarje e thellë politike dhe sociale midis popullsisë etnike ruse dhe shumicës nacionaliste ukrainase; Gjeorgjia ka dy minoritete në territorin e saj – abkhazët dhe osetiano-jugorët – të cilët rebelohen vazhdimisht; po ashtu Azerbajxhani dhe Moldavia.

Putin do jetë e nevojshme që, për të tejkaluar atë që konsiderohet si “poshtërim” në rastin e Kosovës, të aplikohet një sistem ndëshkimesh tjetërkund në hapësirën jetike gjeografike ruse: më konkretisht në vendet e Kaukazit, Ukrainës, Bjellorusisë dhe ato Baltike. Pra, duke qartazi se Ukraina dhe Gjeorgjia do të shërbejë nga njëra anë si një lloj “kompensimi” për Kosovën dhe, nga ana tjetër, si një trampolinë që do i rihapë Ruisë rrugën drejt rifitimit të statusit të një superfuqie në sistemin ndërkombëtar. Faktet dramatike që e detyruan Ukrainën të luhatet fortësisht në orientimin e saj euroatlantik vijnë në kontekstin e pavarësisë së Kosovës dhe të Luftës së Gjeorgjisë.

Rusia dhe aleanca perëndimore: ekuilibri i fuqisë

Rusia është aktualisht një superfuqi e padiskutueshme në sektorin energjetik. Ka rezerva të mëdha hidrokarburesh dhe rezervat më të mëdha në botë të gazit natyror.¹ Aktualisht Rusia siguron 40% të gazit natyror që konsumon Evropa Lindore dhe ajo Perëndimore, shifër kjo e cila pritet të arrijë në 75% brenda 20 viteve të ardhshëm, për shkak të destabilitetit të rajonit të Lindjes së Mesme/Gjirit Persik.² Rusia ishte prodhuesi kryesor i naftës së papërpunuar në 2006, ndonëse vetëm e teta në renditjen globale të rezervave të saj. Të ardhurat e vendit nga shitjet e resurseve energjetike përlllogaritëshin në vitin 2007 rreth 200 miliardë USD.³ Këto të ardhura nuk arrihen nga asnjë sektor tjetër i ekonomisë ruse. Gjithsesi, sipas përlllogaritjeve të PBB rus, ai arrin vetëm në 5% të totalit perëndimor (SHBA dhe BE), duke mbetur edhe nën atë japonez dhe kinez.⁴

Tabloja ndryshon paksa kur analizojmë fuqinë ushtarake. Që prej vitit 1972, barazia strategjike midis Bashkimit Sovjetik (tani Ruisë) dhe SHBA, pranohej nëpërmjet traktatit SALT-1. Në vitin 2008, arsenali bërthamor ofensiv rus përmbante 3.113 mbushje bërthamore⁵, thuajse aq sa arsenali amerikan dhe afër nivelit të lejuar nga traktati START-1 në 1991. Ndërkaq, Traktati i Moskës i vitit 2002 i redukton forcat bërthamore ruse dhe ato amerikane në rreth 20 përqind të nivelit që ato arritën gjatë Luftës së Ftohtë. Është e natyrshme kësisoj, që Rusia të ketë arsye të jetë e kënaqur me statusin e saj si fuqia e dytë bërthamore e botës.

Në nivelin e gjeostrategjisë globale Rusia shfaqet mjaft e shqetësuar rreth ekuilibrit të fuqisë, të cilin e sheh si të paqëndrueshëm. Politikëbërësit rusë janë të ndërgjegjshëm

1 33 % të rezervave globale të gazit natyror në territor rus. Nëse përfshihen edhe republikat fqinje me të, atëherë këto rezerva arrijnë në 55% të rezervave botërore. Shih statistikat e paraqitura në raportin vjetor 2007-2008 të British Petroleum, <http://www.bp.com> – Aksesuar për herë të fundit më 1 dhjetor 2008.

2 Shih <http://www.eia.doe.gov/cabs/russiabackground.html> - Aksesuar për herë të fundit më 1 dhjetor 2008.

3 Ibid.

4 Ibid.

5 Shih Rober S. Norris dhe hans M. Kristensen, “*Russian Nuclear Forces, 2008*”, Bulletin of Atomic Scientists, Maj/Qershor 2008.

për hendekun e resurseve financiare që i ndan ata nga SHBA, i cili prodhon në një plan afatmesëm hendek të madh strategjik që e lë Moskën shumë mbrapa hapit të përsheptuar të fuqizimit ushtarak amerikan, sidomos gjatë presidencës së fundit Bush. Shpenzimet amerikane të mbrojtjes për vitin 2008 arritën në 480 miliardë \$, thuajse 15 herë më shumë se buxheti rus i mbrojtjes, i cili nuk i kaloi 35 miliardë \$.¹ Prandaj përpjekjet e fundit në zhvillimin e teknologjisë ushtarake, stërvitjet e përbashkëta në Euroazi midis trupave ruse, atyre kineze dhe vendeve të rajonit, si dhe prodhimi i gjeneratës së re të raketave, tregojnë një *vëmendje dhe ndërgjegjësim më të madh të Rusisë për pozitën e saj në sistemin ndërkombëtar*. Në këtë kontekst, zyrtarë të lartë të establishmentit rus të politikës së jashtme dhe asaj të mbrojtjes kanë pranuar disa herë se një prej shqetësimeve më të mëdha të Moskës, që përcaktonte hyrjen ose jo në negociata dhe nënshkrimin eventual të një traktati mbi kontrollin e armëve bërthamore, ishte mbi të gjitha nevoja për të parandaluar përsëritjen e garës së armatimeve bërthamore. Kjo, pasi në një garë të tillë Rusia do të rrezikonte shumë, sepse do të gjendej me kapacitete shumë më inferiore prej atyre të Shteteve të Bashkuara: madje ky inferioritet i pengon ata akoma më shumë që t'i detyrojnë amerikanët të angazhohen në kufizimin e ndërtimit të kapacitetit të tyre strategjik.²

Sipas kësaj qasjeje dy janë problemet kryesore për liderët rusë me të cilat atyre do t'u duhet të përballesh. I pari ka të bëjë me regjimin e kontrollit të armëve bërthamore, pasi traktatet që përbëjnë gurin e themelit të këtij regjimi (START-1 dhe SORT) do të skadojnë së shpejti: START-1 mbaron në 2009, kurse SORT në 2012. Për të stabilizuar një regjim tjetër Uashingtoni dhe Moska duhet të hyjnë në negociata bilaterale, por nuk është ende e sigurt nëse Uashingtoni do negociojë rishtazi. Gjithsesi, kjo mbetet për t'u parë gjatë vitit të parë të presidencës së saposhpallur të Barack Obama, ndonëse administrata e paraardhësit nuk e pa të nevojshme të negocionte marrëveshje shtesë të kontrollit të armëve strategjike me Moskën.

Problemi i dytë është ai i pakënaqësisë kronike ruse nga dinamikat e situatës ushtarake në Evropë, pas tërheqjes së forcave ruse nga Gjermania dhe vendet e Evropës Lindore në fillim të viteve 1990. Kjo vjen pasi lidhshipi ushtarako-politik ka shfaqur shpeshherë pakënaqësinë e tij se përpara tërheqjes së forcave ruse nga këto rajone në fillim të viteve '90-të, shumë liderë perëndimorë kishin premtuar se NATO nuk kishte asnjë qëllim të shfrytëzonte avantazhet e krijuara nga vakumi strategjik dhe gjeopolitik i evakuimit rus nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Por dinamikat gjeostrategjike globale nuk bazohen në premtime, por në përllogaritje të sakta interesash dhe strategjish të larta. Tanimë Rusia e gjen veten në një situatë të re ushtarake, të pahasur kurrë më parë, në të cilën të gjitha vendet e ish-Paktit të Varshavës janë integruar në NATO; avionët e të cilës kontrollojnë tashmë hapësirën ajrore të vendeve baltike; kurse bazat amerikane janë shtrirë në Rumani dhe Bullgari; për të mos përmendur vendosjen e

1 Shih http://www.defenselink.mil/comptroller/docs/2008_Budget_Rollout_Release.pdf si dhe <http://www.globalsecurity.org/military/world/russia/mo-budget.htm>

2 Deklaratë e Kryetarit të Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë të Dumës, Dmitri Rogozin, cituar në RFE/RL, "Newsline", 15 maj 2003.

sistemeve anti-raketë në Poloni dhe radarëve anti-raketë në Republikën Çeke. Në këtë situatë, Rusia e percepton veten si të mbërthyer nga një darë gjeopolitike amerikane, e cila vazhdon të zgjerohet kërcënueshëm për të dhe për dominimin e saj në Euroazi. Por, kjo vjen për shkak të mungesës së informacionit dhe/ose keqinterpretimit të lëvizjeve gjeostrategjike të Perëndimit, çka solli shfryrjen e Ruisë kundrejt Gjeorgjisë dhe [kërcënimin ndaj] Ukrainës.

Gjithsesi, situata e vështirë dhe dobësitë ekonomiko-politike i ndaloi vetëm përkohësisht impulset dhe ambiciet imperialiste të liderëve rusë, duke ndërprerë procesin e ndërtimit të fuqisë konvencionale dhe strategjike. Gjatë viteve '90-të vëllimi i prodhimit të industrisë së mbrojtjes u zvogëlua në 10% të kapacitetit real.¹ Por kjo ndryshoi me ripërtëritjen e ekonomisë ruse. Rusia filloi të rindëronte industrinë e mbrojtjes veçanërisht gjatë administratës së dytë Putin, kur në arkat e shtetit po rridhnin shumë herë më tepër të ardhura, kryesisht prej naftës dhe gazit natyror. *Në vitin 2007, Putin aprovoi një plan shtatëvjeçar prej 200 miliardë \$, për të modernizuar forcat strategjike dhe ato konvencionale, përfshirë ndërtimin pesë aeroplanmbajtëseve.*² Forcat ajrore ruse rifilluan itineraret e fluturimeve që kryenin edhe gjatë Luftës së Ftohtë, kur avionët bombardues strategjikë patrullonin oqeanet, si dhe u rrit prania e flotës ruse në Mesdhe, duke vënë në përdorim të plotë bazën ruse në Tartus të Sirisë.³ Prandaj mund të pohohet se gjatë viteve të fundit Rusia ka “punuar fort për të stërvitur muskujt e saj ushtarakë” me qëllim rindërtimin e imazhit të saj si superfuqi me aftësi globale projektimi të fuqisë.

Përfundim

Problemi kryesor për Ruisë në raport me aleancën euroatlantike qëndron në zgjerimin politik dhe forcimin strategjik të kësaj të fundit, i cili i ka dhënë SHBA-së impulse shumë të forta dominimi gjeopolitik, duke shkuar më pranë se kurrë më parë në histori, drejt dominimit të “Ishullit Euroaziatik të Botës”. Nga ana e saj NATO është tepër e ndërgjegjshme për shqetësimet e Ruisë, prandaj ka ndërmarrë dhe disa përpjekje që zgjerimi i saj të mos keqinterpretohej prej Moskës. Këshilli i përbashkët (i quajtur Këshilli NATO-Rusi), i krijuar fillimisht në vitin 1997 dhe më pas në 2002, synonte koordinimin dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak midis NATO-s dhe Ruisë, ndonëse realiteti provoi se efikasiteti i tij për të çliruar Kremlinin nga makthi mbytës i “humbjes së brezit jetik të sigurisë” rezultoi i kufizuar.

Sikurse e përmendëm më herët në analizën tonë, jo shumë kohë pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Rusia ishte e ndërgjegjshme se nuk mund të priste realisht përfshirjen e plotë në aleancën perëndimore si partner organik i saj dhe se duhej të ndiqte një monopol të pavarur në arenën ndërkombëtare. Gjatë viteve të fundit nëpër

1 Shih Paul Rivlin, “*The Russian Economy and Arms Exports to the Middle East*”, Memorandum Nr. 79, Jaffee Center for Strategic Studies, Tel Aviv, 2005.

2 Përmendur në BBC News dhe CNN, 24 Prill 2008.

3 Shih “*The Guardian*”, 5 dhjetor 2007.

analizat e shumë studiuesve në zë të gjeopolitikës, për t'iu referuar Ruisë përdoret termi “demokraci sovrane”. Për sa i përket politikës së jashtme ky koncept e diferencon Ruisë nga vendet e tjera evropiane, të cilat sipas Moskës i janë nënshtruar Shteteve të Bashkuara. Por pikërisht në këtë perceptim qëndron kyçi i kuptimit që duhet të kemi për konceptimin që Rusia ka për botën. Moska nuk është pajtuar aspak me superioritetin perëndimor ushtarak, politik dhe gjeopolitik. Përshtypja që ajo ka krijuar për Perëndimin, dhe të cilën nuk e fshihet, është se, ndërsa Lufta e Ftohtë ka përfunduar, Perëndimi vazhdon të aplikojë kundrejt saj një politikë përmbajtjeje (*containment*). Këtu prehet thelbi i kundërshtisë së ashpër dhe të vrazhdë ruse ndaj çdo përdorimi force nga Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre gjithkund nëpër botë, pa autorizimin e Këshillit të Sigurisë së OKB-së. Këtu identifikohet filli i kundërshtimit të tyre ndaj çdo politike hapjeje dhe qasjeje të vendeve që dikur i përkisnin sferës ruse të influencës. Kështu, në prag të dekadës së dytë të shekullit të ri Rusia ndjehet mjaft e frustruar nga rendi i ri botëror që lindi pasi humbi statusin e saj perandorak dhe mbetet ende konfuze rreth vendit real që ajo zë në familjen e madhe të kombeve.

Strategjia e re e Bashkimit Evropian për zgjerimin¹

Donatos Papagiani²

ABSTRAKT. *Kjo ese trajton nevojën për një strategji të re për zgjerimi të Bashkimit Evropian sidomos pas dështimit të referendumeve në Francë dhe Hollandë. Ky është një moment mjaft i rëndësishëm dhe me një impakt të drejtëpërdrejtë në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Argumenti kryesor i kërrij artikulli është se Bashkimit Evropian i dubet një strategji e re zgjerimi që merr parasysh realitetin e ri si brenda ashtu edhe jashtë BE-së. Për këtë duhen ndërmarrë me kreativitet një sërë reformash institucionale dhe ndryshimesh që ngjallin sërish besim tek projekti Evropian. Sfida është në të vërtetë e madhe, sidomos mbas falimentimit të marrëveshjes për Kushtetutën Europiane.*

Hyrje

Strategjia e re e Bashkimit Evropian për zgjerim është një aktualitet shumë i rëndësishëm. Kjo temë është aktuale sepse në këtë moment kritik për të ardhmen e kontinentit Evropian, kryetarët e shteteve anëtare duhet të marrin vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e Europës. Kryetarët e shteteve dhe qeverive kanë rënë dakort fillimisht për një mini traktat modifikues i cili do të zëvendësojë traktatin për kushtetutën europiane, mbas referendumeve negative në Francë dhe Hollandë. Problematikat mbi zgjerimin marrin një drejtim krejt të ri dhe një rëndësi aktuale, mbas qëndrimit që mban presidenti i ri Francës përse i përket kandidaturës së Turqisë.

Sidomos për shtetet e Ballkanit strategjia e re e BE-së, përse i përket zgjerimit të saj, bëhet akoma më e rëndësishme, sepse shtetet Ballkanike janë pjesa e fundit e kontinentit Evropian të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe gjithashtu

1 Artikulli e përktheu nga origjinali në Greqisht Adriatik Arifi

2 Autori është Assitent Professor në Universitetin Panteion në Athinë.

disa nga këto shtete janë karakterizuar si shtete candidate të mundshme për anëtarësim. Si pasojë është e rëndësishme të bisedojmë në thellësi prospektet e reja që paraqiten, të individualizojmë me saktësi drejtimet e reja që merr politika e zgjerimit së Bashkimit Europian dhe të përgatitim shtetet e Ballkanit përëndimor, për hapin e madh i cili do të na drejtojë në familjen europiane.

Pyetjet që lindin rreth zgjerimit

Bashkimi Europian në 50 vitet e jetës vezulloi një ndricim rrezesh mbi popujt europianë¹. Eksperimenti i bashkëpunimit të popujve europianë midis tyre me praninë e Komunitetit dhe Bashkimit Europian, u vërtetua si një eksperiment me sukses. Metoda hap pas hapi, e quajtur edhe «metodë e komunitetit»² në gjuhën e bashkëpunëtorëve të mi, u vërtetua si një zgjedhje e zgjuar dhe me vlerë, e cila i dha plotësisht të drejtë Jean Monnet³ dhe R. Schuman. Armët ranë në heshtje në kontinentin europian dhe europianët po ndërtojnë paqësisht të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre. “Të gjithë bashkë” siç shkruhet dhe në thirrjen e 50 vjetorit të Bashkimit, me respekt dhe ndryshim, me “Unity in Diversity” (bashkim dhe ndryshim). Përdorimi i dhunës si një mënyrë zgjidhjeje të mosmarrëveshjeve, është lënë pas tashmë nga Bashkimi dhe nga shtetet anëtare që e përbëjnë atë dhe i drejtohen dotrinës së rregullave të drejtësisë.

Arritjet janë të jashtëzakonshme. Paqja është ndoshta arritja më e madhe e Bashkimit në këto 50 vjet të jetës së tij. Një arritje, të cilën fatëkeqësisht në evropianët duket ta kemi harruar dhe nuk e vlerësojmë sa duhet. Ankohemi për çmimin e domates ose për shtrenjtësinë e euros dhe për shumën e merlucit në detin Verior....!!! Dhe në këtë mënyrë harrojmë më të rëndësishmen: paqen e arritur me sukses. Paqen dhe zgjidhjen paqësore të të gjitha mosmarrëveshjeve tona, e cila përbën arsyen e parë dhe kryesore për çdo lloj zhvillimi.

Ky vizion për Europën e bashkuar i preku të gjithë popujt e saj dhe njëri pas tjetrit kërkonin dhe kërkojnë anëtarësimin e tyre në Bashkimin Europian. Më 1957, kur gjashtë shtete të Europës guxuan të merrnin pjesë në këtë eksperiment të shfaqur për herë të parë,⁴ asnjëri nuk mundi të parashikojë atëherë, që viza ndarëse midis lindjes dhe Europës përëndimore do të binte si një kështjellë prej letre, kufijtë e Europës do të preknin kontinentin aziatik. Nga viti 1957 me gjashtë shtete anëtare për të arritur sot me 27 shtetet anëtare aktuale. Mbas shkatërrimit përfundimtar të pushteteve komuniste të Europës qendrore dhe asaj lindore, kompletimi i propozimit të Robert Schuman imponoi anëtarësimin e totalit të shteteve europiane në këtë përpjekje, sepse vetëm në këtë mënyrë do të merrte rëndësi kompletimi europian. Një Europë e ndarë

1 Papagiannis Don., *Isagogi sto evropaiko dikaio*, triti ekdosi, ekd. Ant. N. Sakkoulas, 2007, 26.

2 Skandamis N., *Evropaiko Dikaio*, I, *Thesmi tis Eveopaikis Enosis*, ekd. Ant. N. Sakkoulas, 2003, 42.

3 Bossuat G., Wilkens A., Jean Monnet. *L' Europe et les chemins de la paix*, paris 1999.

4 Zorghibe C., *Histoire de la construction européenne*, Paris 1993.

në përfundim dhe lindje, mbas rënies së forcave lindore nuk do të kishte asnjë kuptim, asnjë bazë arsyetuese.¹

Zgjerimi më i fundit me Bullgarinë dhe Rumaninë, e drejtoi vëmendjen dhe synimet për zgjerim në Ballkan me konsekuenca frytëdhënëse për këtë territor. Suksesi është i shumë i madh. Avancuam me shpejtësi dhe shumë larg². Ky sukses duket se na shkaktoi gjithashtu edhe marramendje. Dyshimet tashmë janë të shumta dhe paraqiten gjithashtu mendime kontraditore dhe të fuqishme. Pyetje kritike vijnë në sipërfaqe: deri ku mund të arrijmë? Ekzistojnë kufinj të Europës të cilët nuk mund t'i kalojmë? A ka vend midis nesh Turqia, Rusia, Shqipëria? A është Europa një "grup kristian"? Cilët janë saktësisht kriteret për anëtarësimin e një shteti kandidat në Bashkim Evropian? Të gjitha këto arsyetime të lartpërmendura dhe shumë të tjera përbëjnë sot një nga problemet thelbësore të bisedimeve për të ardhmen e Europës, të cilën kemi detyrë të ndjekim nga afër.

Baza ligjore e zgjerimit, kriteret e Kopenhagenit.

Gjashtë shtetet e Europës qendrore të cilët tentuan në hapin e parë, bënë një zgjedhje shumë kritike: caktuan organizatën e tyre, Komunitetin Ekonomik European si një organizatë e hapur periferike, me kthjellësi determinuan që çdo shtet evropian mund të anëtarësohet në Komunitetin fillestar. Kushti i vetëm që duhej plotësuar ishte ekzistenca brenda kufinjve evropiane i shtetit kandidat. Në këtë mënyrë ato gjashtë shtete nuk ngjallën asnjë pyetje mbi europaizimin e tyre, sepse të gjithë shtetet candidate ishin sigurisht evropianë.

Ndërkohë që sistemi komunist i Europës lindore binte me shpejtësi, shtetet që e përbënin nxituan të kërkojnë anëtarësimin e tyre në gjirin e Bashkimit³. Sfidat për shtetet anëtare të atëherëshme nuk ishin të vogël. Shtetet candidate duhet të kryenin një punë gjigante, e cila kishte të bënte me ndryshimin e ekonomisë qendrore me atë të tregut të lirë. Bashkimi European gjithashtu kishte si synim të kërkonte zgjidhje të problemeve, jo vetëm përsa i përket temës së buxhetit por sidomos temave të funksionimit të sukseshëm të organizatës, i cili kishte arritur në kufijtë e tij për shkak se sistemi ishte krijuar për gjashtë shtete anëtare. Si rrjedhojë i vetmi synim ishte zgjerimi i mëtejshëm, pa u gjetur zgjidhjet e problemeve të parashtruara më lart. Fatkeqësisht, pasojat e këtyre vendimeve nuk u vonuan të shfaqeshin.

Në të njëjtën kohë u shtua dhe një pyetje e re: A mundej Bashkimi të hapte pa frikë dyert e tij duke u bazuar vetëm në kriterin e "europaizimit" të shtetit kandidat? Çfarë garancie mund të paraqesin vendet candidate të Europës lindore, nëse janë në gjendje

1 Gautron J C, La problématique politique des relations entre la Communauté européenne et l' Europe de l' Est, in: Gautron (dir), Les relations Communauté européenne - Europe de l' Est, Paris, Economica 1991, spéc. 13.

2 Bino Olivi, L Europe difficile ; Editions Gallimard 2001 :

3 Evtimov E., Rechtsprobleme der Assoziierung der Mittel- und Osteuropäischen Länder und der Voraussetzungen für ihren Beitritt zur Europäischen Union, 1999, Meier G. Ost- Erweiterung der Europäischen Union und die verschwiegenen Kosten, EuZW 2001, 33.

ti përshtaten pa asnjë pengesë parimeve së lirisë, demokracisë, të shtetit ligjor dhe të mbrojtjes së të drejtave themeltare? Këto pyetje kritike sollën të ashtuquajturat kriteret e Kopenhagenit. Në Këshillin e lartë të Kopenhagenit të vitit 1993¹, 12 shtetet anëtare të Bashkimit Europian të atëherëshme vendosën dhe ranë dakort që shteti kandidat, jo vetëm duhet të jetë shtet europian por duhet të plotësojë disa kriteret politike dhe ekonomike, të cilat u bënë të njohura në filologjinë europiane si “kriteret e Kopenhagenit”².

Shteti kandidat duhet fillimisht të vërtetohet qëndrueshmëri legislative, e cila mund të garantojë një klasë demokratike ligjore, e domosdoshme jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave individuale por edhe për mbrojtjen e sukseshme të minoriteteve. Kjo konsiderohet si **kriteri i parë** politik. **Kriteri i dytë** i referohet ekonomisë, ku shteti kandidat duhet të krijonte një sistem të sukseshëm në funksionimin e tregut të lirë, e cila do të garantojë funksionimin pa pengesa të konkurrencës së prodhimit. **Kriteri i tretë** dhe i fundit kushtëzon referimin në përgjithësi dhe të papërcaktuar, të aftësisë së shtetit kandidat të ndërmarrë të gjitha detyrimet përkatëse që shfaqen mbas anëtarësimit. Duhej domethënë të marrë përsipër të gjitha pikat e caktuara në 90.000 faqet e Legjislacionit! Këto janë kriteret e ‘famshme’ të Kopenhagenit. I pari nga të tre kriteret, domethënë ai politik, kaloi më 1997 me Marrëveshjen e Amsterdimit në ligjin e paralindur bashkues, sepse në artikullin 49 të Marrëveshjes për Bashkimin Evropian³, caktohet qartë që shteti kandidat duhet të jetë fillimisht europian dhe në vazhdim të respektojë parimet e lirisë, demokracisë, respektin ndaj të drejtave njerëzore, të lirisë themeltare dhe të shtetit ligjor, parime të cilat janë të përbashkëta për shtetet anëtare.

Bazuar në këtë plan, shteti kandidat tashmë, duhet të përmbushë jo vetëm kriteret që caktohen nga ligji fillestar bashkues, domethënë ato të europaizimit dhe ato të sistemit politik demokrat por edhe ato kriteret që nuk përmbahen në ligjin fillestar unifikues të cilat ngjelen në histori si kriteret e Kopenhagenit.

“Evropaizimi” i shtetit kandidat.

Do të përqëndrohëm pak në kriterin e “evropianizimit” i cili shkakton shumë konfrontime idesh në periudhën që po kalojmë, sidomos mbas zgjedhjes së Presidentit të ri francez. Shteti kandidat duhet fillimisht t’i përkasë Evropës. Por ku fillon dhe ku mbaron Evropa? Cili është kriteri që cakton vendin e quajtur “Evropë”? Mos ndoshta Evropa mbaron në Dardanele, në Kaukaz, në malet Urale dhe në lumin Ural? A janë kufijtë e Evropës të bazuar vetëm në gjeografi apo dhe diçka tjetër më shumë? Biseda mori një drejtim tjetër kur në 1999, në Helsinki, shtetet anëtare të Bashkimit karakterizuan si shtet kandidat Turqinë⁴. Që atëherë vallja vazhdon...

1 Bull. CE 6 /1993, point I.13.

2 Katz D. Les “critères de Copenhague”, RdMC et de l UE 2000, 483.

3 Sarcevic E., EU – Erweiterung nach art. 49: EUV Ermessensentscheidungen und Beitrittsrecht, EuR 2002, 461.

4 Tezcan Er., La Turquie et l’ Union Européenne: Le point sur les arguments des partisans et des adversaires de l’ adhésion de la Turquie à l’ Union européenne, R d MC et de l UE 2004, 569.

Përgjigjet e kësaj pyetje mund të jenë politike, por më parë dhe mbi të gjitha duhet të jenë ligjore. Fjala “Evropë” e artikullit 49 së Marrëveshjes së Bashkimit Evropian, duhet të pranohet si një koncept ligjor i papërcaktuar, si një koncept *lato sensu*, i cili ka shumë nevojë të konkretizohet. Nevojitet një perkufizim i saktë, jo me kritere të qëllimshme siç është natyra e politikës, por me kritere të paanshme, objektive¹ që do të nxjerrin në pah nocionin e vetëm dhe të vërtetë të fjalës, e cila do të nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Cili është nocioni i parë i fjalës “Evropë”²? Pa dyshim ai gjeografik. Problemi fillon në atë pikë ku jo vetëm gjeografët e sotëm por edhe gjeografët e hershëm nuk bien dakort në caktimin e saktë të kufijve të kontinentit në fjalë. Këto pyetje më çuan në analizën e mëtejshme të kësaj teme³. Mund të parashtrojë këtu përfundimet e këtij studimi i cili është tashmë i ezauruar.

Pozicioni i parë: Nuk ka një kufi të qartë midis Europës dhe Azisë dhe nuk mund të ketë as në të ardhmen⁴. Kufijtë gjeografikë të Europës, përse i përket kufirit me Azinë, nuk paraqiten me saktësi matematikore, por janë të caktuara aty ku caktohen dhe aty ku pranohet nga bibliografia si territor i Europës.

Pozicioni i dytë: Problemi i “Evropaizimit” i një shteti kandidat, shfaqet vetëm për vendet që ndodhen në territorin gjeografik aty ku kufijtë fillojnë të mos duken. Si rrjedhojë “evropaiteti” i shteteve që ndodhen brenda këtyre kufijve, si p.sh Shqipëria nuk mund të diskutohen nga askush. Dhe këto shtete i përkasin kushteve që përmenden në artikullin 49 të Marrëveshjes së Bashkimit Evropian.

Pozicioni i tretë: Në mënyrë që të vlerësohet “evropaiteti” i shteteve të cilat ndodhen në zonën e diskutueshme duhet të përqëndrohen në kohë⁵ dhe disa kritere më tepër si kriteri historik, politik⁶, kriteri i koshiencës evropiane, ai i madhësisë dhe mbi të gjitha kriteri kulturor⁷. Vetëm në këtë mënyrë dhe nëqoftëse plotësohen të gjitha këto kritere mundet një shtet të karakterizohet si “evropian”.

Pozicioni i katërt: Në çdo rast kriteri fetar nuk mund të përbëjë kriter evropaiteti, ashtu si dhe kriteri i madhësisë. Në momentin që në të gjithë Kushtetutat Demokratike të shteteve anëtare, të gjithë individët kanë të drejtën e lirisë fetare⁸, do të ishte shumë kontraditore që Bashkimi Evropian të përcaktonte fenë Kristiane si kriter për anëtarësim.

As madhësia e shtetit nuk mund të përbëjë kriter anëtarësimi, sepse ndryshimi përse i përket madhësisë është tashmë një paragjykim për arkitekturën e Evropës. Mjafton të mendojë dikush Luksemburgun dhe Gjermaninë të cilët ishin ndër të

1 Bruha Th., Vogt O., Rechtliche Grundfragen der EU – Erweiterung, VRÜ Bd. 30 (1997), 477.

2 Ioakimidis Pan., I ektasi kai ta synora tou evropaikou xorou: Nees pragmatikotites kai nees proklisis, in: Andrikopoulou E, Kafkalas Gr. (epim.), O neos evropaikos xoros, ekd. Themelio, 2000, 70.

3 Papagiannis Don. Ta “synora tis Europis. I ;;europaikotita” tou ypopsifou kratous stin EE kai I mellontiki dievrinsis tis EE, revue hellénique de droit européen, 2003, 261.

4 R. Brunet, Comment aménager les abords de l UE. Libération 12.12.2002

5 Ch. Dorau, Die Öffnung der Europäischen Union für europäischen Staaten, EuR 1999, 736.

6 R. Hofmann, Wie viel Flexibilität für welches Europa? Gedanken zur künftigen Entwicklung der europäischen Integration, EuR 1999, 713.

7 Hedetof U., The Cultural Semiotics of European identity, in: Landau A., Whitman R., Rethinking the European Union, Institution interests and identities, Macmillan, London 1997.

8 W. Bausbank, Religions- und Weltanschauungsfreiheit als Gemeinschaftsrecht, EuR 2000, 261.

parët shtete themeluese të Komunitetit Europian.

Pozicioni i pestë: Për arsye jo vetëm politike por edhe ligjore çështja mbi madhësinë gjeografike të Bashkimit European nuk mund të ngelet e “hapur”¹ dhe e varur nga situata politike. Problemi mbi zgjerimin nuk mundet të mbetet pezull jo vetëm për arsye ligjore por edhe për arsye të mirefillta politike. Duhet të përcaktohet saktësisht. Nëqoftëse Bashkimi shmanget një zgjerimi të vazhdueshëm dhe sidomos jashtë territorit “Evropë”, atëherë rreziku për ekzistencën e e saj është shumë vdekjeprures².

Pozicioni i gjashtë: Lokalizimi i paqartë përse i përket gjërësisë së territorit “Evropë” dhe sidomos kërkesa e Turqisë për anëtarësim imponojnë në përcaktimin e saktë të zgjerimit në të ardhmen e BE-së me referim të veçantë në anëtarësimin e Turqisë, sepse është *prima facie* i vetmi shtet që me sa duket nuk mund të plotësojë kriterin e “evropaitetit”. Në fakt asnjë nga kriteret nuk plotësohen perderisa pozicioni qendror gjeografik, ndodhet në thellësi të Azisë, me një pjesë të vogël të saj e cila ndodhet e shtrirë në pjesën Europiane.

Para se të përfundoj me këtë problematike relative, dëshiroj të rrëfehem personalisht: si duhet të reagojë një shkencëtar, kur e vërteta shkencore, përfundimi i kërkimeve shkencore të tij, nuk i përputhet me ato që ai beson- në bindjet dhe idetë e tij politike. Nuk mund të fsheh që në këtë moment gjendem në një situatë “dyshimi personal”, sepse si qytetar i një shteti europian besoj plotësisht në ecurinë e Turqisë drejt Evropës ndërkohë që si shkencëtar mendoj krejtësisht të kundërtën.

Strategjia e re për zgjerimin dhe mundësia e Bashkimit European

Pas gjithë këtyre debateve të kryera mbi evropaitetin e shtetit kandidat, pa dyshim fshihet problematika që krijojnë bisedimet për integrimin e Turqisë³ në Bashkimin European. Problemi nuk është vetëm i Turqisë, ai është i rëndësishëm sa për Turqinë, aq edhe për Bashkimin European, dhe për këtë të fundit, është me i rëndësishëm dhe primar. Është në gjëndje Bashkimi European të përfshijë në gjirin e tij këtë shtet të madh pa vënë në rrezik funksionimin e tij dhe në fund të fundit vetë ekzistencën e tij? A mundet Bashkimi European të përparojë me zgjerime të reja si p.sh me Kroacinë sot dhe me Shqipërinë nesër, pa zgjidhur më parë problemet e brëndshme të saj, të cilat do t’a lejojnë të vazhdojë funksionimin me sukses? Kjo problematikë⁴ sollli në kujtesë një paragraf komplet të harruar i cili ishte parashtruar në rezultatet tashmë të njohura të Këshillit të Lartë të Kopenhagenit më 1993, ku u vërtetuan përkatësia e kriterëve për shtetet candidate. Paragrafi i përmendur

1 Tsatsos D. Europaiki Sympolitia. Gia mia Enosi laon me isxyres patrides, ekd Kastanioti, 200, σελ.35.

2 Lagenfeld Ch., Erweiterung ad infinitum? Zur Finalität der Europäischen Union, ZRP 2005, 73.

3 Lagenfeld Ch. Erweiterung ad infinitum? Zur Finalität der Europäischen Union, ZRP 2005, 73.

4 Faber A. Die Weiterentwicklung der Europäischen Union: Vertiefung versus Erweiterung ?, integration 2007, 103.

ishite: “Aftësia e Bashkimit Evropian në anëtarësimin e shteteve të reja pa ngadalësuar funksionimin e plotë të Europës, përbën një temë shumë të rëndësishme e cila ka të bëjë jo vetëm me Bashkimin por edhe me shtetet candidate”.¹

E vërteta është se ndoshta atëherë paraqitem një kriter më tepër, një kriter i cili nuk kishte të bënte me shtetin kandidat por me vetë Bashkimin Evropian, domethënë me aftësinë² e tij në pranimin e shteteve të reja candidate, kriter i cili në vazhdim u harrua? Që atëherë rrodhi shumë ujë në lumin e Europës. Bashkimi Evropian arriti në 27 shtete anëtare, ndërkohë që filluan bisedimet mbi anëtarësimin e Kroacisë, Turqisë dhe u karakterizuan si shtet kandidat FYROM (Maqedonia). Shqipëria, Bosnja –Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia karakterizohen si shtete “në fuqi” candidate. Me rregulloren 1085/2006³ u dekretua në favor të këtyre shteteve një mekanizëm i vlefshëm, “Mekanizmi i Ndihmës Paraprake”. Kjo çështje ishte parashtruar që në seksionin e lartë të Selanikut më 2003 dhe me iniciativën greke, shtetet anëtare vërtetuan se marrëveshja e stabilizimit dhe e asociimit do të përbënte kuadër të përgjithshëm për drejtimin evropian të shteteve të ballkanit perëndimor deri në anëtarësimin e tyre në të ardhmen. Shuma që është parashikuar për periudhën kohore 2007-2013 është 11.468 milion euro.

Në mars të vitit 2006 në Salzburg, Bashkimi Evropian përsëriti premtimin e tij që e ardhmja e shteteve të ballkanit perëndimor është në brendësi të BE-së dhe ftoi këto shtete të ndërmarrin me ritme të shpejta punimet mbi bashkëpunimin periferik. Ky bashkëpunim mbetet thelbësor për stabilizimin e ardhshëm dhe afatgjatë, për zhvillimin ekonomik dhe për bashkëpunimin paqësor të ballkanit perëndimor. Ndërkohë që bisedimet për zgjerim drejtoheshin në këto pika, krejt papritur në Nëntor të vitit 2006 Komiteti i Bashkimit Evropian me një deklaratë drejtuar Komunitetit Evropian dhe Këshillit, paraqiti një strategji të re për zgjerimin e periudhës kohore 2006-2007, paralelisht paraqiti dhe një raport të veçantë për sa i përket “aftësisë së BE-së të integrojë anëtarë të tjerë”⁴.

Shumë anëtarë përkrahin mendimin se me këtë raport BE-ja rikthente paragrafin e harruar të 1993 dhe udhëzonte në dekretimin e një artikulli më tepër për të plotësuar anëtarësimin e një shteti kandidat. Tashmë, ky kriter nuk ka të bëjë me shtetin kandidat por me Bashkimin Evropian. Komisioni, për sa i përket raportit të tij, nënvizon: “Bashkimi duhet të vërtetojë se është i aftë të sigurojë një funksionim të plotë për interesat e qytetarëve aktual dhe atyre të së ardhmes. Administrimi i rreptë i marrëveshjeve për anëtarësim do të vazhdojë ndërkohë që Bashkimi përgatitet në brendësi të tij për reforma të reja ligjore.”⁵ Ky konstatim fillimisht duket i vetëkuptueshëm, por në të vërtetë nuk është. Një analizë e mëtejshme Komisioni Evropian konstatoi detyrimin që të qartësohet me saktësi se çfarë do të nënkuptojë me aftësinë e Bashkimit të mirëmbajë domethënë ritmin e integritimit evropian, cilat mund të jenë pjesët e këshillueshme për rezultatin.

1 Bulletin CE 6 - 1993, I, 13.

2 Petit Y., Quelques réflexions sur la capacité de l'intégration européenne, R d MC et de l'UE 2007, 153.

3 JOUE L 210, 31 Juill :

4 Communication de la Commission, stratégie de l'élargissement et principaux défis 2006 2007, y compris rapport spécial joint en annexe sur la capacité de l'UE à intégrer de nouveaux membres, COM (2006) 649 final, 8. nov. 2006.

5 KOM (2006) 649 final, σελ. 18.

Komisioni në këtë raport numëron aftësinë e Bashkimit të pranojë shtete të reja kandidatë në tre drejtime: aftësi, që nënkupton fillimisht aftësinë e Bashkimit të funksionojë, domethënë **reforma ligjore** dhe jo thjesht duke u bazuar në zgjerimin e tij, por në aftësinë e Bashkimit të funksionojë më mirë dhe të jetë rezultativ. Kur flitet për funksionim rezultativ dhe ligjor nuk nënkuptohet vetëm madhësia dhe mënyra e funksionimit të organeve kompetente, si psh. të Komitetit që karakterizohet nga një madhësi e rrezikshme, por flitet edhe për përdorimin e gjuhëve, të cilat arritën tashmë në 22 gjuhë zyrtare. Atëherë lind pyetja se si mund të sigurohet aftësia e Bashkimit të funksionojë, kur Konventa për Kushtetutën Europiane shkoi në kalendat Europiane? Si rrjedhojë a mundet të ekzistojë anëtarësimi i mëtejshëm i një shteti kandidat, nëqoftëse nuk zgjidhet më përpara problemi i funksionimit të saktë dhe demokratik të organeve?

Përmasa e dytë e aftësisë së Bashkimit të pranojë shtete të reja kandidatë ka të bëjë me aftësinë e tij të **zbatojë politikën**, si psh politikën e bashkimit, atë bujqësore, politikën e mbrojtjes së ambientit dhe të marrëdhënieve të jashtme. Bashkimi sa kohë zgjerohet, duhet të jetë në gjendje të vazhdojë të vërë në funksion dhe të zhvillojë politika të përbashkëta në të gjitha drejtimet. Një Bashkim European që nuk do të jetë i aftë të ushtrojë politika të përbashkëta, nuk mund të jetë i aftë për atë që përfaqëson.

Përmasa e tretë dhe e fundit së aftësisë së Bashkimit në pranimin e shteteve të reja kandidatë, i referohet **buxhetit** dhe aftësisë së tij të vazhdojë në financimin jetësor të politikave të tij.

Ky raport i Komisionit nuk mbeti pa një vazhdim. Këshilli i Lartë European në takimin e 14 dhe 15 Dhjetorit të vitit 2006 shfaqti mendimin “*që strategjia e zgjerimit e cila bazohet në kuptimin, në realizimin e kushteve të komunikimit, në kombinim me aftësinë e BE-së të bashkojë anëtarë të rinj, krijon bazën për një omofoni të re përsa i përket çështjes së zgjerimit*”.¹ Ritmi i këtij zgjerimi, vazhdoi Këshilli European, duhet të ketë parasysh aftësinë e Bashkimit në thithjen e anëtarëve të rinj. Këshilli European i bën thirrje Komisionit të paraqesë vlerësimet përkatëse për fushat e politikës përsa i përket kërkesës së anëtarësimit të një shteti dhe të marrëveshjeve për anëtarësim. Ndërkohë që Bashkimi zgjerohet, kompletimi i sukseshëm kërkon që të funksionojnë në mënyrë rezultative organet ligjore të BE-së dhe gjithashtu politikën që synojnë në bashkim të zhvillohen më tej dhe të financohen në mënyrë jetësore.

Çfarë rezultati² do të mund të merrej nga drejtimi i ri që piketoi BE në problemin kritik të zgjerimit të mëtejshëm? Sipas vlerësimit tim nuk mund të flasim për një kriter të ri i cili i referohet shtetit kandidat. E vetmja konsekuencë për shtetin kandidat që mund të paraqitet nga një mënyrë e re është që kriteret të bëhen më të rrepta. *Është e qartë që Bashkimi e shtrëngon shumë qëndrimin e tij ndaj shteteve kandidatë, duke pretenduar respektimin e plotë dhe të rreptë të kriterëve për integrim nga ana e shtetit kandidat. Në këtë mënyrë si rezultat shteti kandidat duhet të përshpëtojë përgatitjet e tij në mënyrë që të marrë përsipër anëtarësimin.*

1 Conclusions (point 4), disponibles sur le site internet du conseil de l'UE.

2 Lang K.O., Argumente für eine neue Erweiterungsstrategie – die Diskussion über die Aufnahmefähigkeit der EU, integration 2007, 117

Përsa i përket tani Bashkimit vetë, aftësia e tij të bashkojë shtete të reja duket jo si një kriter më tepër për anëtarësimin e shteteve të reja kandidatë por si një kriter i konceptueshëm, si një *sine qua non* për anëtarësime të reja. Këtu është dhe vatra e problemit: do të jetë e pakonceptueshme që shteti kandidat të plotësojë të gjitha kriteret e anëtarësimit dhe të mos pranohet nga Bashkimi sepse vetë Bashkimi nuk është i aftë, ose gati për anëtarësimin e shtetit kandidat. Atëherë pse filloi marrëveshjen e anëtarësimit? A është e konceptueshme që shteti kandidat në vend të dekorimit të përpjekjeve të tij të plotësojë paaftësinë e Bashkimit dhe të mos pranojë integrimin duke dënuar shtetin kandidat për përpjekjet e suksesshme të tijtë cilat, si përfundim vetë Bashkimi i kërkoi.

Përfundime

Kontradikta është e dukshme. Bashkimi European autokarakterizohet sot si një Bashkim principesh. Këto principe, të cilat tejkalojnë sistemin komun dhe bashkiak, ashtu si dhe principet e demokracisë, të shtetit të drejtës, të lirisë, solidaritetit të popujve etj. Këto janë principet e përbashkëta në bazë të së cilave u themelua kompletimi i Europës dhe nëpërmjet të së cilave rrezaton BE-ja në botë. Këto principe kushtëzojnë Bashkimin për një politikë të ndershme, transparente dhe të besueshme në sektorin e zgjerimit të mëtejshëm. Kur një shtet kandidat plotëson kriteret e anëtarësimit, atëherë asnjë arsye nga ana e Bashkimit nuk mund të ndalojë integrimin. Sigurisht që shteti kandidat nuk fiton të drejtën e anëtarësimit, as nuk parashikohet ndonjë mekanizëm kontrolli në procesin e integrimin nga ana e shtetit kandidat. Një sjellje e quajtur prej gentelmen-i nga ana tjetër e detyron Bashkimin të mos fshihet mbrapa dobësive të tij me synim që të pengojë në detyrimet e pa marra prej tij.

Kam përshtypjen se pas këtij bisedimi të ri mbi aftësinë e Bashkimit në pranimin e shteteve të reja kandidatë, prapafshihet “lodhja” e BE-se në ndërmarrjen me të njëjtin ritëm shpejtësi për sa i përket procesit të anëtarësimit. Është e qartë që Bashkimi po përballet me problemin e efikasitetit. Funksionimi i strukturës institucionale u krijua para 50 vjetësh dhe i referohej 6 shteteve të të njëjtit nivel të Europës qendrore. Sot situata është komplet ndryshe. Sot shtetet anëtare përbëhen nga shtete të pasura dhe të varfra, gjithashtu të tjera me prodhime bujqësore dhe industriale, disa në veri apo në lindje të Europës me kushte prodhimi komplet të ndryshme. Mundet si rrjedhojë të ekzistojë e njejta strukturë institucionale e cila ishte krijuar për 6 shtetet anëtare – fundamentale? Sigurisht që jo. Kemi nevojë urgjentisht për një frymëzim të ri i cili do të zgjidhë problemet e funksionimit të sukseshëm të Bashkimit me 30 e sipër shtete anëtare.

Sfida është në të vërtetë e madhe, sidomos mbas falimentimit të marrëveshjes për Kushtetutën Europiane e cila jepte një përgjigje të plotë të kërkesave për funksionimin e sukseshëm. Sipas mendimit tim, e gjithë kjo bisedë fsheh dobësinë e shteteve anëtare të sotme për të ecur bashkë, një linjë e përbashkët për 27 shtete anëtare është e vështirë për tu gjetur. Europa e shumë shpejtësive ose si ndryshe do të donte të quhej,

duket se mund të jetë e vetmja dalje nga labirinti i sotëm. Duket se është e pamundur të shkojmë të gjithë bashkë. Disa që nuk dëshirojnë ose që nuk mundën të vazhdojnë më tej duhet të ngelin mbrapa. Një politikan dikur deklaroi: lufta është një çështje shumë serioze për t'u besuar ushtarakeve.

Lexuesi le të më lejojë parafrazimin: ecja drejt Europës për një shtet është një çështje shumë e rëndësishme për t'ia besuar vetëm politikanëve. Shkenca në këtë rast thirret për të dhënë dhe të treguar zgjidhje. Atë që komiteti përshkruan si "komunikim" i cili do ti shfaqë popujve europianë avantazhet e kompletimit europian, duhet të shfrytëzojë shkenca në maksimum dhe të tregojë mënyra se si nëpërmjet një frymëzimi institucional do të drejtohem vazhdimisht në vëllazërinë e popujve europianë.

Shfaqja e antropologjisë heroike në historinë e ideve¹

Albert Doja²

ABSTRAKT. Në këtë artikull shfaqet kontributi i Claude Lévi-Strauss-it në antropologji. Lévi-Strauss-i e shndërroi antropologjinë në një projekt shkencor me një vlerë shumë më të sofistikuar intelektuale për të kuptuar njerëzimin sesa ç'mendohet apo sesa ka arritur më parë kjo fushë. Kontributi i tij përfaqëson rithithjen e kësaj fushe në qendrën e ideve perëndimore, përderisa ai e riformuloi antropologjinë si një projekt intelektual, një profesion të intelektualëve të kohës, në vend të një profili të specializuar me gjuhën, të dhënat, metodat, teknikat, dhe teoritë e tij të ralla. Sipas Clifford Geertz-it, asnjë antropolog nuk ka qenë më insistues sesa Lévi-Strauss-i në faktin se "praktika e profesionit të tij përbëhet nga një kërkim personal i drejtuar, nga një vizion personal dhe që synon shëlbimin personal."³ Në formën e mitit standard profetik të një kërkimi heroik me antropologun si hero, sipas Richard Shweder-it, Lévi-Strauss-i e shndërroi ekspeditën e tij në brendësinë e virgjër të Amazonës në një kërkim vizioni dhe e shndërroi antropologjinë në një mision shpirtëror për të mbrojtur njerëzimin kundër vetvetes.

Hyrje

Është thënë shpesh se Radcliffe-Brown dhe Malinowski pak a shumë me një goditje krijuan antropologjinë moderne. Kjo mund të ketë qenë e tillë në mesin e shekullit të njëzetë, kur antropologjia Boas-iane ishte shpërndarë në disa degë të specializuara ndërsa studentët e Marcel Mauss-it nuk e kishin lënë akoma gjurmën e tyre të ndjeshme në antropologjinë franceze. Studimet

- 1 Ky artikull është botuar për herë të parë në revistën *Journal of the History of Ideas*, vol 66 (4), 2005, pp. 633-650. Ai ri- botohet me rastin e njëqind vjetorit të lindjes së Claude Lévi-Strauss-it.
- 2 Dr. Albert Doja ka punuar në një sërë institucioneve kërkimore dhe në disa universitete perëndimore në Francë dhe në Angli, si University of Hull, University of Limerick, etj. Ai ka qenë gjithashtu edhe zv.Rektor i Universitetit të Durrësit. Dr. Doja ka botuar një sërë artikujsh shkencorë në disa nga revistat më serioze akademike në Britani dhe Francë. Për momentin ai gjithashtu jep mësim në Universitetin Europian të Tiranës (UET).
- 3 Geertz, *The Interpretation of Cultures*, 346.

Britanike të farefisnisë dukeshin në atë kohë të rrënjësura fort në metodën etnografike të Malinowski-t dhe teorinë e zhvilluar prej Radcliffe-Brown; këto studime ishin konsoliduar si një “shkencë e shoqërisë”. Sipas Eriksen dhe Nielse, antropologjia pësoi ndryshime thelbësore në vitet 1950-1960. Ri-konceptualizimet në ekonomi dhe politikë si dhe teori të reja mbi domethënien simbolike e transformuan këtë disiplinë.¹ Zhvillimet në Amerikën Veriore dhe Britani ishin të ndryshme nga njëra tjetra, por problemet e ngritura ishin shumë të ngjashme, prapëseprapë teoricieni i vetëm më i rëndësishëm ishte Francez.

Shpërthimi i Claude Lévi-Strauss-it që në vitet e para pas luftës si një mendimtar ekzemplar, si figura më e rëndësishme në historinë e antropologjisë dhe si antropologu “ekumenik” dhe “shembullor” i pjesës së dytë të shekullit të njëzetë, rrjedhimisht që luajti një rol shumë të rëndësishëm në rrethet intelektuale bashkëkohore dhe në disiplinën e antropologjisë në veçanti.² Në vitet 1950-të dhe 1960-të, për shumë arsye, jo më pak se vetë promovimi i mprehtë që Lévi-Strauss-i i bëri në rrethe më të gjera intelektuale, antropologjia u shndërrua në një nga pikat më të rëndësishme të referencës në diskutimet intelektuale në Francë, duke marrë pjesë në idetë më tërheqëse të asaj kohe që përkufizoheshin si strukturalizëm, i cili kishte si ambicie që të pajiste shkencat shoqërore me një rigorozitet dhe forcë të krahasueshme me atë të shkencave natyrore.

Për më tepër, audienca e “pashoqe” intelektuale dhe fama ndërkombëtare që Lévi-Strauss-i ka arritur në antropologji ka influencuar jashtëzakonisht jo vetëm antropologjinë, por edhe degë të tjera të dijes humane, që nga historia dhe psikoanaliza deri te filozofia dhe studimet letrare. “Kontributi i punës së tij mbi konceptin e kulturës, mbi kuptimin tonë të gjuhës dhe proceseve mendore, të interpretimit tonë të historisë është aq direkt dhe inovator saqë, sipas George Steiner-it, njohuria mbi Lévi-Strauss-in është bërë pjesë e njohurive të përgjithshme që duhet t’i ketë kushdo.”³ Puna e tij ka sjell një shkëputje epistemologjike me metodat e mëparshme analitike dhe kjo mund të quhet edhe si një revolucion antropologjik.

Një aspekt i nënvlerësuar i punës së Lévi-Strauss-it është se formulimi i tij origjinal i metodës strukturaliste trajtonte probleme specifike rreth pozitës së antropologjisë si fushë, jo vetëm probleme të teorisë antropologjike, por më gjerësisht të çështjes së natyrës dhe kompetencave të antropologjisë dhe të raportit të saj me shkencat e tjera humane. Duket se Lévi-Strauss-i synon gjithmonë të thotë diçka më të përgjithshme mbi natyrën e fushës që ai praktikon, mbi pikat e saj të referencës dhe kërkesat e saj shkencore dhe humaniste, në një mënyrë esencialisht gjithëpërfshirëse të të menduarit.⁴ Ai nuk mjaftohet që të shprehet vetëm në emrin e vet dhe në emrin e perceptimit të tij lokal, por është i aftë të shprehet edhe në emër të një kolektivi, në emrin e antropologjisë,

1 Thomas H. Eriksen and Finn. S. Nielsen, *A History of Anthropology* (London: Pluto Press, 2001), 95.

2 Stanley Diamond, “The Inauthenticity of Anthropology: The Myth of Structuralism,” in *In search of the Primitive: A Critique of Civilization* (New Brunswick, NJ.: Transaction Books, 1974), 292-331.

3 Geroge Steiner, *Language and Silence: Essays on Language, Literature and the Inhuman* (London: Faber, 1967), 250.

4 Johnson, Claude Lévi-Strauss, 181.

në mbrojtje të asaj çka beson të jetë kontributi i tij i veçantë në dijen bashkëkohore, aq sa përfundimet e tij kanë kontribuar “më tepër në ndryshimin e sensit të antropologjisë mbi veten sesa të sensit të saj mbi subjektin e saj.”¹ Aftësia për të bërë sinteza, vështrim të përgjithshëm, thënie refleksive mbi atë çka është një fushë e caktuar dijesh dhe se çfarë mund të jetë ajo, është një nga tiparet thelbësore të Lévi-Strauss-it, i cili nuk është thjesht riprodhues idesh dhe teorish, por, në mënyrë të padiskutueshme, një mendimtar me shumë influencë, një *maitre a penser* (mjeshtër mendimi).

Lévi-Strauss-i e shndërroi antropologjinë në një projekt shkencor me një vlerë shumë më të sofistikuar intelektuale për të kuptuar njerëzimin sesa ç'mendohet apo sesa ka arritur më parë kjo fushë. Kontributi i tij përfaqëson rithithjen e kësaj fushe në qendrën e ideve perëndimore, përderisa ai e riformuloi antropologjinë si një projekt intelektual, një profesion të intelektualëve të kohës, në vend të një profili të specializuar me gjuhën, të dhënat, metodat, teknikat dhe teoritë e tij të ralla. Zhvillimi i vetë strukturalizmit është historikisht i pandashëm nga prestigji i antropologjisë. Strukturalizmi lindi si një alternativë ndaj marksizmit dhe fenomenologjisë, dhe impakti i tij në përgjithësi mbi jetën intelektuale ishte të paktën po aq i theksuar sa në antropologji. Në Francë, studiues të rëndësishëm si Lakan, Barthes, Foucault, dhe Bourdieu u ushqyen me strukturalizmin, u rebeluan kundër tij, dhe rebelimi i tyre është njohur dhe debatuar nga antropologë që i përfshinë këta autorë në veprat klasike të antropologjisë.

Konteksti intelektual

Në Francë, me botimin e *Të Qënurit dhe Asgjëja* dhe *Fenomenologjia e Perceptimit*, fenomenologjia mbizotëronte jetën intelektuale në formën e ekzistencializmit, i cili arriti të bëhej një lëvizje gjithëpërfshirëse filozofike nën drejtimin karizmatik të Jean Paul Sartre-it.² Fenomeni i strukturalizmit tërhoqi vëmendjen e inteligjencës pariziane nga fundi i viteve 1950 dhe 1960 dhe vendosi kornizat e debatit intelektual për një dekadë të tërë. Debatet që zhvilloheshin rreth ekzistencializmit dhe strukturalizmit në vitet 1960 përbënin një kundërvënie dialektike tipike midis shkollave të ndryshme të mendimit që kishte qenë një tipar konstant i jetës intelektuale në Francë.³ Me kombinimin e tij të shkencës me humanizmin, strukturalizmi u konsiderua si pasardhësi i logjikshëm i ekzistencializmit. Vëllimi i parë i *Antropologjisë Strukturale*⁴ të Lévi-Strauss-it në njëfarë mënyre u shfaq në atë kohë si manifestoja e strukturalizmit dhe për Lévi-Strauss-in atëhere flitej si për një

1 Clifford Geertz, *Works and Lives: The Anthropologist as Author* (Stanford, Calif.: Stanford University Press, 1988), 25.

2 Jean Paul Sartre, *L'Être et le Néant: essai d'ontologie phénoménologique* (Paris: Gallimard, 1943); Maurice Merleau-Ponty, *Phénoménologie de la perception* (Paris: Gallimard, 1945).

3 Johnson, *Claude Lévi-Strauss*, 107-8.

4 Claude Lévi-Strauss, *Antropologie Structurale* (Paris: Plon, 1958).

filozof, si themeluesin e strukturalizmit, në të njëjtën mënyrë që Sartre-i konsiderohej themeluesi i ekzistencializmit.

Strukturalizmi ishte një reagim ndaj prirjes dominuese të fenomenologjisë në filozofinë franceze në vitet e pasluftës. Në këtë kuptim, është e pamundur të kuptohet suksesi fenomenal i strukturalizmit në Francë pa iu referuar hegjemonisë së mëparshme të ekzistencializmit. Strukturalizmi, pra është një refuzim pikë për pikë i ekzistencializmit. Në përgjithësi, filozofët e pasluftës e të njëjtës gjeneratë si Lévi-Strauss-i formuluan të njëjtat kundërshtime si ai ndaj filozofisë tradicionale, me një fjalë ndaj sistemit të kontrasteve të rreme dhe të pakapërcyeshme midis subjektit dhe objektit që gjithmonë riprodhojnë të njëjtat koncepte të ngushta dhe që pengojnë çfarëdolloj pune kërkimore. Por një koshiencë që ishte reduktuar në shprehjen karteziane “unë mendoj”, fenomenologjia e zëvendësoi me një koshiencë që i hapej eksperiencës trupore dhe ngjarjeve historike. Subjekti ishte i prekshëm nëpërmjet perceptimit dhe eksperiencës. *Cogito* e Descart-it ia la vendin *percipio* –s të Merleau-Ponty-s, *praxis* të Sartre-it dhe *gramma* të Derrida-së. Për më tepër, ndërsa ekzistencializmi i Sartre-it dhe gramatologjia e Derrida-së ishin të rrënjosura në terrenin e zakonit të filozofisë perëndimore, për Lévi-Strauss-in projekti i antropologjisë strukturale dhe shkencat shoqërore përbënin një shkëputje nga metafizika, një refuzim të problemeve tradicionale filozofike në mënyrë që të ndiqej një hulumtim shkencor i sjelljes njerëzore.

Strukturalizmi mbi të gjitha ishte mishërimi i një gare dhe korrespondonte me një moment të historisë perëndimore ku shprehej një urrejtje ndaj vetvetes, një refuzim i kulturës tradicionale perëndimore, dhe një shpresë për një modernizëm në kërkim modelesh të reja. Strukturalizmi i kundërvuri glorifikimit të vlerave të vjetra një lloj ndjeshmërie ndaj gjithçkaje të shtypur gjatë historisë perëndimore, të kundërtën e domethënies së shprehur, anën e represionuar dhe të pakapshme të natyrës njerëzore. Foucault-ja, në veprën e tij *Fjalët dhe Sendet*, saktësisht e përshkroi psikoanalizën e Lacan-it dhe antropologjinë e Lévi-Strauss-it si të frymëzuara “nga parimi i vazhdueshëm i ankthit, i ngritjes së pikëpyetjeve, i kritikës dhe kontestimit të gjithçkaje që duket si e natyrshme.”¹ Nga ky këndvështrim, zgjedhja e modelit lingvistik nga Lévi-Strauss-i nuk është e rastësishme pasi një nga parimet më revolucionare që lingvistika strukturale ka sjellë në metodologjinë shkencore është pikërisht zhvendosja e fokusit kërkimor nga niveli i lingvistikës koshiente në atë të infrastrukturës subkoshiente. Mënyra e konceptualizimit të marrëdhënieve subkoshiente që zbulon analiza strukturale e Lévi-Strauss-it është intuitivisht përfytyrimi më i kuptueshëm i subkoshiencës.²

Rënia e fuqive evropiane dhe valët e dekolonizimit pas Luftës së Dytë Botërore ndikuan që shumë veta të vinin në pikëpyetje vlerat, superioritetin e kulturës dhe koshiencës evropiane duke kritikuar etnocentrizmin e saj. Në këtë kontekst ishte mëse logjike që antropologjia, në rolin e saj ndërmjetësues të kulturave jo-perëndimore, të bëhej vatra e këtyre kritikave dhe pikëpyetjeve. Në fakt, antropologjia strukturale justifikohet si një

1 Michel Foucault, *Let mots et les choses: une archéologie des sciences humaines* (Paris: Gallimard, 1966), 385.

2 Claude Lévi-Strauss, “L’analyse structurale en linguistique and en anthropologie,” in *Anthropologie structurale* (Paris: Plon, 1958), 40.

shkencë humane e kulturave jo-perëndimore falë eksperiencës moderne të tjetërsimit (alienimit) dhe sjell pra një formë alternative humanizmi. Ky humanizëm i ri që Lévi-Strauss-i synoi ta përcjellë në “tërë përmasat e njerëzimit” ndërthur ambicien për një analizë shkencore me detyrimin për një ndërgjegje globale.¹ Vizioni i njerëzimit sipas Lévi-Strauss-it ishte më i gjerë sesa ai i humanizmit të filozofisë tradicionale. Duke u fokusuar në konceptin e individit si karakteristikë kulturore, ai përmbushte akoma më mirë atë universalizëm që pretendonte humanizmi i vjetër.

Në fakt, humanizmi i vjetër, siç mishërohej në figurën e Sartre-it, dukej krahasimisht më i ngushtë, si në kufizimin e tij mbas një tradite specifike të filozofisë perëndimore, ashtu edhe në mungesën e interesit ndaj zhvillimeve të reja të shkencës bashkëkohore. Humanizmi i ri i antropologjisë së Lévi-Strauss-it ndërthuri rigorozitetin shkencor me një vizion më të gjerë të njerëzimit, duke vepruar njëkohësisht si ndërgjegje dhe koshiencë e civilizimit perëndimor, ndërsa përcaktonte një rol më modest për individin.

Në këtë kuptim, misioni shkencor i antropologjisë strukturale nuk mund të përjashtojë marrjen në konsideratë të çështjes së vlerave dhe të ideologjisë. Për Lévi-Strauss-in, antropologjia strukturale si shkencë humane dhe si humanizëm nuk janë në kundërshtim me njëra tjetrën. Ndërthurja e epistemologjisë me etikën tek vepra e Lévi-Strauss-it, në mënyrën sesi ai e ndërthurte eksperiencën e tij jetësore me punën e tij teorike, zotëron një përmbledhje didaktike dhe një unitet metodologjike që shkon përtej programit të ngushtë shkencor të strukturalizmit. Është e evidente se paradigma e antropologjisë strukturale nuk mundet thjesht të njehsohet me fushën e strukturalizmit, por përbën diçka komplet tjetër dhe më komplekse.

Që nga vitet 1960, strukturalizmi lulëzoi edhe në fusha të tjera dhe shumë shpejt u shndërrua në një formë (shpesh të kritikueshme) mode intelektuale, filozofike dhe letrare me të gjitha shtrembërimet dhe thjeshtëzimet që shoqërojnë këtë lloj popullarizimi. Lévi-Strauss-i gjithmonë e distancoi veten dhe ia mohoi atësinë e tij pasioneve ideologjike që i hapën rrugën modës strukturaliste. Ai vazhdimisht insistonte se strukturalizmi që u zhvillua në Francë në fund të viteve 1950 dhe fillimi i viteve 1960 duhet të dallohej nga ai strukturalizëm që ai u përpoq të arrinte në antropologji.

Shpesh atij i kërkohet të përshkruante fusha dijesh, të cilat ai nuk i zotëronte mirë, metoda që ai nuk i njihte ose këndvështrime që nuk kishin asnjë të përbashkët me karakterin teknik të punës së tij kërkimore. Së fundi, ai e kuptoi sesi këto lloj modash intelektuale mund të dëmtonin publikisht dhe akademikisht rigorozitetin dhe vlerësimin e qetë të punës së tij. Ishte kjo arsyeja përse ai në shumicën e rasteve vendosi të rrinte i tërhequr dhe larg kësaj zhurme intelektuale. Padyshim i preokupuar që të kishte kontroll mbi trashëgiminë e punës së tij, ai mjaftohej vetëm me korigjime të sulmeve të keqinformuara mbi praktikën e tij rreth analizës strukturale, dhe përfshihej vetëm në debate në antropologji apo në fushat e përafërta, të cilat shtronin pyetje precize dhe kritika me vend ndaj ti dhe ndaj vetes së tyre.

1 Claude Lévi-Strauss, “Le champ de l’antropologie,” in *Antropologie structurale deux* (Paris: Plon, 1973 [New York: Basic Books, 1976]), 44 [32].

Për Lévi-Strauss-in strukturalizmi s'ishte gjë tjetër veçse një kornizë e ngushtë e një projekti brilant. Në thelb, vepra e tij është njëkohësisht më modeste, më e kujdesshme, dhe shumë më domethënëse për dijen antropologjike, edhe pse stili i saj mbetet një përzierje baroke e ekuilibrit me gjallërinë shpotitëse. Edhe nëse strukturalizmi mund të ketë pasur njëherë e një kohë një rol të dobishëm, sot për sot ai është kthyer në një pengesë e zhvillimit të plotë të ideve për të cilat antropologjia i mbetet borxhlike Lévi-Strauss-it. Qasja e tij huazoi më pak parime të përgjithshme sesa një qëndrim intelektual egzigjent dhe guximtar. Falë këtij qëndrimi dhe një sërë intuitash të mprehta, puna teorike i ofroi atij mundësinë joshëse për të kërkuar rregull dhe kaos dhe për të dhënë një kontribut shumë të përgjithshëm, por edhe shumë personal ndaj antropologjisë.

Nëse antropologjia kulturore konsiston në studimin e rregullave dhe shpalosjen e ligjeve nëpërmjet analizës së disa aspekteve të jetës sociale apo të materializimit kulturor vlefshmëria e të cilëve testohet edhe në aspekte të tjera, atëhere nuk është një pyetje e strukturalizmit ideologjik ajo që do të sillte një mesazh apo të ofronte një filozofi të përgjithshme mbi njeriun. Qasja epistemologjike e Lévi-Strauss-it synon të jetë veçse një metodë rigorozë që i afrohet dijes shkencore dhe që thjesht kërkon të shtojë një nivel rigoroziteti në një fushë studimi ku kjo ka munguar më parë. Disa pjesë të veprës së tij pa dyshim i afrohen ekselit të optimizmit metodologjik, ku analiza strukturale në dukje shkrihet me vetë shkencën, mënyrat mbretërore të së cilës, përfshirë këtu edhe matematikën, përfundimisht iu hapën fushave të dijes që deri tani kishin qëndruar rebele. Gjithsesi ai nuk përzieu asnjëherë skemën e një sistemi të ri dogmatik me frymëzim shkencor me disa digresione më personale që ai këndshëm i cilësoi si "shkelje pa leje në territorin e gjuetisë së filozofisë," pavarësisht thellësisë së mendimit që mund të shprehnin ato.

Thithja dhe zhvillimi i teorive stimuluese dhe të diskutueshme të Lévi-Strauss-it tërhoqën vëmendjen e një sërë antropologëve të talentuar jo vetëm në Francë, por edhe në Britani e më tej. Një nga ironitë e historisë së interpretimit të veprës së Lévi-Strauss-it në antropologji është se ai shpesh është kritikuar nga kolegët e tij francezë për lidhjen e tij të panevojshme me traditën "anglo-saksone", ndërsa kolegët e tij anglisht-folës e kanë kritikuar atë për tendencën e tij "franceze" për të spekuluar, abstraguat dhe përgjithësuar.¹

Edhe pse antropologjia britanike është mësuar tanimë me huazimin e teorive nga Franca, vepra e Lévi-Strauss-it arriti një abstraksion të atillë sa që hezitimi pothuajse i natyrshëm britanik mund të tejkalohet vetëm nga elokuenca shpotitëse e Edmund Leach-it. Ndër të tjera, në hyrjen e një botimi me ese nga antropologë britanikë që aplikonin teorinë e mitit të totemizmit nga Lévi-Strauss-i, Leach-i komentoi se disa nga kontribuesit nuk dukeshin se kishin lexuar ndonjë gjë të Lévi-Strauss-it dhe që kritika e tyre varej "ose nga arroganca angleze ose thjesht nga keqinformimi."² Ishte

1 Johnson, *Claude Lévi-Strauss*, 9.

2 Edmund Leach (ed.), *The Structural Study of Myth and Totemism, A.A.A. Monographs*, 5 (London: Tavistock, 1967), xv.

pikërisht kjo paraqitje e shkrimeve të Lévi-Strauss-it, mbase më cilësorja ndër shumë të tjera, e cila e zgjeroi shumë njohurinë e veprës së Lévi-Strauss-it në botën anglisht-folëse.¹

Leach-i ka qenë antropologu më entuziast dhe krijues britanik që eksperimentoi me aplikimin e metodave strukturale ndaj tematikave të reja antropologjike dhe që u përpoq shumë për t'i bërë idetë e strukturalizmit të kuptueshme për një publik të gjerë.² Lévi-Strauss-i vetë ka komentuar shumë mbi farefisninë ndër Kachin (objekti i studimit të Leach-it) ndërsa Leach-i e kishte kuptuar menjëherë vlerën e përfundimeve të Lévi-Strauss-it edhe për studimet e tij.³ Ashtu siç rrefeu edhe vetë më vonë, “ajo çka më habiti në atë kohë ishte fakti se Lévi-Strauss-i kishte perceptuar shumë më qartë se unë disa tipare thelbësore të strukturës së shoqërisë Kachin.”⁴ Rodney Needham-i ishte gjithashtu një entuziast i Lévi-Strauss-it, edhe pse me pak rezerva, të cilat u forcuan edhe më tepër nga vetë Lévi-Strauss-i, i cili e hidhte poshtë interpretimin e teorisë së tij të farefisnisë nga Needham-i. Të gjitha rezervat e këtij të fundit jo vetëm që nuk u zhdukën, por përkundrazi ato morën formën e një çështjeje kombëtare dhe shumë antropologë britanikë iu kundërvunë Lévi-Strauss-it me ashpërsi. Edhe pse shumë më pozitiv ndaj Lévi-Strauss-it, Leach-i gjithashtu ngriti shumë polemika kundër tij, shpeshherë shumë provokative.

Tek strukturalizmi, ama, Leach-i dhe shumë të tjerë zbuluan një alternativë shumë të sofistikuar të empirizmit britanik. Jo rastësisht, pasioni britanik për antropologjinë strukturale të Lévi-Strauss-it shoqërohej nga një refuzim pothuajse organik i funksionalizmit struktural të Radcliff-Brown-it. Needham-i⁵ i dedikoi këtij të fundit një mერი patologjike ndërsa në leksionin Radcliff-Brown në Akademinë Britanike, Leach-i⁶ e paraqiti admirimin e tij për Lévi-Strauss-in si një rrjedhim logjik të përbuzjes që kishte për Radcliff-Brown-in. Suksesi që patën Leach-i dhe Needham-i, dhe më vonë Mary Douglas-i,⁷ në konvertimin e studentëve më të shkëlqyer kundrejt ideve të Lévi-Strauss-it lehtësohej shumë nga entuziasmi pothuajse religjioz i tyre ndaj Lévi-Strauss-it:

1 Edmund Leach, *Claude Lévi-Strauss* (London: Fontana/Collins, 1970)

2 Edmund Leach, *Culture and Communication: The Logic by which Symbols are Connected* (Cambridge: Cambridge University Press, 1976).

3 Edmund Leach, *Political Systems of Highland Burma: A Study of Kachin Social Structure* (Cambridge, Mass: Harvard University Press/London School of Economics and Political Science, 1954)

4 Edmund Leach, “Telstar et les aborigines ou la Pensee sauvage,” in *Anthropology and Society*, ed. Stephen-Hugh-Jones and James Laidlaw (New Haven, Conn.: Yale University Press, 2000), 121.

5 Rodney Needham, *Struktura dhe Ndjenja: Një Rast Testi në Antropologjinë Sociale* (Chicago: University of Chicago Press, 1962).

6 Edmund Leach, “Social Anthropology: A Natural Science of Society? [British Academy Radcliffe-Brown Lecture],” in *Anthropology and Society*, ed. Stephen Hugh-Jones and James Laidlaw (New Haven, Conn.: Yale University Press, 2000).

7 Mary Douglas, *Purity and Danger: An Analysis of Concepts of Pollution and Taboo* (London; Routledge & Kegan Paul, 1966)

“Strukturalizmi arriti të ketë elemente të një lëvizjeje fetare dhe disa nga pasuesit e tij ndjenë se u bënë pjesë e një shoqërie sekrete e atyre që ishin në gjendje të shikonin në një botë të verbërish. Konvertimi nuk ishte thjesht çështje e pranimit të paradigmes së re. Mbi të gjitha, ishte pothuajse një çështje shëlbimi”.¹

Shtetet e Bashkuara ishin padyshim më pak të përshkueshme nga idetë dhe teoritë e antropologëve francezë, edhe pse Lévi-Strauss-i si “amerikanist i vetë-përfshirë” mund të konsiderohet deri diku si pasardhës i traditës së Franz Boas-it.² Siç na rikujton edhe Adam Kuper-i, kush përveç Boas-it do të merrte mundimin të botonte fletë të tëra me receta embëlsirash me mana të grupit indigjenas Kwakiutl në gjuhën e tyre mëmë, dhe kush tjetër përveç Lévi-Strauss-it do të kishte interes të ri-analizonte këtë material?³ Vërtet se analizat dhe kritikrat e Lévi-Strauss-it kanë qenë të zakonshme dhe që vepra e tij është diskutuar nga antropologë amerikanë si dhe nga të tjerët. Ndër të tjera trajtimi më gjithëpërfshirës është kapitulli mbi “të egrin e mënçur” të Clifford Geertz-it, i cili paraqet një rilexim origjinal të veprës së Lévi-Strauss-it.⁴ Marshall Sahlins-i, që fillimisht ishte influencuar nga marksizmi struktural dhe neo-evolucionizmi, është një nga të parët që në kritikën e tij ndaj marksizmit për pamundësinë e tij për të shpjeguar themelet e “shoqërisë tribale” konsideroi strukturalizmin si me avantazhe në këtë aspekt.⁵ Edhe pse ende e pafuqishme që të kapë ndryshimin “struktura është fillimi i urtësisë historike” dhe Sahlins-i ishte nga të parët që u mundua ta bënte antropologjinë strukturale më historike.⁶

Megjithatë, krahina e kulturalizmit ishte në konflikt me idenë se logjika e simbolizmit mund të rridhte prej mendjes njerëzore. Shumica e antropologëve anglo-amerikanë në fakt ishin shumë dyshues ndaj Lévi-Strauss-it. Edhe pse të sfiduar nga supozimet e këtij, ata ishin të revoltuar nga mënyra selektive e zgjedhjes së të dhënave nga Lévi-Strauss-i; të tërhequr nga stili i tij brilant letrar, ata nervozoheshin nga arroganca që ata shihnin si në kontradiksion me humanizmin e Lévi-Strauss-it; dhe të joshur nga pikëpyetjet e tij filozofike, ata ndjenin mosbesim dhe pothuajse turp kur ballafaqoheshin me ngushtësinë në të cilën koncepti i tij i strukturës arrin të kthejë një rrjetë shumëpalëshe të problemeve të simbolizmit dhe historisë njerëzore.⁷ Në një masë të madhe të gjithë u provokuan nga modelet abstrakte dhe të logjikës deduktive dhe, edhe pse ata nuk ishin dakort me presupozimet e pazakonta mbi martesën apo përmbledhje tendencioze të një seleksioni mitesh, shumica mbeten të impresionuar

- 1 Adam Kuper, *Anthropologists and Anthropology: The Modern British School*, 3rd ed. (London/New York: Routledge, 1996), 215.
- 2 Regna Darnell, *Invisible Genealogies: A History of Americanist Anthropology* (Lincoln: University of Nebraska Press, 2001), 282.
- 3 Kuper, *Anthropologists and Anthropology*, 223.
- 4 Clifford Geertz, *The Interpretation of Cultures* (New York: Basic Books, 1973), 345-59.
- 5 Marshall Sahlins, *Culture and Practical Reason* (Chicago: University of Chicago Press, 1976).
- 6 Marshall Sahlins, *Historical Metaphors and Mystical Realities: Structure in the Early History of the Sandwich Island Kingdom* (Ann Arbor: University of Michigan Press, 1981).
- 7 Eleanor B. Leacock, “Structuralism and Dialectics,” *Reviews in Anthropology*, 5 (1978), 117-28.

nga stili joshës i tij, i cili ndërthur mendime të gjera filozofike, thënie koncize teorike dhe një diskutim mbresëlënës dhe eksplorues të materialit mitik dhe social. Clifford Geertz-i për shembull, pavarësisht “sketicizmit [të tij] të pranuar kundër projektit strukturalist si një program kërkimor” dhe “armiqësisë së hapur [të tij] ndaj këtij projekti si një filozofi e mendjes” bën të qartë se ai e shikon “ndërtimin [nga Lévi-Strauss-i] e një fushe të tërë ligjërimi nga një pikënisje e caktuar si një arritje marramendëse, tërësisht e denjë për vëmendjen e merituar.”¹

Kritika anti-strukturale

Që nga fillimi Lévi-Strauss-i ishte një autor mjaft i diskutuar dhe me influencë, dhe sidomos sfida e tij ndaj antropologjisë pozitiviste ka ende shume influencë. Megjithë literaturën shumë të gjerë dytësore mbi Lévi-Strauss-in, ende ka shumë debat mbi vlefshmërinë e metodave të Lévi-Strauss-it, të cilat mund të duken si të mundshme në teori, por që paraqesin vështirësi praktike shumë të rëndësishme.

Kritikat e vepresë Lévi-Strauss-it ndahen në dy kategori kryesore, pasi kundërshtarët e kësaj metode nënçmojnë jo vetëm indiferencën në dukje të strukturalizmit ndaj historisë, por edhe modelin e tij kufizues të koshiencës dhe të papërshtatshmërisë së saj empirike. Një nga kritikantët e para serioze, e shprehur fillimisht në polemikat e Jean-Paul Sartre-it në *Kritiken e Logjikës Dialektike*, i drejtohej konceptit të kufizuar të Lévi-Strauss-it për sa i përket historisë.² Kritika më shpartalluese erdhi nga Jacques Derrida-ja në *Gramatologjinë*, ku ai theksoi formalizmin e shtjelluar dhe të gënjeshtërt të universalizmave që supozon strukturalizmi dhe që janë shembuj veçse të miteve të traditës filozofike “fonologjike” dhe “logocentrice” perëndimore.³ Rishtazi dhe në mënyrë metodike Derrida-ja sulmoi strukturalizmin dhe një sërë vepra të Lévi-Strauss-it që i akuzoi se nuk kishin marrë parasysh “lojën” e lirë të kuptimit të shenjës.⁴

Është sidomos çështja e raportit subjekt – objekt aty ku debati është më i ashpër pasi filozofët dyshojnë se Lévi-Strauss-i e reduktonte njeriun dhe veprat e tij thjesht në një reflektim objektiv. Nga pikëpamja e fenomenologjisë, ata fajësojnë qasjen strukturale për varfërimin e praktikës sociale ose për pazotësinë për të arritur nivelin interpretativ të kuptimit. Eksportuar në botën anglisht-folëse pyetja kritike u bë ajo e inisjativës, e “kush” përdor “çfarë” dhe në ç’masë, “çka” mund të bëhet e pavaruar nga “kush”. Eiseistë dhe filozofë me horizonte të ndryshme e dënuan analizën strukturale si një doktrinë që mohon lirinë prodhimit të kuptimit dhe të autonomisë së praktikës individuale, aftësia vepruese njerëzore kështu bëhej komplet e varur në perceptimin e realitetit dhe ndërgjegjes nga ligje universale ngritur mbi një logjikë që ekziston paraprakisht.

1 Geertz, *works and Lives*, 27.

2 Jean-Paul Sartre, *Critique de la Raison Dialectique* (Paris: Gallimard: 1960).

3 Jacques Derrida, *De la grammatologie* (Paris: Minuit, 1967).

4 Jacques Derrida, *L'écriture et la différence* (Paris: Seuil, 1967), 409-28.

Ndërsa ekzistencializmi i Sartre-it preokupohej më shumë me eksperiencën e subjektit në botë duke theksuar rëndësinë e situatës historike dhe të nevojës së zgjedhjes dhe përgjegjësisë individuale, strukturalizmi fokusohej në strukturat inkoshiente që paraprinin veprimin individual dhe që rezistonin koincidencën historike, dhe të paktën në parim, qëndronte afër çështjeve të natyrës morale dhe etike. Sartre-i kritikonte abstragimin e analizës strukturale dhe objektifimin që i bënte ajo eksperiencës njerëzore, e cila neglizhonte realitetet dialektike të marrëdhënieve konkrete dhe proceseve historike.¹ Sipas tij, prioriteti që i jepej strukturave autonome dhe inkoshiente e dehumanizonte subjektin dhe përjashtonte çdo mundësi veprimi individual.² “Vdekja e subjektit” ishte në fakt një temë e preferuar e strukturalizmit francez gjatë viteve 1960. Për sa i përket natyrës së izomorfizmit të Lévi-Strauss-it midis ligjeve të universit dhe ato të mendjes, Paul Ricoeur-i u shpreh që në fillim se këtu i bëhej homazh inkoshiencës Kantiane:

“Jo një subkoshiencë freudiane e impulseve instiktive dhe erotike dhe të forcës së saj të simbolizimit, por një subkoshiencë kategorike dhe kombinuese për sa i përket organizimit të saj, meqë këtu jemi të preokupuar me një sistem kategorik që nuk i referohet një subjekti që mendon; është kjo arsyeja pse strukturalizmi si një filozofi prodhon një lloj intelektualizmi që është thelbësisht anti-reflektiv, anti-idealist dhe anti-fenomenologjik”.³

Strukturat synojnë përputhjen nëpërmjet predispozitave mendore hipotetike që reflektojnë njëra-tjetrën dhe duke reflektuar njëra tjetrën në mënyra të ndryshme. Në skemën e Lévi-Strauss-it duket të mos ketë ndonjë ndryshim në zhvillim, por thjesht permutacione dhe kombinime. Në *Tristes Tropiques*, kur ai e lidhte marksizmin dhe impulse të tjera kryesore të zhvillimit të tij intelektual dhe të konceptit të tij të etnografisë, ai preokupohej nga e njëjta pyetje kryesore: “Atë të raportit midis ndjenjës dhe arsyes, eksperiencës dhe racionalitetit, dhe synimi ishte i njëjtë: të arrihej një lloj super-racionalizmi, i cili do të integronte të parën me të dytën pa sakrifikuar asnjë karakteristikë të saj.”⁴

Kjo mund të jetë një mënyrë shumë abstrakte për të thënë se marksizmi ishte një etiologji, një përpjekje për të ndjekur gjurmët e kushteve të shoqërisë, të ambientit material dhe të ndërgjegjes njerëzore në burimet e tyre të fshehura. Marrëdhëniet sociale dhe përfaqësimet kolektive janë koordinatat parësore të teorisë së Lévi-Strauss-it, i cili sugjeron më tej se vetë marksizmi është veçse një rast i pjesshëm i një teorie më të përgjithshme të komunikimit. Kjo teori do të jetë korniza e një sociologjie vërtet racionale dhe gjithëpërfshirëse. Jo rastësisht, marksistët i kanë kritikuar pretendimet e teorisë së Lévi-Strauss-it dhe kanë sulmuar aspektet e saj “iracionale” dhe “anti-historike”.

1 Jean-Paul Sartre, *Critique de la Raison Dialectique* (Paris: Gallimard, 1985), 490-93.

2 Jean-Paul Sartre, “L’anthropologie,” in *Situations* (Paris: Gallimard, 1972), 9:83-89.

3 Paul Ricoeur, *Le conflit des interprétations: essais d’hermeneutique* (Paris: Seuil, 1969), 37.

4 Claude Lévi-Strauss, *Tristes Tropiques* (Paris: Plon, 1955), 62.

Nuk mjaftonte, pra që thjesht të përcaktoheshin strukturat farefisnore apo kornizat mendore; ishte po aq i rëndësishëm procesi nëpërmjet të cilit janë prodhuar dhe riprodhuar këto. Nëpërmjet farefisnisë Lévi-Strauss-i kishte trajtuar këtë çështje duke theksuar reciprocitetin dhe martesën ndër-kushërinj. Duke e anashkaluar atë në studimet e tij të intelektit, me formulën e “formës që imponohet mbi përmbajtjen”¹ Lévi-Strauss-i mendohet të ketë rënë vetë viktimë e metodologjisë së vetë.²

Gjithsesi, nëse metodat e Lévi-Strauss-it dhe Marx-it theksojnë forcën determinuese të strukturave të fshehura, sot kjo mund të quhet jo më shumë se një truizëm shkencor. Strukturalizmi duket se ia mohon domethënien fenomeneve sipërfaqësore si për shembull veprimeve dhe praktikës sociale pasi e konsideron domethënien si një aftësi të strukturës së thellë dhe si të pa-modifikueshme nga eksperiencia. Divorci i analizës strukturale në formën e saj Lévi-Strauss-ian nga këto diskutime, ashtu si edhe divorci i vetë strukturës nga format sociale dhe kulturore që supozohet të jenë mbartësit e tyre, mendohet të rezultojë si pasojë e përkushtimit a priori të Lévi-Strauss-it ndaj ideologjisë së Saussure-it.³ Zhvendosja e konceptit të strukturës jashtë konstrakteve kulturore konkrete do të thotë në fakt se sistemet sociale apo kulturore janë me përkufizim të ndara nga çfarëdolloj marrëdhënie me ndërgjegjen subjektive, domethënien interpretative, aktet sociale apo organizimi social. Këto ndarje pra konvergojnë me kontrastet thelbësore të ideologjisë linguistike të Saussure-it, inter alia ndarja e mendimit nga veprimi, kulturës nga shoqëria, paradigma nga sintagma, teksti nga konteksti, struktura nga procesi historik dhe subjektiviteti nga strukturat e ndërgjegjes.

Për më tepër, duke konsideruar se Lévi-Strauss-i huazoi përfundimet esenciale të analizës strukturale nga linguistika, kritikët e shohin si paradoks që gjuha, tematika kryesore e fushës së linguistikës, nuk u përfshi fare në imagjinatën e tij. Disa thonë se ashtu sikurse edhe Durkheim-i, ai dështoi t’i jepte zgjidhje kritikës së linguistikës historike se metoda komparative paraqet metodën më të përafërt “shkencore” të mundur në shkencat shoqërore.⁴ Të tjerë mendojnë se ai nuk e konsideron fare gjuhën si sistem komunikimi nëpërmjet të cilit krijohen dhe manipulohen simbolet në procese si bindja apo qortimi, kërkimi i mbështetjes në mendim, katarzit, shijimit, apo përpjekjet për të kuptuar situata të ndryshme. Në shpjegimet e tij nuk ka shumë vend për ndjenjat, për mrekullitë, gëzimet, dhimbjen dhe dashurinë. Edhe pse gjithmonë i preokupuar me domethënien, ai supozonte të reduktonte semantikën në thjesht një vegël për të zbuluar strukturat binare. Vepra e tij bazohet në universalizmin e metaforës, e megjithatë ai e trajton metaforën si një realitet, si një element përbërës të strukturës së trurit dhe jo si një prodhim të fuqishëm të gjuhës.⁵ Shumica e konsiderojnë këtë si një model të keqkuptuar të strukturës linguistike së bashku me një ndarje të mitit nga produkte të

1 Claude Lévi-Strauss, “Histoire et ethnologie,” in *Anthropologie structurale* (Paris: Plon, 1949), 28.

2 Gary Roth, “Claude Lévi-Strauss in Retrospect,” *Dialectical Anthropology*, 18 (1993), 31-42.

3 Terence S. Turner, “On Structure and Entropy: Theoretical Pastiche and the Contradictions of Structuralism,” *Current Anthropology*, 31 (1990), 563-68.

4 Regna Darnell, “The Structuralism of Claude Lévi-Strauss,” *Historiographia Linguistica: International Journal for the History of the Language Science*, 22 (1995), 217-34.

5 Leacock, “Structuralism and Dialectics.”

tjera gjuhësore me të cilat presupozohet të përputhen pikëpamjet mekanistike të Lévi-Strauss-it mbi sistemet sociale.

Në këtë vrashtë kritike ndeshim edhe një mbyetje të çështjes së ritualit. Akuza nga antropologë britanikë si Victor Turner është se përqendrimi ekskluziv mbi simboliken dhe mendimin lë mënjanë realitetin e gjendjes ekstreme të ndjenjave që përjetohen gjatë aktiviteteve sociale si ritualet, të cilat nuk mund thjesht të reduktohen në modalitete të intelektit.¹

Mbi të gjitha, kritikët fokusohen edhe në faktin se duke përcaktuar rolin e vecantë të antropologjisë, Lévi-Strauss nuk përfshin fare proceset sociale si shfrytëzimin, alienimin, ndarjen ekstreme të detyrave të punës, luftën moderne dhe karakterin e shtetit.² Duke marrë parasysh afërsinë me Marksizmin, Lévi-Strauss pritej që të kërkonte për bazat e strukturave universale në cilësinë e jetës materiale, jo vetëm të aktiviteteve ekonomike por në dimensionin e plotë të jetës sociale që përbënte pëlhurën e aktivitetit njerëzor.³ Por duke kontribuar në rimëkëmbjen e antropologjisë Marksiste dhe kritikës letrare, ai në fund i shpërfilli të dyja këto. Dhe pavarësisht pretendimeve të tij për kalimin nga preokupimet infrastrukturore në ato superstrukturore, ai në fakt qortohet që nuk u përfshi në asnjërën nga këto.

Etja e tij për absoluten supozohet t'i shpëtojë realitetit tonë ose, mbase të konsiderojë këtë si një rastësi. Me sa duket, në ciklin e tij *Mitologjikat*⁴ marëdhënia ndërmjet miteve dhe njerëzve që i përdorin ato analizohen shumë rrallë dhe këndvështrimi struktural kritikohet që e konsideron mitin thjesht si një manifestim të logjikës mbështetëse të një sistemi i të cilit bën pjesë, i arritjeve dhe tragjedi, i eksperiencave të përsëritshme me forcat dhe lëvizjet e mahnitshme dhe të frikshme, dhe më pak nga të gjitha me dramën që përbëjnë komunikimin njerëzor. Kompleksiteti magjepsës i gamës së gjerë së kërkimeve të Lévi-Strauss-it në tematikën e miteve thuhet të ketë maskuar faktin që ai ka izoluar dhe ngushtuar seriozisht qëllimin e kësaj pune kërkimore, për sa i përket një teorie të përgjithshme mbi shoqërinë.

Lévi-Strauss-i gjithashtu thuhet të ketë denaturuar mendjen njerëzore duke e reduktuar atë në një makinë për të prodhuar rregulla logjike. Nëse mitet mund të shpjegojnë gjithçka, kritikët pyesin nëse logjika e tyre ka karakter intelektit. Në fakt sipas kritikëve të Lévi-Strauss-it, duket sikur ai flet veçse për çifte të kundërtash dhe transformimin nga një nivel në tjetrin nëpërmjet një qasjeje që duket shumë mekanistike. Procedurat teknike të analizave strukturale që mohojnë domethënien në nivelin e veprimit përfaqësojnë diskutime të miteve nga më intelektualiste dhe abstrakte ndër shkollat e mendimit më gjerësisht. Thuhet se qasja e Lévi-Strauss-it në përgjithësi duket të na çojë më larg dhe jo më në brendësi të çështjeve të raporteve

1 Victor w. Turner, *The Ritual Process: Structure and Anti-Structure, The Lewis Henry Morgan Lectures*, 1966 (Chicago: Aldine, 1969).

2 Diamond, "The Inauthenticity of Anthropology."

3 Roth, "Claude Lévi-Strauss in Retrospect."

4 Claude Lévi-Strauss, *Le Cru et le Cuit* (Paris: Plon, 1968); *Du miel et du cendres* (Paris: Plon, 1966); *L'origine des manieres de table* (Paris: Plon, 1968); *L'homme nu* (Paris: Plon, 1971).

midis mitologjive dhe sistemeve sociale dhe për transformimet e këtyre raporteve ndërkohë që ndryshojnë sistemet sociale.

Për më tepër, për arsye se seksualiteti feminin dhe dëshirat e grave janë të shpërfillura nga teoria e tij e farefisnisë, Lévi-Strauss-i u përball me shumë kritika nga feministet amerikane të cilat filluan të fitojnë popullaritet në antropologji në vitet 1970. Në veçanti kapitulli i Gayle Rubin-it u shndërrua në një kritikë klasike feministe e qendrimit strukturalist, dhe e paraqiste kontributin e Lévi-Strauss-it në tërësi si reaksionar.¹ Më tej, ndërsa në vitet 1970 feministet e konsideronin *Strukturat Elementare të Farefisnisë*² si një trajtim të seksizmit, ai konsiderohet edhe si homofobik nga lëvizjet e mëvonshme për të drejtat e homoseksualëve për t'u martuar dhe për pasur fëmijë.³

Sado detaje mund të ketë trajtuar Lévi-Strauss-i në kornizën e tij analitike, forcat motivuese pas këtij procesi mbeten të pakuptueshme dhe procedurat e tij arbitrare, edhe pse nganjëherë shumë sqaruese.⁴ Edhe *Tristes Tropiques*⁵ janë kritikuar shumë nga teoristët e studimeve kulturore për pothuajse gjithçka, që nga racizmi deri tek një thjeshtëzim i tropeve të udhëtimit dhe të punës në terren!⁶ Disa autorë si Jack Goody-i apo Jacques Derrida-ja akuzojnë Lévi-Strauss-in për përdorimin e kategorizimeve etnocentrike,⁷ por padia e racizmit është thjesht e pavënd. Një ekzaminim i plotë dhe rivlerësim i të gjitha kritikave të Lévi-Strauss-it është e pamundur në këtë artikull. Gjithsesi, duhet thënë se stili parodik dhe potpuri është goxha popullor ndër kritikuesit e Lévi-Strauss-it.

Antropologu si hero

Duket se aktualisht ka një keqkuptim total të qendrimit të Lévi-Strauss-it në antropologjinë bashkëkohore amerikane, ku e thënë troç, ai duket të jetë pranë mospërfilljes pasi shumica e antropologëve praktikanë nuk e ndejnë veten aspak të influencuar nga kjo qasje. Më së shumti, Lévi-Strauss-i lexohet në kontekstin e historisë së antropologjisë dhe aty ai shpesh herë hidhet

1 Gayle Rubin, "The Traffic in women: Notes on the Political Economy of Sex," in *Toëard an Anthropology of Women*, ed. Rayna Reiter (New York: Monthly Revieë Press, 1975), 157-210.

2 Claude Lévi-Strauss, *Les structures elementaires de la parente* (Paris: Mouton, 1967)

3 Jeanne Favret-Saada, "La pensee Lévi-Strauss," *Journal des Anthropologues*, 82-83 (2000), 53-70; Patrice Maniglier, "L'humanisme interminable de Claude Lévi-Strauss," *Les Temps Modernes*, 609 (2000), 216-41.

4 Jeanne Favret-Saada, "La pensee Lévi-Strauss," *Journal des Anthropologues*, 82-83 (2000), 53-70; Patrice Maniglier, "L'humanisme interminable de Claude Lévi-Strauss," *Les Temps Modernes*, 609 (2000), 216-41.

5 Lévi-Strauss, *Tristes Tropique*.

6 James Clifford, *Routes: Travel and Translation in the Late Tëentieth Century* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1997).

7 Jack Goody, *The Domestication of the Savage Mind* (Cambridge: Cambridge University Press, 1977); Jacques Derrida, de la grammatologie.

poshtë, kjo, për ironi, pikërisht për atë arsye për të cilën ai duhet lavdëruar. Me fjalë të tjera, ai kritikohet për insistimin e tij në rigorozitetin shkencor, thjesht pasi ky koncept fatkeqësisht është i huaj për shumë antropologë amerikanë. Rezultati i kësaj situatë është më pak një kritikë e vazhdueshme e Lévi-Strauss-it sesa një neglizhim i shkujdesur. Thënë më troç, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britani sot shpesh studentët pasuniversitarë të antropologjisë nuk lexojnë fare nga Levi-Strauss-i. Ai pothuajse nuk përmendet fare në seminare e leksione, gjë që është një veprim tragjik dhe dritëshkurtër për fushën e antropologjisë. Më tej, më dramatikja është se shumica e antropologëve amerikanë gjatë tre dekadave të kaluara as që mendojnë se Lévi-Strauss-i është aq i rëndësishëm sa për argumentuar me të. Shumë shkurt ai shpërfilllet në praktikën e përditshme të lëndës që në përgjithësi ka përqafuar postmodernizmin.

“Tropetë e trishta” të postmodernëve kanë parë empiricizmin dhe historicizmin si një problem të sinqertë dhe të mirënjohur, kryesisht nëpërmjet një qëndrimi shpërfillës ndaj analizës shkencore dhe një përvetësimi jo-kritik të kritikës letrare.¹ Nuk është e habitshme që në këto kushte teoritë e Derrida-së kanë kapur sidomos departamentet e letërsisë së Amerikës Veriore. “Dekonstruktimi” i tij i transplantuar përtej Atlantikut nga një grup kërkimesh filozofike evropiane dhe praktikuar mbi terrenin e komenteve letrare amerikane, po fillon të duket sa vjen e më amerikan sesa francez. Edhe në Evropë shpesh kjo perceptohet si një grup teoremash amerikane, një diskurs apo një shkollë që sa vjen e njihet si një shpikje amerikane. Kjo, gjithsesi, nuk nënkupton vetëm se dekonstruksioni është thjesht një “diçka” amerikane, por për më tepër se vetëm në Amerikë ky lloj dekonstruksioni kuptohet si “diçka”. Me fjalë të tjera, nuk është se vetëm në Amerikë ekziston diçka si dekonstruksioni, por se vetë Amerika është dekonstruksioni i Evropës.²

Nuk është çudi atëhere që ekzistojnë dhe që do të ketë një numër në rritje të studiuesve, të cilët kanë zgjedhur drejtime të tjera dhe që punën e tyre e kryejnë pa marrë parasysh përfundimet e Lévi-Strauss-it në kontekstin e zhvillimeve të reja në antropologji në mbarë botën. Por kjo nuk vë në pikëpyetje vlerën e tij bashkëkohore dhe rëndësinë e tij të veçantë për të ardhmen, as nuk i jep kjo shpjegim trajektore negative që ka marrë reputacioni i Lévi-Strauss-it sidomos në antropologjinë kulturore amerikane. Shumica e antropologëve janë të pakënaqur me këtë situatë dhe teoria e Lévi-Strauss-it në fakt është pritur në antropologji me më shumë kujdes dhe padyshim në kontrast me reagimet kritike që tekstet e para të antropologjisë strukturale i shkaktuan një sërë recensuesve, më të gatshëm për të hedhur poshtë presupozimet e tyre filozofike sesa të gjykonin impaktin e tyre në fushën e antropologjisë, të cilën nuk e mbizotëronte asnjëri prej tyre.

1 Nicole Polier and Éilliam Roseberry, “Tristes tropes: Post-modern Anthropologists Encounter the Other and Discover Themselves,” *Economy and Society*, 18 (1989). 245-64.

2 Anselm Haverkamo (ed.), *Deconstruction is/in America* (New York: New York University Press, 1995), 28. Anselm Haverkamo (ed.), *Deconstruction is/in America* (New York: New York University Press, 1995), 28.

Lévi-Strauss ishte vërtet një eksplorues që kërkonte rrugën e tij në një ambient të ri: një botë e re e mitit dhe imagjinatës. Në këtë aspekt, puna e tij kishte të bënte me analizën e përmbajtjes së miteve si dhe të proceseve mendore që i mundësonin ato. Për arsye se këto përmbajtje mitike dhe procese mendore kishin qenë tematika studimi të interpretimeve alegorike Frazeriane apo spekulimeve Frojddjane, shkrimet e Lévi-Strauss-it fituan një rëndësi përtej botës imediate të kërkimit antropologjik. Letrarë, psikologë, historianë, dhe filozofë u ndjenë të detyruar të ballafaqoheshin me pikëpamjet radikale të Lévi-Strauss-it, por fakti që shumica e këtyre dishepujve dinin pak për teknikalishtet e sistemeve farefisnore, ekzigjencat e xhunglës në Brazil, apo debatet rreth organizimit dualist si dhe çështje të tjera të ngjashme bëri që Lévi-Strauss-i vetë të shndërrohej në një figurë mitike.

Për shumë veta, teoritë e Lévi-Strauss-it janë ende shumë “intelektualiste” dhe pengojnë të kuptohet mrekullia e veprimit dhe praktikës njerëzore. Por kjo kritikë është njësoj sikur dikush të ngrihej kundër teorisë kinetike të gazrave nën pretekstin se duke shpjeguar pse ajri i nxehtë hollohet dhe shkon lart, vihet në rrezik jeta e familjes dhe morali i vatrës, ngrohtësia e së cilës do të humbiste rezonancën e saj simbolike dhe emocionale. Ose, me një shembull tjetër, sikur fakti i njohjes sesi punon ora nga brenda do të na pengonte të kuptonim se çfarë roli mund të luante ora në jetën emocionale personale, ose nëse formula kimike e sheqerit do të na privonte nga shijimi i shijes së tij dhe, përkundrazi, do të na bënte të preferonim një shije të kripur në vend të së ëmbëlës.

Shpirtrat sensibël refuzojnë të kuptojnë se nuk janë emocionet ato që prodhojnë kulturën, por e kundërta, ashtu sikurse muzika është një kombinim matematik me valë të ndryshme që krijon emocione rezultat i të cilave nuk është. Me insistimin e tij mbi ndarjen e mprehtë midis ndërgjegjes individuale dhe asaj kolektive, Durkheim-i nuk arriti t'i japë theksin e duhur mundësisë për të kuptuar tërësisht faktet sociale. Kjo korrespondoi, sipas Lévi-Strauss-it me një të metë të shkencës sipas së cilës tiparet subjektive janë lënë në një anë ndërkohë që ne kërkojmë shpjegime në forma tërësisht objektive. Me konceptin e tij të “fakteve sociale totale”, Mauss-i nënkuptoi se në të kundërt kjo dikotomi e thjeshtë dhe e volitshme është e papranueshme për sociologjinë:

“Në mënyrë që të kuptojmë një fakt social total është e nevojshme ta kuptojmë atë totalisht, pra nga pikpamja e jashtme si një dicka, por si një dicka pjesë integrale e së cilës është botëkuptimi subjektiv, njëkohësisht i ndërgjegjshëm dhe pandërgjegjshëm që kemi për atë sikurse për të kuptuar të qenurit njeri ne duhet ta jetojmë këtë fakt ashtu sikurse e jeton një indigjenas, në vend që ta vëzhgojmë atë si etnografë.”¹

1 Claude Lévi-Strauss, “Introduction a l'oeuvre de Marcel Mauss,” in Marcel Mauss, *Sociologie et Anthropologie* (Paris: Presses Universitaires de France, 1950), xxviii.

Ashtu sikurse ideali i një kimie totale e cila “duhet të shpjegojë jo vetëm formën dhe shpërndarjen e molekulave të një luleshtrydheje, por sesi shija e veçantë rezulton nga kjo formë,” Lévi-Strauss-i është përpjekur t’i mari gjërat seriozisht, duke i treguar vetes që ato janë objekte që kërkojnë analizë të gjatë dhe shumë të duruar.¹ Miti, për shembull, është një realitet *sui generis* që mund dhe duhet të studiohet në vetvete, pa iu referuar një konteksti të caktuar, qoftë ky historik, psikologjik apo sociologjik. Mitet ‘janë ushtrimi i mendjes së egër; uniteti i tyre i brendshëm dhe logjika e tyre koherente nuk ndodhen në anën e ngjashmërisë apo të referencës.”²

Interpretimi teorik i Lévi-Strauss-it, bazuar në zbardhjen e veprimeve të mendjes njerëzore, realizoi një raport midis natyrës dhe kulturës, sidomos në studimin e sistemeve të farefisnisë dhe të prodhimit të miteve. Originaliteti i tij qëndronte tek sfida që ai i bëri dilemës së kundërvënies konceptuale të papërputhshme të natyrës njerëzore dhe kulturës, ku ai u përpoq të tregojë se njëra mbështet tjetrën në të njëjtën mënyrë që një strukturë abstrakte dhe homogjene kontrollon manifestime konkrete dhe të ndryshme. Ky parim nuk është i ri, por është mbajtur rezervë nga antropologjia filozofike tradicionale, por njohuria etnografike moderne e ka vënë në pikëpyetje. Lévi-Strauss-i kishte marrë përsipër një detyrë: t’i rikthehej këtij parimi dhe të sfidonte empiricizmin etnografik duke u munduar njëkohësisht të identifikonte ligje të mendjes njerëzore që shprehen nëpërmjet fushave si farefisnia, miti, arti, dhe format “primitive” të klasifikimit, pra për të shpjeguar më së miri karakteristikat kulturore dhe për të vendosur bashkimin intelektual të njerëzimit.

Kritika në përgjithësi i jepte Lévi-Strauss-it mundësi për të ngulmuar në bindjen e tij se shkencat sociale dhe antropologjia, duke ndjekur metodologjinë e shkencave natyrore, duhet të kuptojnë se realiteti i objektit të tyre të studimit nuk është plotësisht i kapshëm nga syri vëzhgues. Kjo është e qartë sidomos në “finalen” e ciklit “Mitologjike”, që mund të shihet si mbrojtje e zgjatur e metodës strukturale. Në përpjekjen e tij për të qartësuar divergjencat e tij nga filozofët e të njëjtit subjekt ai predikonte një humanizëm të përcaktuar më pak nga kultura e një momenti të caktuar historik dhe konfirmoi, kundër kritikës marksiste, besnikërinë e tij ndaj Marksit dhe shpirtit dialektik të materializmit historik. I edukuar si filozof, ai në të vërtetë nuk e abandonoi asnjëherë filozofinë, pavarësisht protestave të tij për të kundërtën, dhe shkroi kritika të rëndësishme të ekzistencializmit dhe fenomenologjisë. Në retrospektivë duket qartë natyra dhe masa e sfidës së antropologjisë së Lévi-Strauss-it ndaj filozofisë. Kritikat e shumëllojshme të ngritura kundër strukturalizmit, reduksionizmit të tij, antihumanizmit të tij, dhe anti-historicizmit të tij, të gjitha janë të kundërshtuara, të riformuluara dhe të kthyera sërish si kritikë ndaj filozofisë për: mungesën e njohurisë shkencore, etnocentrizmin dhe antropocentrizmin e saj dhe obsesionit të saj me historinë.

Siç na kujtonte edhe Leach-i, rëndësia e Lévi-Strauss-it qëndronte në mënyrën e ligjërimit që kishte krijuar për të shpalosur fakte dhe mënyra shpjegimi dhe idesh, duke sugjeruar gjithmonë mënyra të pazakonta për të shikuar fakte shumë të zakonata,

1 Claude Lévi-Strauss, *ibid.*, xxvii.

2 Marcel Henaff, Claude Lévi-Strauss et l’anthropologie structurale (Paris: Belfond, 1991), 171.

dhe kështu provokonte mendimin mbi bazat e dijes.¹ Në një kapitull të mahnitshëm mbi “totemin dhe kastën,” për shembull, Lévi-Strauss-i vendos të tregojë se struktura e sistemit të kastës në Indi është një transformim logjik i strukturës së rregullit totemik të indigjenasve australianë.² “Fishekzjarre intelektuale” e këtij lloji, sipas Leach-it, vetvetiu nuk na zgjerojnë botëkuptimin tonë të rregullit të kastës apo të totemizmit australian, por ato na ftojnë të mendojmë më thellë mbi shoqërinë njerëzore dhe për atë çka është në veçanti më njerëzore.³ Sipas pikëpamjes së Lévi-Strauss-it është më e rëndësishme të kuptosh dallimin midis kulturës dhe natyrës sesa të merresh me argumenta skolastikë si për shembull, sesi despotizmi oriental ka ngjashmëri me feudalizmin në çfarëdo sekuence të determinizmit historik.

Me konstatimin e tij se satisfaksioni mendor është produkt i gjërave “të mira për t’u menduar,”⁴ ai e çoi antropologjinë drejt një metode më formale dhe më shkencore, dhe pa dashje ndezi një entuziazëm intelektual që përshkoi pothuajse tërë shkencat sociale dhe filologjike dhe u bë, në fjalët e Susan Sontag-ut, antropologu i parë hero.⁵ Por nuk është vetëm kërkimi formalist për çiftet e kundërta që është me të vërtetë i vlefshëm ashtu sikurse nuk janë faktet e çuditshme apo shpjegimet akoma më të çuditshme që ka sjellë Lévi-Strauss-i dhe që e bëjnë atë një hero intelektual. Sipas Clifford Geertz-it, asnjë antropolog nuk ka qenë më insistues sesa Lévi-Strauss-i në faktin se “praktika e profesionit të tij përbëhet nga një kërkim personal i drejtuar nga një vizion personal dhe që synon shëlbimin personal.”⁶ Në formën e mitit standard profetik të një kërkimi heroik me antropologun si hero, sipas Richard Shweder-it, Lévi-Strauss-i e shndërroi ekspeditën e tij në brendësinë e virgjër të Amazonës në një kërkim vizioni dhe e shndërroi antropologjinë në një mision shpirtëror për të mbrojtur njerëzimin kundër vetvetes.

Për këtë arsye Lévi-Strauss-i admirohet jo dhe aq shumë për idetë e reja sesa për origjinalitetin e guximshëm me të cilin i aplikoi ai ato në një gamë të gjerë lidhjesh. Ky kompleksiteti shfaqet si diçka që nxjerr shumë gjëra në dritë në vend që të krijojë konfuzion. Është organizimi i ideve të Lévi-Strauss-it që krijon faktet “si një ciklotron që krijon pjesëzat përbërëse të atomit.”⁷ Pa dyshim që ai do të kujtohet për shumë gjëra, përfshi këtu edhe aftësitë e tij si një punues kërkimor shumë i kujdesshëm, që i zotëronte detajet në mënyrë të paprecedent, dhe si një studiues, i cili nuk përtoi asnjëherë t’u përgjigjej kritikëve dhe, i cili herë herë korrigjonte idetë e tija kur e ndiente se kritika ishte serioze dhe e fuqishme. Sidoqoftë, vepra e Lévi-Strauss-it është përfundimisht e çuditshme dhe më shmangëse sesa duket. E rrënjosur në racionalizëm ajo është ndërtuar mbi një Rusoizëm paradoksal, por e gjallëruar nga një ironi e mugët e një

1 Leach, *Claude Lévi-Strauss*.

2 Claude Lévi-Strauss, *La pensée sauvage* (Paris: Plon, 1962), 144-77.

3 Leach, “Telstar et les aborigènes ou la Pensée sauvage,” 111.

4 Claude Lévi-Strauss, *Le totemisme aujourd’hui* (Paris: Presse Universitaires de France, 1962), 132.

5 Nelson E. Hayes and Tanya Hayes (eds.), *Claude Lévi-Strauss: The Anthropologist as Hero* (Cambridge, Mass: Massachusetts Institute of Technology Press, 1970).

6 Geertz, *The Interpretation of Cultures*, 346.

7 Diamond, “The Inauthenticity of Anthropology.”

“pesimizmi aktiv.” Ndërsa të tremb me forcën e tij radikale, të mahnit me delikatesën e mënyrës së tij të të bërit të gjërave dhe të pushton me mendjemprehtësinë me të cilën imponon logjikën e tij. Shkruar për të të bërë për vete, vepra e Lévi-Strauss-it është padyshim bazuar në rigorozitetin e paqortueshëm shkencor dhe akademik. Në të njëjtën kohë, ajo shprehet në një prozë evokuese, poetike dhe të kulluar në kalimet e saj më të vështira, e lëkundshme dhe e lehtë edhe në rrugën e saj më lineare dhe të përcaktuar. Është plot me shije të ndryshme, ndjenja shumëngjyrëshe, thurur me kënaqësitë e të shkruarit dhe sa vjen e më e frymëzur nga një prezencë e rëndësishme.

Recencë e kërkimi i legjitimitetit dhe venitja e utopisë nga Fatos Tarifa

Blendi Kajsio

Çdo libër ka kohën e tij. Ndoshta kjo është një nga ato klishetë prej të cilave nuk shpëton dot as libri “Kërkimi i Legjitimitetit dhe Venitja e Utopisë” i Fatos Tarifës. Ky libër që në mënyrë mjeshtërore ndriçon legjitimitetin e të ashtëquajturit *socializëm real* në Evropën Lindore është sot më shumë se kurrë në kohën e duhur. Tashmë që po mbushen pothuajse dy dekada nga transformimet epokale që ndodhën në Evropën Lindore është më e lehtë që regjimet që ato përmbysën të analizohen në mënyrë më të ftohtë, më të logjikshme dhe racionale. Vitet e para pas përmbysjes së regjimeve komuniste në Evropën Lindore u shoqëruan nga një triumfalizëm politik që i zhveshi nga çdo lloj kompleksiteti social. Ato u kthyen thjesht në të kundërtën e demokracisë, lirisë, legjitimitetit dhe zhvillimit që shpresohet se do të arrihej me përmbysjen e tyre. Kështu këto regjime u kthyen në një periudhë homogjene, të errët, pa histori, pa liri dhe pa legjitimitet. Ato u reduktuan thjesht tek zgjedhja që perandoria e keqe Sovjetike, ose një grusht diktatorësh lokalë, u kish imponuar popujve të mirë të Evropës Lindore. Për pasojë edhe vetë Lindja u trajtua shpesh, jo vetëm në politikën por edhe në akademinë e Perëndimit si një entitet ahistorik dhe homogjen, duke injoruar kështu jo vetëm diferencat mes vendeve të ndryshme, por edhe ndryshimet historike të një vendi të caktuar në periudha të ndryshme.

Në librin e tij Fatos Tarifa arrin që në mënyrë bindëse dhe sistematike të hedhë poshtë këtë kuadër semplist duke analizuar legjitimitetin e regjimeve socialiste në Evropën Lindore si në kohë ashtu edhe në hapësirë. Në këtë mënyrë Tarifa sjell në vëmendjen e kërkimit shkencor rreth ish-kampit lindor konceptin e neglizhuar të legjitimitetit. Këtu libri i Tarifës shënon një arritje të dyfishtë. Së pari, nëpërmjet konceptit të legjitimitetit ai arrin që të rrëzojë konceptimin e Lindjes si një entitet ahistorik dhe homogjen. Duke u fokusuar tek legjitimiteti Tarifa arrin të tregojë se Lindja nuk ishte një hapësirë homogjene pasi regjimet në fuqi kishin mbështetje dhe legjitimitet të ndryshëm në vende të ndryshme. Duke analizuar luhatjet e legjitimitetit

përgjatë historisë së këtyre regjimeve Tarifa nxjerr në pah edhe dinamikën historike të Lindjes duke hedhur poshtë konceptimin e saj si entitet ahistorik. Por e gjitha kjo nuk do të kish qenë e mundur në mungesë të një shtjellimi dhe aplikimi rigoroz të konceptit të legjitimitetit në hapësirën gjeografike dhe historike të Evropës Qëndrore dhe Lindore. Dhe kjo është arritja e dytë madhore e Tarifës në këtë libër. Kjo arritje e dytë është e dyfishtë në vetvete pasi jo vetëm që Tarifa arrin ta shtjellojë qartë konceptin tejet kompleks të legjitimitetit në dimensionin e tij teorik, por arrin që këtë koncept ta aplikojë me sukses në analizën konkrete të regjimeve socialiste në Evropën Qëndrore dhe Lindore.

Pikërisht për këtë arsye ndonëse libri trajton një temë komplekse si legjitimiteti, dhe për më tepër të shtrirë në kohë dhe hapësirë, ai është lehtësisht i lexueshëm dhe mjaft bindës. “Në Kërkim të Legjitimitetit dhe Venitja e Utopisë” është një nga ata libra akademik që studiuesi jo vetëm e lexon ‘me një frymë’ por ndjen edhe një farë trishtimi kur libri mbaron duke i dhënë fund një kënaqësie të veçantë intelektuale. Në studimin e tij Tarifa ka arritur që lexuesi të thjeshtojë dhe qartësojë fenomenin kompleks të legjitimitetit dhe realitetin e koklavitur të Evropës Qëndrore dhe Lindore por pa banalizuar as njërin dhe as tjetrin. Prandaj libri i Tarifës është një arritje akademike që na ndihmon, si qytetarë, studiues apo intelektualë të kuptojmë më mirë dinamikën politike dhe sociale të një të kaluarë së cilës i përkasim.

Në këtë aspekt libri “Kërkimi i Legjitimitetit dhe Venitja e Utopisë” është një nga ata libra të rrallë ku e ashtëquajtura Lindje arrin të hedhë një vështrim të qartë mbi vetveten. Është e rëndësishme të theksohet këtu që Lindja si kategori konceptuale, politike dhe sociale është krijuar kryesisht nëpërmjet vështrimit perëndimor. Janë librat, kërkimet shkencore, botimet dhe autorët perëndimorë në përgjithësi ata që e kanë përshkruar dhe analizuar Lindjen komuniste. Libri i Tarifës është një arritje për t’u vlerësuar në fushën e studimit të ish-Lindjes komuniste pasi për nga cilësia jo vetëm që mund të krahasohet por edhe mund të tejkalojë disa nga veprat më të mira dhe më të njohura të autorëve perëndimorë të fushës. Kjo ndodh edhe për faktin që Tarifa si autor ofron një kombinim të mjeshtërisë analitike dhe konceptuale me eksperiencën personale në regjimin komunist që i mungon shumë autorëve perëndimorë. Në këtë mënyrë libri i Tarifës, që fatmirësisht është i botuar edhe në anglisht, i shërben edhe pasurimit të fushës së studimeve të ish-Lindjes komuniste.

Prandaj libri “Në Kërkim të Legjitimitetit dhe Venitja e Utopisë” është një arritje akademike jo vetëm për Tarifën në veçanti por edhe për shkencat sociale shqiptare në përgjithësi. Ky libër futet në një kolanë botimesh shkencore mbi të cilat mund dhe duhet të ndërtohet më tej kërkimi shkencave sociale shqiptare. Studentit dhe studiuesit shqiptar libri i Tarifës minimalisht mund t’i shërbejë si një model i përkryer për kërkimin shkencor. Prandaj ky libër mund dhe duhet të përdoret gjerësisht në universitetet shqiptare, por jo vetëm si një model i kërkimit të suksesshëm akademik. Ai mund të shërbejë shumë lehtë edhe si një themel apo pikënisje që mund të ndriçojë dhe të stimulojë kërkime të mëtejshme në fushën e legjitimitetit të regjimit komunist shqiptar. Ndonëse libri i Tarifës analizon Evropën Qëndrore dhe Lindore

në përgjithësi ai ka një relevancë të drejtëpërdrejtë për ish regjimin komunist shqiptar. Si koncepti i legjitimitetit ashtu edhe analiza historike që zhvillon Tarifa mund të përdoren shumë mirë për të ndriçuar jo vetëm të kaluarën tonë 'komuniste' por edhe të tashmen 'demokratike', si dhe për të hedhur poshtë disa nga mitet apo klishetë nëpërmjet të cilave shpjegohet e kaluara dhe e tashmja jonë.

Le të marrim si shembull trajtimin që Tarifa i bën konceptit të legjitimitetit nëpërmjet të cilit e justifikonin ekzistencën e tyre shumë prej regjimeve socialiste. Sipas Tarifës:

“Një racionalitet i tillë substancial (racionalitet ose efçencë në arritjen e qëllimeve të përcaktuara në mënyrë substanciale), i cili nuk haset në racionalitetin formal që nënkupton tipi racional-legal i Weber-it për autoritetin legjitim, ka qenë një ndër bazat kryesore të pretendimeve legjitimuese në të gjitha shtetet socialiste”. (faqe 64)

Pra sipas Tarifës legjitimiteti i shumë vendeve socialiste bazohet mbi një racionalitet instrumental që e justifikonte komunizmin nëpërmjet produkteve të tij. Në një farë kuptimi ky është një racionalitet makiavelist që nënkupton se qëllimi justifikon mjetet; lufta e klasave, persekutimi, dhe ekzekutimet politike sado të dhimbshme justifikoheshin si një e keqe e domosdoshme që duhej kaluar për të krijuar botën e re, pa klasa, shfrytëzim dhe varfëri. Ajo që është interesante është fakti që të paktën në rastin e Shqipërisë racionaliteti instrumental, përkundër atij Weberian proceduralo – formal, përcaktoi edhe legjitimitetin e rendit të ri kapitalist. Kapitalizmi dhe ekonomia e tregut u përqaftuan me shumë zell jo për ndonjë vlerë që ato kishin në vetvete por sepse ato shikoheshin si instrumentet më të suksesshme në arritjen e objektivave si zhvillimi ekonomik dhe konsumi i të mirave materiale. Në këtë aspekt si racionaliteti ashtu edhe legjitimiteti i regjimit të ri 'kapitalist' bazoheshin në një llogjikë të ngjashme me atë të regjimit që u përmbys. Kjo mund të shpjegojë se përse regjimi i ri i ngjante aq shumë regjimit të vjetër si në aksion ashtu edhe në artikulum. Kështu duke u nxitur dhe nisur nga libri i Tarifës do të ishte me interes për studiuesit shqiptar që të analizonin paralelet që mund të ekzistojnë mes procesit të ndërtimit të kapitalizmit në fillim të tranzicionit me procesin e ndërtimit të socializmit përpara fillimit të tranzicionit.

Duke analizuar të kaluarën tonë 'socialiste' libri i Tarifës na shërben mjaft mirë për të kuptuar edhe të tashmen tonë 'demokratike'. Kështu analiza që Tarifa i bën krizës së regjimit komunist shqiptar hedh shumë dritë në krizën që po kalon sot sistemi ynë demokratik. Tarifa na thotë se në vitet 1970-të dhe 1980-të korrupsioni moral dhe politik prekte kuadro të ndryshëm teksa besimi në idealet e komunizmit venitej. Ky është një proces që na kujton rritjen e korrupsionit në sistemin tonë aktual teksa idealet e elitës politike dhe besimi i popullatës tek institucionet demokratike venitet. Por është akoma më interesante të shohim mënyrën se si Tarifa e shpjegon legjitimitetin e sistemit komunist shqiptar përballë venitjes së idealeve dhe utopisë komuniste:

“Mbështetur në përvojën time morale dhe intelektuale në kushtet e sistemit të socializmit shtetëror, unë e shoh legjitimitetin e sundimit të partisë-shtet dhe të udhëheqësve të saj në Shqipërinë e viteve 1970-të dhe 1980-të si të bazuar pjesërisht mbi “argumente” negative se sa në ato pozitive. Koha e “arritjeve spektakolare” kishte përfunduar”. (faqe 97)

Një fenomen i tillë ka ndodhur dhe ndodh rëndom gjatë vetë tranzicionit shqiptar. Argumentimi negativ apo ‘anti’ është ndoshta një nga karakteristikat më të qenësishme të skenës sonë politike edhe sot; anti-komunizmi, anti-berishizmi, anti-korrupsioni, anti-politika, janë ligjërimet dominuese në skenën tonë politike edhe sot. Pra edhe sot kemi një fenomen të ngjashëm ku sa më shumë delegjitimohen institucionet dhe elitat politike aq më shumë ato e ndërtojnë legjitimitetin mbi një argumentim negativ. Për këtë arsye shtjellimi i legjitimitetit të djeshëm të regjimit komunist nga Tarifa na ndriçon edhe ne sot për të kuptuar se si sendërtohet legjitimiteti i regjimit të sotëm, ndonëse në kushte mjaft të ndryshme. Prandaj libri i Tarifës mund dhe duhet të shërbejë si një pikënisje apo të frymëzojë të gjithë ata studiues shqiptarë që dëshirojnë ta njohin më mirë të kaluarën dhe të tashmen tonë.

Së fundmi, jam i bindur se ky libër do t’i shërbejë gjithashtu edhe brezit të ri që sot ne shkollojmë në universitetet tona. Ky brez në rastin më të keq nuk ka aspak njohuri për të kaluarën tonë komuniste. Në rastin më të mirë e njeh regjimin komunist thjesht si një periudhë të errët ku për pesëdhjetë vite populli shqiptar ka vuajtur në zgjedhën e diktaturës komuniste. “Zgjedha”, një instrument blegtoral, është në fakt koncepti më i përdorur analitik jo vetëm në shpjegimin e të kaluarës sonë komuniste por edhe të asaj otomane. Me librin e Tarifës “*Në Kërkim të Legjitimitetit dhe Venitaja e Utopisë*” studentëve u jepet një aparat konceptual dhe analizë mjaft e sofistikuar që i shërben jo vetëm për të kuptuar më mirë regjimin komunist shqiptar dje por edhe sistemin tonë demokratik sot. Prandaj libri i Tarifës është një lajm i mirë për akademikët, intelektualët, studiuesit, studentët dhe lexuesit shqiptarë. Ai është gjithashtu në kohën e duhur, edhe pse librave të tillë gjithmonë i vjen koha pavarësisht se kur botohen.

ABSTRACTS

Fatos Tarifa

Abstract. In light of recent international developments, which precipitated in the September 11 tragic events and the onset of the war in Iraq in the spring of 2003, it is of interest to analyse the structure of the current system of international relations as well as the role of the great powers in this system. Focusing on the structure of the present global system and contextualizing the treatment of this issue historically and geopolitically, the following analysis aims to help better understand the dynamics of present international relations as well as the nature of the global system that will characterize the 21st century.

Antoine Heemeryck

Abstract. This article tries to shed light the limitations of democratisation through the prescription of global norms by focusing on Romania. First of all, the article aims to show some salient aspects of the notion of governance and transparency as it is prescribed from the international level to the post-communist countries. Then, the result of a monitoring operation about a law on transparency realized by an NGO is analysed and then it is compared to an affair of corruption concerning the government. In this way the limits and the consequences of this policy (democratisation) for the actors such as NGO, the state and political parties, appear more clearly. In the same way as the political technology of democratisation, the quest for ‘transparency’ is more oriented towards inter-national standardisation and legitimation than towards local problems.

Dr. Kurt Gostentschnigg

Abstract. The relative economic backwardness of Austria-Hungary in comparison with the western industrial countries and the inner economical structural crises were the reasons for its concentration of commercial and transport policy towards Southeast Europe. Since the Congress of Berlin in 1878 Austria-Hungary competed with Italy for the control over the sea and overland routes to secure the commercial and strategic hegemony in the western Balkans. In this context the Albanian territories had a crucial importance. The means to reach this aim were the shipping line “Lloyd”, the trade

by the port of Trieste, the agitation of the Austrian “Albania-committee”, assisted by the foreign ministry, and the hostel for Albanian students in Vienna, aided by the ministries of foreign affairs and commerce. Austria-Hungary played an important role for the independence of Albania, but it also aimed to have a growing political, cultural and economical influence in the little country in its southern periphery through an informal imperialism based on structural violence.

Aurora Guxolli

Abstract. This essay is based on the assumption that globalisation is an irreversible process. Taking for granted the contradictory impact of globalisation on democracy and human rights compared with the promised results, this essay searches for a way of improving the impact of globalisation on these two phenomena and consequently on the social welfare. Globalisation and democracy are interrelated in such a way that even though global transformations take place on a democratic terrain, they cross the national borders. This is where the contradiction between these two phenomena appears, embodied in the uncertainty of accountability, *who has to respond to who*. International integration has positively influenced human rights, facilitating the initiation of human rights movements that not only raise awareness but that also take real protective measures as well. Nevertheless, the absence of a consolidated system of global governing with no global government has negatively influenced development, especially the development of currently globalising and developing countries. These indicators support the idea of reciprocal dependency of the nation-state and international actors in all the aspects of global order. Instead of invalidating either the concept of nation-states or the global order, or globalisation itself, cosmopolitan democracy can offer a new political system that will harmonise these three phenomena.

Prof. Dr. Paskal Milo

Abstract. The history of Albanian-German relations is much older than the 20 years of our contemporary history. This paper is a first attempt to view these relations from a historic perspective. I am aware that this paper will be incomplete since the events covered here are still quite recent in historical terms, and the historian feels more confident and better informed in his profession, like a good wine taster does, when events and documents are judged from a sufficient distance of time. It is my privilege to bring these unpublished Albanian documentary sources of the high communist nomenclature, as well as of the Albanian policymaking institutions of the last 15 years. However a better understanding of Albanian-German relations of the last 20 years needs to be completed by German sources. I hope that in the future this insufficiency will be filled with the contribution of German researchers of Albanian issues.

Klodiana Beshku

Abstract. During the last twenty years, the Western Balkans has been the terrain of interstate and intrastate conflicts while the area is still considered partially instable by the collective image of peoples and politicians of the western EU countries. This article, through a description of the historic and institutional past of this territory, tries to shed light on the similarities and differences that characterise the countries having emerged from ex-Yugoslavia as well as on the economic and social factors that influenced the relatively non-consolidated democratic culture in these countries. This quick historic panorama emphasises some moments that constitute the foundations of ethnic conflicts and old animosities in the Western Balkans. It also introduces the idea of a broader regional collaboration with the aim of healing the wounds of the past.

Enri Hide

Abstract. The war between Russia and Georgia of August 2008 discloses two aspects of Russian foreign policy: Russian political goals in the ex-soviet space, closely related to the perpetual Russian geopolitical vision throughout the 20th century, one of Russia's dominance on the so-called "vital space of Russian security"; as well as the broader international context: the way post-soviet Russia considers herself within the international system, particularly in her relations with the western alliance. The following essay will focus on examining these two conceptual pillars of Russian foreign policy. This article will continuously combine global geo-strategy with empiric observation. It will combine these two basic parameters of the analysis of international relations for producing a realistic and concrete approach with the aim of seeing the world as it is rather than as it should be.

Donatos Papagiani

Abstract. This essay explores the need for a new strategy through which the European Union should approach its process of expansion, especially after the French and Dutch referenda. This is an important moment that directly affects the membership efforts of the countries in the Western Balkans. The main argument that this article puts forth is that the EU needs a new expansion strategy, more in tune with the new internal and external realities that it faces. To this end a number of creative reforms should be undertaken so as to rekindle the enthusiasm with regard to the European project. This is a major challenge especially today when the agreement for a new European Constitution has failed.

Albert Doja

Abstract. This article develops Claude Lévi-Strauss's contribution to anthropology. Lévi-Strauss transformed anthropology into a scientific project far more sophisticated than it had been deemed possible and than what the field had achieved before. His contribution represents the re-inclusion of this field into the core of western ideas since he managed, through his language, data, methods, techniques and rare theories, to reformulate anthropology as an intellectual project, as a profession of the intellectuals of the time, instead of simply being a specialized profile. According to Clifford Geertz, no anthropologist has insisted more than Lévi-Strauss that "the practise of his profession consists of a personal quest, directed by a personal vision that aims personal salvation." In the form of standard prophetic myth of a heroic research with the anthropologist as its hero, according to Richard Shweder, Lévi-Strauss transformed his expedition in the virgin interior of the Amazon River into a search for a vision and turned anthropology into a spiritual mission to defend humankind against itself.